



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 2969/ 15 prot.

Datë 06.03.2024

V E N D I M
Nr. 238/2024

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaid Myzyri	Kryetar
Fiorent Zguro	Nënkryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Anila Malaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 06.03.2024 shqyrtoi ankesën me:

Objekt: Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për skualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “Alko Impex General Construction” SHPK në procedurën e prokurimit “Procedurë e Hapur”, me Nr. REF-78915-09-04-2023, me objekt: “Rikonstruksion i Spitalit Rajonal Diber ‘Rrahim Xhika’”, me fond limit 325,049,984 (treqind e njëzet e pesë milionë e dyzetë e nëntë mijë e nëntëqind e tetëdhjetë e katër) lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 25.10.2023, nga autoriteti kontraktor, Drejtoria e Spitalit Rajonal Diber.

Ankimues: Operatori ekonomik “Alko Impex General Construction” SHPK, me NIPT K91326028I, me adresë Rruga “Reshit Petrela”, Kompleksi “Usluga”, Tiranë.

Autoriteti Kontraktor: Drejtoria e Spitalit Rajonal Diber.
Adresa: Rruga “Donika Kastrioti”, Blv “Elez Isufi” Peshkopi.

Subjekt i interesuar: BOE “Rafin Company” SHPK & “UDHA” SHPK, me NIPT L52125110A dhe K77524909Q, me adresë Rruga “Gjik Kuqali”, Pallati “C&S”, Ap. 4, Tiranë, dhe Lagjja “Pjetër Budi”, Burrel.

Operatori ekonomik “Ndregjoni” SHPK, me NIPT K31329048I, me adresë Rruga “Sule Bega”, Nd. nr. 32. Hyrja. 8, Tiranë.

Baza Ligjore:

Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, e ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4 i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoji relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim e pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

V ë r e n:**I***Vlerësimi paraprak*

I.1. Vlëra limit e përlloritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është mbi kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga të gjithë anëtarët, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

I.4. Ankimuesi ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II*Rrethanat e çështjes*

II.1. Në datën 19.04.2023, në Sistemin e Prokurimeve Elektronike është publikuar procedura e prokurimit “Procedurë e Hapur”, me Nr. REF-66182-04-14-2023, me objekt: “Rikonstruksion i Spitalit Rajonal Dibër ‘Rrahim Xhika’”, me fond limit 325,049,984 (treqind e njëzet e pesë milionë e dyzetë e nëntë mijë e nëntëqind e tetëdhjetë e katër) leke pa TVSH, zhvilluar më datë 10.05.2023, nga autoriteti kontraktor, Drejtoria e Spitalit Rajonal Dibër.

II.2. Në datën 10.05.2023, autoriteti kontraktor zhvilloi procedurën e prokurimit objekt-ankimi.

II.3. Në datën 30.05.2023, autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH), përkatësisht:

1. “Alko Impex General Construction” SHPK	299.105.123,33 lekë	skualifikuar
2. “Ndregjoni” SHPK	317.170.464	lekë kualifikuar
3. “Kupa” SHPK	320.242.599	lekë skualifikuar
4. “ASI-2A CO” SHPK	322.169.997	lekë skualifikuar
5. “Valona Konstruksion” SHPK	324.036.695	lekë skualifikuar
6. “Frontier Construction” SHPK	pa ofertë ekonomike	skualifikuar

II.4. Në datën 30.05.2023, operatori ekonomik “Alko Impex General Construction” SHPK është njoftuar elektronikisht për klasifikimin e ofertave, si dhe skualifikimin e tij në këtë procedurë prokurimi me argumentet si më poshtë vijon:

I- Operatori ekonomik “Alko Impex General Construction” SHPK , nuk plotëson kërkesën e pikës 2.3., të kriterëve të veçanta për kualifikim, të dokumenteve të tenderit, lidhur me përvojën e suksesshme në kontrata të mëparshme, sipas së cilës “Operatorët ekonomikë duhet të kenë përvojë të suksesshme në kontrata të mëparshme dhe për këtë duhet të paraqesin: a) Punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 40% e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet, konkretisht në vlerën 130,019,994 (Njëqind e tridhjetë milion e nëntëmbëdhjetë mijë e nëntëqind e nëntëdhjetë e katër) lekë dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, b) Punë të ngjashme deri në një kufi ku vlera monetare totale e punëve të kryera e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit është jo më e vogël se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet, konkretisht: 650,099,968 (Gjashtëqind e pesëdhjetë milion e nëntëdhjetë e nëntë mijë e nëntëqind e gjashtëdhjetë e tetë) lekë. Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme. Ne rast se oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, kushti i përcaktuar në shkronjën “a”, plotësohet nga anëtari, i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontrata të ngjashme, në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Në rastin kur operatorët ekonomikë, anëtarë të një bashkimi, kanë të njëjtën përqindje pjesëmarrjeje në bashkim, vendosin me marrëveshje në kontratën e bashkëpunimit se cila prej tyre do të përmbushë këtë kusht.

Për përmbushjen e kësaj kërke, operatori ekonomik “Alko Impex General Construction” SHPK, ka paraqitur në sistemin e prokurimit elektronik, dokumentacionin si më poshtë: 1. Kontratën Nr.2832/5Prot date 11.06.2019 me object Rikonstruksion i shkollës së mesme profesionale 26 Marsi Kavaje nënshkruar nga Bashkimi i Operatoreve Ekonomik Alko Impex Shpk & 2 T Shpk , ku sipas kontratës për bashkimin e përkohshëm të shoqërive Nr. 2703.Rep Nr. 2050 Kol date 16.04.2019, shoqëria Alko Impex Shpk ka marrë përsipër 86.5 % të punimeve. Referuar situacionit progresiv Nr.4 (Përfundimtar) ka kryer punime ne vleren 106,395,557 leke pa tvsh. Formulari i vlersimit nuk është plotësuar sipas kërkesave të 4

dokumentave standarte te tenderit , nuk dëshmon që shoqëria Alko Impex General Construction SHPK ka qenë Bashkimi Operatoresh Ekonomik me shoqërin 2 T Shpk 2. Kontratën Nr. 1643/6 date 22.05.2017 me objekt Rikonstruksion Shkolla e Mesme Profesionale Ali Myftiu Elbasan me vlerë 80,896,117 lekë pa tvsh. 3. Kontraten Nr. 2317/4 Prot me objekt “Rehabilitim i kullës se kontigjences” date 27.12.2017 me vlerë 41,547,358 lekë pa tvsh. 4. Në lidhje me Kontraten Nr. 3890/8 date 07.09.2017 me objekt Masat mbrojtëse në anën e majtë të rrjedhës së lumit drin , në biefin e poshtëm të digës së fierzes nuk është as në natyrë as në kompleksitet as në metodologji punimesh e ngjashme me objektin që prokurohet , kjo referuar dhe zërave të punimeve që ka kryer OE “Alko Impex General Construction” SHPK, në objektin e paraqitur, si rrjedhoj nuk mund të konsiderohen punime të ngjashme me objektin që prokurohet. Operatori ekonomik “Alko Impex General Construction” SHPK punë të ngjashme me vlera totale 228,839,032 lekë pa tvsh.

Nuk plotes asnjërin nga kushtet e kerkuar ne DST (Pika 2.3./a dhe Pika 2.3./b).

2- Operatori ekonomik Alko Impex General Construction SHPK nuk plotëson pikën 2.3.9 të kriterëve të veçanta për kualifikim , të dokumenteve të tenderit. Referuar dokumentacionit të paraqitur (Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8 të DT dhe deklaratës për stafin) dhe OE rezulton se për punonjësit e specializuar si më poshtë: 2 (dy) Arben Reci, Fates Lita - Instalues dhe riparues te sistemeve ftohese- ngrohese; ka deklaruar se deshmitë profesionale janë të lëshuara nga subjekti AQScert, me NUIS L31511026K. Lidhur me këto certifikata, KVO verifikoi në QKB dhe rezulton se kjo shoqëri nuk ka asnjë licencë aktive dhe për rrjedhojë nuk përmbushet kërkesa për kualifikim që dëshmitë e kualifikimit profesional/certifikatë/diploma, të jenë të lëshuara nga institucione (shtetërore apo private) të licencuara/akredituara nga autoritetet përgjegjëse shtetërore, sipas ligjit nr. 15/2017 “Per arsimin dhe formimin profesional në R.Sh. ”. Kete qendrim ka mbaajtur edhe KPP ne vendimin nr. 441/2020, ku citohet si vijon: Pra rezulton se dokumentet e paraqitura për dy punonjësit pllakashtrues, në zbatim të pikës 8 si më sipër cituar nuk përmbushin kërkesën e autoritetit kontraktor për “Diplomë nga institucionet e arsimit të mesëm profesional të akredituara sipas ligjit Nr.15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në RSH”, pasi shoqëria ASQCERT, e cila ka lëshuar Certifikatat e Trajnimit për “Kurs Trajnimi për pllakashtrues”, nuk është licencuar nga ana Ministrisë se Financave dhe Ekonomisë dhe nuk disponon asnjë licencë per te ofruar kurse trajnimi per formimin profesional ne perputhje me ligjin nr.15/2017, "Per arsimin dhe formimin profesional ne Republiken e Shqiperise." Formimi profesional i personelit përbën domosdoshmeri dhe garanton autoritetin kontraktor për kapacitetet profesionale të ofertuesve për përmbushjen me sukses të kontratës, gjë e cila vërtetohet vetëm me Certifikatë/dëshmi/diplomë që është dokument zyrtar dhe i lëshuar një organ certifikues, sipas procedurave standarde ligjore dhe që regjistrojnë arritjet e një individi pas vlerësimit të caktuar.

Referuar dokumentacionit të paraqitur (Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8 të DT-ve dhe deklaratës për stafin), rezulton se punonjësit e specializuar:

- Hidraulik (Kadri Fusha)
- Elektracist (Sali Allmeta)
- Hekurkthyes (Artan Jonuzi, Ramazan Emini, Englison Demiri)

- Hekurpunues (Lavdrim Tota, Entil Guga)
- Karpentier (Krenar Plakalli , Arben Deliu)
- Betonues (Arben Lecini, Klodian Ramka)
- Elektromekanik (Islam Demiri)
- Mekanik (Hoselito Seferi)
- Specialist gipsi, sistemet e thata në ndërtesa (Hamid Tafa, Mariglen Ramazani, Florid Toska, Riza Kola)
- Punonjes Duroalumini (Ylli Xhepa)
- Muratore (Agron Kullolli, Bledar Cela, Xhemail Emimi, Abaz Kullolli, Ramadan Kruja, Hajri Tafani)
- Suvatues (Albert Murataj, Erlin Xhafai, Ervin Shehu)
- Hidroizolues (Ermal Tafaj, Hekuran Balloshiti, Zyhdi Elezi, Zenel Gjini)
- Bojaxhi (Derman Cangeli, Luan Qekai, Syrjan Qekai, Xhuliano Hasani, Edmond Sula)
- Shtgues pllakash (Jonuz Leci, Ylli Driza, Fatmir Alushi, Haxhi Seferi, Fatos Bunoca, Luan Ali) janë të pajisur me dëshmi profesionale nga subjekti “TCPE”, me NUIS L52031020F. Lidhur me këto certifikata, KVO verifikoi në QKB dhe rezultoi se kjo shoqëri nuk ka asnjë licencë aktive dhe për rrjedhojë nuk përmbushet kërkesa për kualifikim që dëshmitë e kualifikimit profesional/certifikatë/diploma, të jenë të lëshuara nga institucione (shtetërore apo private) të licencuara/akredituara nga autoritetet përgjegjëse shtetërore, sipas ligjit nr. 15/2017 “Per arsimin dhe formimin profesional në R.Sh. ”. Këtë qëndrim ka mbajtur edhe KPP në vendimin Nr. 441/2020 dhe nr. 745/2022 në lidhje me dëshmitë e lëshuara nga subjekte të palicensuara.
- Referuar dokumentacionit të paraqitur (Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8 të DT-ve dhe deklaratës për stafin), rezultoi se punonjësit e specializuar:
 - Hidraulik (Sokol Bufi)
 - Instalues dhe riparues te sistemeve ftohese- ngrohese (Emiljano Beba)
 - Duroalumini (Albi Lloga, Muhamet Isallari) janë të pajisur me dëshmi profesionale nga subjekti “HTM”, me NUIS K97006004D. Lidhur me këto certifikata, KVO verifikoi në QKB dhe rezultoi se kjo shoqëri nuk ka asnjë licencë aktive dhe për rrjedhojë nuk përmbushet kërkesa për kualifikim që dëshmitë e kualifikimit profesional/certifikatë/diploma, të jenë të lëshuara nga institucione (shtetërore apo private) të licencuara/akredituara nga autoritetet përgjegjëse shtetërore, sipas ligjit nr. 15/2017 “Per arsimin dhe formimin profesional në R.Sh. ”. Këtë qëndrim ka mbajtur edhe KPP në vendimin Nr. 441/2020 dhe nr. 745/2022 në lidhje me dëshmitë e lëshuara nga subjekte të palicensuara.
- Referuar dokumentacionit të paraqitur (Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8 të DT-ve dhe deklaratës për stafin), rezultoi se punonjësit e specializuar:
 - Elektracist (Servet Gjuzi, Shkelqim Paja)
 - Hekurkthyes (Megli Cano, Venture)
 - Hidraulik (Kledi Myrto, Kujtim Shehu)
 - Karpentier (Sokol Peqini, Venture)
 - Punonjes Duroalumini (Syrja Shena)
 - Saldator (Besnik Spahiu, Rustem Isha, Daniel Kruja), janë të pajisur me dëshmi profesionale nga subjekti FUSION EV sh.p.k., me NUIS M11314044Q. Lidhur me këto certifikata, KVO

verifikoi në QKB dhe rezulton se kjo shoqëri nuk ka asnjë licencë aktive dhe për rrjedhojë nuk përmbushet kërkesa për kualifikim që dëshmitë e kualifikimit profesional/certifikatë/diploma, të jenë të lëshuara nga institucione (shtetërore apo private) të licencuara/akredituara nga autoritetet përgjegjëse shtetërore, sipas ligjit nr. 15/2017 “Per arsimin dhe formimin profesional në R.Sh.”. Këte qëndrim ka mbajtur edhe KPP në vendimin Nr. 441/2020 dhe 745/2022 në lidhje me deëshmitë e lëshuara nga subjekte të palicensuara.

- Referuar dokumentacionit të paraqitur (Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8 të DT-ve dhe deklaratës për stafin), rezulton se punonjësit e specializuar:

- Karpentier (Uesli Shehaj)

- Hidraulik (Memo Lila)

- Bojaxhi Klajdi (Hametaj)

- Specialist gipsi, sistemet e thata (Elian Shena)

- Instalues dhe riparues te sistemeve ftohese- ngrohese (Adriatik Gogo, Leonard Sulka) janë të pajisur me dëshmi profesionale nga subjekti Qendra e Trajnimeve të Avancuara – QTA me NUIS L61325037A.

Lidhur me këtë certifikatë, KVO verifikoi në QKB nga ku rezulton se kjo shoqëri nuk është e licencuar për të ofruar dëshmi kualifikimi për këtë profesion dhe për rrjedhojë nuk përmbushet kërkesa për kualifikim që dëshmitë e kualifikimit profesional/certifikatë/diploma, të jenë të lëshuara nga institucione (shtetërore apo private) të licencuara/akredituara nga autoritetet përgjegjëse shtetërore, sipas ligjit nr. 15/2017 “Per arsimin dhe formimin profesional në R.Sh.”. Këtë qëndrim ka mbajtur edhe KPP në vendimin Nr. 441/2020 dhe nr. 745/2022 në lidhje me dëshmitë e lëshuara nga subjekte të palicensuara.

3- Operatori ekonomik “Alko Impex General Construction” SHPK, nuk plotëson kërkesën e pikës 2.4.3 dhe 2.4.4 , të kriterëve të veçanta për kualifikim, të dokumenteve të tenderit konkretisht:

- Për materialet elektrike mungon autorizimi distributorit Bosch, LTD, Canovat, Schneider Electric, ITC, katalog celesa elektrik, Priza elektrike shuko, Panele elektrik, Automat, Kamera etjer. I gjithë informacioni i paraqitur nga operatori ekonomik “Alko Impex General Construction” SHPK nuk është në gjuhen shqipe,

- Për materialet hidraulike ka paraqitur kontrate furnizimi date 14.09.2022 që përfundon me date 14.09.2023 , neni 3 pika 2 shprehet qarte që palet bien dakord që afati i kontrates se qerese mund të zgjatet duke njoftuar paraprakisht njëra tjetrën në këtë rase kemi te bëjmë me kontrate furnizimi jo qiraje . Në sistem ka paraqitur autorizim prodhuesi nga Grundfos Srbija d.o.o. për pompa dhe Centrometal për kaldajë (Të pa përkthyer në gjuhen shqipe). Mungo autorizimi prodhuesit për distributorin P.F Haki Sinan nga prodhuesit SABIANA S.p.A, IMQ S.p.a, VAREM S.p.A, BONIMINI S.r.l, Varem S.p.a, ITAP Spa, Comisa srl, Varem S.p.a dhe Ferplast. Për materialet per furnizimin me uje, Pompe per sistemin MNZ mungojne Skedat teknike/kataloge te shoqeruara me raportet e testimi nga laboratore te akredituar ose certifikata aprovimi/performance. I gjithë informacioni i paraqitur nuk është në gjuhen Shqip sipas pikes 4.7 Gjuha (ët) në të cilat mund të hartohen ofertat: Shqip.

- Për materialet hidraulike HVAC nuk ka paraqitur dokumentacion për Pompe Nxehtesie (Versioni ajer / uje Inverter, komplet me kitin hidraulik), NJESI TRAJTIMI AJRI, RIKUPERATOR NXEHTESIE Seksioni i Rikuperimit te Nxehtesise Fryrj Derg/Rikthim:

1500m³/h , Rezervuar per karburant mungon autorizim prodhuesi, Kataloget/ skedat teknike te shoqeruara me Certifikatë Konfirmimit CE/Deklarata Performance. Për materialet Ene zgjerimi ka paraqitur vetem katalog nga Varem S.p.a mungo autorizimi prodhuesi, Certifikatë Konformiteti CE/Deklarata Performance.

- Për materialet Bojë Akrilike Bojë vaji mungo certifikim ku të vërtetohet se produkti është boje ekologjike, për Boje Hidroplastike certifikim ku të vërtetohet se produkti është boje ekologjike dhe antibakteriale. Për Pllakë shtrimi grez porcelanato Veshje me pllakë majolike nuk ka paraqiten Kataloget/skedat teknike te shoqeruara me Certifikatë Konfirmiteti CE/Deklarata Performance leshuar nga prodhuesi.

- Për materialet plakë gipsi nuk ka paraqitur dokumentacion sipas kerkesave te dokumenteve standarde te tenderit mungo autorizim /kontrate bashkepunimi nga prodhuesi / distributor, me të cilin prodhuesi / distributori autorizon kompaninë ofertuese, Kataloget/skedat teknike te shoqeruara me Certifikatë Konfirmiteti CE/Deklarata Performance leshuar nga prodhuesi. - Për materialet durale ka paraqitur Autorizim nga shoqëria Usluga Shpk dhe katalog nga shoqëria turke DEMİRTAŞ METAL A.Ş, bazuar ne dokumentat që janë paraqitur në sistem shoqëria Usluga Shpk nuk verteto që është prodhues - Për materialet Ashensor informacioni i paraqitur nuk është në gjuhen Shqip sipas pikes 4.7 Gjuha (ët) në të cilat mund të hartohen ofertat: Shqip.

II.5. Në datën 06.06.2023, autoriteti kontraktor ka publikuar në Sistemin e Prokurimit Elektronik “Publikimi i Njoftimit të Fituesit Paraprak” për procedurën e prokurimit objekt-shqyrtimi.

II.6. Në datën 12.06.2023 pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është dorëzuar ankesa me nr. 1341 prot, datë 12.06.2023 e operatorit ekonomik “Alko Impex General Construction” SHPK, ku u konstatua se objekti i saj lidhet me kundërshtimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, mbi skualifikimin e ofertës së tij ekonomike.

II.7. Bazuar në nenin 112 pika 3 të ligjit 162/2020 “Për prokurimin Publik” Komisioni i Prokurimit Publik ka publikuar në bazën e të dhënave të tij, të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe formularin për publikim Nr. 1341/2 prot., datë 13.06.2023, me arsyet e skualifikimit që operatori ekonomik “Alko Impex General Construction” SHPK kundërshton me anë të ankesës me nr. 1341 prot, datë 12.06.2023.

II.8. Nëpërmjet shkresës me nr. 536/2 prot., datë 15.06.2023, protokolluar me tonën me shkresën nr. 1341/3 prot., datë 16.06.2023 me objekt “Kthim-përgjigje”, është depozituar nga autoriteti kontraktor akti i trajtimit të ankesës së operatorit ekonomik ankimues, ku konstatohet, se me Vendimin Nr. 1, datë 15.06.2023 autoriteti kontraktor ka vendosur refuzimin e ankesës mos pranimit e saj.

II.9. Nga verifikimi i dokumentacionit të administruar në dosjen e shqyrtimit administrativ, u konstatua, se në datën 16.06.2023 pranë Komisionit Prokurimit Publik është protokolluar më shkresën nr. 1341/4 prot “Formulari i Paraqitjes së Argumentave nga Operatori Ekonomik i

Interesuar Ndregjoni SHPK”, në përputhje me nenin 113 të ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”.

II.10. Në datën 03.08.2023 Komisioni i Prokurimit Publik me vendimin Nr. 716/2023 ka vendosur:

1. *Të pranojë pjesërisht ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Alko Impex General Construction” SHPK për procedurën e prokurimit “Procedurë e Hapur”, me Nr. REF-66182-04-14-2023, me objekt: “Rikonstruksion i Spitalit Rajonal Diber ‘Rrahim Xhika’”, me fond limit 325,049,984 (treqind e njëzet e pesë milionë e dyzetë e nëntë mijë e nëntëqind e tetëdhjetë e katër) lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 10.05.2023 nga autoriteti kontraktor, Drejtoria e Spitalit Rajonal Diber.*
2. *Autoriteti kontraktor të anulojë procedurën e mësipërme të prokurimit dhe me rihapjen e procedurës të ketë parasysh konstatimet e mësipërme të bëra nga Komisioni i Prokurimit Publik.*
3. *T’i propozojë Agjencisë së Prokurimit Publik nisjen e hetimit administrativ për konstatimet e mësipërme, për shkeljet e kryera nga të gjithë zyrtarët përgjegjës.*
4. *Autoriteti kontraktor brenda 5 ditëve të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.*
5. *Ngarkohet zyra e financës që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Alko Impex General Construction” SHPK.*
6. *Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.*
7. *Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.*

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

II.11. Me shkresën nr. 684/1 prot., datë 15.08.2023, protokolluar me tonën nr. 1341/7 prot., datë 17.08.2023, autoriteti kontraktor Drejtoria e Spitalit Rajonal Diber., informon se: “[...] Mbështetur në ligjin nr. 162 datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, në VKM nr. 285, datë 19/05/2021 “Për Rregullat e Prokurimit Publik” i ndryshuar, ne VKM nr. 918 datë 29/12/2014 “Për kryerjen e procedurave të prokurimit publik në mënyrë elektronike”, Titullari i Ak Drejtoria e Spitalit Rajonal Diber, me mbërritjen e vendimit të KPP nr. 716/2023 datë 03.08.2023, ka nxjerrë Urdhrin e Anulimit të procedurës së prokurimit elektronik me objekt “Rikonstruksion i Spitalit Rajonal Diber ‘Rrahim Xhika’” në përputhje me vendimin e KPP. Procedura “Rikonstruksion i Spitalit Rajonal Diber ‘Rrahim Xhika’” është anuluar dhe një kopje e Urdhrit të Anulimit dhe print screen të faqes së SPE me veprimet e kryera janë bashkangjitur kësaj shkrese”. Komisioni i Prokurimit Publik, bëri verifikimet përkatëse në sistemin e prokurimeve elektronike të Agjencisë së Prokurimit Publik, lidhur me zbatimin e vendimit K.P.P 716/2023, datë 03.08.2023, të Komisionit të Prokurimit Publik, për procedurën e prokurimit “Procedurë e Hapur”, me Nr. REF-66182-04-14-2023, me objekt: “Rikonstruksion i Spitalit Rajonal Diber ‘Rrahim Xhika’”, me fond limit 325,049,984 (treqind e njëzet e pesë milionë e dyzetë e nëntë mijë e nëntëqind e tetëdhjetë e katër) leke pa TVSH, zhvilluar më datë 10.05.2023, nga autoriteti kontraktor, Drejtoria e Spitalit Rajonal Diber. Nga ky verifikim, rezultoi, se autoriteti kontraktor ka anuluar në SPE procedurën e mësipërme të prokurimit, por nuk ka dorëzuar pranë KPP-së, dokumentet e reja të tenderit të hartuara në përputhje me vendimin nr. 716/2023, datë 03.08.2023, të Komisionit të Prokurimit Publik, për

procedurën e prokurimit të cilën do të ripublikojë. Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon, se autoriteti kontraktor, nëse do të ripublikojë procedurën e prokurimit objekt-ankimi duhet të ketë në konsideratë në momentin e hartimit të dokumenteve të reja të tenderit, përcaktimet e bëra në vendimin KPP 716/2023, datë 03.08.2023, si dhe të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik. Referuar shkresës së mësipërme, të dorëzuar nga autoriteti kontraktor pranë Komisionit të Prokurimit Publik, dokumentacionit bashkëlidhur saj, si dhe nga verifikimi në sistemin e prokurimeve elektronike të Agjencisë së Prokurimit Publik, konstatohet, se autoriteti kontraktor ka zbatuar vendimin KPP 716/2023, duke anuluar në SPE procedurën e mësipërme të prokurimit. Autoriteti kontraktor duhet të ketë në konsideratë, se me rihedhjen e procedurës në Sistemin e Prokurimeve Elektronike, duhet të dërgoje pranë Komisionit të Prokurimit Publik, dokumentacionin e tenderit, me reflektimet përkatëse sipas përcaktimeve të bëra në vendimin KPP 716/2023 datë 03.08.2023.

II.12. Në datën 21.08.2023, Komisioni i Prokurimit Publik me vendimin Nr. 779/2023 ka vendosur:

1. *Të lejojë autoritetin kontraktor për vijimin me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit “Procedurë e Hapur”, me Nr. REF-66182-04-14-2023, me objekt: “Rikonstruksion i Spitalit Rajonal Dibër ‘Rrahim Xhika”, me fond limit 325,049,984 (treqind e njëzet e pesë milionë e dyzetë e nëntë mijë e nëntëqind e tetëdhjetë e katër) leke pa TVSH, zhvilluar me datë 10.05.2023 nga autoriteti kontraktor, Drejtoria e Spitalit Rajonal Dibër.*
2. *Autoriteti Kontraktor me ripublikimin e procedurës së prokurimit, të dërgojë pranë Komisionit të Prokurimit Publik dokumentet standarde të tenderit (DST) të firmosura dhe të vulosura, ku të jenë pasqyruar reflektimet përkatëse të bëra në vendimin 716/2023 të Komisionit të Prokurimit Publik.*
3. *Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.*

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

II.13. Me shkresën nr. 726/1 prot., datë 04.09.2023, protokolluar me tonën nr. 1341/9 prot., datë 07.09.2023, autoriteti kontraktor Drejtoria e Spitalit Rajonal Dibër, informon, se ka përgatitur modifikimet përkatëse në dokumentet e tenderit në përputhje me vendimin Nr. 716/2023, datë 03.08.2023, të Komisionit të Prokurimit Publik, për procedurën e prokurimit “Procedurë e Hapur”, me Nr. REF-66182-04-14-2023, me objekt: “Rikonstruksion i Spitalit Rajonal Dibër ‘Rrahim Xhika’”, me fond limit 325,049,984 (treqind e njëzet e pesë milionë e dyzetë e nëntë mijë e nëntëqind e tetëdhjetë e katër) lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 10.05.2023 nga autoriteti kontraktor, Drejtoria e Spitalit Rajonal Dibër. Referuar shkresës së mësipërme, të dorëzuar nga autoriteti kontraktor pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si dhe verifikimeve të kryera në Sistemin e Prokurimeve Elektronike, Komisioni vëren, se autoriteti kontraktor nëpërmjet shkresës së sipërcituar ka dërguar pranë Komisionit Prokurimit Publik dokumentet standarde të tenderit të reja, por nga verifikimi i tyre konstatohet se Autoriteti Kontraktor nuk ka kryer modifikimet në përputhje të plotë me përcaktimet dhe interpretimet e vendimit Nr. 716/2023, datë 03.08.2023, konkretisht pikës III.1.11, e në vijim të vendimit për sa i përket kriterit 2.4.2, të kërkesat e tjera të veçanta për kualifikim.

II.14. Në datën 15.09.2023, Komisioni i Prokurimit Publik me vendimin Nr. 917/2023 ka vendosur:

1. *Të mos lejojë autoritetin kontraktor për vijimin me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit “Procedurë e Hapur”, me Nr. REF-66182-04-14-2023, me objekt: “Rikonstruksion i Spitalit Rajonal Dibër ‘Rrahim Xhika”, me fond limit 325,049,984 (treqind e njëzet e pesë milionë e dyzetë e nëntë mijë e nëntëqind e tetëdhjetë e katër) leke pa TVSH, zhvilluar me datë 10.05.2023 nga autoriteti kontraktor, Drejtoria e Spitalit Rajonal Dibër.*
2. *Autoriteti kontraktor të pezullojë procedurën e re të prokurimit dhe të zbatojë plotësisht Vendimin Nr. 716/2023, datë 03.08.2023 të Komisionit të Prokurimit Publik dhe ta vërë në dijeni atë për veprimet e kryera.*
3. *Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.*

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

II.15. Me shkresën nr. 833 prot., datë 27.09.2023, protokolluar me tonën nr. 1341/11 prot., datë 02.10.2023, autoriteti kontraktor Drejtoria e Spitalit Rajonal Dibër, informon se ka kryer modifikimet në dokumentet e tenderit, si dhe ka publikuar shtojcën e modifikuar në SPE në përputhje me vendimin Nr. 716/2023, datë 03.08.2023, të Komisionit të Prokurimit Publik, për procedurën e prokurimit “Procedurë e Hapur”, me Nr. REF-66182-04-14-2023, me objekt: “Rikonstruksion i Spitalit Rajonal Dibër ‘Rrahim Xhika”, me fond limit 325,049,984 (treqind e njëzet e pesë milionë e dyzetë e nëntë mijë e nëntëqind e tetëdhjetë e katër) leke pa TVSH, zhvilluar më datë 10.05.2023, nga autoriteti kontraktor, Drejtoria e Spitalit Rajonal Dibër. Referuar shkresës së mësipërme, të dorëzuar nga autoriteti kontraktor pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si dhe verifikimeve të kryera në Sistemin e Prokurimeve Elektronike, Komisioni vëren, se autoriteti kontraktor nëpërmjet shkresës së sipërcituar, ka dërguar pranë Komisionit të Prokurimit Publik shtojcën e modifikuar të dokumenteve standarde të tenderit, ku nga verifikimi konstatohet, se Autoriteti Kontraktor ka modifikuar dokumentet standarde të tenderit, në përputhje të plotë me përcaktimet dhe interpretimet e vendimit Nr. 716/2023, datë 03.08.2023, konkretisht pikës III.1.11, e në vijim të vendimit.

II.16. Në datën 10.10.2023, Komisioni i Prokurimit Publik me vendimin Nr. 1017/2023, ka vendosur:

1. *Të lejojë autoritetin kontraktor për vijimin me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit “Procedurë e Hapur”, me Nr. REF-66182-04-14-2023, me objekt: “Rikonstruksion i Spitalit Rajonal Dibër ‘Rrahim Xhika”, me fond limit 325,049,984 (treqind e njëzet e pesë milionë e dyzetë e nëntë mijë e nëntëqind e tetëdhjetë e katër) lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 10.05.2023, nga autoriteti kontraktor, Drejtoria e Spitalit Rajonal Dibër.*
2. *Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.*

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

II.17. Në datën 06.09.2023, në Sistemin e Prokurimeve Elektronike është publikuar procedura e prokurimit “Procedurë e Hapur”, me Nr. REF-78915-09-04-2023, me objekt: “Rikonstruksion i Spitalit Rajonal Diber ‘Rrahim Xhika’”, me fond limit 325,049,984 (treqind e njëzet e pesë milionë e dyzetë e nëntë mijë e nëntëqind e tetëdhjetë e katër) leke pa TVSH, zhvilluar më datë 25.10.2023, nga autoriteti kontraktor, Drejtoria e Spitalit Rajonal Diber.

II.18. Në datën 25.10.2023, autoriteti kontraktor zhvilloi procedurën e prokurimit objekt-ankimi.

II.19. Në datën 14.11.2023, autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH), përkatësisht:

1. “Rej” SHPK	269.132.666,78 lekë	skualifikuar
2. “Alko Impex General Construction” SHPK	289.373.205,34 lekë	skualifikuar
3. BOE “Rafin Company” SHPK & “Udha” SHPK	291.541.221 lekë	kualifikuar
4. BOE “ED Konstruksion” & “LIS Konstruksion” & “OB Konstruksion” & “Totila” SHPK	296.148.651,67 lekë	skualifikuar
5. “Ndregjoni” SHPK	315.627.524 lekë	kualifikuar
6. “AEK Munella” SHPK	320.138.518 lekë	skualifikuar
7. “2Z Konstruksion” SHPK	321.104.462 lekë	skualifikuar
8. “Kthella” SHPK	323.030.385 lekë	skualifikuar
9. “ADR Trading” SHPK	Pa ofertë ekonomike	
10. “Zuli Konstruksion” SHPK	Pa ofertë ekonomike	

II.20. Në datën 14.11.2023 operatori ekonomik “Alko Impex General Construction” SHPK është njoftuar elektronikisht për klasifikimin e ofertave, si dhe skualifikimin e tij në këtë procedurë prokurimi me argumentet si më poshtë vijon:

Për arsyet e mëposhtme:

A. *Ne DST si dhe shtojcen per ndryshime ne DST te publikuar ne SPE per kete procedure prokurimi ne kriteret e vecanta per kualifikim konkretisht: **2.4 “Kërkesa të tjera të veçanta për kualifikim pika”, pika 2.4.3)** eshte kerkuar:*

2.4.3 Për impiantin e gazeve mjekësore dhe pajisjet mjekësore

-Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë një dokument nga organet shtetërore qe pajisjet mjekësore janë të autorizuar për tregtim në Republikën e Shqipërisë, duhet të paraqitet dokument lëshuar nga Agjencia Kombëtare e Barnave dhe Pajisjeve: Mjekësore Certifikatë Regjistrimi në përputhje me ligjin 89/2014 “Për pajisjet mjekësore”.

- Operatori ekonomik duhet të paraqesë kontratë furnizimi nga prodhuesi ose distributori i autorizuar nga prodhuesi, me të cilin prodhuesi/distributori i autorizuar autorizon kompaninë pjesëmarrëse në tender të ofertojë këto pajisje në këtë procedure prokurimi.

PLAN - ORGANIZIMIN e punimeve të objektit ku te reflektoje te gjitha masat tekniko-organizative dhe elementet e tjere qe kerkon nje plan organizimi i mirëfilltë.

PLANIN E SIGURISE NE KANTIER per punimet ne objekt ne format sipas VKM nr. 692 date 13.12.2001 “Per masat e vecanta te sigurimit dhe ruajtjes se shendetit ne pune, te ndryshuar me VKM nr. 742 date 06.11.2003”, sipas kerkesave, si rrethimi provizor, depozitimi i materialeve kryesore, ambientet e kantierit, rruge kalimet, tabelat e sig. teknik etj.

GRAFIKUN E PUNIMEVE në përputhje me afatin e realizmit të punimeve.

ANALIZË TEKNIKE për të gjithë zërat e preventivit të ofertës. Mosparaqitja në formën e kërkuar përbën kusht për skualifikim. Bazuar në VKM Nr. 514, datë 15.08.2007 “Për informatizimin e llogaritjes së kostos dhe hartimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit”, pika 10.

Referuar dokumentacionit te paraqitur OE “Alko Impex General Construction” SHPK nuk ploteson piken 2.4.3 ne lidhje me “Analizen Teknike”

*Analizat teknike te cmimeve te paraqitura nuk jane plotesuar sipas VKM nr.113 date 1.03.2023 “Per percaktimin e pages minimale ne shkalle vendi”, ku ne piken 3 te kesaj VKM-je percaktohet: 3. **Paga bazë minimale orare të jetë 229,9 (dyqind e njëzet e nëntë pikë nëntë) lekë,** por ne shumicen e zerave te punes kjo page eshte e ulet dhe e padiferencuar per kategori punetoresh te kualifikuar edhe pse duke qene se jane punime speciale OE “Alko Impex General Construction” SHPK e ka percaktuar oren e punes 185 leke ne te gjitha proceset e punes duke mos bere diferencim te kategorizimit te punetoreve sipas specialiteteve por me pagese me te ulet dhe se minimumi i percaktuar sipas VKM nr.113 date 1.03.2023.*

Bazuar ne VKM nr. 514 date 15.08.2007 “Per informatizimin e llogaritjes se kostos dhe hartimin e manualeve teknike te cmimeve te punimeve te ndertimit” pika 10 thuhet: “Operatori ekonomik pjesemarres ne tender se bashku me preventivin duhet te dorezoje analizen teknike per te gjithë zerat e preventivit te ofertes. Mos paraqitja ne formen e kerkuar perben kusht per skualifikim.

OE “Alko Impex General Construction” SHPK nuk e ka respektuar kete kusht, nuk ka paraqitur te sakte analizen teknike sipas legjislacionit ne fuqi.

B. *Referuar Formularit permbledhes te vetedeklarimit sipas shtojces 8 te DST perkatesisht pika 2.3.9 OE “Alko Impex General Construction” SHPK ka deklaruar staf teknik punonjesit G.A dhe G.Xh per punime duralumini te pajisur me certifikate kualifikimi leshuar nga subjekti Fusion Engineering Venture me NIUS L71813001C.*

Gjithashtu OE “Alko Impex General Construction” SHPK eshte mbeshtetur nga subjekti Alko Impex General Construction SHPK dhe ka deklaruar punonjesit A.B dhe V.B per punime duralumini te pajisur me certifikate kualifikimi leshuar nga subjekti Fusion Engineering Venture me NIUS L71813001C.

Nga verifikimet e kryera subjekti Fusion Engineering Venture nuk eshte i pajisur me miratim/akreditim per te ofruar kursin per punime duralumini.

Nga verifikimi i kryer në faqen zyrtare eëë.qkb.gov.al, në seksionin Kërko për Licence, shoqëria si më sipër është e licencuar me licencën me nr. LN-2242-04-2021 me Titull “Formim profesional” për të cilën figurojnë 3 (tre) miratimet nga Ministria e Financave dhe Ekonomise dhe nga QKB:

- Me Vendimin nr. 6344/2 prot., datë 04.05.2021, i është miratuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomise.
- Me Vendimin nr. 15695/2 prot., datë 02.09.2022, i është miratuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomise.
- Me Vendimin nr. 10232/2 prot., datë 04.07.2023, i është miratuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomise.

Në këto tre miratime, rezulton se shoqëria “*Fusion Engineering Venture*” me NUIS L71813001C është e licencuar për ofrimin e kurseve profesionale të ndryshme por jo për ofrimin e kurseve profesionale sipas ligjit Nr. 15/2017 “*Per arsimin dhe formimin profesional në R.Sh.*” **për profesionet “Punime Duralumini”**

OE nuk ploteson piken 2.3.9 te kerkuar ne DST ne 2.3 “Kapaciteti teknik”, pasi nuk ka paraqitur 4 (kater) punonjes duralumini te vertetuar me diploma/certifikata te arsimit professional te leshuara nga institucionet te akredituara sipas ligjit nr. 15/2017 “Per arsimin dhe formimin professional ne Republiken e Shqiperise” ose ekuivalente. (Këtë qëndrim ka mbajtur edhe KPP në vendimin nr. 745/2022 në lidhje me dëshmitë e lëshuara nga subjekte të palicencuara).

Referuar Formularit permbledhes te vetedeklarimit sipas shtojces 8 te DT perkatesisht pika 2.3.9 OE “*Alko Impex General Construction*” SHPK ka deklaruar staf Teknik punonjesin mekanik B.M te pajisur me certificate kualifikimi leshuar nga subjekti Fusion Engineering Venture me NUIS L71813001C.

Nga verifikimi i kryer në faqen zyrtare www.qkb.gov.al, në seksionin Kërko për Licence, shoqëria si më sipër është e licencuar me licencën me nr. LN-2242-04-2021 me Titull “*Formim profesional*” për të cilën figurojnë 3 miratimet nga Ministria e Financave dhe Ekonomise dhe nga QKB:

- Me Vendimin nr. 6344/2 prot., datë 04.05.2021, i është miratuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomise.
- Me Vendimin nr. 15695/2 prot., datë 02.09.2022, i është miratuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomise.
- Me Vendimin nr. 10232/2 prot., datë 04.07.2023, i është miratuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomise.

Në këto tre miratime, rezulton se shoqëria “*Fusion Engineering Venture*” me NUIS L71813001C është e licencuar për ofrimin e kurseve profesionale të ndryshme por jo për ofrimin e kurseve profesionale sipas ligjit Nr. 15/2017 “*Per arsimin dhe formimin profesional në R.Sh.*” **për profesionet “Mekanik”**.

OE nuk ploteson piken 2.3.9 te kerkuar ne DST ne 2.3 “Kapaciteti teknik”, pasi nuk ka paraqitur 1 (nje) punonjes mekanik te vertetuar me diploma/certifikata te arsimit professional te leshuara nga institucionet te akredituara sipas ligjit nr. 15/2017 “Per arsimin dhe formimin professional ne Republiken e Shqiperise” ose ekuivalente. (Këtë qëndrim ka

mbajtur edhe KPP në vendimin nr. 745/2022 në lidhje me dëshmitë e lëshuara nga subjekte të palicencuara).

C. Ne DST si dhe shtojcen per ndryshime ne DST te publikuar ne SPE per kete procedure prokurimi ne kriteret e vecanta per kualifikim konkretisht: **2.4 “Kërkesa të tjera të vecanta për kualifikim pika”, pika 2.4.2)** eshte kerkuar:

2.4.2 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë autorizim prodhuesi ose distributori. Në rast paraqitje autorizim distributori duhet të paraqitet kontrata ose dokumenti i angazhimit midis prodhuesit dhe distributorit, për materialet (paisjet mjekesore, hidroizolues, paisjet mekanike, paisjet hidrosanitare, shtrese pvc antibakteriale, dyer/dritare, gipse, bojrat, pajisjet e zjarri, pajisjet e sistemin HVAC, ashensori) per objektet shendetesore. Per materialet e kerkuara OE duhet te paraqese katalogun/et ose skedat teknike të prodhuesit/ve, ku të specifikohen materialet që do të ofrohen si dhe te paraqiten certifikatë/deklaratë konfirmimiti CE ose ekuivalente, me qëllim përmbushjen e standardeve të kërkuara ne Specifikimet teknike. **Operatori ekonomik duhet të paraqesë ofertën teknike, në formën e një tablele sipas modelit të mëposhtëm, e cila duhet të plotësohet në mënyrë rigoroze. Oferta teknike duhet të përmbajë të dhënat si më poshtë;**

Nr.	Emri i kompanisë prodhuese	Emërtimi i katalogut të prodhuesit	Nr. i faqes	Nr. rep &Nr.kol (njehsim origjinali-Vertetim perkthimi
1.				

Të dhënat e deklaruara në ofertën teknike duhet të korrespondojnë me të dhënat për artikujt në katalogët/skedat teknike të dorëzuara ne SPE. Moskorrespondimi i këtyre të dhënave do të sjellë pavlefshmëri të ofertës.

Ne lidhje me kete pike OE “Alko Impex General Construction” SHPK ka deklaruar te dhena per materialet me te cilat eshte autorizuar per te marre pjese ne kete procedure prokurimi. OE “Alko Impex General Construction” SHPK nuk ka plotesuar dhe nuk ka paraqitur oferten teknike sipas tabelës se kerkuar ne piken 2.4.2.

Materialet e paraqitura nga OE ne SPE nuk jane te perkthyer ne gjuhen shqipe, gjuhe ne te cilen jane kerkuar dokumentet ne DT referuar pikes **4.7 Gjuha (ët) në të cilat mund të hartohen ofertat:**

Shqip X Anglisht

Si dhe ne shtojcen 7 ne “Kriteret e përgjithshme të përzgjedhjes/ kualifikimit” eshte kerkuar/parashikuar: **“Nëse gjuha e përdorur në procedurë është gjuha shqipe, atëherë dokumentet e gjuhës së huaj duhet të shoqërohen nga një përkthim i noterizuar në shqip”.**

Ne DT eshte percaktuar qe “Të dhënat e deklaruar në ofertën teknike duhet të korrespondojnë me të dhënat për artikujt në katalogët/skedat teknike të dorëzuara ne SPE. Moskorrespondimi i këtyre të dhënave do të sjellë pavlefshmëri të ofertës”

Po rendisim mangesite e OE “Alko Impex General Construction” SHPK sipas dokumentacionit te dorezuar ne SPE ne lidhje me kete pike (ne kriteret e vecanta per kualifikim 2.4 “Kërkesa të tjera të veçanta për kualifikim pika”, pika 2.4.2), si me poshte:

- Per pajisjet mjekesore mungon katalogu ose skedat teknike sipas kerkesave te DST 2.4.2 te dokumenteve standarde te tenderit.*
- Per materialin hidroizolues ka paraqitur Test raporte ne gjuhen angleze (te paperkthyer dhe noterizuar).*
- Per materialet pajisje fikje zjarrit nuk ka paraqitur autorizim prodhuesi ose distributori me Bocciolone Antincendio S.p.a., disponon vetem katalog ne gjuhen Italiane (te paperkthyer dhe noterizuar).*
- Per materialet shtrese pvc antibakteriale ka paraqitur autorizim nga distributor Teknoedil, Katalogu ne gjuhen angleze dhe certifikata ne gjuhen angleze (te paperkthyer dhe noterizuar).*
- Nuk ka paraqitur autorizim prodhuesi ose distributori, Katalog ose Skede teknike per Dyer te brendshme laminat me kase alumini e pajisur me aksesore "heavy duty", me nje ose dy kanata sipas vizatimeve.*
- Per materialin gips ka paraqitur autorizim prodhuesi nga Dekoll Sh.A shoqeruar me katalog te weber saint gobain, Dekoll Sh.A nuk verteton se prodhon materiale gipsi, mungon katalogu ose skedat teknike si dhe certifikata/deklarata konformitetit CE.*
- Per materialin boje autorizimi prodhuesit Colorificio Sammarinese s.p.a eshte ne gjuhen Italiane, Skeda teknike ne gjuhen italiane dhe certifikatë ne gjuhen italiane (te paperkthyer dhe noterizuara).*
- Pajisjet e sistemit HVAC, ka paraqitur kontratë furnizimi nga Haki Sianani, mungon autorizim prodhuesit, mungojne kataloget per (Pompe Nxehtesie, Njesi Trajtimi Ajri Dergim, Njesi Trajtimi Ajri Rikthim, Njesi Trajtimi Ajri Rikuperator Nxehtësie, Fan Coil DysHEMEJE, Mono Split Mural, Radiator çeliku) si dhe certifikata/deklarata konformitetit CE.*
- Pajisjet e sistemit HVAC, ka paraqitur Kaldaje nga prodhuesi Centrometac d.o.o ne gjuhen angleze, katalog /Skede teknike ne gjuhen angleze (te paperkthyer dhe noterizuara).*
- Nuk ka paraqitur autorizim prodhuesi ose distributori per Pompe karburanti.*
- Nuk ka paraqitur autorizim prodhuesi ose distributori per Rezervuari i lendes djegese.*

OE “Alko Impex General Construction” SHPK nuk ploteson specifikimet e kerkuara, nuk ka plotesuar oferten teknike rrjedhimisht oferta e paraqitur eshte e pavlefshme.

C. Ne DST te publikuar ne SPE per kete procedure prokurimi ne kriteret e veçanta per kualifikim konkretisht: **2.3 “Kapaciteti teknik”, pika 2.3.1)** eshte kerkuar:

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Operatorët ekonomikë duhet të kenë përvojë të suksesshme në kontrata të mëparshme dhe për këtë duhet të paraqesin :

- a) dokumentacion për punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të ulët se 40% e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës;
- b) dokumentacion për punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e ulët se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet.
 - **Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.**
 - Ne rast se oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, kushti i përcaktuar në shkronjën “a”, plotësohet nga anëtari, i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontrata të ngjashme, në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Në rastin kur operatorët ekonomikë, anëtarë të një bashkimi, kanë të njëjtën përqindje pjesëmarrjeje në bashkim, vendosin me marrëveshje në kontratën e bashkëpunimit se cila prej tyre do të përmbushë këtë kusht.

Vlerësimi i përvojës së suksesshme të Operatorit Ekonomik do të kryhet bazuar në deklaratat e dokumentet e mëposhtme:

- Për kontrata të realizuara me ente publike operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:
 - Formular vlerësimi per realizimin e punimeve sipas shtojcës Nr. 9 (ku të përcaktohet qartazi vlera, afati i perfundimit te kontrates si dhe natyra e punes se kryer);
 - Kontratë Sipërmarrje;
 - Situacionin përfundimtar;
 - Fatura tatimore perkatese.
 - Aktin e kolaudimit;
 - certifikata e marrjes ne dorezim
- Për kontrata të realizuara me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm :
 - Formular vlerësimi per realizimin e punimeve sipas shtojcës Nr. 9 (ku të përcaktohet qartazi vlera, afati i perfundimit te kontrates si dhe natyra e punes se kryer);
 - Kontrate Sipërmarrje;

- Situacionin përfundimtar;
 - Fatura tatimore perkatese.
 - Aktin e kolaudimit;
 - certifikatë përdorimi / marrjes në dorëzim
- Për kontratat e realizuara si Bashkim Operatoresh, operatori ekonomik ofertues, krahas dokumentacionit të sipërcituar për secilin rast respektivisht, duhet të paraqesë edhe Kontratën e bashkimit të operatoreve shoqëruar me tabelën e ndarjes së punimeve, ku të cilësohen punimet që ka marrë përsipër të kryejë secili anëtar i BOE.

Për përmbushjen e kësaj kërkesë, operatori ekonomik “Alko Impex General Construction” SHPK, ka paraqitur në sistemin e prokurimit elektronik, dokumentacionin si më poshtë:

Kontrata me Nr.3890/8 date 07.09.2017 me objekt Masat mbrojtëse në anën e majtë të rrjedhjes së lumit Drin në biefin e poshtëm të digës së Fierzes me vlerë 56,8609,805 pa TVSh, kontratë e cila nuk është as në natyrë as në kompleksitet as në metodologji punimesh e ngjashme me objektin që prokurohet, kjo referuar dhe zërave të punimeve që ka kryer OE “Alko Impex General Construction” SHPK, në objektin e paraqitur, si rrjedhojë nuk mund të konsiderohen punime të ngjashme me objektin që prokurohet.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit i paraqitur nga OE “Alko Impex General Construction” SHPK, në përmbushje të kriterit për punime të ngjashme, nga krahasimi i situacioneve përfundimtare të punimeve në zbatim të kontratës të sipërcituar, të realizuara nga OE “Alko Impex General Construction” SHPK, me preventivin dhe relacionin teknik të objektit të prokurimit konstatohet:

NR	An	PËRSHKRIMI I PUNIMEVE	NJESIA	SASIA	CMIMI	VLERA	Përshkrimi bazuar në zërat e preventivit të punimeve
1	3.106/b	Germim dheu me ekskavator me zinxhir 0.5 m ³ për trasenë e mbrojtjes dhe rrugët hyrëse në kanale gjeres $i > 2m$, prani uji-2m, kategoria e IV, me shkarkim në mjet (shtrati i	ml	2,365	1,888	4,464,742	Bazuar në Analizë e cmimit dhe në përshkrimin e punimeve nuk përputhen me preventivin e objektit që prokurohet

		<i>perroit rreth kuotes V 175m)</i>					
2	2.48/an	<i>Germim shkëmbi I forte me çekiç me ekskavator me zingjit për trasene e mbrojtjes</i>	<i>m3</i>	388	1,888	732,544	<i>Bazuar ne Analize e çmimit dhe ne pershkrimin e punimeve nuk perputhen me preventivin e objektit që prokurohet</i>
3	An.124/4a	<i>Germim shkëmbi i forte sek i lire, me mina te vogla me eskavator 1 m3 per trasene e mbrojtjes</i>	<i>m3</i>	350	1,888	660,800	<i>Bazuar ne Analize e çmimit dhe ne pershkrimin e punimeve nuk perputhen me preventivin e objektit që prokurohet</i>
4	3,158/2a	<i>Transport dheu me auto deri 2.0 km për zerat 1,2, 3, 11</i>	<i>m3</i>	3,703	319	1,181,193	<i>Bazuar ne Analize e çmimit dhe ne pershkrimin e punimeve nuk perputhen me preventivin e objektit që prokurohet</i>

5	3.164	Rrafshim e ngjeshje dhe I gërmuar me shtresa jo me shume se 30 cm per trasene e mbrojtjes	m3	4,254	418	1,778,172	Bazuar ne Analize e cmimit dhe ne pershkrimin e punimeve nuk perputhen me preventivin e objektit që prokurohet
6	An.164/1b	Mbushje me cakell e gur gurore ne trupine rruges, perhapur e ngjeshur me makineri (per trasene e mbrojtjes dhe rruget hyrese)	m3	4,454	1,854	8,257,716	Bazuar ne Analize e çmimit dhe ne pershkrimin e punimeve nuk perputhen me preventivin e objektit që prokurohet
7	An.SD7	Shpim me sonda me nevojen per kemishim gjate procesit te shpimit cl>1200mm, thellesia derl ne 30m	m	9,288	15,246	141,604,848	Bazuar ne Analize e çmimit dhe ne pershkrimin e punimeve nuk perputhen me preventivin e objektit që prokurohet
8	AN-8	Mbushje me cakell pas mureve mbajtes	m3	7,194	1,854	13,337,676	Bazuar ne Analize e çmimit dhe ne pershkrimin e punimeve nuk

							<i>perputhen me preventivin e objektit që prokurohet</i>
9	3,193/b	<i>Shtrese filtri t=20cm (d=0-40} mm poshte shtreses mbrojtese me gure dhe betoni</i>	<i>m2</i>	864	524	452,736	<i>Bazuar ne Analize e çmimit dhe ne pershkrimin e punimeve nuk perputhen me preventivin e objektit që prokurohet</i>
10	AN.1	<i>Mbushje me gure kave, te vendosur, me peshe nga 0,03-0,05 ton (per mbrojtjen e skarpates)</i>	<i>m3</i>	953	1,854	1,766,862	<i>Bazuar ne Analize e çmimit dhe ne pershkrimin e punimeve nuk perputhen me preventivin e objektit që prokurohet</i>
11	AN.49	<i>Prishje struktura prej betoni te mbrojtjeve te shkaterruara</i>	<i>m3</i>	600	2,366	1,419,600	<i>Bazuar ne Analize e çmimit dhe ne pershkrimin e punimeve nuk perputhen me preventivin e objektit që prokurohet</i>

12	AN-9	Mbushje me zhavor poshte shtreses mbrojtese prej betoni	m3	61	1,854	113,650	Bazuar ne Analize e çmimit dhe ne pershkrimin e punimeve nuk perputhen me preventivin e objektit që prokurohet
13	3.245/1	Struktura monolite beloni C25/30, per pilota dhe traun e vazhduar te tyre	m3	14,965	11,487	171,903,885	Bazuar ne Analize e çmimit dhe ne pershkrimin e punimeve nuk perputhen me preventivin e objektit që prokurohet
14	3.244	Struktura monolite betonl C20/25, per muret mbajtes dhe shtresat mbrojtese skarpates	m3	4,241	11,449	48,558,380	Bazuar ne Analize e çmimit dhe ne pershkrimin e punimeve nuk perputhen me preventivin e objektit që prokurohet
15	3.240	Struktura monolite betonl C20/15 per mbushjet e hapësirave ndermjet traun dhe shtreses se	m3	1,162	10,304	11,973,248	Bazuar ne Analize e çmimit dhe ne pershkrimin e punimeve nuk

		<i>betonit ekzistues dhe traut te rine kokat e pilotave</i>					<i>perputhen me preventivin e objektit që prokurohet</i>
16	3.288	<i>FV hekur betoni periodik Ø > 12 mm</i>	<i>ton</i>	1,489	107,694	160,403,751	<i>Bazuar ne Analize e çmimit dhe ne pershkrimin e punimeve nuk perputhen me preventivin e objektit që prokurohet</i>
		SHUMA				568,609,805	
		FONDI REZERVE 5%					
		Totali me fondin rezerve				568,609,805	
		TVSH 20 %				113,721,961	
		TOTALI METVSH				682,331,766	

KVO konstaton se operatori ekonomik ka kryer punime të ngjashme për punime dhe mbrojtje lumore sistemime hidraulike dhe bonifikime etj., por në asnjë rast nuk dëshmon se disponon eksperiencën e nevojshme për Rikonstruksion dhe mirëmbajtje godinash civile e industriale, të cilat kërkojnë ekspertizë dhe eksperiencë të ndryshme nga ato të dëshmuara nga operatori ekonomik me anë të kontratës së sipërcituara, pasi edhe metodologjia e ndërtimit të tyre është e ndryshme etj. KVO gjykon se krahasueshmëria e kontratës nëse janë të ngjashme nuk ka të bëjë vetëm me natyrën e kontratës nëse ajo është një kontratë pune publike, por duhet parë në lidhje me të gjithë zërat konkretë të punimeve të kryera. Në rastin konkret, pavarësisht se kontratat janë punë publike me objekte të gjëra veprimtarie, në zbatimin e këtyre kontratave nuk ka pasur punime të ngjashme me një pjesë të rëndësishme të punimeve objekt prokurimi dhe për rrjedhojë kontrata e mësipërme nuk do të merret parasysh.

Kontrata me Nr.37/8 date 28.09.2020 me objekt Permiresim i banesave ekzistuese per komunitetet te varfëra dhe te pafavorizuara (Rikonstruksion) me vlere 26876125 pa TVSh i mungon -Formular vleresimi per realizimin e punimeve sipas shtojcës Nr. 9. Kjo Kontrate nuk do të merret parasysh pasi nuk ploteson kerkesat e kriterëve te vecanta te kualifikimit Kapaciteti teknik 2.3.1.

Kontrata me Nr.2832/5 date 11.06.2019 me objekt “Rikonstruksion i shkolles se mesme profesionale 26 Marsi” me vlere 106,395,557 pa tvsh konstatohet se formulari i vlersimit nuk është plotësuar sipas kërkesave të dokumenteve standarde te tenderit, nuk dëshmon që OE “Alko Impex General Construction” SHPK ka qenë Bashkimi Operatoresh Ekonomik me shoqërine “2T” ShPK. Në shtojcen 9 të dokumenteve standardet të tenderit duket qartë se kur një kontratë është kryer nga nje bashkim operatorësh ekonomikë duhet të plotësohet Bashkimit të operatorëve NIPTET/ dhe % e bashkimit te O.E.

Kontrata për bashkimin e përkohshëm të shoqërive Nr.2703.Rep Nr.2050.Kol date 16.04.2019 është fotokopje në kundërshtim me kërkesën ne kriteret e veçanta te kualifikimit paragrafi I fundit, ku cilësohet: **“Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara...”**

Kontrata me Nr.2317/4 date 27.12.2017 me objekt “Realizim i rehabilitimit te kullës se Kontigjences” me vlere te realizuar: 36,805,018 pa TVSh;, Kontrata me Nr.5196 date 24.02.2020 me objekt: “Rikonceptim dhe unifikim i veshjeve strukturore dhe shesheve funksionale ne disa Drejtori Rajonale e ndare ne 2 lote” me vlere te realizuar: 23,552,692 pa tvsh;, Kontrata me Nr.1643/6 date 22.05.2017 me objekt: "Rikonstruksion i shkolles Ali Myftiu Elbasan” me vlere te realizuar: 80896117 pa tvsh dhe Kontrata me Nr.1195 date 09.06.2020 me objekt: “Rindertimi i kopshtit Niko Hoxha Kamez”, me vlere te realizuar: 30,222,222 pa TVSh. Ne lidhje me keto kontrata te vlefshme OE “Alko Impex General Construction” SHPK ka paraqitur punë të ngjashme me vlera totale: 171,476,048 lekë pa TVSh, nga **650,099,968** lekë qe duhet te paraqiste ne permbushje te pikes 2.3.1

OE “Alko Impex General Construction” SHPK bazuar dokumentacionit te paraqitur ne SPE rezulton qe mbeshtetet ne me shume se 50% te kapaciteteve teknike subjekti “2 T” ShPK ne lidhje me plotesimin e pikes 2.3.1 te kapacitetit teknik, kjo ne kundërshtim me VKM 285, date 19.05.2021 “Rregullat e Prokurimit Publik”, te ndryshuar, Neni 90 “Mbështetja në kapacitetet e subjekteve të tjera”, pika 2 ku citohet: [...] Në çdo rast, operatori ekonomik ofertues që dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, duhet të provojë se plotëson të paktën 50% të kërkesave të përcaktuara nga autoriteti ose enti kontraktor [...].

D. OE “Alko Impex General Construction” SHPK mbeshtetet ne me shume se 50% te kapaciteteve teknike nga OE “Alko Impex Construction” SHPK me nipt K91628013D, ne lidhje me plotesimin e pikes 2.3.9 te kapacitetit teknik “Alko Impex General Construction” disponon 35 punonjes, ndersa shoqeria mbeshtetese “Alko Impex Construction” SHPK sipas dokumentacionit te paraqitur ne SPE e mbeshtet me 37 punonjes), kjo ne kundërshtim me VKM 285, date 19.05.2021 “Rregullat e Prokurimit Publik”, te ndryshuar, Neni 90 “Mbështetja në kapacitetet e subjekteve të tjera”, pika 2 ku citohet: [...] Në çdo rast, operatori ekonomik ofertues që dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, duhet të provojë se plotëson të paktën 50% të kërkesave të përcaktuara nga autoriteti ose enti kontraktor [...].

II.21. Në datën 21.11.2023, autoriteti kontraktor ka publikuar në Sistemin e Prokurimit Elektronik “Publikimi i Njoftimit të Fituesit Paraprak” për procedurën e prokurimit objekt-shqyrtimi.

II.22. Në datën 30.11.2023, nëpërmejt sistemit të ankesave elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe autoritetit kontraktor, është dorëzuar ankesa me nr. A/2023/3655 dhe me nr. 2969/2023 prot, datë 30.11.2023 e operatorit ekonomik “Alko Impex General Construction” SHPK, ku u konstatua se objekti i saj lidhet me kundërshtimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, mbi skualifikimin e ofertës së tij ekonomike si dhe anulimin e procedurës së prokurimit objekt - shqyrtimi me pretendime si më poshtë vijon:

A. Ne dst si dhe shtojcen per ndryshime ne dst te publikuar ne spe per kete procedure prokurimi ne kriteret e vecanta per kualifikim konkretisht: 2.4 ikerkesa te tjera te vecanta per kualifikim pika , pika 2.4.3) eshte kerkuar: 2.4.3 per impiantin e gazeve mjekesore dhe pajisjet mjekesore - operatori ekonomik ofertues duhet te paraqese nje dokument nga organet shtetërore qe pajisjet mjekesore jane te autorizuar per tregtim ne Republiken e Shqipërise, duhet te paraqitet dokument leshuar nga agencia kombëtare e barnave dhe pajisjeve: mjekesore certifikate regjistrimi ne përputhje me ligjin 89/2014 për pajisjet mjekësore. - operatori ekonomik duhet te paraqese kontratë furnizimi nga prodhuesi ose distributori i autorizuar nga prodhuesi, me të cilin prodhuesi/distributor i autorizuar autorizon kompanine pjesemarrëse ne tender te ofertoje keto pajisje ne kete procedure prokurimi. Plan - organizimin e punimeve te objektit ku te reflektoje te gjitha masat tekniko-organizative dhe elementet e tjere qe kerkon nje plan organizimi të mirefillte. Planin e sigurise ne kantier per punimet ne objekt ne format sipas vkm nr. 692 date 18.12.2001 per masat e veçanta te sigurimit dhe ruajtjes se shendetit ne pune, te ndryshuar me vkm nr. 742 date 06.11.2003 , sipas kerkesave, si rrethimi provizor, depozitimi i materialeve kryesore, ambientet e kantierit, rruge kalimet, tabelat e sig, teknik etj. Grafikon e punimeve ne perputhje me afatin e realizmit te punimeve. Analize teknike per te gjithë zerat e preventivit te ofertës. Mosparaqitja ne formen e kerkuar perben kusht per skualifikim. Bazuar ne vkm nr. 514, date 15.08.2007 per informatizimin e llogaritjes se kosos dhe hartimin e manualeve teknike te çmimeve te punimeve te ndertimit , pika 10.

B. Referuar dokumentacionit te paraqitur oe alko-impex general construcion nuk ploteson piken 2,4,3 ne lidhje me analizen teknike analizat teknike te cmimeve te paraqitura nuk jane plotesuar sipas vkm nr.113 date 1.03.2023 per percaktimin e pages minimale ne shkalle vendi, ku ne piken 3 te kesaj vkm-je percaktohet: 3. Paga bazë minimale orare te jete 229,9 (dyqind e njëzet e nente pike nente) leke, por ne shumicen e zerave te punes kjo page eshte e ulet dhe e padiferencuar per kategori punetoresh te kualifikuar edhe pse duke qene se jane punime speciale oe alko-impex general construcion e ka percaktuar oren e punes 185 leke ne te gjitha proceset e punes duke mos bere diferencim te kategorizimit te puntoreve sipas specialiteteve por me pagese me te ulet dhe se minimumi i percaktuar sipas vm nr.113 date 1.03.2023. Bazar ne vkm nr. 514 date 15.08.2007 per informatizimin e llogaritjes se kosos dhe hartimin e manualeve teknike te çmimeve te punimeve te ndertimi pika 10 thuhet: operatori ekonomik pjesemarrës ne tender se bashku me preventivin duhet te dorëzojë analizen teknike per te gjithë zerat e preventivit te ofertes. Mos paraqitja ne formen e kerkuar perben kusht per skualifikim. Oe alko-impex general construcion nuk e ka respektuar kete kusht, nuk ka paraqitur te sakte analizen teknike sipas legjislacionit ne fuqi.

C. Referuar formularit permblledhes te vetedeklarimit sipas shtojces 8 te dst perkatesisht pika 2.3.9 Oe alko-impex general construcion ka deklaruar staf teknik punonjesit g.a dhe g.xh per punime duralumini te pajisur me certifikate kualifikimi leshuar nga subjekti fusion engineering venture me nius l71813001c. Gjithashtu oe alko-impex general construcion eshte mbeshtetur nga subjekti alko impex general construction shpk dhe ka deklaruar punonjesit a.b dhe v.b per punime duralumini te pajisur me certifikate kualifikimi leshuar nga subjekti fusion engineering venture me nius l71813001c. Nga verifikimet e kryera subjekti fusion engineering venture nuk eshte i pajisur me miratim/akreditim per te ofruar kursin per punime duralumini. Nga verifikimi i kryer ne faqen zyrtare www.qkb.gov.al, ne seksionin kerko per licence, shoqëria si me siper eshte e licencuar me licencen me nr. Ln-2242-04-2021 me titull formim profesional per te cilen figurojne 3 (tre) miratimet nga ministria e financave dhe ekonomise dhe nga qkb: - me vendimin nr. 6344/2 prot., date 04.05.2021, i eshte miratuar nga ministria e financave dhe ekonomise. - me vendimin nr. 15695/2 prot., date 02.09.2022, i eshte miratuar nga ministria e financave dhe ekonomise. Me vendimin nr. 10232/2 prot., date 04.07.2028, i eshte miratuar nga ministria e financave dhe ekonomise. Ne keto tre miratime, rezulton se shoqeria fusion engineering venture me nuis L71813001C eshte e licencuar per ofrimin e kurseve profesionale te ndryshme por jo per ofrimin e kurseve profesionale sipas ligit nr. 15/2017 per arsimin dhe formimin profesional ne r.sh. Per profesionet punime duralumini oe nuk ploteson piken 2.3.9 te kerkuar ne dst ne 2.3 kapaciteti teknik , pasi nuk ka paraqitur 4 (kater) punonjes duralumini te vertetuar me diploma/certifikata te arsimit profesional te leshuara nga institucionet te akredituara sipas ligit ne 15/2017 per arsimin dhe formimin profesional ne Republiken e Shqiperise ose ekuivalente. (kete qendrim ka mbajtur edhe kpp ne vendimin nr. 745/2022 ne lidhje me deshmite e leshuara nga subjekte te palicencuara).

D. Referuar formularit permblledhes te vetedeklarimit sipas shtojces 8 te dt perkatesisht pika 2.3.9 OE Alko-Impex General Construcion ka deklaruar staf teknik punonjesin mekanik b.m te pajisur me certifikate kualifikimi leshuar nga subjekti fusion engineering venture me nius l71813001c. Na verifikimi i kryer ne faqen zyrtare www.qkb.gov.al, ne seksionin kerko per licence, shoqëria si me siper eshte e licencuar me licencen me nr. Ln-2242-04-2021 me titull formim profesional per te cilen figurojne 3 miratimet nga ministria e financave dhe ekonomise dhe nga qkb: me vendimin nr. 6344/2 prot., date 04.05.2021, i eshte miratuar nga ministria e Financave dhe ekonomise.- me vendimin nr .15695/2 prot. Date 02.09.2022, eshte miratuar nga ministria e financave dhe ekonomise. - me vendimin nr. 10232/2 prot., date 04.07.2023, eshte miratuar nga ministria e financave dhe ekonomise. Ne keto tre miratime , rezulton se shoqeria fusion engineering venture me nuis L71813001C eshte e licencuar per ofrimin e kurseve profesionale te ndryshme por jo per ofrimin e kurseve profesionale sipas ligjit nr.15/2017 per arsimin dhe formimin profesional ne r.sh. Per profesionet mekanikë OE nuk ploteson piken 2.3.9 te kerkuar ne dst ne 2.3 kapaciteti teknikë pasi nuk ka paraqitur 1 (nje) punonjes mekanik te vertetuar me diplome /certifikate te arsimit profesional te leshuara nga institucionet e akredituara sipas ligjit nr.15/2017 per arsimin dhe formimin profesional ne Republiken e Shqiperise ose ekuivalente. (kete qendrim ka mbajtur edhe kkp ne vendimin nr.745/2022 ne lidhje me deshmite e leshuara nga subjekte te palicencuara).

C. ne dst si dhe shtojcen per ndryshime ne dst te publikuar ne spe per kete procedure prokurimi ne kriteret e vecanta per kualifikim konkretisht: 2.4 kerkesa te tjera te vecanta per kualifikim pika, pika 2.4.2) eshte kerkuar: 2.4.2 operatori ekonomik ofertues duhet te paraqese autorizim prodhuesi ose distributori. Në rast paraqitje autorizim distributori duhet te paraqitet kontrata ose dokumenti i angazhimit midis prodhuesit dhe distributorit, për materialet (pajisjet mjekesore, hidroizolues, pajisjet mekanike, pajisjet hidrosanitare, shtrese pvc antibakteriale, dyer/dritare, gipse, bojrat, pajisjet e zjarrit, pajisjet e sistemin hvac, ashensori) per objektet shendetesore. Per materialet e kerkara oe duhet te paraqese katalogun/et ose skedat teknike te prodhuesit/ve, ku te specifikohen materialet qe do te ofrohen si dhe te paraqiten certifikate/deklarate konfirmiteti ce ose ekuivalente, me qellim permbushjen e standardeve te kerkuara ne specifikimet teknike. Operatori ekonomik duhet te paraqese oferten teknike, ne formen e nje table sipas modelit te meposhtem, e cila duhet te plotësohet ne menyre rigoroze. Oferta teknike duhet te permbaje te dhenat si me poshte; nr. Emri i kompanise prodhuese emertimi i katalogut te prodhuesit nr i faqes nr. Rep dhe nr.kol (njehesim origjinali-vertetim perkthimi 1. Te dhenat e deklaruara ne oferten teknike duhet te korrespondojne me te dhenat per artikujt ne kataloget/skedat teknike te dorezuara ne spe. Moskorrespondimi i ketyre te dhenave do te sjelle pavlefshmeri te ofertes. Ne lidhje me kete pike OE Alko-Impex General Construcion ka deklaruar te dhena per materialet me te cilat eshte autorizuar per te marre pjese ne kete procedure prokurimi. OE Alko-Impex General Construcion nuk ka plotesuar dhe nuk ka paraqitur oferten teknike sipas tabelës se kerkuar ne piken 2.4.2. Materialet, e paraqitura nga oe ne spe nuk jane te perkthyer ne gjuhen shqipe, gjuhe ne te cilen jane kerkuar dokumentat ne dst referuar pikes 4.7 gjuha (et) ne te cilat mund te hartohen ofertat: shqip x anglisht si dhe ne shtojcen 7 ne kriteret e pergjithshme te perzgjedhjes/kualifikimit eshte kerkuar/parashikuar: nese gjuha e perdorur ne procedure eshte gjuha shqipe, atehere dokumentet e gjuhes se huaj duhet te shoqerohen nga nje perkthim i noterizuar ne shqip. Ne DST eshte percaktuar qe te dhenat e deklaruara ne oferten teknike duhet te korespondojne me te dhenat per artikujt ne kataloget/skedat teknike te dorezuara ne spe. Moskorespondimi i ketyre te dhënave do te sjelle pavlefshmeri te ofertes po rendisim mangesite e OE Alko-Impex General Construcion sipas dakumentacionit te dorezuar ne spe ne lidhje me kete pike (ne kriteret e vecanta per kualifikim 2.4 kerkesa te tjera te vecanta per kualifikim pika, pika 2.4.2), si me poshte: - per pajisjet mjekësore mungon katalogu ose skedat teknike sipas kerkesave te dst 2.4.2 te dokumenteve standarde te tenderit. - per materialin hidroizolues ka paraqitur test raporte ne gjuhen angleze (te paperkthyer dhe noterizuar). – per materialet pajisje fikje zjarrit nuk ka paraqitur autorizim prodhuesi ose distributori me bocciolone antincendio s.p.a disponon vetem katalog ne gjuhen italiane (te paperkthyer dhe noterizuar). – per materialet shtrese pvc antibakteriale ka paraqitur autorizim nga distributor tekno edil, katalogu ne gjuhen angleze dhe certifikata ne gjuhen angleze (te paperkthyer dhe noterizuar). - nuk ka paraqitur autorizim prodhuesi ose distributori, katalog ose skede teknike per dyer te brendshme laminat me kase alumini e pajisur me aksesore heavy duty, me nje ose dy kanata sipas vizatimeve. - per materialin gips ka paraqitur autorizim prodhuesi nga dekolll sh.a shoqeruar me katalog te weber saint gobain, dekall sh. A nuk verteton se prodhon materiale gipsi, mungon katalogu ose skedat teknike si dhe certifikata/deklarata konformitetit CE. - per materialin boje autorizimi prodhuesit.colarificio sammarinese s.p.a eshte ne gjuhen italiane, skeda teknike ne gjuhen italiane dhe certifikate ne gjuhen italiane (te paperkthyer dhe noterizuara) paisjet e sistemit

hvac, ka paraqitur kontrat furnizimi nga haki sianani, mungon autorizim prodhuesit, mungojne kataloget per (pompe nxehtesie, njesi traitimi ajri dergim, njesi trajtimi ajri rikthim, njesi trajtimi ajri rikuperator nxetesie, fan coil dyshemje, mono split mural, radiator celiku) si dhe certifikata/deklarata konformitetit CE. - paisjet e sistemit hvac, ka paraqitur kaldaje nga prodhuesi centrometac d.o.o ne gjuhen angleze, katalog /skeda teknike ne gjuhen angleze (te paperkthyer dhe notenzuara). - nuk ka paraqitur autorizim prodhuesi ose distributori per pompe karburanti. - nuk ka paraqitur autorizim prodhuesi ose distributori per rezervuari i lendes djegese. OE Alko-Impex General Construcion nuk ploteson specifikimet e kerkuara, nuk ka plotesuar oferten teknike rrjedhimisht oferta e paraqitur eshte e pavlefshme.

Ç. Ne dst te publikuar ne spe per kete procedure prokurimi ne kriteret e vecanta per kualifikim konkretisht: 2.3 kapaciteti teknik, pika 2.3.1) eshte kerkuar: 2.3 kapaciteti teknik: 2.3.1 operatoret ekonomike duhet te kene pervoje te suksesshme ne kontrata te meparshme dhe per kete duhet te paraqesin: a) dokumentacion per pune te ngjashme per nje objekt te vetem ne nie vlere jo me te ulet se 40% e vleres se perlllogaritur te kontrates qe prokurohet dhe qe eshte realizuar gjate pese viteve te fundit, nga data e shpalljes se njoftimit te kontrates; b) dokumentacion per pune te ngjashme deri ne nje kufi, ku vlere monetare totale e punëve te kryera, e marre se bashku gjate pese viteve te fundit, eshte jo më e ulet se dyfishi i vleres limit te kontrates qe prokurohet. - plotesimi i njerit prej dy kushteve te siperpermendura e ben oferten te kualifikueshme. - ne rast se oferta paraqitet nga nje bashkim operatoresh, kushti i percaktuar ne shkronjen ia iplotesohet nga anetari, i cili ka perqindjen me te madhe te pjesemarrjes ne bashkim. Anetaret e tjere te bashkimit do te paraqesin kontrata te ngjashme, ne raport me perqindjen e pjesemarrjes se tyre ne bashkim. Ne rastin kur operatoret ekonomikë, anetaret e nje bashkimi, kane te njejten perqindje pjesemarrjeje ne bashkim, vendosin me marreveshje ne kontraten e bashkepunimit se cila prej tyre do te permbushe kete kusht. Vlerësimi i përvojës së suksesshme të operatorit ekonomik do të kryhet bazuar ne deklaratat e dokumentet e mëposhtëm: per kontrata te realizuara me ente publike operatori ekonomik duhet te paraqese dokumentacionin e meposhtem: - formular vleresimi per realizimin e punimeve sipas shtojcës nr.9 (ku të përcaktohet qartazi vlere, afati i perfundimit te kontrates si dhe natyra e punes se kryer). Kontrate sipermarrje, - situacionin përfundimtar; - fatura tatimore perkatese. Aktin e kolaudimit; - certifikata e marrjes ne dorezim. Për kontrata të realizuara me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e meposhtem: - formular vleresimi per realizimin e punimeve sipas shtojcës nr. 9 (ku të përcaktohet qartazi vlere, afati i perfundimit te kontrates si dhe natyra e punes se kryer. - kontrate sipërmarrje; -situacionin përfundimtar; - fatura tatimore perkatese. Aktin e kolaudimit; - certifikata perdorimi/marrjes ne dorezim. Për kontrata të realizuara me bashkim operatoresh, operatori ekonomik ofertues, krahas dokumentacionit të sipërcituar për secilin rast respektivisht, duhet te paraqesë edhe kontraten e bashkimit te operatoreve shoqeruar me tabelen e ndarjes se punimeve ,ku te cilesohen punimet qe ka marre persiper te kryeje secili anetar i boe. Për përmbushjen e kësaj kërkesë, operatori ekonomik Alko-Impex General Construcion, ka paraqitur në sistemin e prokurimit elektronik, dokumente te rrjedhjes se lumit Drin ne biefin e poshtem te diges se fierzes me vlere 56,8609,805 pa tvsh, kontrate e cila nuk është as në natyrë as në kompleksitet as në metodologji punimesh e ngjashme me objektin qe prokurohet,kjo referuar dhe zerave te punimeve qe ka kryer oe alko-impex general construcion,

ne objektin e paraqitur, si rrjedhoje nuk mund te konsiderohen punime te ngjashme me objektin qe prokurohet. Nga shqyrtimi i dokumentacionit, i paraqitur nga oe alko-impex general construcion, ne permbushje te kriterit per punime te ngjashme nga krahasimi i situacioneve perfundimtare te punimeve perfundimtare ne zbatim te kontrates te sipercituara, te realizuara OE Alko-Impex General Construcion, me preventivin dhe relacionin teknik te objektit te prokurimit te kontrates: nr an pershkrimi i punimeve njesia sasia cmimi vlera pershkrimi bazuar ne zerat e preventivit te punimeve 1 3.106/b.germim dheu me ekskavator me zinxhir 0.5 m³ per trasen e mbrojtjes dhe rruget hyrese ne kanale me gjeresi i >2m, prani uji 2 m, kategoria iv, me shkarkim ne mjet (shtrati i perroit rreth kuotes v 175 m) ml 2,365 1,888 4,464,742 bazuar ne analize e cmimit dhe ne pershkrimin e punimeve nuk perputhen me preventivin e objektit qe prokurohet 2 2.48/an germim shkemb i forte me cekic me ekskavator me zinxhir per trasen mbrojtese m³ 388 1.888 732.544 .bazuar ne analizen e cmimit dhe ne pershkrimin e punimeve nuk perputhen me preventivin e objektit qe prokurohet 3 an.124/4a. Germim shkemb i forte sek i lire, me mina te vogla me eskavator 1 m³ per trasen e mbrojtjes m³ 350 1.888 660,800 bazuar ne analizen e cmimit dhe ne pershkrimin e punimeve nuk perputhen me preventivin e objektit qe prokurohet. 4 358/2a.transport dheu me auto deri 2.0 km per zerat 1.2.3.11.m³ 3.703 319 1,181,193. Bazuar ne analizen e cmimit dhe ne pershkrimin e punimeve nuk perputhen me preventivin e objektit qe prokurohet 5 3.164. Rrafshim e ngjeshje dheu i germuar me shtres jo me shume se 30 cm per trasen e mbrojtjes m³ 4,254 418 1,778,172. Bazuar ne analizen e cmimit dhe ne pershkrimin e punimeve nuk perputhen me preventivin e objektit qe prokurohet 6 an164/1b mbushje me cakull e gur gurore ne trupin e rruges, perhapur e ngjeshur me makineri (per trasene e mbrojtjes dhe rruget hyrese) m³ 4,454 1,854 8,257,716. Bazuar ne analizen e cmimit dhe ne pershkrimin e punimeve nuk perputhen me preventivin e objektit qe prokurohet 7 an. sd7 shpim me sonda me nevojen per kemishim gjate procesit te shpimit cl>1200mm, thellesia deri ne 30 mm 9,288 15,246 141,604,848 bazuar ne analizen e cmimit dhe ne pershkrimin e punimeve nuk perputhen me preventivin e objektit qe prokurohet 8 an-8 mbushje me cakell pas mureve mbajtes m³ 7,194 1,854 13,337,676 bazuar ne analizen e cmimit dhe ne pershkrimin e punimeve nuk perputhen me preventivin e objektit qe prokurohet 9 3,193/b shtrese filtri t=20 cm (d=0-40)mm poshte shtreses mbrojtese me gure dhe betoni m² 864 524 452,736 .bazuar ne analizen e cmimit dhe ne pershkrimin e punimeve nuk perputhen me preventivin e objektit qe prokurohet 10 an.1 mbushje me gure kave, te vendosur, me peshe nga 0,03-0,05 ton (per mbrojtjen e skarpates) m³ 953 1,854 1,766,862 bazuar ne analizen e cmimit dhe ne pershkrimin e punimeve nuk perputhen me preventivin e objektit qe prokurohet 11 an.49 prishje struktura prej betoni te mbrojtjeve te shkaterruara m³ 600 2,366 1,419,600 bazuar ne analizen e cmimit dhe ne pershkrimin e punimeve nuk perputhen me preventivin e objektit qe prokurohet an-9 mbushje me zhavorr poshte shtreses mbrojtese prej betoni m³ 61 1,854 113,650 bazuar ne analizen e cmimit dhe ne pershkrimin e punimeve nuk perputhen me preventivin e objektit qe prokurohet 13 3.245/1 struktura monolite beloni c25/30, per pilota dhe traun e vazhduar te tyre m³ 14,965 11,487 171,903,885 bazuar ne analize e cmimit dhe ne pershkrimin e punimeve nuk perputhen me preventivin e objektit ge prokurohet 14 3.244 struktura monolite betoni c20/25, per muret mbajtes dhe shtresat mbrojtese skarpates m³ 4,241 11,449 48,558,380 bazuar ne analize e cmimit dhe ne pershkrimin e punimeve nuk perputhen me preventivin e objektit qe prokurohet 15 3.240 struktura monolite betonl c20/15 per mbushjet e hapsirave ndermjet traun dhe shtreses se betonit ekzistues dhe traun te rine kokat e pilotave

m3 1,162 10,304 11,973,248 bazuar ne analize e çmimit dhe ne pershkrimin e punimeve nuk perputhen me preventivin e objektit qe prokurohet 16 3.288 fv hekur betoni periodik? > 12 mm ton 1,489 107,694 160,403,751 bazuar ne analize e cmimit dhe ne pershkrimin e punimeve nuk perputhen me preventivin e objektit qe prokurohet shuma 568,609,805 fondi rezerve 5% totali me fondin rezerve 568,609,805 TVSh 20 % 113,721,961 totali me TVSh 682,331,766 kvo konstaton se operatori ekonomik ka kryer punime te ngjashme per punime dhe mbrojtje lumore sistemime hidraulike dhe bonifikime etj, por ne asnje rast nuk deshmon se disponon eksperiencen e nevojshme per rikonstruksion dhe mirembajtje godinash civile e industriale, te cilat kerkojne espertize dhe eksperience te ndryshme nga ato te deshmuara nga operatori ekonomik me ane te kontrates se sipercituara, pasi edhe metodologjia e ndertimit te tyre eshte e ndryshme etj. KVO gjykon se krahasueshmeria e kontrates nese jane te ngjashme nuk ka te beje vetem me natyren e Kontrates nese ajo eshte nje kontrate pune publike, por duhet pare ne lidhje me te githe zerat konkrete te punimeve te kryera. Ne rastin konkret, pavaresisht se kontratat jane pune publike me objekte te gjera veprimtarie, ne zbatimin e ketyre kontratave nuk ka patur punime te ngjashme me nje pjese te rendësishme te punimeve objekt prokurimi dhe per rjedhoje kontrata e mesiperme nuk do te merret parasysht. Kontrata me nr.37/8 date 28.09.2020 me objekt permiresim i banesave ekzistuese per komunitetet te varfera dhe te pafavorizuara (rikonstruksion) me vlere 26876125 pa TVSh i mungon formular vleresimi per realizimin e punimeve sipas shtojces nr. 9. Kjo kontrate nuk do te merret parasysht pasi nuk ploteson kerkesat e kriterave te vecanta te kualifikimit kapaciteti teknik 2.3.1. Kontrata me nr.2832/5 date 11.06.2019 me objekt rikonstruksion i shkollës së mesme profesionale 26 marsi me vlere 106,395,557 pa TVSh konstatohet se formulari vleresimit nuk eshte plotesuar sipas kerkesave te dokumenteve standarde te tenderit, nuk deshmon qe oe alko-impex general construcion ka qene bashkimi operatorësh ekonomik me shoqerine 2T shpk. Ne shtojcen 9 te dokumenteve standardet te tenderit duket qarte se kur nje kontratë e eshte kryer nga nje bashkim operatorësh ekonomik duhet te plotesohet bashkimit te operatoreve niptet/ dhe % e bashkimit te o.e. kontrata per bashkimin e perkohshem te shoqerive nr.2703 rep nr2050.kol date 16.04. 2019 eshte fotokopje ne kundershtim me kerkesen ne kriteret e vecanta te kualifikimit paragrafi i fundit, ku cilesohet te gjitha dokumentet duhet te jene origjinale ose kopje te noterizuara. Kontrata me nr.2317/4 date 27.12.2017 me objekt realizim i rehabilitimit të kullës së kontigjences me vlere te realizuar: 36,805,018 pa tvsh, kontrata me nr.5195 date 24. 02. 2020 me objekt: Rikonceptim dhe unifikim i veshjeve strukturore dhe shesheve funksionale ne disa drejtori rajonale e ndare ne 2 lote me vlere te realizuar: 23,552,692 pa TVSh;, Kontrata me nr.1643/6 date 22.05.2017 me objekt: Rikonstruksion i shkollës “Ali Myftiu” Elbasan me vlere te realizuar 80896117 pa TVSh dhe kontrata me nr.1195 date 09.06.2020 me objekt: Rindertimi i kopshtit Niko Hoxha Kamez, me vlere te realizuar: 30,222,222 pa TVSh. Ne lidhje me keto kontrata te vlefshme OE Alko-Impex General Construcion ka paraqitur pune te ngjashme me vlera totale: 171,476,048 leke pa TVSh, nga 650,099,968 leke qe duhet te paraqiste ne permbushje te pikes 2.3.1 OE Alko-Impex General Construcion bazuar dokumentacionit te paraqitur ne SPE rezultan qe mbeshtetet ne me shume se 50% te kapaciteteve teknike subjekti 2T ShPK ne lidhje me plotesimin e pikes 2.3.1 te kapacitetit teknik, kjo ne kundershtim me vkm 285, date 19.05.2021 rregullat e prokurimit publik, te ndryshuar, neni 90 mbeshtetja ne kapacitetet e subjekteve te tjera, pika 2 ku citohet: [...] Ne cdo rast, operatori ekonomik ofertues qe deshiron te mbeshtetet ne kapacitetet e

subjekteve te tjera, duhet te provoje se ploteson te pakten 50% te kerkesave te percaktuara nga autoriteti ose enti kontraktor [.].

D. OE Alko-Impex General Construcion mbeshtetet ne me shume se 50% te kapaciteteve teknike nga OE Alko-Impex General Construcion me nipt K91628013D, ne lidhje me plotesimin e pikes 2.3.9 te kapacitetit teknik (Alko-Impex General Construcion disponon 35 punonjes, ndersa shoqeria mbeshtetese Alko Impex Construction sipas dokumentacionit te paraqitur ne SPE e mbeshtet me 37 punonjes), kjo ne kundershkrim me vkm 285, date 19.05.2021 rregullat e prokurimit publik, te ndryshuar, neni 90 mbeshtetja ne kapacitetet e subjekteve te tjera, pika 2 ku citohet: [...] Ne cdo rast, operatori ekonomik ofertues qe deshiron te mbeshtetet ne kapacitetet e subjekteve te tjera, duhet te provoje se ploteson te pakten 50% te kerkesave te percaktuara nga autoritet ose enti kontraktor....së pari vërejmë se nga ana e KVO jemi skualifikuar për arsye të cilat çmojmë se KVO duhet ti kishte konstatuar si kriteri që vijnë në kundërshtim me ligjin dhe se vlerësimi në këtë rast është bërë subjektivisht për sa më poshtë sqarojmë.

KVO si arsye skualifikimi citon:

A. Ne dst si dhe shtojcen per ndryshime ne dst te publikuar ne spe per kete procedure prokurimi ne kriteret e veçanta per kualifikim konkretisht: 2.4 kerkesa te tjera te veçanta per kualifikim pika , pika 2.4.3) eshte kerkuar: 2.4.3 per impiantin e gazeve mjekesore dhe pajisjet mjekesore - operatori ekonomik ofertues duhet te paraqese nje dokument nga organet shtetërore qe pajisjet mjekesore jane te autorizuar per tregtim ne Republiken e Shqipërise, duhet te paraqitet dokument leshuar nga agjencia kombëtare e barnave dhe pajisjeve: mjekesore certifikate regjistrimi ne përputhje me ligjin 89/2014 per pajisjet mjekësore . - operatori ekonomik duhet te paraqese kontratë furnizimi nga prodhuesi ose distributori i autorizuar nga prodhuesi, me të cilin prodhuesi/distributor i autorizuar autorizon kompanine pjesemarrëse ne tender te ofertoje keto pajisje ne kete procedure prokurimi. Plan - organizimin e punimeve te objektit ku te reflektoje te gjitha masat tekniko-organizative dhe elementet e tjere qe kerkon nje plan organizimi të mirefillte. Planin e sigurise ne kantier per punimet ne objekt ne format sipas vkm nr. 692 date 18.12.2001 per masat e veçanta te sigurimit dhe ruajtjes se shendetit ne pune, te ndryshuar me vkm nr. 742 date 06.11.2003 , sipas kerkesave, si rrethimi provizor, depozitimi i materialeve kryesore, ambientet e kantierit, rruge kalimet, tabelat e sig, teknik etj. Grafikon e punimeve ne perputhje me afatin e realizmit te punimeve. Analize teknike per te gjithë zerat e preventivit te ofertes. Mosparaqitja ne formen e kerkuar perben kusht per skualifikim. Bazar ne vkm nr 514, date 15.08.2007 per informatizimin e llogaritjes se kostos dhe hartimin e manualeve teknike te çmimeve te punimeve te ndertimit , pika 10. Referuar dokumentacionit te paraqitur OE Alko-Impex General Construcion nuk ploteson piken 2.4.3 ne lidhje me analizen teknike analizat teknike te cmimeve te paraqitura nuk jane plotesuar sipas vkm nr.113 date 1.03.2023 per percaktimin e pages minimale ne shkalle vendi, ku ne piken 3 te kesaj vkm-je percaktohet: 3. Paga bazë minimale orare te jete 229,9 (dyqind e njëzet e nente pike nente) leke, por ne shumicen e zerave te punes kjo page eshte e ulet dhe e padiferencuar per kategori punetoresh te kualifikuar edhe pse duke qene se jane punime speciale OE Alko-Impex General Construcion e ka percaktuar oren e punes 185 leke ne te gjitha proceset e punes duke mos bere diferencim te kategorizimit te puntoreve sipas specialiteteve por me pagese me te ulet dhe se

minimumi i percaktuar sipas vkm nr.113 date 1.03.2023. Bazuar ne vkm nr. 514 date 15.08.2007 per informatizimin e llogaritjes se koshtos dhe hartimin e manualeve teknike te cmimeve te punimeve te ndertimi pika 10 thuhet: operatori ekonomik piesemarrës ne tender se bashku me preventivin duhet te dorëzojë analizen teknike per te githe zerat e preventivit te ofertes. Mosparaqitja ne formen e kerkuar perben kusht per skualifikim. OE Alko-Impex General Construcion nuk e ka respetuar kete kusht, nuk ka paraqitur te sakte analizen teknike sipas legjislacionit ne fuqi. Ndërkohë në dst nga ana e ak-së është kërkuar:

Plan - organizimin e punimeve të objektit ku te reflektoje te gjitha masat tekniko-organizative dhe elementet e tjere qe kerkon nje plan organizimi i mirëfilltë. Planin e sigurise ne kantier per punimet ne objekt ne format sipas vkm nr. 692 date 13.12.2001 per masat e vecanta te sigurimit dhe ruajtjes se shendetit ne pune, te ndryshuar me vkm nr. 742 date 06.11.2003ë, sipas kerkesave, si rrethimi provizor, depozitimi i materialeve kryesore, ambientet e kantierit, rruge kalimet, tabelat e sig. Teknik etj. Grafikon e punimeve në përputhje me afatin e realizmit të punimeve. Analiza teknike për të gjithë zërat e preventivit të ofertës. Mosparaqitja në formën e kërkuar përbën kusht për skualifikim. Bazuar në vkm nr 514, datë 15.08.2007 për informatizimin e llogaritjes së koshtos dhe hartimin e manualeve teknike të cmimeve të punimeve të ndërtimit, pika 10.

Së pari, lidhur me grafikun e punimeve vjen në kundërshtim me ligjin pasi: Në vkm nr. 285/2021 , në nenin 15 të është parashikuar: Përmbajtja e dokumenteve standarde të tenderit

1. Dokumentet standarde të tenderit përmbajnë informacionin e përgjithshëm dhe informacionin specifik.

2. Informacioni i përgjithshëm përgatitet sipas formularëve përkatës, pjesë e dokumenteve standarde të tenderit. Ky informacion përfshin të paktën:

- njoftimin paraprak të informacionit/ njoftimin periodik të Informacionit
- njoftimin e kontratës;
- ftesën për ofertë (në rastet e procedurave me faza);
- udhëzimet për kandidatët/ofertuesit;
- kriteret e përgjithshme të kualifikimit/pjesëmarrjes;
- formulari përmbledhës i vetëdeklarimit;
- deklaratën e konfliktit të interesit;
- deklaratën e informacionit konfidencial;
- formularin e ofertës ekonomike;
- sigurimin e ofertës;
- njoftimin e skualifikimit të ofertuesve/kandidatëve;
- njoftimin e fituesit
- formularin e ankesës;
- modelin e marrëveshjes kuadër;
- njoftim për lidhjen e marrëveshjes kuadër;
- model kontrate, ku përfshihen kushtet e përgjithshme dhe kushtet e veçanta të Propozuara të kontratës;
- sigurimin e kontratës;
- njoftimin e lidhjes së kontratës;

- njoftimin e anulimit të procedurës.

3. Informacioni specifik përmban informacion për kontratat e punëve, mallrave dhe shërbimeve:

A) informacioni specifik për kontratat e punëve përfshin të paktën:

- projektin dhe specifikimet;
- preventivin e hollësishëm dhe strukturën e kostos/ mënyrën e paraqitjes së Ofertës;
- grafikun e zbatimit;
- kërkesat e veçanta për kualifikim dhe kriteret e shpalljes së fituesit.

B) informacioni specifik për kontratat e mallrave përfshin të paktën:

- specifikimet teknike;
- grafikun e lëvrimit;
- kërkesat e veçanta për kualifikim dhe kriteret e shpalljes së fituesit.

C) informacioni specifik për kontratat e shërbimeve përfshin të paktën:

- termat e referencës;
- grafikun e ekzekutimit;
- kërkesat për personelin kryesor;
- kërkesat e veçanta për kualifikim dhe kriteret e shpalljes së fituesit.

Për sa më sipër, grafiku i zbatimit të kontratës është një kusht që duhet pasqyruar nga ana e Autoritetit kontraktor në dst në kuptim dhe zbatim në nenin 15. Vlerësimi i kryer nga KVO lidhur me këtë pikë për ofertuesit pjesëmarrës është subjektiv pasi në fakt një dokument i tillë duhet të ishte hartuar nga ana e autoritetit kontraktor. Së dyti, lidhur me pretendimin se: Analizat teknike të cmimeve të paraqitura nuk janë plotësuar sipas vkm nr.113 date 1.03.2023 për percaktimin e pages minimale në shkallë vendi, ku në pikën 3 të kësaj vkm-je percaktohet: 3. Paga bazë minimale orare të jete 229,9 (dyqind e njëzet e nente pike nente) leke, por në shumicën e zerave të punës kjo page është e ulët dhe e padiferencuar për kategori punëtorësh të kualifikuar edhe pse duke qenë se janë punime speciale OE Alko-Impex General Construcion e ka percaktuar orën e punës 185 leke. Ky citim bie ndesh si me ligjin dhe me vet koston e përlllogaritur nga ana e autoritetit kontraktor në momentin e përlllogaritjes së fondit limit. Autoriteti kontraktor në cdo rast për përlllogaritjen e fondit limit bazohet tek manuali cmimeve teknike të ndërtimit. Në vendimin e keshillit të ministrave nr. 216 date 13.04.2023 është vendosur që vendimi i mëparshëm që rregullon cmimet e zerave të punimeve në ndërtim. Nr. 629 date 15.07.2015 do të aplikohet deri në 3 muaj pas publikimit të sistemit të integruar. Hartimi i preventivit apo situacionit, si dhe zbatimi i mbikëqyrjes së cdo punimi ndërtimi, që realizohet nga persona fizikë dhe juridikë, publikë ose privatë, me fonde publike ose private, në territorin e republikës së shqipërisë, do të bëhet nëpërmjet sistemit të integruar të manualit të cmimeve për zërat e punimeve në ndërtim. Në referim të këtij manuali kosto e përlllogatitur për kategorinë e punëtorëve është percaktuar 185 lek, pra e njëjtë me atë të ofruar dhe nga ana e operatorit ekonomik ankimues. Për më tepër që kërkesa për dorëzimin e analiza teknike bie në kundërshtim me ligjin pasi ligji nuk parashikon një kërkim të tillë në këtë moment procedural ku ndodhet faza e procedurës së prokurimit. Në nenin 82 pika 4 të vkm-së nr. 285/2021 është

parashikuar: pas korrigjimit të gabimeve aritmetike, komisioni i vlerësimit të ofertave verifikon nëse ofertat e vlefshme janë ose jo me cmim anomalisht të ulët sipas formulës së përcaktuar në dokumentet standarde të tenderit. Përlllogaritja e ofertës anomalisht të ulët bëhet në mënyrat e mëposhtme: - në rastin kur janë të vlefshme dy ose më pak oferta, në përputhje me nenin 93, të LPP-së, oferta vlerësohet anomalisht e ulët kur ajo është ulur më shumë se 25% e fondit limit të përlllogaritur; - në rastin kur janë të vlefshme tri ose më shumë oferta, në përputhje me nenin 93, të lpp-së, oferta vlerësohet anomalisht e ulët nëse vlera e saj do të jetë më e vogël se 85% e mesatares së ofertave të vlefshme, komisioni i vlerësimit të ofertave duhet të kërkojë sqarime nga ofertuesit, përpara se të marrë vendim për kualifikimin ose jo të tyre, në përputhje me nenin 93, të LPP-së. Në cdo rast, ofertuesi ka detyrimin të argumentojë dhe të dokumentojë me prova shkresore, sqarimet për elementin/elementet e vecanta të ofertës, në përputhje me kërkesat e nenit 93, të lpp-së. 5. Në rastin e procedurave të prokurimit me faza, komisioni i vlerësimit të ofertave lexon emrin dhe adresën e kandidatit dhe listën e të gjitha dokumenteve të kualifikimit, të paraqitura prej tij. Jo më vonë se 15 (pesëmbëdhjetë) ditë për procedurat mbi kufirin e lartë monetar dhe 10 (dhjetë) ditë për procedurat nën kufirin e lartë monetar, nga data e dorëzimit të dokumentacionit të kërkuar, komisioni i vlerësimit përcakton listën përfundimtare të kandidatëve të kualifikuar, që do të vlerësohen për ofertën dhe ia komunikojnë këtë informacion menjëherë të gjithë kandidatëve, që kanë paraqitur kërkesë për pjesëmarrje. Kandidatëve të kualifikuar, në përfundim të afateve të ankimit, u dërgohet një ftesë për ofertë, në përputhje me nenin 58, të LPP-së. Më pas, komisioni i vlerësimit të ofertave vazhdon vlerësimin e ofertave teknike të kandidatëve të kualifikuar dhe bën klasifikimin teknik. Në varësi të llojit të procedurës së prokurimit, komisioni i vlerësimit të ofertave, në varësi të kompleksitetit të kontratës, mund të zhvillojë negociata në faza të ndryshme me secilin nga kandidatët e përzgjedhur, por gjithmonë duhet të pasqyrojë përmbajtjen e tyre në procesverbalin përkatës. Komisioni i vlerësimit të ofertave kalon në shqyrtimin e ofertës ekonomike dhe verifikon nëse ka gabime aritmetike apo cmim anomalisht të ulët, sipas përcaktimeve në pikat 3 dhe 4, të këtij neni. Nëse është e nevojshme, komisioni i vlerësimit të ofertave kërkon sqarime nga ofertuesit, të cilat duhet të jenë vetëm me shkrim ose të pasqyruara në procesverbal. Në bazë të Ofertave të Pranuara, komisioni i vlerësimit të Ofertave merr vendim për shpalljen e fituesit, i cili publikohet në sistemin e prokurimit elektronik menjëherë, por jo më vonë se 5 (pesë) ditë pas përfundimit të procedurës së vlerësimit. Në rastin e procedurave me negociim, pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës, afatet për vlerësimin e ofertave përcaktohen nga autoriteti kontraktor, në varësi të kompleksitetit të kontratës dhe situatës konkrete. 6. Nëse dy ose më shumë oferta kanë të njëjtin cmim më të ulët ose kanë pikë të njëjta, atëherë fituesi do të përcaktohet me short, në prani të ofertuesve. Njoftimi për datën dhe orën e hedhjes së Shortit u njoftohet ofertuesve. Mospjesëmarrja e ofertuesve gjatë procesit të hedhjes së shortit nuk përbën shkak për skualifikim. Pra akti nënligjor ka parashikuar qartë dhe pa ekuivokë se autoriteti kontraktor ka të drejtë të kërkojë sqarime të hollësisht mbi ofertën e paraqitur vetëm në kushtet kur gjendemi përpara një oferte anomalisht të ulët. Pra edhe lidhur me këtë moment vlerësues, cmojmë se kvo duhet të kishte propozuar anulimin e procedurës së prokurimit për 2 arsye: 1. Se oferta e paraqitur pavaresisht bazës ligjore të pretenduar si arsye skualifikimi është në përputhje me manualin teknik të çmimeve 2. Një kërkim i tillë në këtë moment procedural nuk i është njohur si e drejtë autoritetit kontraktor.

Lidhur me arsyen tjetër të skualifikimit:

Bazuar dokumentacionit të paraqitur në spe rezultan që mbështetet në më shumë se 50% të kapaciteteve të nike subjekti 2T të shpk në lidhje me plotesimin e pikës 2.3.1 të kapacitetit teknik, kjo në kundërshtim me vkm 285, datë 19.05.2021 rregullat e prokurimit publik, të ndryshuar, nëni 90 mbështetja në kapacitetet e subjekteve të tjera, pika 2 ku citohet: [...] Në cdo rast, operatori ekonomik ofertues që dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, duhet të provojë se ploteson të paktën 50% të kërkesave të përcaktuara nga autoriteti ose enti kontraktor [.]. D. OE Alko-Impex General Construcion mbështetet në më shumë se 50% të kapaciteteve teknike nga OE Alko Impex Construction me nipt K91628013D, në lidhje me plotesimin e pikës 2.3.9 të kapacitetit teknik (Alko-Impex General Construcion disponon 35 punonjes, ndërsa shoqëria mbështetëse Alko Impex Construction sipas dokumentacionit të paraqitur në SPE e mbështet me 37 punonjes), kjo në kundërshtim me vkm 285, datë 19.05.2021 rregullat e prokurimit publik, të ndryshuar, nëni 90 mbështetja në kapacitetet e subjekteve të tjera, pika 2 ku citohet: [...] Në cdo rast, operatori ekonomik ofertues që dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, duhet të provojë se ploteson të paktën 50% të kërkesave të përcaktuara nga autoritet ose enti kontraktor....

Në dst nga ak është kërkuar:

2.3.4 dëshmi për fuqinë punëtore të operatorit ekonomik:

Operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet të kenë të punësuar staf inxhinierik për kryerjen e të gjitha punimeve në objekt, të përfshirë në licencën e shoqërisë, të vërtetuar me kontratë pune të vlefshme, diplomë përkatëse, si dhe të figurojnë në listpagesat e shoqërisë minimumi për periudhën qershor - gusht 2023, konkretisht:

- arkitekt 1 (një)*
- inxhinier ndërtimi 1 (një)*
- inxhinier hidroteknik 1 (një)- inxhinier mekanik 1 (një)*
- inxhinier elektrik 1 (një)*
- inxhinier gjeodet 1 (një)*

Shënim: në momentin e vlerësimit dhe shqyrtimit të kriterëve kualifikuesë ky kriter do të konsiderohet i përmbushur me dorëzimin e vetdeklarimit përmbledhës sipas shtojcës 8, bazuar në nenin 82 të ligjit nr. 162/2020 për prokurimin publikë si dhe në gërmën dh) të pikës 2 të nenit 26 të vendimit nr. 285 datë 19.05.2021 të këshillit të ministrave për miratimin e rregullave të prokurimit publikë i ndryshuar. Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për tu kërkuar sqarime nga ak.

2.3.5 operatorët ekonomikë duhet të përcaktojnë me anë të një deklaratë nga (administratori i Shoqërisë), drejtuesin teknik të punimeve në objekt i cili të jetë i përfshirë në licencën e shoqërisë, dhe që do të sigurojë drejtimin teknik të punimeve në kantier dhe nuk duhet të jetë i angazhuar në kontrata të tjera. Drejtuesi teknik i punimeve në objekt, i deklaruar duhet të plotësojë kriteret e përcaktuara në udhëzimin nr. 2, datë 13.5.2005 për zbatimin e punimeve të ndërtimit të (në rastin e bashkimit të operatoreve ekonomik secili operator duhet të

përcaktojë me anë të një deklaratë drejtuesin teknik të punimeve në objekt, i cili duhet të jetë i përfshirë në licencën e shoqërisë dhe të deklarojë se nuk është i angazhuar në kontrata të tjera dhe te jetë i pranishëm gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objekt në varesi të vlerës së preventivit të punimeve që ka marrë persiper sipas përqindjes së bashkepunimit). 2.3.6 operatori ekonomik ofertues duhet të ketë të punësuar mjekun e shoqërisë i cili të ketë kontratë pune, diplomë, licencë urdhër mjeku dhe të figurojë në listëpagesat e operatorit ekonomik ofertues minimumi për periudhën qeshor - gusht 2023, ose duhet të paraqitet një kontratë e vlefshme për ofrimin e këtij shërbimi me një subjekt të licencuar, sipas ligjit në fuqi. Në rast bashkimi operatorësh ekonomikë, secili nga operatorët ekonomikë duhet ta plotësojë këtë kusht në përputhje me numrin respektiv të punonjësve sipas kërkesave ligjore. Shënim: në momentin e vlerësimit dhe shqyrtimit të kriterëve kualifikuese ky kriter do të konsiderohet i përmbushur me dorëzimin e vetdeklarimit përmbledhës sipas shtojcës 8, bazuar në nenin 82 të ligjit nr. 162/2020 për prokurimin publikë si dhe në gjurmën h) të pikës 2 të nenit 26 të vendimit nr. 285 datë 19.05.2021 të këshillit të ministrave për miratimin e rregullave të prokurimit publikë i ndryshuar. Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për tu kërkuar sqarime nga ak.

2.3.7 operatori ekonomik duhet të disponojë punonjës të specializuar/të kualifikuar, si më poshtë: a) operatorët ekonomikë duhet të vërtetojnë se kanë të punësuar në stafin e tyre I (një) punonjës i cili të plotësojë kërkesat dhe të disponojë certifikatën si përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë, në përputhje me klauzolat e ligjit nr. 10237 date 18/02/2010 për sigurinë dhe shëndetin në punë dhe v.k.m nr. 312, date 05.05.2010 për miratimin e rregullores për sigurinë në kantier. B) operatorët ekonomikë duhet kenë të punësuar në stafin e tyre I (një) auditues energjie, bazuar në ligjin nr. 124/2015 për efikasitetin e energjisë, i ndryshuar, i cili duhet të jetë i pajisur me certifikatë për auditues energjistik në ndertesa, lëshuar nga agjencia për efikasitetin e energjisë. Për këto operatorët ekonomikë duhet të paraqesin :

- kontratën e punës,*
- diplomën/certifikatën përkatëse.*
- të figurojë në listëpagesat e operatorit ekonomik ofertues minimum për periudhën qeshor - gusht 2023*

Shënim: në momentin e vlerësimit dhe shqyrtimit të kriterëve kualifikuese ky kriter do të konsiderohet i përmbushur me dorëzimin e vetdeklarimit përmbledhës sipas shtojcës 8, bazuar në nenin 82 të ligjit nr. 162/2020 për prokurimin publikë si dhe në gjurmën h) të pikës 2 të nenit 26 të vendimit nr. 285 datë 19.05.2021 të këshillit të ministrave për miratimin e rregullave të prokurimit publikë i ndryshuar. Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për tu kërkuar sqarime nga ak.

2.3.8 operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate duhet të disponojë fuqi punëtore prej minimalisht 75 (shtatëdhjetë e pesë) persona minimumi për periudhën qeshor - gusht 2023 e vertetuar kjo me:

Vërtetim të lëshuar nga administrata tatimore, ku të specifikohet numri i punonjësve dhe listpagesat përkatëse të konfirmuara nga autoritetet përgjegjëse, shoqëruar me formularët e deklarimit të pagesave për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore. Shënim: në momentin e

vlerësimin dhe shqyrtimin të kriterëve kualifikuese ky kriter do të konsiderohet i përmbushur me dorëzimin e vetdeklarimit përmbledhës sipas shtojcës 8, bazuar në nenin 82 të ligjit nr. 162/2020 (për prokurimin publikë si dhe në gjurmën dh) të pikës 2 të nenit 26 të vendimit nr. 285 datë 19.05.2021 të këshillit të ministrave për miratimin e rregullave të prokurimit publikë i ndryshuar. Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për tu kërkuar sqarime nga ak.

Në këtë rast cmojmë se vendimi autoritetit kontraktor për skualifikimin është i pabazuar pasi sic vërehet më sipër, vlerësimi i kryer është subjektiv dhe për këtë shkak KVO nuk duhet të kishte vijuar me vlerësimin por me propozimin për anulimin e procedurës së prokurimit pasi kriteri i vendosur nga autoriteti kontraktor në dst është i paqartë pasi nuk specifikohet nëse, stafi teknik (inxhinierët, personi përgjegjës për sigurinë në kantier, mjeku, audituesi energjise, drejtuesi teknik etj a përfshihen tek numri i përgjithshëm i punonjësve apo jo? Në nenin 2 qëllimi të ligjit nr. 162/2020 për prokurimin publikë, parashikohet shprehimisht se: qëllim i këtij ligji është: a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik; b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale; c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik; ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë; d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik. Ndërkohe në nenin 3 parime të përgjithshme të ligjit nr. 162/2020 për prokurimin publikë, parashikohet shprehimisht se: 1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale. 2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar. 3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me kushtetutën.

Në nenin 98 të ligjit nr. 162/2020 (për prokurimin publikë, parashikohet se: 1. Autoriteti ose enti kontraktor anulon procedurën e prokurimit në rastet kur: a) në procedurat me faza nuk është dorëzuar asnjë kërkesë e përshtatshme; b) në procedurat me një fazë nuk është dorëzuar asnjë ofertë e përshtatshme; c) konstaton se dokumentet e tenderit përmbajnë gabime ose mangësi të rëndësishme; ç) për shkak të rrethanave të paparashikueshme dhe objektive, nevojat ose aftësia paguese e autoritetit ose entit kontraktor kanë ndryshuar; d) kur komisioni i prokurimit publik vendos anulimin sipas parashikimeve në këtë ligj. 2. Kur procedura e prokurimit publik anulohet në pajtim me shkronjën e të pikës 1 të këtij neni, autoriteti ose enti kontraktor nuk duhet të shpallë një procedurë të re për të njëjtin objekt prokurimi e me të njëjtat të dhëna. 3. Autoriteti ose enti kontraktor nuk mban asnjë përgjegjësi ndaj ofertuesve që kanë paraqitur oferta për vendimin e marrë në bazë të pikës 1 të këtij neni. 4. Autoriteti ose enti kontraktor u komunikon të gjithë kandidatëve ose ofertuesve vendimin dhe arsyet për të mos e vazhduar procedurën e prokurimit menjëherë, por jo më vonë se 3 ditë nga marrja e vendimit. 5. Autoriteti ose enti kontraktor publikon vendimin e anulimit vetëm pas kalimit të afateve të

ankimimit sipas parashikimeve të nenit 110 të këtij ligji. Ndërkohë neni 75 i vkm nr. 285/2021 parashikon: nëse një apo disa oferta vlerësohen si anomalisht të ulëta, komisioni 1. Komisioni i vlerësimit të ofertave emërohet me urdhër të vecantë të titullarit të autoritetit/entit kontraktor dhe përbëhet nga jo më pak se 3 (tre) persona me arsim të lartë, ku të paktën njëri është ekspert i fushës, nëse nevojitet për objektin e prokurimit. 2. Personat përgjegjës për hartimin e dokumenteve të tenderit nuk mund të emërohen anëtarë të komisionit të vlerësimit të ofertave. 3. Një prej anëtarëve të komisionit caktohet kryetar dhe është përgjegjës për fillimin e punës menjëherë pas krijimit të komisionit. Në cdo rast, numri i anëtarëve duhet të jetë tek. Në rastin e mungesës së personelit, autoriteti/enti kontraktor mund të punësojë me kontratë ekspertë të jashtëm, si anëtarë të komisionit të vlerësimit të ofertave. 4. Komisioni është përgjegjës për shqyrtimin dhe vlerësimin e ofertave. Anëtarët e komisionit duhet të zbatojnë detyrat në pavarësi të plotë. Nëse kërkohen sqarime për dokumentet e tenderit, këto merren nga njësia e prokurimit. Në cdo rast, përgjegjësia për vlerësimin e ofertave është e komisionit të vlerësimit të ofertave. Përrjashtimisht, nëse komisioni i vlerësimit të ofertave vlerëson dhe argumenton se një ose disakritere janë hartuar në kundërshtim me legjislacionin e prokurimit dhe/ose legjislacionin e fushës në fuqi, ka të drejtë ti propozojë titullarit anulimin e procedurës. Anëtarët e komisionit nuk kryejnë asnjë veprim tjetër, përveç atyre të përcaktuara shprehimisht në këto rregulla. Për sa më sipër, nga KVO duhet të ishte konstatuar se kriteret kualifikuese janë hartuar në kundërshtim me legjislacionin e prokurimit dhe/ose legjislacionin e fushës në fuqi duhet të kishte kërkuar anulimin e procedurës së prokurimit.

Si rrjedhojë përfundimisht kërkohet:

1. Anulimin e procedurës së prokurimit.

II.22.1. Bazuar në nenin 112, pika 3 të ligjit 162/2020 “Për prokurimin Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik ka publikuar në bazën e të dhënave të tij, të dhëna për: a) ankimesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe formularin për publikim Nr. 2969/2 prot., datë 01.12.2023, me arsyet e skualifikimit dhe pretendimin që operatori ekonomik “Alko Impex General Construction” SHPK kundërshton me anë të ankesës me nr. 2969/2023 prot, datë 30.11.2023.

II.22.2. Nga verifikimi i dokumentacionit të administruar në dosjen e shqyrtimit administrativ, u konstatua, se në datën 04.12.2023, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është protokolluar më shkresën nr. 2969/3 prot “Formulari i Paraqitjes së Argumenteve nga Operatori Ekonomik i Interesuar Rafin Company SHPK”, në përputhje me nenin 113 të ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”.

II.22.3. Nëpërmjet shkresës me nr. 1020/1 prot., datë 04.12.2023, protokolluar me tonën me shkresën nr. 2969/4 prot., datë 05.12.2023, me objekt “Kthim përgjigje mbi formularin e ankesës me numër elektronik A/2023/3655, datë 30.11.2023 e operatorit ekonomik “Alko Impex General Construction”, e administruar në Drejtorinë e Spitalit Rajonal Dibër me nr. 1011 prot, datë 30.11.2023, është depozituar nga autoriteti kontraktor akti i trajtimit të ankesës

së operatorit ekonomik ankimues nr. 1020 prot, datë 04.12.2023, ku konstatohet, se autoriteti kontraktor ka vendosur refuzimin e ankesës.

II.22.4. Nga verifikimi i dokumentacionit të administruar në dosjen e shqyrtimit administrativ, u konstatua, se në datën 05.12.2023, pranë Komisionit të Prokurimit Publik është protokolluar më shkresën nr. 2969/5 prot “*Formulari i Paraqitjes së Argumenteve nga Operatori Ekonomik i Interesuar Rafin Company SHPK & Udha SHPK*”, në përputhje me nenin 113 të ligjit Nr.162/2020 “*Për Prokurimin Publik*”.

II.22.5. Nëpërmjet shkresës me nr. 1032 prot., datë 07.12.2023, protokolluar me tonën me shkresën nr. 2969/6 prot., datë 11.12.2023 me objekt “*Kthim - përgjigje mbi argumentet të BOE “Rafin Company” SHPK dhe “Udha” SHPK të paraqitura sipas Formularit të paraqitjes së argumenteve datë 04.12.2023, e administruar në Drejtorinë e Spitalit Rajonal Dibër me nr. 1024 prot, datë 04.12.2023*”, është depozituar nga autoriteti kontraktor akti i trajtimit të argumenteve të bashkimit të operatorëve ekonomikë “*Rafin Company*” SHPK & “*Udha*” SHPK ku konstatohet, se autoriteti kontraktor ka vendosur se pretendimet e argumenteve të BOE “*Rafin Company*” SHPK & “*Udha*” SHPK të paraqitura sipas Formularit të paraqitjes së argumenteve datë 04.12.2023, e administruar në Drejtorinë e Spitalit Rajonal Dibër me nr. 1024 prot, datë 04.12.2023, qëndrojnë.

II.22.6. Nëpërmjet shkresës me nr. 1074 prot., datë 18.12.2023, protokolluar me tonën me shkresën nr. 2969/7 prot., datë 20.12.2023 me objekt “*Informacion sqarues në lidhje me formularin e ankesës me numër elektronik A/2023/3655, datë 30.11.2023 të operatorit ekonomik “Alko Impex General Construction”, e administruar në Drejtorinë e Spitalit Rajonal Dibër me nr. 1011 prot, datë 30.11.2023, për procedurën e prokurimit me objekt Rikonstruksion i Spitalit Rajonal Dibër Rahim Xhika, me Nr. Ref-78915-09-04-2023*”, është depozituar nga autoriteti kontraktor informacion dhe dokumentacion në lidhje me procedurën e prokurimit objekt - shqyrtimi.

II.22.7. Nëpërmjet shkresës me nr. 22 prot., datë 08.01.2024, protokolluar me tonën me shkresën nr. 2969/8 prot., datë 10.01.2024 me objekt “*Kërkesë për nxjerrjen e vendimit përfundimtar për objektin Rikonstruksion i Spitalit Rajonal Dibër Rahim Xhika me Nr. Ref-78915-09-04-2023*”, autoriteti kontraktor ndër të tjera citon se: “*Në lidhje me procedurën e prokurimit me objektin e mësipërm, ju bëjmë me dije se është investim i vënë në dispozicion nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, investim i cili është shumë i rëndësishëm për institucionin tonë pasi godina ekzistuese aktualisht është një godinë e vjetër dhe tejet e amortizuar e cila theksojmë që ka të nevojshme ndërhyrje urgjente. Në këtë godinë ushtrojnë aktivitetin e tyre shërbimet dhe stafi mjekësorë si: Shërbimi i Urgjencës, Poliklinikës, Kirurgjisë, Patologjisë, Neurologjisë, Infektivit, Farmacisë, Imazherisë si dhe administrata, prapavija, gjithashtu në përfundim të punimeve në këtë godinë do të rehabilitohen dhe shërbimet që janë në godinën tjetër Pediatri dhe Obstetrikë-Gjinekologji etj. Për sa më sipër cituam duke qenë se ky investim është i kufizuar në afate kohore si dhe bazuar në nenin 115 të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 Për Prokurimin Publik, lutemi nga ana juaj nxjerrjen e vendimit përfundimtar në*

lidhje me ankesën e mësipërme në mënyrë që të konkludojmë në lidhjen e kontratës për këtë objekt prokurimi”.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur saj, si dhe informacionit të autoritetit kontraktor dhe verifikimeve të kryera,

Arsyeton

III.1. Para shqyrtimit në themel të pretendimeve të operatorit ekonomik ankimues, në zbatim të nenit 29, pika 2 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 766/2021, datë 13.10.2021 *“Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”*, në të cilin parashikohet se *“1. Komisioni shqyrton ankesën brenda objektit dhe shkaqeve të parashtruara në ankesë. 2. Përfundimisht, kur ka lidhje midis objektit të ankesës dhe vendimeve apo veprimeve të tjera të autoritetit kontraktor gjatë procedurës së prokurimit, Komisioni vendos edhe për ligjshmërinë e tyre.”*, KPP gjykon, se autoriteti kontraktor është organi përgjegjës për prokurimin e fondeve publike, në përputhje me dispozitat ligjore e nënligjore në fuqi. Në këtë kuadër, përcaktimi i kriterëve të veçanta për kualifikim është lënë nën përgjegjësinë e autoritetit kontraktues, gjithnjë në përputhje e përpjesëtim me objektin e natyrën e kontratës objekt-prokurimi, si përcaktimet ligjore të parashikuara në nenin 77 të LPP (qëllimi i kriterëve të veçanta të kualifikimit). Referuar materialeve të administruara në fashikullin e shqyrtimit administrativ, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon të ndalet fillimisht në ligjshmërinë e kriterit të përcaktuar nga autoriteti kontraktor, si dhe në ligjshmërinë e veprimeve të autoritetit kontraktor, për sa kohë që objekti i ankesës ka lidhje me vendimet dhe veprimet e autoritetit kontraktor gjatë zbatimit të hapave të procedurës së prokurimit objekt-ankimi. Akoma më tej, referuar nenit 118 pika 2 dhe 3 të ligjit nr. 162/2020 datë 23.12.2020 *“Për prokurimin publik”* të ndryshuar, parashikohet se: *“2. Përpara lidhjes së kontratës, Komisioni i Prokurimit Publik ka të drejtë: a) të refuzojë ankesën, për shkak të mosplotësimit të elementeve të domosdoshme për shqyrtimin e saj, sipas parashikimeve të nenit 111 të këtij ligji; b) të pranojë ankesën dhe të urdhërojë autoritetin ose entin kontraktor të anulojë plotësisht ose pjesërisht një veprim ose vendim, të nxjerrë në kundërshtim me ligjin; c) të refuzojë ankesën dhe të lejojë autoritetin ose entin kontraktor të vazhdojë procedurën e prokurimit, kur gjykon se nuk ka shkelje të dispozitave ligjore; ç) të nxjerrë vendim deklarativ për mbylljen e çështjes, sipas parashikimeve të pikave 2 dhe 3 të nenit 115 të këtij ligji; d) të refuzojë ankesën, e cila ka si objekt kundërshtimin e një vendimi të dhënë nga Komisioni i Prokurimit Publik, në rast të një ankese tjetër që i përket të njëjtës procedurë, të paraqitur nga i njëjti operator ekonomik. 3. Pas lidhjes së kontratës, Komisioni i Prokurimit Publik, kur gjykon se një vendim apo veprim i autoritetit ose entit kontraktor është në kundërshtim me ndonjë nga dispozitat e këtij ligji, ka të drejtë: a) të deklarojë absolutisht të pavlefshme kontratën e nënshkruar, në përputhje me parashikimet e këtij ligji; b) të urdhërojë autoritetin kontraktor për shkurtimin e kohëzgjatjes së kontratës dhe të kërkojë ndërprerjen e parakohshme të saj; c) të marrë një vendim deklarativ, në bazë të të*

cilit pushteti gjyqësor mund të dëmshtëpërblejë ankuesin, që ka pësuar humbje ose dëme si rezultat i shkeljes së këtij ligji”, Sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik konstaton se:

III.1.1. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “Alko Impex General Construction” SHPK në lidhje me skualifikimin e tij nga procedura e prokurimit objekt - ankimi me pretendimin se: “Referuar dokumentacionit të paraqitur OE “Alko Impex General Construction” SHPK nuk plotëson pikën 2.4.3 në lidhje me “Analizen Teknike” Analizat teknike të cmimeve të paraqitura nuk janë plotësuar sipas VKM nr.113 date 1.03.2023 “Për percaktimin e pages minimale në shkallë vendi”, ku në pikën 3 të kësaj VKM-je përcaktohet: 3. Paga bazë minimale orare të jetë 229,9 (dyqind e njëzet e nëntë pikë nëntë) lekë, por në shumicën e zerave të punës kjo page është e ulët dhe e padiferencuar për kategori punetore të kualifikuar edhe pse duke qenë se janë punime speciale OE “Alko Impex General Construction” SHPK e ka përcaktuar orën e punës 185 leke në të gjitha proceset e punës duke mos bërë diferencim të kategorizimit të punetoreve sipas specialiteteve por me pagese me të ulët dhe se minimumi i përcaktuar sipas VKM nr.113 date 1.03.2023. Bazuar në VKM nr. 514 date 15.08.2007 “Për informatizimin e llogaritjes së kostos dhe hartimin e manualeve teknike të cmimeve të punimeve të ndërtimit” pika 10 thuhet: “Operatori ekonomik pjesëmarrës në tender se bashku me preventivin duhet të dorëzojë analizen teknike për të gjithë zerat e preventivit të ofertës. Mosparaqitja në formën e kërkuar përben kusht për skualifikim. OE “Alko Impex General Construction” SHPK nuk e ka respektuar këtë kusht, nuk ka paraqitur të saktë analizen teknike sipas legjislacionit në fuqi.”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.2. Në shtojcën nr. 7/2 “Kriteret e Veçanta të Kualifikimit” në pikën 2.4.3 “Kapaciteti Teknik” në dokumentet standarde të tenderit, autoriteti kontraktor ka përcaktuar si më poshtë:

2.4.3 Për impiantin e gazeve mjekësore dhe pajisjet mjekësore

-Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë një dokument nga organet shtetërore që pajisjet mjekësore janë të autorizuar për tregtim në Republikën e Shqipërisë, duhet të paraqitet dokument lëshuar nga Agjencia Kombëtare e Barnave dhe Pajisjeve: Mjekësore Certifikatë Regjistrimi në përputhje me ligjin 89/2014 “Për pajisjet mjekësore”.

- Operatori ekonomik duhet të paraqesë kontratë furnizimi nga prodhuesi ose distributori i autorizuar nga prodhuesi, me të cilin prodhuesi/distributori i autorizuar autorizon kompaninë pjesëmarrëse në tender të ofertojë këto pajisje në këtë procedure prokurimi.

PLAN - ORGANIZIMIN e punimeve të objektit ku të reflektuje të gjitha masat tekniko-organizative dhe elementet e tjera që kërkon një plan organizimi i mirëfilltë.

PLANIN E SIGURISE NE KANTIER për punimet në objekt në format sipas VKM nr. 692 date 13.12.2001 “Për masat e veçanta të sigurimit dhe ruajtjes së shëndetit në punë, të ndryshuar me VKM nr. 742 date 06.11.2003”, sipas kërkesave, si rrethimi provizor, depozitimi i materialeve kryesore, ambientet e kantierit, rrugë kalimet, tabelat e sig. teknik etj.

GRAFIKUN E PUNIMEVE në përputhje me afatin e realizimit të punimeve.

ANALIZË TEKNIKE për të gjithë zërat e preventivit të ofertës. Mosparaqitja në formën e kërkuar përbën kusht për skualifikim. Bazuar në VKM Nr 514, datë 15.08.2007 “Për informatizimin e llogaritjes së kostos dhe hartimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit”, pika 10.

III.1.3. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar në Sistemin e Prokurimit Elektronik nga operatori ekonomik “Alko Impex General Construcion” SHPK, për përmbushjen të kriterit të mësipërm, rezulton, se ky i fundit ka paraqitur dokumentacion si më poshtë vijon:

-File Analizat Spitali Peshkopi pdf 572 KB

III.1.4. Në nenin 2 “Qëllimi i ligjit” të ligjit nr. 162/2021 “Për prokurimin publik” parashikohet se: *Qëllim i këtij ligji është: a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik; b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale; c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik; ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë; d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik; dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.*

III.1.5. Në nenin 3 “Parime të përgjithshme” të ligjit nr. 162/2021 “Për prokurimin publik” parashikohet se *1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale. 2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar. 3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.*

III.1.6. Në nenin 77, të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: *1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:*

a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;

b) gjendjen ekonomike dhe financiare;

c) aftësinë teknike dhe profesionale.

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

III.1.7. Neni 39 “Kërkesa të veçanta për kontratat për punë publike”, të VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, parashikon shprehimisht se: “4. Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike në përputhje me nenin 77, të LPP-së. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti ose enti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.

III.1.8. Ndërsa në nenin 92/3 të LPP-së përcaktohet se: “3. Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji...”

Neni 93 Oferta anomalisht e ulët të LPP-së përcaktohet se:

1. Kur autoritetet ose entet kontraktore vërejnë se oferta për punët, furnizimet ose shërbimet është anomalisht e ulët, i kërkon operatorit ekonomik të paraqesë me shkrim dhe brenda tri ditëve pune shpjegime për çmimin ose kostot e propozuara në ofertë.

2. Shpjegimet e përmendura në pikën 1 jepen veçanërisht për:

a) anën ekonomike të procesit të prodhimit, të shërbimeve të ofruara ose të metodës së ndërtimit;

b) zgjidhjet teknike të përzgjedhura dhe/ose ndonjë kusht favorizues të jashtëzakonshëm që ka ofertuesi për furnizimin e produkteve ose shërbimeve ose për kryerjen e punës;

c) origjinalitetin e punës, furnizimeve ose shërbimeve të propozuara nga ofertuesi;

ç) pajtueshmërinë me detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fushën e mjedisit, në fushën sociale dhe të punës;

d) mundësinë e ofertuesit për të marrë ndihmë shtetërore.

III.1.9. Në pikën 4, të Nenit 82 “Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave” të VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: “4.as korrigjimit të gabimeve aritmetike, komisioni i vlerësimit të ofertave verifikon nëse ofertat e vlefshme janë ose jo me çmim anomalisht të ulët sipas formulës së përcaktuar në dokumentet standarde të tenderit. Përlllogaritja e ofertës anomalisht të ulët bëhet në mënyrat e mëposhtme:

- Në rastin kur janë të vlefshme dy ose më pak oferta, në përputhje me nenin 93, të LPP-së, oferta vlerësohet anomalisht e ulët kur ajo është ulur më shumë se 25% e fondit limit të përlllogaritur;

- Në rastin kur janë të vlefshme tri ose më shumë oferta, në përputhje me nenin 93, të LPP-së, oferta vlerësohet anomalisht e ulët nëse vlera e saj do të jetë më e vogël se 85% e mesatares së ofertave të vlefshme.

Nëse një apo disa oferta vlerësohen si anomalisht të ulëta, komisioni i vlerësimit të ofertave duhet të kërkojë sqarime nga ofertuesit, përpara se të marrë vendim për kualifikimin ose jo të tyre, në përputhje me nenin 93, të LPP-së.

Në çdo rast, ofertuesi ka detyrimin të argumentojë dhe të dokumentojë me prova shkresore, sqarimet për elementin/elementet e veçanta të ofertës, në përputhje me kërkesat e nenit 93, të LPP-së.

III.1.10. Në Vendimin nr. 629, datë 15.7.2015 “Për Miratimin e Manualeve Teknike të Çmimeve të Punimeve të Ndërtimit dhe të Analizave Teknike të tyre (ndryshuar me VKM nr. 631, datë 26.10.2018)”, parashikohe tse:

1. Miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre, të rishikuara, që do të përdoren në përcaktimin e fondit limit të objekteve në ndërtim, sipas tabelave që i bashkëlidhen këtij vendimi. **4. Çmimet e zërave të punimeve, të përcaktuara në manualet teknike, janë orientuese dhe referuese për planifikimin e buxhetit vjetor.**

III.1.11. Në Vendim nr. 514, datë 15.8.2007 “Për Informatizimin e Llogaritjes së Kostos dhe Hartimin e Manualeve Teknike të Çmimeve të Punimeve të Ndërtimit”, parashikohet se:

1. **Unifikimin e metodologjisë së llogaritjes dhe të formatit të paraqitjes së preventivave e të analizës së kostos për punimet e ndërtimit**, sipas programeve kompjuterike të miratuara për lehtësimin e veprimtarisë së subjekteve, që zhvillojnë veprimtari në këtë fushë, lehtësimin e kontrollit tekniko-financiar të punimeve të ndërtimit dhe shmangien e informalitetit në veprimtarinë prodhuese, në tregun e ndërtimeve në Shqipëri.

2. Hartimi i çdo preventivi në fushën e ndërtimit, si dhe zbatimi e mbikëqyrja e çdo punimi ndërtimi, që realizohet nga persona, fizikë dhe juridikë, publikë ose privatë, vendas ose të huaj, me fonde publike ose private, në territorin e Republikës së Shqipërisë, bëhet në përputhje me këtë vendim.

4. Nëse nuk përcaktohet ndryshe, termat e përdorura në këtë vendim kanë kuptimin, si më poshtë vijon: dh) manuali teknik i çmimeve për punimet e ndërtimit ose thjesht manuali i çmimeve të ndërtimit, është buletini periodik i çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe i analizave teknike të çmimeve, i detyrueshëm për zbatim, sipas pikës 2 të këtij vendimi; e) buletini i çmimeve të materialeve të ndërtimit, është buletini periodik i çmimeve të materialeve të ndërtimit dhe i produkteve për ndërtim, të ofruara nga tregu përkatës, brenda vendit;

9. Preventivat, pa përjashtim, për objektet e reja, me financimin, publik ose privat, të projektuara nga subjekte, shtetërore apo private, që ushtrojnë veprimtari në fushën e projektimit dhe të preventivimit të objekteve të ndërtimit, të llogariten duke përdorur çmimet e manualit teknik të çmimeve të ndërtimit, bazuar në analizat teknike të çmimeve për punimet e ndërtimit, të përfshira në manual.

10. Të gjitha subjektet, private apo publike, që kryejnë veprimtari në fushën e tregtimit të materialeve apo të produkteve të ndërtimit ose në fushën e ndërtimit e që marrin pjesë në tendera publike, detyrohen të paraqesin analizat teknike për çmimet e ofertave të tyre për çdo zë punimi ndërtimor, sipas formatit të unifikuar dhe programit të miratuar dhe metodologjisë së përcaktuar në kreun I të udhëzimit nr.2, datë 8.5.2003 të Këshillit të Ministrave.

11. Të gjitha institucionet shtetërore, që kryejnë programime të fondeve, për efekt planifikimi investimesh për ndërtimin e veprave publike, me fonde publike, nga Buxheti i Shtetit apo nga donatorë të huaj, detyrohen të llogarisin çmimet e zërave të punës, për të përcaktuar

vlerën limit të objektit, në bazë të manualit të miratuar të çmimeve të ndërtimit, mbështetur në analizat teknike të çmimeve.

III.1.12. Në Udhëzimin nr. 1, datë 16.06.2011 “Për disa ndryshime në udhëzimin nr.3, datë 15.2.2001 të Këshillit të Ministrave “Për Mbikëqyrjen dhe Kolaudimin e Punimeve të Ndërtimit”, të ndryshuar, parashikohet se:

b) Pas pikës 3 shtohen pikat 3.1, 3.2 dhe 3.3, me këtë përmbajtje:

“3.1. Preventivat e objekteve të reja, pa përjashtim, që paraqiten për marrjen e lejes së ndërtimit me financim publik ose privat, të projektuara nga subjekte publike apo private, që ushtrojnë veprimtarinë në fushën e projektimit dhe të preventivimit të objekteve të ndërtimit, të llogariten duke përdorur çmimet e manualit teknik të çmimeve të ndërtimit, të miratuara çdo vit nga Këshilli i Ministrave. Në rastet kur në manualin teknik të çmimeve të ndërtimit mungojnë çmimet e zërave të punimeve të vendosura në projekt, projektuesi harton analizën teknike përkatëse të çmimeve dhe vepron në përputhje me procedurën e përcaktuar në pikën 8 të vendimit nr.514, datë 15.8.2007 të Këshillit të Ministrave “Për informatizimin e llogaritjes së kostos dhe hartimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit.”. Subjekti projektues, privat apo shtetëror, është përgjegjës për saktësinë e volumeve të ndërtimit, të cilat jepen në preventiv.

III.1.13. KPP gjykon, se kriteret për kualifikim vendosen që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Gjithashtu, një ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurës së prokurimit është ai barazisë në trajtimin e kërkesave dhe të detyrimeve, që u ngarkohen ofertuesve ose kandidatëve, parashikuar nga neni 3 i ligjit nr. Nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar. Zbatimi i parimit të transparencës, barazisë dhe mosdiskriminimit, janë garancitë kyçe ndaj ofertuesve që ofron kuadri ligjor në fuqi. Këto parime ndër të tjera nënkuptojnë, se operatorët ekonomikë duhej të jenë në një pozicion barazie, si kur përgatisin ofertat e tyre, ashtu dhe kur të vlerësohen ato. KPP gjykon, se autoriteti kontraktor në përputhje me nenin 2 dhe 3 të ligjit 162/2021 “Për prokurimin publik” ka për detyrë d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik; dhe të garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale. Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t’i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

III.1.14. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar në SPE nga operatori ekonomik “Alko Impex General Construcion” SHPK, Komisioni konstaton, se ka ngarkuar në SPE dokumentin me emërtim *Analiza çmimesh*. Referuar arsyes së skualifikimit që ka evidentuar autoriteti kontraktor, se *Referuar dokumentacionit të paraqitur OE “Alko Impex General Construcion” SHPK nuk ploteson piken 2.4.3 në lidhje me “Analizen Teknike” Analizat teknike të cmimeve të paraqitura nuk janë plotësuar sipas VKM nr.113 date 1.03.2023 “Per percaktimin e pages minimale në shkallë vendi”, ku në piken 3 të kesaj VKM-je percaktohet: 3. Paga bazë minimale orare të jetë 229,9 (dyqind e njëzet e nëntë pikë nëntë) lekë, por në shumicën e zerave të punës kjo page është e ulët dhe e padiferencuar për kategori punetoresh të kualifikuar edhe pse duke qene se janë punime speciale OE “Alko Impex General Construcion” SHPK e ka percaktuar oren e punës 185 leke në të gjitha proceset e punës duke mos bere diferencim të kategorizimit të punetoreve sipas specialiteteve por me pagese me të ulët dhe se minimumi i percaktuar sipas VKM nr.113 date 1.03.2023. Bazuar në VKM nr. 514 date 15.08.2007 “Per informatizimin e llogaritjes së kostos dhe hartimin e manualeve teknike të cmimeve të punimeve të ndertimi” pika 10 thuhet: “Operatori ekonomik pjesëmarrës në tender se bashku me preventivin duhet të dorëzojë analizen teknike për të gjithë zërat e preventivit të ofertes. Mos paraqitja në formën e kerkuar përben kusht për skualifikim. OE “Alko Impex General Construcion” SHPK nuk e ka respektuar këtë kusht, nuk ka paraqitur të sakte analizen teknike sipas legjislacionit në fuqi.*

KPP gjykon, se autoriteti kontraktor është organi përgjegjës për prokurimin e fondeve publike, në përputhje me dispozitat ligjore e nënligjore në fuqi. Në këtë kuadër, edhe përcaktimi i kriterëve të veçanta për kualifikim është lënë nën përgjegjësinë e autoritetit kontraktues, por gjithnjë në përputhje e përpjesëtim me objektin e natyrën e kontratës objekt-prokurimi dhe në përputhje me frymen e lex specialis.

Në vijim, referuar nenit 77 të Ligjit 162/2020 “Për prokurimin publik”, përcaktohet se kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë të cilat duhet të bazohen në a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale; b) gjendjen ekonomike dhe financiare; dhe c) aftësinë teknike dhe profesionale [...].

Sa më sipër, referuar këtij neni, autoritetit kontraktor i është lënë në diskrecion vendosja e kriterëve të kualifikimi për një procedurë prokurimi, në përputhje me qëllimin dhe përcaktimet e nenit 77 të LPP, por nga ana tjetër qëllimi i ligjit të prokurimit publik nuk është shmangia apo e drejta absolute e autoritetit kontraktor për të mos vendosur asnjë kriter kualifikimi, fakt ky i cili do të shkaktonte shtrembërim të konkurrencës. Kriteret për kualifikim vendosen që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Gjithashtu, një ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurës së prokurimit është ai barazisë në trajtimin e kërkesave dhe të detyrimeve, që u ngarkohen ofertuesve ose kandidatëve, parashikuar nga neni 3 i ligjit nr. Nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar. Zbatimi i parimit të transparencës, barazisë

dhe mosdiskriminimit, janë garantitë kyçe ndaj ofertuesve që ofron kuadri ligjor në fuqi. Këto parime ndër të tjera nënkuptojnë, se operatorët ekonomikë duhet të jenë në një pozicion barazie, si kur përgatisin ofertat e tyre, ashtu dhe kur të vlerësohen ato. Gjithashtu, nisur nga natyra, lloji i veçantë i kësaj procedure prokurimi, si dhe ndikimi dhe ndjeshmëria e lartë që kjo procedurë ka drejtpërdrejtë në jetën e njerëzve, gjykojmë se autoriteti kontraktor duhet të hartojë me përgjegjësi të veçantë, brenda diskrecionit të dhënë nga ligji, kriteret e veçanta të kualifikimit, me qëllim që të sigurohet që përmes kriterëve të veçanta të kualifikimit të arrijë të përmbushë qëllimin e parashikuar nga neni 77 i ligjit të prokurimit publik, atë të vërtetimit të përshatshmërisë së veprimtarisë profesionale, gjendjen ekonomike, financiare dhe teknike e profesionale. Qëllimi i kushteve të përzgjedhjes (kualifikimit), është identifikimi i atyre operatorëve ekonomikë që janë të aftë të kryejnë dhe plotësojnë kontratën që do të fitohet. Autoriteti kontraktor duhet të përcaktojë kërkesat që janë të barabarta për të gjithë operatorët ekonomikë. Kur vendos kushtet për pjesëmarrje, autoriteti kontraktor mund të përcaktojë nivelet minimale të kapacitetit që operatorët ekonomikë duhet të plotësojnë, kur është e përshatshme, duke përfshirë kapacitetet e palëve të treta. Këto kushte duhet të jenë të lidhura dhe proporcionale me objektin e prokurimit. Procesi i përzgjedhjes duhet të kufizohet në një vlerësim, nëse arsyet për përjashtim (të detyrueshme ose fakultative) janë përmbushur, si dhe një vlerësim të përshatshmërisë së operatorit ekonomik për të kryer shërbimin, gjendjes së tij financiare dhe ekonomike, si dhe kapacitetit të tij teknik dhe/ose profesionale.

Prokurimi publik është një ndër veprimtaritë kryesore të shtetit, ndaj jo rastësisht ligjvënësi ka parashikuar edhe 6 qëllime kryesore të ligjit: a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik; b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale; c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik; ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë; d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik; dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik. Në parimet e përgjithshme të ligjit për prokurimin publik është parashikuar, si një risi e re në ligj edhe detyrimi i autoriteteve kontraktore që të shmangin çdo formë artificiale për të ngushtuar konkurrencën. Në kuptim të ligjit, konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar.

Për këtë arsye KPP gjykon, se është me vend të ndalet në një test balancues të dy elementeve kryesore. *Së pari*, nëse kërkesa në fjalë është e përshatshme për arritjen e synimit të kërkuar dhe *së dyti*, nëse kërkesa në fjalë shkon përtej asaj, se çfarë është e nevojshme për të arritur synimin në zbatim të nenit 77 të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se është me vend të ndalet në faktin se cili është qëllimi i kriterëve të veçanta të kualifikimit të parashikuara nga ligjvënësi në nenin 77 pika 1 të lex specialis pra autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: a) përshatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale; b) gjendjen ekonomike dhe financiare; c) aftësinë teknike dhe profesionale. Duke marrë shkas nga kriteri i përcaktuar në dokumentet standarde të tenderit, kriter për të cilin është skualifikuar edhe operatori

ekonomik ankimes, KPP gjykon, se kriteri në fjalë për sa i përket Analizës Teknike për të gjithë zërat e preventivit të ofertës, nuk është në përputhje me asnjë nga përcaktimet e nenit 77 të lex specialis, pra qartësisht autoriteti kontraktor nuk i është përmbajtur parashikimeve ligjore të lex specialis, në lidhje me hartimin e kriterëve të veçanta të kualifikimit.

Së pari, KPP gjykon të merret në analize legjislacioni sektorial në fushën specifike mbi këtë kërkesë, rastet kur kjo është e aplikueshme dhe qëllimi në vetvete i kërimit të analizës teknike të çmimeve në kuadër të pjesëmarrjes në procedurat e prokurimit publik.

Së pari, referuar legjislacionit sektorial të fushës së ndërtimit, konkretisht udhëzimit nr. 1, datë 16.06.2011 *“Për disa ndryshime në udhëzimin nr.3, datë 15.2.2001 të Këshillit të Ministrave “Për Mbikëqyrjen dhe Kolaudimin e Punimeve të Ndërtimit”*, të ndryshuar, në të cilin parashikohet specifikisht momenti procedural i kërimit të analizës teknike, moment të cilin e lidhë me fazën e projektimit konkretisht, *“Preventivat e objekteve të reja, pa përjashtim, që paraqiten për marrjen e lejes së ndërtimit me financim publik ose privat, të projektuara nga subjekte publike apo private, që ushtrojnë veprimtarinë në fushën e projektimit dhe të preventivimit të objekteve të ndërtimit, të llogariten duke përdorur çmimet e manualit teknik të çmimeve të ndërtimit, të miratuara çdo vit nga Këshilli i Ministrave. Në rastet kur në manualin teknik të çmimeve të ndërtimit mungojnë çmimet e zërave të punimeve të vendosura në projekt, projektuesi harton analizën teknike përkatëse të çmimeve dhe vepron në përputhje me procedurën e përcaktuar në pikën 8 të vendimit nr.514, datë 15.8.2007 të Këshillit të Ministrave “Për informatizimin e llogaritjes së kostos dhe hartimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit.”*. Subjekti projektues, privat apo shtetëror, është përgjegjës për saktësinë e volumeve të ndërtimit, të cilat jepen në preventiv. Gjithashtu, edhe në Vendimin nr. 629, datë 15.7.2015 *“Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre”* (Ndryshuar me VKM nr. 631, datë 26.10.2018) dhe në Vendimin nr. 514, datë 15.8.2007 të Këshillit të Ministrave *“Për informatizimin e llogaritjes së kostos dhe hartimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit”*, ligjvënësi ka parashikuar unifikimin e metodologjisë së llogaritjes **si dhe të formatit të paraqitjes së analizave të kostos për punimet e ndërtimit, çmimet** e të cilave sipas manualit teknik të ndërtimit janë orientuese dhe referuese, si dhe **subjektet e interesuara që marrin pjesë në tendera publikë, janë të detyruar të paraqesin analizat teknike për çmimet e ofertave të tyre për çdo zë punimi ndërtimor, sipas formatit të unifikuar dhe programit të miratuar dhe metodologjisë së përcaktuar në kreun I të udhëzimit nr.2, datë 8.5.2003 të Këshillit të Ministrave “Për Klasifikimin Dhe Strukturën E Kostos Së Punimeve Të Ndërtimit”**.

Për më tepër, duke iu referuar hartimit të kriterit në dokumentet standarde të tenderit, në pikën 2.4.3. *Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë ANALIZË TEKNIKE për të gjithë zërat e preventivit të ofertës. Mosparaqitja në formën e kërkuar përbën kusht për skualifikim. Bazuar në VKM Nr 514, datë 15.08.2007 “Për informatizimin e llogaritjes së kostos dhe hartimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit”, pika 10*”, KPP konstaton, se autoriteti kontraktor ka kërkuar analizën teknike për të gjithë zërat e preventivit të ofertës, në kundërshtim me nenin 93 *“Oferta anomalisht e ulët”* të LPP-së dhe pikës 4, të nenit 82 *“Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave”* të VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 *“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”*, i ndryshuar, sipas së cilave, në rastet kur autoritetet ose entet kontraktore vërejnë se oferta për punët është anomalisht e ulët, i kërkojnë operatorit ekonomik

të paraqesë me shkrim dhe brenda tri ditëve pune shpjegime për çmimin ose kostot e propozuara në ofertë si dhe ofertuesi ka detyrimin të argumentojë dhe të dokumentojë me prova shkresore, sqarimet për elementin/elementet e veçanta të ofertës, në përputhje me kërkesat e nenit 93, të LPP-së. Ligjvënësi në dispozitat e sipërcituara e ka përcaktuar qartësisht se cili është momenti procedural i kërkit të analizës së kostos. Për sa kohë që vetë autoriteti kontraktor nuk ka konstatuar që oferta e paraqitur nga operatori ekonomik ankimes është anomalisht e ulët, atëherë Komisioni nuk mund t'i hyjë shqyrtimit në thelbi të analizimit të analizës së kostos, pasi vetë organi i caktuar me ligj nuk e ka konstatuar një fakt të tillë.

Referuar proces - verbalit të argumentimit të kriterëve të veçanta të kualifikimit, KPP konstaton se autoriteti kontraktor këtë kërkesë e ka vendosur referuar arsyetimit se: *“Analizat teknike të çmimeve për zërat e preventivit të ofruara, janë kërkuar në funksion të formularit të ofertës sipas shtojcës 2 “Lista e çmimeve sipas zërave të preventivit”, të dokumenteve standarde të tenderit për kontratat e punëve, në të cilën parashikohet që për çdo zë preventivi të jepet përshkrimi i analizës së kostos. Kjo kërkesë synon të garantojë autoritetin kontraktor se ofertat e deklaruara janë të përgjegjshme dhe ofertuesi është i aftë të realizojë punimet në cilësinë, standardin dhe kohën e kërkuar. Këto të dhëna të deklaruara paraprakisht i vijnë në ndihmë KVO në rast të klasifikimit të ofertave anomalisht të ulëta, për vlerësimin e tyre”.*

Së pari, autoriteti kontraktor ka argumentuar kërkesën e mësipërme me arsyetimin, se kjo e fundit garanton se ofertat e deklaruara janë të përgjegjshme. Ndërkohë koncepti i ofertës së përgjegjshme nuk gjen një rregullim të posaçëm në nivel ligji, por parashikohet vetëm në nenin 82 të Vendimit nr.285 datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave *“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”*, të ndryshuar, në të cilin përcaktohet se: *“Një ofertë e përgjegjshme/vlefshme është ajo që plotëson kërkesat e dokumenteve të tenderit pa devijim material, rezervë ose mospranim, siç përcaktohet më poshtë: i. “Devijimi” është shmangia e ofertuesit nga kërkesat e specifikuara në dokumentet e tenderit; ii. “Rezervimi” është përcaktimi, nga ana e ofertuesit, i kushteve kufizuese ose ndalimi nga pranimi i plotë i kërkesave të specifikuara në dokumentet e tenderit; dhe iii. “Mospranimi” është mosparaqitja e një pjese ose e të gjithë informacionit ose dokumenteve të kërkuara në dokumentet e tenderit”.*

Së dyti, vetë autoriteti kontraktor ka pranuar se kjo kërkesë i shërbën këtij të fundit: *“Omississ... në ndihmë KVO në rast të klasifikimit të ofertave anomalisht të ulëta, për vlerësimin e tyre.”*. Ndërkohë, kjo është në kundërshtim me ligjin, pasi rregullat e konstatimit të një oferte anomalisht të ulët dhe veprimet që duhet të kryejë autoriteti/enti kontraktues janë përcaktuar qartësisht në nenin 93 të ligjit nr.162/2020 *“Për prokurimin publik”* edhe në nenin 82 të Vendimit nr.285, datë 19.05.2021, të Këshillit të Ministrave *“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”*, të ndryshuar. Së pari, vetë autoriteti kontraktor ka dështuar të argumentojë si të mbështetur në ligjin e prokurimit publik vendosjen e këtij kriteri, së dyti vetë ky i fundit ka vlerësuar se ky kriter do t'i shërbejë KVO-së në rast hipotetik (të së ardhmes) të konstatimit të një oferte anomalisht të ulët, ndërkohë që rezulton se oferta e operatorit ekonomik të skualifikuar nuk rezulton anomalisht e ulët.

Pra edhe sipas argumentit të mësipërm, vetë autoriteti kontraktor ka dështuar të argumentojë se si ky kriter plotëson testin e proporcionalitetit, i shërbën qëllimit të nenit 77 të vendosjes së kriterëve të veçanta të kualifikimit dhe se si përmes këtij kriteri autoriteti kontraktor mund të

vlerësojë kapacitetet ekonomiko-tekniko-financiare të operatorëve ekonomikë pjesëmarrës në kuadër të pjesëmarrjes në procedurat e prokurimit publik.

Pra, në radhë të parë, detyrimi i parashikuar në Vendimin nr. 514, datë 15.8.2007 të Këshillit të Ministrave “*Për informatizimin e llogaritjes së kostos dhe hartimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit*”, lidhet me dorëzimin sipas formatit të analizës së çmimeve për operatorët ekonomikë të cilët marrin pjesë në procedurat e prokurimit publik, por ndërkohë momenti i kërimit dhe dorëzimit të tyre rregullohet në legjislacionin e posaçëm, ligjin për prokurimin publik, konkretisht në nenin 93 të ligjit nr.162/2020 “*Për prokurimin publik*”.

Në këtë kontekst, kërkesa në lidhje me paraqitjen e analizës teknike për të gjithë zërat e preventivit të ofertës është në kundërshtim me nenin 93 “*Oferta anomalisht e ulët*” të LPP-së dhe pikës 4, të nenit 82 “*Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave*” të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021, “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, i ndryshuar, pasi referuar mënyrës së plotësimit të këtij kriteri nga ana e operatorëve ekonomikë, mbi dorëzimin e analizave teknike për të gjithë zërat e preventivit të ofertës, siç është kërkuar në dokumentet e tenderit, ligjvënësi ka parashikuar momentin procedural në ligjin e prokurimit publik, rastet kur autoriteti kontraktor evidenton rastin e një oferte anomalisht të ulët. Një ndër parimet kryesore të LPP-së është ai i mosdiskriminimit, transparencës dhe proporcionalitetit. Qëllimi në vetvete i LPP-së është trajtimi i barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Akoma më tej, Komisioni konstaton, se legjislacioni specifik, konkretisht Udhëzimi nr. 1, datë 16.06.2011 “*Për disa ndryshime në udhëzimin nr.3, datë 15.2.2001 të Këshillit të Ministrave “Për Mbikëqyrjen dhe Kolaudimin e Punimeve të Ndërtimit*”, i ndryshuar, parashikon se *Preventivat e objekteve të reja, pa përjashtim, që paraqiten për marrjen e lejes së ndërtimit me financim publik ose privat, të projektuara nga subjekte publike apo private, që ushtrojnë veprimtarinë në fushën e projektimit dhe të preventivimit të objekteve të ndërtimit, të llogariten duke përdorur çmimet e manualit teknik të çmimeve të ndërtimit, të miratuara çdo vit nga Këshilli i Ministrave. Në rastet kur në manualin teknik të çmimeve të ndërtimit mungojnë çmimet e zërave të punimeve të vendosura në projekt, projektuesi harton analizën teknike përkatëse të çmimeve dhe vepron në përputhje me procedurën e përcaktuar në pikën 8 të vendimit nr. 514, datë 15.8.2007 të Këshillit të Ministrave “Për informatizimin e llogaritjes së kostos dhe hartimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit.*”. Subjekti projektues, privat apo shtetëror, është përgjegjës për saktësinë e volumeve të ndërtimit, të cilat jepen në preventiv, pra nga sa më sipër, rezulton se analiza e kostos hartohet në fazën e projektimit për t’i shërbyer autoritetit kontraktor për hartimin e fondeve limite, ndërkohë që autoriteti kontraktor po prokuron një kontratë pune, për zbatimin e projektit me objekt “*Rikonstruksion i Spitalit Rajonal Diber "Rrahim Xhika*”. Në këtë kuadër KPP gjykon, se përcaktimi në mënyrë eksplicite i paraqitjes së analizës - teknike në këtë fazë të procedurës për të gjithë zërat e preventivit të ofertës, nuk është në përputhje me dispozitat e legjislacionit sektorial në fuqi e konkretisht Udhëzimin nr. 1, datë 16.06.2011 “*Për disa ndryshime në udhëzimin nr.3, datë 15.2.2001 të Këshillit të Ministrave “Për Mbikëqyrjen dhe Kolaudimin e Punimeve të Ndërtimit*”, të ndryshuar dhe Vendimin nr. 514, datë 15.8.2007 “*Për Informatizimin e Llogaritjes së Kostos dhe Hartimin e Manualeve Teknike të Çmimeve të Punimeve të Ndërtimit*”, vendim në të cilin është bazuar edhe autoriteti kontraktor në

përcaktimin e këtij kriteri, ku nga verifikimi në Qendrën e Publikimeve Zyrtare rezulton, se baza ligjore e këtij vendimi konkretisht si ligji nr. 8464/1999 “Për Standartizimin” edhe ligji 8560/1999 “Për Procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, janë të shfuqizuara. Për sa më sipër rezulton, se ky vendim mbështet mbi baza ligjore të shfuqizuara. Pra, në analizim të kriterit të hartuar nga ana e autoritetit kontraktor si dhe kuadrit ligjor sektorial, sqarohet qartë që analiza teknike nuk është e nevojshme në fazën e zbatimit, me përjashtim të rastit kur autoriteti kontraktor gjatë shqyrtimit të ofertës, e konstaton ofertën e operatorit ekonomik si ofertë anomalisht të ulët. Në këtë rast e ngarkon me detyrim autoritetin, që ti kërkojë operatorit ekonomik analizën teknike për të justifikuar ofertën e tij të kostatkuar si anomalisht të ulët.

III.1.15. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se autoriteti kontraktor është organi përgjegjës për prokurimin e fondeve publike, në përputhje me dispozitat ligjore e nënligjore në fuqi. Në këtë kuadër, përcaktimi i kriterëve të veçanta për kualifikim dhe specifikimeve teknike është lënë nën përgjegjësinë e autoritetit kontraktor, gjithnjë në përputhje e përpjesëtim me objektin e natyrën e kontratës objekt-prokurimi, si dhe aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi që lidhen në mënyrë të drejtpërdrejtë me kriterin e vendosur. Sa më sipër, KPP gjykon, se vetë ligjvënësi ka parashikuar në nenin 2 gërma “dh”, se qëllimi i ligjit të prokurimit publik është ndër të tjera të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik. Ashtu si edhe GJED ka nënvizuar ndër vite, parimi i transparencës dhe barazisë janë të lidhura ngushtë me njëra-tjetrën, por detyra thelbësore e transparencës në një procedurë prokurimi është që të krijohen kushte dhe rregulla të hollësishme për të gjitha palët në proces. Në këto kushte, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se autoriteti kontraktor ka hartuar dokumentet e tenderit të mësipërm, në kundërshtim me dispozitat ligjore në fuqi për prokurimin publik. Komisioni i Prokurimit Publik thekson, se kriteret e kualifikimit nga autoriteti kontraktor duhet të përcaktohen të qarta, të sakta dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi, me qëllim që të kryhet një vlerësim i drejtë dhe jodiskriminues, duke mos penguar pjesëmarrjen në një procedurë prokurimi, si dhe t’i japin mundësi ofertuesve të përcaktojnë objektin e kontratës.

Komisioni i Prokurimit Publik shfaqet në cilësinë e një organi quasi gjyqësor, i krijuar në përputhje me Direktivën 89/665 datë 21 dhjetor 1989, krijuar me ligj për të mbrojtur interesin e ligjshëm të operatorëve ekonomikë në një procedurë prokurimi. Në zbatim të nenit 24 pika 3 të Ligjit nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” në të cilin përcaktohet se: *“Komisioni i Prokurimit Publik merr vendime për ankesat e paraqitura para tij dhe nxjerr interpretim për rregullat ose parimet ligjore, që duhet të zbatohen për objektin e ankesës, të cilat zbatohen për sa janë të vlefshme në vendimmarrjet e ardhshme. Në marrjen e vendimeve mban parasysht, përveç parimeve të përgjithshme të përmendura në nenin 3 të këtij ligji, edhe parimet e mëposhtme: paanshmërinë në shqyrtimin e ankesave, qëndrueshmërinë në vendimmarrje, ligjshmërinë, shpejtësinë dhe efikasitetin, aksesin, karakterin publik, si edhe parimin e kontradiktoritit”*, Komisioni thekson, se qëndrueshmëria në vendimmarrje tashmë e konsoliduar prej tij, është një prej elementeve thelbësore të shqyrtimit të ankesave, për arsye se ka lidhje të drejtpërdrejtë me zbatimin dhe respektimin e parimit të ligjshmërisë, transparencës, barazisë dhe mbi të gjitha të sigurisë juridike, të cilat KPP gjatë kryerjes së detyrave të saj zbaton me profesionalizëm, integritet dhe korrektësi, kuadrin ligjor të prokurimeve publike. Konkretisht Komisioni i Prokurimit Publik, në vendimmarrjen e tij ka

krijuar një qendrueshmëri edhe për sa i përket rastit konkret arsyes së skualifikimit të operatorit ekonomik ankimes, mjafton të citojmë këtu vendimet nr. 1235/2023, datë 30.11.2023, nr. 1246/2023, datë 05.12.2023, vendime në të cilat Komisioni ka mbajtur të njëjtin qëndrim si në rastin konkret, pra duke konsoliduar vendimmarrjen e tij për raste të ngjashme, vendime këto, jo vetëm që janë të publikara në faqen e tij zyrtare dhe në buletinet mujore, por gjenden dhe në një seksion të posaçëm të faqes zyrtare të Komisionit Prokurimit Publik në seksion Praktika Gjyqësore dhe Vendime mbi Interpretimin e dispozitave të zbatueshme, për sa janë të vlefshme në vendimmarrjet e ardhshme, të cilat u drejtohen jo vetëm operatorëve ekonomikë dhe subjekteve të interesuara, por edhe autoriteteve kontraktore.

III.1.16. Bazuar në nenin 118, pika 2, gërma “b” të Ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, sipas të cilit: *“Përpara lidhjes së kontratës, Komisioni i Prokurimit Publik ka të drejtë: të pranohet ankesën dhe të urdhërojë autoritetin ose entin kontraktor të anulohet plotësisht ose pjesërisht një veprim ose vendim, të nxjerrë në kundërshtim me ligjin; nenin 98, pika 1, gërma “d” të këtij ligji ku thuhet shprehimisht: “Autoriteti ose enti kontraktor anulon procedurën e prokurimit në rastet kur Komisioni i Prokurimit Publik vendos anulimin sipas parashikimeve në këtë ligj”, si dhe në nenin 45, pika 1 gërma “b” të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, ku parashikohet se: “[...]Komisioni i Prokurimit Publik në kuadër të veprimtarisë së shqyrtimit të ankesave para lidhjes së kontratës procedon me: b) Vendim për pranimin e ankesës dhe urdhërimin e autoritetit/entit kontraktor, që të anulohet plotësisht ose pjesërisht një veprim ose vendim, të nxjerrë në kundërshtim me ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” [...]”, në përfundim, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se kriteret e kualifikimit në lidhje me kërkesën për paraqitjen e analizës teknike për të gjithë zërat e preventivit të ofertës, në kundërshtim me nenin 93 “Oferta anomalisht e ulët” të LPP-së dhe pikës 4, të nenit 82 “Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave” të VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, përbëjnë shkak për anulimin e procedurës së prokurimit, me qëllim trajtimin e barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë. Në këto kushte, KPP gjykon, se autoriteti kontraktor duhet të anulohet procedurën e prokurimit dhe në rishpalljen e saj të mbajë në konsideratë parashikimet e këtij vendimi.*

III.2. Lidhur me arsyen e skualifikimit të operatorit ekonomik “Alko Impex General Construction” SHPK se: *“Operatori ekonomik Alko Impex General Construction SHPK nuk plotëson pikën 2.3.9 të kriterëve të veçanta për kualifikim, të dokumenteve të tenderit. Referuar dokumentacionit të paraqitur (Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8 të DT dhe deklaratës për stafin) dhe OE rezultojnë se për punonjësit e specializuar si më poshtë: 2 (dy) Arben Reci, Fates Lita - Instalues dhe riparues të sistemeve ftohese- ngrohese; ka deklaruar se dëshmitë profesionale janë të lëshuara nga subjekti AQScert, me NUIS L31511026K. Lidhur me këto certifikata, KVO verifikoi në QKB dhe rezultojnë se kjo shoqëri nuk ka asnjë licencë aktive dhe për rrjedhojë nuk përmbushet kërkesa për kualifikim që dëshmitë e kualifikimit profesional/certifikatë/diploma, të jenë të lëshuara nga institucione (shtetërore apo private) të licencuara/akredituara nga autoritetet përgjegjëse shtetërore, sipas ligjit nr. 15/2017 “Per arsimin dhe formimin profesional në R.Sh.”. Kete qëndrim ka mbajtur edhe KPP në vendimin nr. 441/2020, ku citohet si vijon: Pra rezultojnë se dokumentet e*

paraqitura për dy punonjësit pllakashtrues, në zbatim të pikës 8 si më sipër cituar nuk përmbushin kërkesën e autoritetit kontraktor për “Diplomë nga institucionet e arsimit të mesëm profesional të akredituara sipas ligjit Nr.15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në RSH”, pasi shoqëria ASQCERT, e cila ka lëshuar Certifikatat e Trajnimit për “Kurs Trajnimi për pllakashtrues”, nuk është licencuar nga ana Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë dhe nuk disponon asnjë licencë për të ofruar kurse trajnimit për formimin profesional në përputhje me ligjin nr.15/2017, “Per arsimin dhe formimin profesional ne Republikën e Shqipërisë.” Formimi profesional i personelit përbën domosdoshmeri dhe garanton autoritetin kontraktor për kapacitetet profesionale të ofertuesve për përmbushjen me sukses të kontratës, gjë e cila vërtetohet vetëm me Certifikatë/dëshmi/diplomë që është dokument zyrtar dhe i lëshuar një organ certifikues, sipas procedurave standarde ligjore dhe që regjistrojnë arritjet e një individi pas vlerësimit të caktuar. Referuar dokumentacionit të paraqitur (Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8 të DT-ve dhe deklaratës për stafin), rezulton se punonjësit e specializuar: - Hidraulik (Kadri Fusha); - Elektricitist (Sali Allmeta); - Hekurkthyes (Artan Jonuzi, Ramazan Emini, Englison Demiri); - Hekurpunues (Lavdrim Tota, Entil Guga); - Karpentier (Krenar Plakalli , Arben Deliu); - Betonues (Arben Lecini, Klodian Ramka); - Elektromekanik (Islam Demiri); - Mekanik (Hoselito Seferi); - Specialist gipsi, sistemet e thata në ndërtesa (Hamid Tafa, Mariglen Ramazani, Florid Toska, Riza Kola); - Punonjes Duroalumini (Ylli Xhepa); - Muratore (Agron Kullolli, Bledar Cela, Xhemail Emini, Abaz Kullolli, Ramadan Kruja, Hajri Tafani); - Suvatues (Albert Murataj, Erlin Xhafai, Ervin Shehu); - Hidroizolues (Ermal Tafaj, Hekuran Balloshiti, Zyhdi Elezi, Zenel Gjini); - Bojaxhi (Derman Cangeli, Luan Qekai, Syrjan Qekai, Xhuliano Hasani, Edmond Sula); - Shtrues pllakash (Jonuz Leci, Ylli Driza, Fatmir Alushi, Haxhi Seferi, Fatos Bunoca, Luan Ali) janë të pajisur me dëshmi profesionale nga subjekti “TCPE”, me NUIS L52031020F. Lidhur me këto certifikata, KVO verifikoi në QKB dhe rezulton se kjo shoqëri nuk ka asnjë licencë aktive dhe për rrjedhojë nuk përmbushet kërkesa për kualifikim që dëshmitë e kualifikimit profesional/certifikatë/diploma, të jenë të lëshuara nga institucione (shtetërore apo private) të licencuara/akredituara nga autoritetet përgjegjëse shtetërore, sipas ligjit nr. 15/2017 “Per arsimin dhe formimin profesional në R.Sh.”. Këtë qëndrim ka mbajtur edhe KPP në vendimin Nr. 441/2020 dhe nr. 745/2022 në lidhje me dëshmitë e lëshuara nga subjekte të palicensuara. - Referuar dokumentacionit të paraqitur (Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8 të DT-ve dhe deklaratës për stafin), rezulton se punonjësit e specializuar: - Hidraulik (Sokol Bufi); - Instalues dhe riparues të sistemeve ftohese- ngrohese (Emiljano Beba); - Duroalumini (Albi Lloga, Muhamet Isallari) janë të pajisur me dëshmi profesionale nga subjekti “HTM”, me NUIS K97006004D. Lidhur me këto certifikata, KVO verifikoi në QKB dhe rezulton se kjo shoqëri nuk ka asnjë licencë aktive dhe për rrjedhojë nuk përmbushet kërkesa për kualifikim që dëshmitë e kualifikimit profesional/certifikatë/diploma, të jenë të lëshuara nga institucione (shtetërore apo private) të licencuara/akredituara nga autoritetet përgjegjëse shtetërore, sipas ligjit nr. 15/2017 “Per arsimin dhe formimin profesional në R.Sh.”. Këtë qëndrim ka mbajtur edhe KPP në vendimin Nr. 441/2020 dhe nr. 745/2022 në lidhje me dëshmitë e lëshuara nga subjekte të palicensuara. - Referuar dokumentacionit të paraqitur (Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8 të DT-ve dhe deklaratës për stafin), rezulton se punonjësit e specializuar: - Elektricitist (Servet Gjuzi, Shkelqim Paja); - Hekurkthyes (Megli Cano, Venture); - Hidraulik (Kledi Myrto, Kujtim

Shehu); - Karpentier (Sokol Peqini, Venture); - Punonjes Duroalumini (Syrja Shena); - Saldator (Besnik Spahiu, Rustem Isha, Daniel Kruja), janë të pajisur me dëshmi profesionale nga subjekti FUSION EV sh.p.k., me NUIS M11314044Q. Lidhur me këto certifikata, KVO verifikoi në QKB dhe rezultoi se kjo shoqëri nuk ka asnjë licencë aktive dhe për rrjedhojë nuk përmbushet kërkesa për kualifikim që dëshmitë e kualifikimit profesional/certifikatë/diploma, të jenë të lëshuara nga institucione (shtetërore apo private) të licencuara/akredituara nga autoritetet përgjegjëse shtetërore, sipas ligjit nr. 15/2017 “Per arsimin dhe formimin profesional në R.Sh.”. Këte qëndrim ka mbajtur edhe KPP në vendimin Nr. 441/2020 dhe 745/2022 në lidhje me deëshmitë e lëshuara nga subjekte të palicensuara. - Referuar dokumentacionit të paraqitur (Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8 të DT-ve dhe deklaratës për stafin), rezultoi se punonjësit e specializuar: - Karpentier (Uesli Shehaj); - Hidraulik (Memo Lila); - Bojaxhi Klajdi (Hametaj); - Specialist gipsi, sistemet e thata (Elian Shena); - Instalues dhe riparues të sistemeve ftohëse- ngrohëse (Adriatik Gogo, Leonard Sulka) janë të pajisur me dëshmi profesionale nga subjekti Qendra e Trajnimeve të Avancuara – QTA me NUIS L61325037A. Lidhur me këtë certifikatë, KVO verifikoi në QKB nga ku rezultoi se kjo shoqëri nuk është e licencuar për të ofruar dëshmi kualifikimi për këtë profesion dhe për rrjedhojë nuk përmbushet kërkesa për kualifikim që dëshmitë e kualifikimit profesional/certifikatë/diploma, të jenë të lëshuara nga institucione (shtetërore apo private) të licencuara/akredituara nga autoritetet përgjegjëse shtetërore, sipas ligjit nr. 15/2017 “Per arsimin dhe formimin profesional në R.Sh.”. Këtë qëndrim ka mbajtur edhe KPP në vendimin Nr. 441/2020 dhe nr. 745/2022 në lidhje me dëshmitë e lëshuara nga subjekte të palicensuara”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.2.1. Në shtojcën 7/2 “Kriteret e veçanta të kualifikimit”, pika 2.3.9 “Kapaciteti teknik”, të dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt - ankimi, të publikuara nga autoriteti kontraktor në SPE, është parashikuar plotësimi i kriterit si më poshtë vijon:

2.3.9 Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë të punësuar si staf teknik punonjës minimumi:

- Punonjës teknik ndërtimi 1 (një)
- Punonjës teknik elektroteknikë 1 (një)
- Punonjës teknikë/Specialistë të inxhinierisë elektronike dhe/ose të teknologjisë së informacionit dhe komunikimit 1 (një)
- Punonjës Hidraulikë 5 (pese)
- Punonjës Elektricitë 3 (tre)
- Punonjës instalues dhe riparues të kondicionerëve dhe sistemeve ftohëse-ngrohëse 5 (pese)
- Punonjës Hekurkthyes 5 (pese)
- Punonjës Hekurpunim (Konstruksione Metalike) 2 (dy)
- Punonjës Karpentier 5 (pese)
- Punonjës Betonues 2 (dy)
- Punonjës Saldator 3 (tre)
- Punonjës elektromekanik 1 (një)
- Punonjës Mekanik 1 (një)

- Punonjës Specialist gipsi (Sisteme te thata në ndërtesa) 5 (pese)
- Punonjës duro-alumini 4 (katër)
- Punonjës Muratorë / Suvatues 10 (Dhjetë)
- Punonjës Hidroizolues 4 (katër)
- Punonjës Bojaxhi 6 (gjashtë)
- Punonjës Shtrues pllakash 7 (shtate)

të vërtetuar me diploma/certifikata të arsimit profesional të lëshuara nga institucionet të akredituara sipas Ligjit Nr.15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë” ose ekuivalente, kontratë pune të vlefshme, si dhe të rezultojnë në listëpagesat e shoqërisë për periudhën Qershor – Gusht 2023.

Për punonjësit me profesionet si më sipër, operatorët ekonomikë duhet të plotësojnë dhe të paraqesin tabelën me të dhënat si më poshtë:

Nr	Emër Mbiemër i punonjësit	Profesioni	Institucioni publik/privat lëshues i certifikatës/diplomës	Nr. NIPT (Në rast se lëshuesi është institucion privat)	Numri i regjistrimit të certifikatës së Akreditimit (Në rast se lëshuesi është institucion privat)
1					
2					
etj.					

Shënim: Në momentin e vlerësimit dhe shqyrtimit të kriterëve kualifikuese ky kriter do të konsiderohet i përmbushur me dorëzimin e vetëdeklarimit përmbledhës sipas Shtojcës 8, bazuar në nenin 82 të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” si dhe në gjurmën dh) të pikës 2 të nenit 26 të Vendimit nr. 285 datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për tu kërkuar sqarime nga AK.

III.2.2. Në shtojcën 8 “Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit”, në dokumentet standarde të tenderit të procedurës së prokurimit objekt-ankimi, autoriteti kontraktor ka përcaktuar si më poshtë vijon:

Shtojca 8

(Shtojcë për tu paraqitur nga operatori ekonomik)

FORMULARI PËRMBLEDHËS I VETËDEKLARIMIT

I. Unë i nënshkruari _____ në cilësinë e _____ të operatorit ekonomik _____ deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë që:

PJESA I: A. INFORMACION NË LIDHJE ME OPERATORIN EKONOMIK

Identifikimi	Përgjigjja
Emri i operatorit ekonomik: (Ju lutemi renditni të gjithë operatorët ekonomikë nëse jeni një BOE. Ju lutemi tregoni rolin e operatorit ekonomik në BOE)	-----
Numri NIPT/et:	----- -
Adresa postare: Qyteti / qyteti; Kodi postar	----- ----
Përfaqësuesi (emri):	-----
Telefoni:	----- ---
E-mail:	----- -----

B: DEKLARATË

Për nënkontraktorët dhe subjektet në kapacitetet, e të cilave do të mbështetet Operatori Ekonomik (nëse është e zbatueshme)

Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se:

- **Informacione për nënkontraktorin**

Emri i nënkontraktorit të propozuar	NIPT -i	Përqindja e nënkontraktimit	Mallrat/ shërbimet e lidhura me to për t'u nënkontraktuar

- **Informacion mbi subjektet mbi kapacitetin, e të cilëve do të mbështetet operatori ekonomik**

Emri (at) e subjekteve	NIPT-i	Lloji i kapacitetit për të cilin do të mbështetet operatori ekonomik	Specifiko konkretisht kapacitetin/et

Pjesa II: Shkaqet e përjashtimit

A: DEKLARATA PËR PËRMBUSHJEN E KRITEREVE TË PËRGJITHSHME TË KUALIFIKIMIT

Deklarata
<p>Operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv.</p> <p><i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i></p> <hr/>
<p>Operatori ekonomik nuk është dënuar për ndonjë nga veprat penale të parashikuara në nenin 76/1 të LPP-së ose ka qenë i dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së.</p> <p><i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i></p> <hr/>
<p>Personi / personat në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtorit ose mbikëqyrësit, si aksionar ose si ortak, ka ose kompetenca përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, si më poshtë:</p> <hr/> <p>etj.</p> <p>nuk janë të dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për ndonjë nga veprat penale të përcaktuara në nenin 76/1 të LPP-së ose kanë qenë i dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së, etj.</p> <p><i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i></p> <hr/>
<p>Operatori ekonomik nuk është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale.</p> <p><i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i></p> <hr/>

<p>Operatori ekonomik nuk është në proces falimentimi (statusi aktiv).</p> <p><i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i></p> <hr/>
<p>Operatori Ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për taksat dhe kontributet e sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi, ose ndodhet në një nga rastet e parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së</p> <p><i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i></p> <hr/>
<p>Operatori ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet e energjisë elektrike, për të gjitha adresat e ushtrimit të aktivitetit, sipas legjislacionit përkatës në fuqi.</p> <p>Ky informacion kërkohet për operatorët ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.</p> <p><i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i></p> <hr/>
<p>Operatori ekonomik ushtron aktivitetin e tij në zbatimin e kërkesave ligjore në fuqi.</p> <p><i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i></p> <hr/>
<p>Operatori ekonomik nuk është në listën e operatorëve ekonomikë të ndaluar për të fituar kontrata publike në përputhje me nenin 78 të LPP-së.</p> <p>Operatori ekonomik nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë /kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të përfituar fonde publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.</p> <p><i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i></p> <hr/>

B: DEKLARATA

<p>Ne cilësinë e përfaqësuesit të operatorit ekonomik, në mbështetje të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, si dhe në mbështetje të Ligjit Nr.9121/2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, bëj këtë deklaram dhe garantoj se deklaratat e mëposhtme janë të vërteta dhe të plota në çdo aspekt:</p> <p>1. Unë kam lexuar dhe kuptuar përmbajtjen e kësaj Deklarate;</p>

2. Unë kuptoj që oferta e paraqitur do të s'kualifikohet dhe/ose përjashtohet nga fitimi i kontratave publike, nëse kjo Deklaratë vërtetohet se nuk është e plotë dhe / ose e saktë në çdo aspekt;
3. Unë jam i autorizuar nga Ofertuesi të firmos këtë Deklaratë dhe të paraqes ofertë në interes të Ofertuesit;
4. Çdo person, firma e të cilit shfaqet në dokumentacionin e ofertës, është i autorizuar nga Ofertuesi për të përgatitur dhe për të nënshkruar ofertën në interes të Ofertuesit;
5. Për qëllim të kësaj deklarate dhe ofertës së paraqitur, unë kuptoj që fjala “konkurrentë” nënkupton çdo operator tjetër ekonomik, të ndryshëm nga Ofertuesi, të paraqitur ose jo si bashkim operatorësh ekonomik, që:
 - a) paraqesin një ofertë në përgjigje të Njoftimit të Kontratës dhe/ose të Ftesës për Ofertë, të bërë nga Autoriteti Kontraktor;
 - b) është një ofertues i mundshëm, i cili bazuar në kualifikimin, aftësitë ose përvojat e tij, mundet të dorëzojë një ofertë në përgjigje, të Njoftimit të Kontratës dhe/ose të Ftesës për Ofertë.
6. Ofertuesi deklaron se: (kliko një nga alternativat e mëposhtme):
 - a) Ofertuesi ka përgatitur ofertën e tij në mënyrë të pavarur, pa u konsultuar, pa komunikuar dhe pa bërë marrëveshje apo pa rënë dakord me asnjë konkurrent tjetër;
 - b) Ofertuesi është konsultuar, ka komunikuar, ka bërë marrëveshje me një ose më shumë konkurrentë në lidhje me këtë procedurë prokurimi. Ofertuesi deklaron se në dokumentet bashkangjitur, në detajet e kësaj oferte, janë përfshirë emrat e konkurrentëve, natyra dhe shkaqet e konsultimit, komunikimit, marrëveshjes apo angazhimit (rasti i bashkimit të operatorëve ekonomikë ose nënkontraktimit).
7. Në veçanti, pa kufizuar paragrafët 6. a) dhe 6. b), të përmendur më lart, nuk ka pasur konsultime, komunikime, kontratë apo marrëveshje me ndonjë konkurrent në lidhje me:
 - a) çmimet ;

- b) metodat, faktorët ose formulat e përdorura për llogaritjen e çmimit;
- c) qëllimin apo vendimin për të paraqitur apo jo një ofertë; ose,
- d) paraqitjen e një oferte që nuk i plotëson specifikimet e kërkesës për ofertë.

8. Përveç kësaj, nuk ka pasur konsultime, komunikime, marrëveshje apo kontrata me ndonjë konkurrent në lidhje me cilësinë, sasinë, specifikimet apo dërgesa të veçanta të produkteve apo shërbimeve të cilat lidhen me prokurimin në fjalë, përveç se kur janë deklaruar sipas paragrafit të mësipërm 6. b).

9. Kushtet e ofertës nuk u janë bërë të njohura dhe as nuk do t'u bëhen të njohura me qëllim nga Ofertuesi konkurrentëve të tjerë, në çdo mënyrë qoftë, para datës dhe kohës së hapjes zyrtare të ofertave, shpalljes fitues dhe lidhjes së kontratës, vetëm nëse kërkohet me ligj ose nëse deklarohen në mënyrë specifike sipas paragrafit 6.b).

C: DEKLARATA MBI KONFLIKTIN E INTERESIT

Deklarata

Në cilësinë e operatorit ekonomik, ne deklarojmë se jemi të vetëdijshëm për sa vijon:
Konflikti i interesit është një situatë e konfliktit midis detyrës publike dhe interesit privat të një zyrtari, në të cilën ai / ajo ka interesa private direkte ose indirekte që ndikojnë, ose që mund të ndikojë ose që duket se ndikojnë në kryerjen e padrejtë të detyrave dhe detyrimeve publike.

Në përputhje me nenin 21, paragrafi 1, Ligji Nr. 9367, datë 07.04.2005, kategoritë e zyrtarëve siç parashikohen në Kapitullin III, Seksioni II, që janë absolutisht të ndaluara të përfitojnë drejtpërdrejt ose indirekt nga nënshkrimi i kontratave midis një pale dhe institucionit publik janë:

Presidenti i Republikës, Kryeministri, Zëvendës Kryeministri, Ministrat, ose Zëvendësministrat, Deputetët, Gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese, Gjyqtarët e Gjykatës së Lartë, Kreu i Kontrollit të Lartë të Shtetit, Prokurori i Përgjithshëm, Gjyqtarët dhe Prokurorët në nivelin e Gjykatës së Shkallës së Parë dhe Gjykatës së Apelit, Avokati i Popullit, Anëtarët e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Anëtarët e Këshillit të Lartë të Drejtësisë, Inspektori i Përgjithshëm i Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesit, Anëtarët e Enteve Rregullatore (Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë, përfshirë Guvernatorin dhe Zëvendësguvernatorin; konkurrenca; telekomunikacioni; energjia elektrike; furnizimi me ujë; sigurimi; bonot; autoritetet e medias), sekretarët e përgjithshëm të institucioneve qendrore si dhe çdo zyrtar publik në çdo institucion publik pozicioni i të cilit është i barabartë me atë të Drejtorit të Përgjithshëm, drejtuesit e organeve të administratës publike që nuk janë pjesë e shërbimit civil.

Për nëpunësit civilë të nivelit të mesëm, sipas nenit 31 dhe zyrtarët sipas nenit 32 të kreut III, seksionit 2 të këtij ligji, ndalimi në paragrafin 1 të këtij neni, për shkak të interesave private të

zyrtarit, siç përcaktohet këtu të zbatohet vetëm në rast të lidhjes së kontratave brenda fushës dhe territorit të institucionit dhe juridiksionit të institucionit, ku punon zyrtari. Ky ndalim do të zbatohet edhe kur pala në kontratë është një institucion varësie.

Kur zyrtari është kryetar bashkie ose nënkryetar i një bashkie ose komune, ose kryetar i një këshilli rajonal, anëtar i këshillit përkatës, ose një zyrtar i lartë i menaxhimit të një njësie të qeverisjes vendore, ndalimi për shkak të interesave private të zyrtarit, specifikuar këtu, do të zbatohet vetëm në rastin e lidhjes së kontratave, nëse ka, me bashkinë, komunën ose rajonin ku zyrtari ushtron një detyrë të tillë. Ky ndalim do të zbatohet gjithashtu kur pala në kontratë është një institucion publik në varësi të kësaj njësie (neni 21, paragrafi 2, Ligji Nr. 9367, datë 07.04.2005).

Ndalimet e parashikuara në nenin 21, paragrafët 1, 2 të Ligjit Nr. 9367, datë 07.04.2005, me përjashtimet përkatëse, do të zbatohen në të njëjtën masë edhe për personat e lidhur me zyrtarin, d.m.th. bashkëshortin, bashkëjetuesin, fëmijët madhorë e prindërit e zyrtarit dhe të bashkëshortit dhe bashkëjetuesit.

Unë jam në dijeni të kërkesave dhe ndalimeve të parashikuara në Ligjin Nr. 9367, datë 07.04.2005 "Për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksioneve Publike", të ndryshuar, dhe aktet nënligjore të miratuara në bazë të tij nga Inspektorati i Lartë i Deklarimi dhe Kontrolli i Pasurive, si dhe Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik".

Në përputhje me to, unë deklaroj këtu se asnjë zyrtar publik, siç përcaktohet në Kapitullin III, Seksioni II të Ligjit Nr. 9367, datë 07.04.2005, dhe në këtë deklaratë, nuk ka ndonjë interes privat, direkt ose indirekt, me personin juridik që unë përfaqësoj këtu.

D: DEKLARATA “Për zbatimin e dispozitave ligjore në marrëdhëniet e punës”

Deklarata

Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time se:

- Operatori ekonomik _____garanton mbrojtjen e të drejtës së punësit dhe profesionit nga çdo formë diskriminimi, të parashikuar nga legjislacioni i punës në fuqi.
- Operatori ekonomik _____lidh me punëmarrësit kontratat përkatëse të punës dhe garanton masat në drejtim të sigurisë dhe shëndetit në punë për të Gjithë dhe, në mënyrë të veçantë, për grupet e rrezikuara, bazuar në legjislacionin e punës në fuqi.
- Operatori ekonomik _____nuk ka masë Ligjore në fuqi, të vendosur nga Inspektoriati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore (ISHPSHSH). Në rastet kur janë konstatuar shkelje ligjore, operatori ekonomik ka marrë masat e nevojshme për adresimin e tyre, brenda afateve të përcaktuara nga ISHPSHSH.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme

Pjesa III: Kriteret e Përzgjedhjes/Kualifikimit

A: DEKLARATË

“Per permbushjen e specifikimeve teknike dhe grafikun e realizimit të objektit të kontratës”

Deklarata	Përgjigje
Në cilësinë e operatorit ekonomik, ne deklarojmë se plotësojnë të gjitha specifikimet teknike, siç udhëzohet në dokumentet e tenderit, dhe këtë e provojmë përmes certifikatave dhe dokumenteve të paraqitura me këtë deklaratë (nëse kërkohet nga Autoriteti/Enti Kontraktor), dhe marrim përsipër të realizojmë objektin në përputhje me preventivin e punimeve dhe grafikun e zbatimit të punimeve të përcaktuar nga Autoriteti/Enti kontraktor.	Po [] Jo []

B: DEKLARATË “Për disponimin e punonjësve të nevojshëm për realizimin e punimeve objekt kontrate”

Deklarata	Përgjigje
Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time se: Unë kam punonjësit e nevojshëm siç përcaktohet në dokumentet e tenderit, dhe e vërtetoj këtë me dokumentacionin përkatës, të cilin do ta paraqes në kopje origjinale ose të noterizuar, nëse fitoj, ose nëse më kërkohen sqarime nga autoriteti/enti kontraktor.	Punonjës Po [] Jo [] Nëse, po, numri i punonjësve Gjithashtu, disponoj personelin kryesor të poshtëshënuar, sipas profileve (profesioneve/kualifikimeve) përkatëse: Z. _____, me profesion _____, i punësuar pranë shoqërisë sonë, në rolin e _____, Z. _____, me profesion _____, i punësuar pranë shoqërisë sonë, në rolin e _____, Z. _____, me profesion _____, i punësuar pranë shoqërisë sonë, në rolin e _____, Makineri e mjete Po [] Jo [] Nëse, po, të listohen me të dhënat konkrete

C: DEKLARATË

“Për disponimin e mjeteve/pajisje/makinerive të nevojshme për realizimin e punimeve objekt kontrate”

Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time se, kam në dispozicion dhe/ose do të me vihen në dispozicion mjetet, pajisjet teknike dhe asetet e tjera fizike për të realizuar këtë kontratën, si me poshte:

Në pronësi				
Lloji i Mjetit	Targa	Nr. Lejes qarkullimit	Nr. Shasisë	Të tjera
1				
2				
3				
4				
5				

Me qira					
Lloji i Mjetit	Targa e mjetit	Nr. Lejes qarkullimit të mjetit	Nr. Shasisë së mjetit	Nr. Kont së qerasë (noterisë)	Afati i kontratës qerasë(data e fillimit dhe mbarimit)
1					
2					
3					
4					
5					
6					

Kontratë furnizimi	

Materiali/pro dukti për të cilin paraqitet kontrata e furnizimit	Nr. Kont së furnizimit (noterisë)	Afati i kontratës furnizimit (data e fillimit dhe mbarimit)	Të tjera	
1.				
2				
3				
4				

D. Deklaratë mbi Mosangazhimin e Kapaciteteve Teknike në Kontrata Te Tjera

Deklarata

Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time se:

Mjetet/pajisjet/makineritë e deklaruar në këtë procedurë prokurimi, pavarësisht formës së disponimit të tyre, do të jene ne dispozicion gjatë zbatimit të kontratës sipas grafikut te punimeve.

Nëse kërkohet, stafi teknik i poshtëshënuar:

Z. _____, me profesion _____, i punësuar pranë shoqërisë sonë, në rolin e _____, etj .,

i deklaruar në këtë procedurë prokurimi, nuk është i angazhuar në asnjë kontratë apo punëmarrje tjetër publike, që bie ndesh me legjislacionin e fushës së ndërtimit, dhe do të angazhohet vetëm për realizimin e këtij objekti.

Emri, Mbiemri _____

Firma _____

Vula _____

Data e dorëzimit të deklaratës _____

Ju lutemi sigurohuni që:

- Secili pjesëmarrës i renditur në një bashkim operatorësh ekonomikë të paraqesë një **Formular të veçantë të Vetëdeklarimit.**
- Në rast se, operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, një Formular i veçantë i Vetëdeklarimit duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

- Çdo vetdeklarim i pavërtetë/pasaktë nga ana e operatorëve ekonomikë jo vetëm që përbën shkak për skualifikimin nga procedura konkrete, por përbën shkak edhe për përjashtimin e tyre nga e drejta për të fituar kontrata publike deri në 3 vjet, sipas parashikimeve të ligjit për prokurimin publik.
- Operatorët ekonomikë që ofertojnë në procedurat e prokurimit të vetdeklarojnë në çdo rast informacionin e saktë që i korrespondon gjendjes së tyre faktike.

Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik për sa më sipër.

- *Në çdo rast, përpara publikimit të njoftimit të fituesit paraprak dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor duhet t'i kërkojë ofertuesit fitues që të dorëzojë dokumentet provuese për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, si dhe dokumentet e paraqitura si pjesë e ofertës në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin.*
- *Informacioni i pasqyruar në formularin e vetëdeklarimit, i cili gjendet në një bazë të dhënash, ku autoriteti/enti kontraktor mund të aksesojë direkt këtë informacion dhe /ose dokumentin, duhet të shoqërohet me adresën përkatëse për këtë bazë të dhënash.*

III.2.3. Në përmbushje të kriterit më sipër cituar, operatori ekonomik “Alko Impex General Construction” SHPK ka paraqitur në sistemin e prokurimit elektronik SPE dokumentacionin si më poshtë:

1- Aktë Marrëveshje datë 25.10.2023 lidhur midis “Alko Impex Construction” SHPK dhe “Alko Impex General Construction” SHPK. “Meqenëse shoqëria “Alko Impex General Construction” SHPK ka shprehur vullnetin e saj të lirë e të plotë, për të marrë pjesë konform procedurave përkatëse në procedurat e prokurimit që organizon Drejtoria e Spitalit Rajonal Dibër, me objekt “Rikonstruksion i Spitalit Rajonal Dibër Rahim Xhika”, kërkon mbështetje në aftësitë teknike, profesionale nga shoqëria Alko Impex Construction ShPK. Nëpërmjet kësaj kontrate, operatori ekonomik në plotësim të kriterëve të përcaktuara në DST nga AK në procedurën e prokurimit, e konkretisht atë të kapacitetit teknik dhe profesional, si dhe realizimit me sukses të kontratës në rast të shpalljes fituese, do të mbështetet në kapacitetet teknike dhe profesionale të shoqërisë “Alko Impex Construction” SHPK. Ky i fundit deklaron dhe bie dakort se do të mbështesë operatorin ekonomik “Alko Impex General Construction” SHPK për pikën 2.3.9 (stafi teknik) 2.3.10 (mjetet dhe pajisjet).

2- Deklaratë datë 25.10.2023 nga mbështetësi i kapaciteteve “Alko Impex Construction” SHPK.

3- Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit “Alko Impex General Construction” SHPK. Në Pjesën III: “Kriteret e Përzgjedhjes/Kualifikimit”, gërma “B”: “DEKLARATË “Për disponimin e punonjësve të nevojshëm për realizimin e punimeve objekt - kontrate”, operatori ekonomik “Alko Impex General Construction” SHPK deklaron:

Shtojca 8.

FORMULARI PËRMBLEDHËS I VETËDEKLARIMIT

Unë i nënshkruari **Arbër Abazi** në cilësinë e perfaqësuesit të operatorit ekonomik **Alko Impex General Construction dshh** deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë që:

A. Pjesa I: Informacion në lidhje me Operatorin Ekonomik

Identifikimi	Përgjigjja
Emri i operatorit ekonomik: (Ju lutemi renditni të gjithë operatorët ekonomikë nëse jeni një BOE. Ju lutemi tregoni rolin e operatorit ekonomik në BOE)	Alko Impex General Construction dshh
Numri NIPT/et:	K 913260281
Adresa postare: Qyteti / qyteti; Kodi postar	Rruga “ Reshit Petrela”, Kompleksi Usluga, Tirane
Përfaqësuesi (emri):	Arbër Abazi

- Informacion mbi subjektet mbi kapacitetin, e të cilëve do të mbështetet operatori ekonomik

Emri (at) e subjekteve	NIPT-i	Lloji i kapacitetit për të cilin do të mbështetet operatori ekonomik	Specifiko konkretisht kapacitetin/et
ALKO IMPEX CONSTRUCTION	K91628013D	Kapaciteti teknik	Pika 2.3.9(STAFI Teknik)2.3.10(mjetet dhe pajisjet)
ARKONSTUDIO	L42019004I	Kapaciteti teknik	Pika 2.3.4, (Arkitekti)2.3.7(Auditues Energjie)
“2 T”shpk	K01731001M	Kapaciteti teknik	2.3.1, ne lidhje me Kapacitetin teknik

B: DEKLARATË “Për disponimin e punonjësve të nevojshëm për realizimin e punimeve objekt kontrate”

Deklarata	Përgjigje
Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time se: Unë kam punonjësit e nevojshëm siç përcaktohet në dokumentet e tenderit, dhe e vërtetoj këtë me dokumentacionin përkatës, të cilin do ta paraqes në kopje origjinale ose të noterizuar, nëse fitoj, ose nëse më kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.	Punonjës Po [X] Jo [] Nëse, po, numri i punonjësve Alko Impex General Construction ka të pusesuar mesatarisht 338 punonjes per periudhen Qershor-Gusht 2023 Gjithashtu, disponoj personelin kryesor të poshtëshënuar, sipas profileve (profesioneve/kualifikimeve) përkatëse: 1. me profesion Inxhinier Ndertimi, i punesuar prane shoqërise sone,ne rolin drejtues teknik. 2. me profesion Inxhinier gjeodet, i punësuar pranë shoqërisë sonë, në rolin e drejtuesit teknik, 3. , me profesion Inxhinier hidroteknik, i punesuar prane shoqërise sone, ne rolin e drejtuesit Teknik. Inxhinier i pajisur me certifikate “Pergjegjes per sigurine dhe mbrojtjene shendetit ne pune”

	<ol style="list-style-type: none"> 4. me profesion Inxhinier mekanike, e punesuar prane shoqerise sone, ne rolin e drejtuesit Teknik 5. me profesion Inxhinier elektrik, i punesuar prane shoqerise sone, ne rolin e drejtuesit Tekni. 6. me profesion Mjek i pergjitheshem i punesuar prane shoqerise sone, 7. me profesion Teknik ndertimi i punesuar prane shoqerise sone. 8. me profesion Teknik elektroteknike i punesuar prane shoqerise sone. 9. me profesion Inxhinier Elektronike i punesuar prane shoqerise sone. 10. me profesion Hidraulik i punesuar prane shoqerise sone. 11. me profesion Hidraulik i punesuar prane shoqerise sone. 12. me profesion Elektricist, i punësuar pranë shoqërisë sone 13. me profesion Elektricist, i punësuar pranë shoqërisë sone. 14. me profesion Instalues te kondicionereve dhe sistemeve ftohes ngrohës i punësuar pranë shoqërisë sone. 15. me profesion Instalues te kondicionereve dhe sistemeve ftohes ngrohës i punësuar pranë shoqërisë sone. 16. me profesion Instalues te kondicionereve dhe sistemeve ftohes ngrohës i punësuar pranë shoqërisë sone. 17. me profesion Instalues te kondicionereve dhe sistemeve ftohes ngrohës i punësuar pranë shoqërisë sone. 18. me profesion Hekurkthyes, i punësuar pranë shoqërisë sone.
	<ol style="list-style-type: none"> 19. me profesion Hekurkthyes, i punësuar pranë shoqërisë sone 20. me profesion Karpentier , i punësuar pranë shoqërisë sone. 21. me profesion Betonues , i punësuar pranë shoqërisë sone. 22. me profesion Betonues , i punësuar pranë shoqërisë sone. 23. me profesion Saldator, i punesuar prane shoqerise sone. 24. me profesion Mekanik, i punesuar prane shoqerise sone. 25. me profesion Specialist Gipsi/sisteme te thata , i punësuar pranë shoqërisë sone. 26. me profesion Specialist Gipsi/sisteme te thata , i punësuar pranë shoqërisë sone. 27. me profesion Specialist Gipsi/sisteme te thata , i punësuar pranë shoqërisë sone. 28. me profesion Specialist Gipsi/sisteme te thata , i punësuar pranë shoqërisë sone. 29. me profesion Punonjes Duro-alumini , i punësuar pranë shoqërisë sone. 30. me profesion Punonjes Duro-alumini , i punësuar pranë shoqërisë sone. 31. me profesion Suvatues/murator, i punesuar prane shoqerise sone. 32. me profesion Suvatues/murator, i punesuar prane shoqerise sone 33. me profesion Suvatues/Muratore, i punesuar prane shoqerise sone. 34. me profesion Suvatues/Muratore, i punesuar prane shoqerise sone. 35. me profesion Hidroizolues, i punesuar prane shoqerise sone. 36. me profesion Bojaxhi, i punesuar prane shoqerise sone.

	<p>37. me profesion Bojaxhi, i punësuar pranë shoqërisë sone.</p> <p>38. me profesion Pllakashtrues, i punësuar pranë shoqërisë sone.</p> <p>39. me profesion Pllakashtrues, i punësuar pranë shoqërisë sone.</p> <p>40. me profesion Pllakashtrues, i punësuar pranë shoqërisë sone.</p> <p>41. me profesion Pllakashtrues, i punësuar pranë shoqërisë sone.</p> <p>Makineri e mjete</p> <p>Po [X] Jo []</p> <p>Nëse, po, të listohen me të dhënat konkrete</p>

4- Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit “Alko Impex Construction” SHPK. Në Pjesën III: “Kriteret e Përzgjedhjes/Kualifikimit”, gërma “B”: “DEKLARATË “Për disponimin e punonjësve të nevojshëm për realizimin e punimeve objekt kontrate”, operatori ekonomik “Alko Impex Construction” SHPK deklaron:

B: DEKLARATË “Për disponimin e punonjësve të nevojshëm për realizimin e punimeve objekt kontrate”

Deklarata	Përgjigje
<p>Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time se:</p> <p>Unë kam punonjësit e nevojshëm siç përcaktohet në dokumentet e tenderit, dhe e vërtetoj këtë me dokumentacionin përkatës, të cilin do ta paraqes në kopje origjinale ose të noterizuar, nëse fitoj, ose nëse më kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.</p>	<p>Punonjës</p> <p>Po [X] Jo []</p> <p>Nëse, po, numri i punonjësve Alko Impex Construction ka të punësuar mesatarisht 339 punonjës për periudhën Qershor-Gusht</p> <p>Gjithashtu, disponoj personelin kryesor të poshtëshënuar, sipas profileve (profesioneve/kualifikimeve) përkatëse:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. me profesion Hidraulik, i punësuar pranë shoqërisë sone. 2. me profesion Hidraulik, i punësuar pranë shoqërisë sone. 3. me profesion Hidraulik, i punësuar pranë shoqërisë sone. 4. me profesion Elektracist, i punësuar pranë shoqërisë sone. 5. me profesion Instalues të kondicionereve dhe sistemeve ftohese-ngrohese i punësuar pranë shoqërisë sone. 6. me profesion Hekurkthyes, i punësuar pranë shoqërisë sone 7. me profesion Hekurkthyes, i punësuar pranë shoqërisë sone 8. me profesion Hekurkthyes, i punësuar pranë shoqërisë sone 9. me profesion Hekurpunues, i punësuar pranë shoqërisë sone 10. me profesion Hekurpunues, i punësuar pranë shoqërisë sone 11. me profesion Karpiertier, i punësuar pranë shoqërisë sone. 12. me profesion Karpiertier, i punësuar pranë shoqërisë sone. 13. me profesion Karpiertier, i punësuar pranë shoqërisë sone. 14. me profesion Karpiertier, i punësuar pranë shoqërisë sone. 15. me profesion Saldator, i punësuar pranë shoqërisë sone.

	<p>16. me profesion Saldator, i punesuar prane shoqerise sone.</p> <p>17. me profesion Elektromekanik , i punësuar pranë shoqërisë sone.</p> <p>18. me profesion Specialist Gipsi , i punësuar pranë shoqërisë sone.</p> <p>19. me profesion Punonjes Duro-alumini , i punësuar pranë shoqërisë sone.</p> <p>20. me profesion Punonjes Duro-alumini , i punësuar pranë shoqërisë sone.</p> <p>21. me profesion Suvatues, i punesuar prane shoqerise sone.</p> <p>22. me profesion Suvatues, i punesuar prane shoqerise sone</p> <p>23. me profesion Muratore, i punesuar prane shoqerise sone.</p> <p>24. me profesion Muratore, i punesuar prane shoqerise sone.</p> <p>25. me profesion Muratore, i punesuar prane shoqerise sone.</p> <p>26. me profesion Muratore, i punesuar prane shoqerise sone.</p> <p>27. me profesion Hidroizolues, i punesuar prane shoqerise sone.</p> <p>28. me profesion Hidroizolues, i punesuar prane shoqerise sone.</p> <p>29. me profesion Hidroizolues, i punesuar prane shoqerise sone.</p> <p>30. me profesion Bojaxhi, i punesuar prane shoqerise sone.</p> <p>31. me profesion Bojaxhi, i punesuar prane shoqerise sone.</p> <p>32. me profesion Bojaxhi, i punesuar prane shoqerise sone.</p> <p>33. me profesion Bojaxhi, i punesuar prane shoqerise sone.</p> <p>34. me profesion Pllakashtrues, i punesuar prane shoqerise sone.</p> <p>35. me profesion Pllakashtrues, i punesuar prane shoqerise sone.</p> <p>36. me profesion Pllakashtrues, i punesuar prane shoqerise sone.</p>
--	---

	<p>37. me profesion Elektromekanik, i punesuar prane shoqerise sone.</p> <p>.Makineri e mjete</p> <p>Po [X] Jo []</p> <p>Nëse, po, të listohen me të dhënat konkrete</p>
--	--

III.2.4. Në nenin 2 “Qëllimi i ligjit” të ligjit nr. 162/2021 “Për prokurimin publik” parashikohet se: Qëllim i këtij ligji është: a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik; b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale; c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik; ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë; d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik; dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.

III.2.5. Në nenin 3 “Parime të përgjithshme” të ligjit nr. 162/2021 “Për prokurimin publik” parashikohet se 1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale. 2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar. 3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.

III.2.6. Në nenin 77, pika 4 dhe 5 të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: 1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

2. Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionalë ose tregtarë.

Në procedurat e prokurimit për shërbime, ku është e nevojshme që operatorët ekonomikë të kenë një autorizim të veçantë ose të jenë anëtarë të një organizate të veçantë për të kryer shërbimin në fjalë në shtetin e tyre të origjinës, autoriteti ose enti kontraktor mund t'u kërkojë atyre të vërtetojnë se e kanë këtë autorizim ose anëtarësim.

3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën.

Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Xhironja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës.

Kur një kontratë ndahet në lote, ky nen zbatohet për çdo lot individual. Megjithatë, autoriteti ose enti kontraktor mund të përcaktojë xhiron vjetore minimale që u kërkohet operatorëve, duke iu referuar grupeve të loteve, në rast se ofertuesi i suksesshëm merr disa lote që duhet të zbatohen në të njëjtën kohë.

Në rastin e kontratave që bazohen në një marrëveshje kuadër, kërkesa për xhiron minimale llogaritet mbi bazën e përmasave maksimale të kontratave specifike që do të zbatohen në të njëjtën kohë ose, kur përmasat nuk dihen, mbi bazën e vlerës së parashikuar të marrëveshjes kuadër.

4. *Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.*

Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.

Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.

5. *Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.”*

III.2.7. Neni 39 “Kërkesa të vecanta për kontratat për punë publike”, të VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, parashikon shprehimisht se:

“Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon:

a) licenca profesionale të shoqërisë për realizimin e punimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe/ose

b) që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionalë ose tregtarë, kur një gjë e tillë është e detyrueshme nga legjislacioni përkatës; dhe/ose

c) një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla sipas legjislacionit përkatës; dhe/ose

ç) fuqinë minimale punëtore të operatorit ekonomik, të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit; dhe/ose

d) mjetet e pajisjet teknike, të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

III.2.8. Në nenin 82 “*Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit*” pika 1 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, parashikohet shprehimisht : “1. *Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si provë paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik.*”

Ndërsa në nenin 92/3 të LPP-së përcaktohet se: “3. *Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji...*”

III.2.9. Në nenin 26 “*Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit*” të Vendimit Nr. 285 datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, parashikohet se: “1. *Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla.*

2. *Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit përmban informacion dhe deklarin, si më poshtë vijon:*

a) *operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin ose sipas legjislacionit të posaçëm, në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;*

b) *operatori ekonomik nuk është dënuar për asnjë nga veprat penale, të parashikuara në pikën 1, të nenit 76, të LPP-së;*

c) *personi/at në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtuesit ose mbikëqyrësit, aksionerit ose ortakut, ose që ka kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, nuk është ose ka qenë i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për asnjë nga veprat penale, të përcaktuara në pikën 1, të nenit 76, të LPP-së;*

ç) *operatori ekonomik nuk është dënuar me vendim të gjykatës së formës së prerë, për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale;*

d) *operatori ekonomik nuk është në proces falimentimi;*

dh) *operatori ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e taksave dhe tatimeve¹ të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas parashikimeve të pikës 2, të nenit 76, të LPP-së;*

e) *operatori ekonomik ka shlyer të gjitha detyrimet e maturuara të energjisë elektrike, dhe përmbush kërkesat që rrjedhin nga legjislacioni i fushës në fuqi. Ky informacion kërkohet për operatorët ekonomikë, të cilët ushtrojnë veprimtarinë në territorin e Republikës së Shqipërisë;*

¹ Ndryshuar me Vendimin Nr. 710 datë 24.11.2021

ë)operatori ekonomik nuk ndodhet në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;

f)operatori ekonomik ushtron aktivitetin në zbatim të kërkesave ligjore të legjislacionit mjedisor, social dhe të punës;

g)operatori ekonomik ka paraqitur ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;

gj)operatori ekonomik përmbush specifikimet teknike, sipas kërkesave të përcaktuara nga autoriteti/enti kontraktor;

h)operatori ekonomik disponon fuqinë punëtore, të nevojshme për ekzekutimin e kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor (kur është rasti);

i)operatori ekonomik disponon mjetet dhe makineritë e nevojshme për ekzekutimin e kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor, kur është rasti;

j)informacion mbi subjektet, mbi kapacitetet e të cilave, operatori ekonomik do të mbështetet, nëse është rasti dhe nënkontraktorët e mundshëm, nëse është rasti;

k)operatori ekonomik ushtron aktivitetin konform kërkesave të legjislacionit në fuqi.

3. Informacioni i pasqyruar në formularin e vetëdeklarimit, i cili gjendet në një bazë të dhënash, ku autoriteti/enti kontraktor mund të aksesojë direkt këtë informacion dhe /ose dokumentin, duhet të shoqërohet me adresën përkatëse për këtë bazë të dhënash.

4. Për përmbushjen e detyrimit sipas këtij neni, operatorët ekonomikë mund të përdorin një formular vetëdeklarimi që është përdorur gjatë një procedure prokurimi të mëparshme, nëse informacioni që ajo përmban vazhdon të jetë i saktë dhe i vlefshëm.

5. Operatorëve ekonomikë nuk u kërkohet të dorëzojnë dokumente mbështetëse, kur autoriteti ose enti kontraktor që ka dhënë kontratën ose ka lidhur marrëveshjen kuadër, i ka këto dokumente.

6. Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të nenit 26 të V, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike². Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin.

Autoriteti/enti kontraktor pranon një dokument të lëshuar nga i njëjti institucion ose palë e tretë dhe që ka të njëjtin informacion me atë të paraqitur në procedurën e zhvilluar në mënyrë elektronike.

Operatorët ekonomikë të huaj duhet të paraqesin dokumentet në formën e kërkuar nga legjislacioni në fuqi për njohjen e dokumentacionit të lëshuar në një shtet të huaj.

Për dokumentet që nuk lëshohen në vendin e origjinës, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë këtë fakt, përndryshe dokumentacioni do të konsiderohet i paparaqitur.

7.Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër, ose t'i kërkojë operatorit sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.”

III.2.10. Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim, ka si synim kryesor që t'i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor, janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të vërtetojnë se zotërojnë reputacionin, besueshmërinë, kapacitetet e konsideruara të nevojshme nga autoriteti kontraktor, për të zbatuar kontratën objekt-prokurimi. KPP sqaron, se në një procedurë prokurimi, subjekti i parë i interesuar është operatori ekonomik, i cili e përgatit ofertën e tij në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, dhe nga ana tjetër, është autoriteti kontraktor, i cili përzgjedh operatorin ekonomik që plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit, si dhe që ka përgatitur ofertën në përputhje me legjislacionin në fuqi. Autoriteti kontraktor do të konsiderojë një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specififikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit. Për pasojë, Komisioni gjykon, se operatorët ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi duhet të plotësojnë vetëm kërkesat e vendosura në dokumentet e tenderit, e rrjedhimisht, vlerësimi e kualifikimi i tyre duhet të bëhet në përputhje vetëm me këto kërkesa.

Në pikën 1 dhe 6 të nenit 26 “*Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit*”, të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*” i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: “*Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla.* 2. *Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit përmban informacion dhe deklarin, si më poshtë vijon: i) operatori ekonomik disponon mjetet dhe makineritë e nevojshme për ekzekutimin e kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor, kur është rasti; 6. Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin.*

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të administruar, Komisioni i Prokurimit Publik, konstaton, se për përmbushjen e kriterit 2.3.9 të kriterëve të veçanta të kualifikimit, si më sipër cituar, operatori ekonomik ankimes ka dorëzuar formularin e tij përmbledhës të vetëdeklarimit si dhe formularin përmbledhës të vetëdeklarimit të operatorit ekonomik mbi kapacitetet e të cilit do të mbështetet në lidhje me këtë kriter, dokument të cilin në zbatim të parashikimeve ligjore në fuqi, autoriteti/enti kontraktor e pranon si provë paraprake, *në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, dhe vetëm përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari, dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të nenit 26, të Vendimit Nr. 285 datë 19.05.2021, të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike, duke i rezervuar në këtë mënyrë të drejtën autoritetit kontraktor të kryejë verifikime në rast nevojë apo të dërgojë kërkesa për sqarim, mbi dokumentacionin e paraqitur nga operatorët ekonomikë.*

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar në SPE, Komisioni konstaton, se operatori ekonomik ankimes me dorëzimin e Formularit të tij Përmbledhës të Vetëdeklarimit si dhe Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit të mbështetësit në kapacitete “Alko Impex Construction” SHPK, ka plotësuar të gjitha të dhënat e mundshme që parashikon formulari përmbledhës, konkretisht ka deklaruar numrin e punonjësve që disponon, si dhe profilet e parashikuara në pikën 2.3.9 të dokumenteve të tenderit. Për më tepër, autoriteti kontraktor gjatë vlerësimit për këtë procedurë prokurimi dhe përpara publikimit të njoftim-fituesit nuk ka zbatuar përcaktimet e bëra në pikën 6 të nenit 26 të VKM, ku thuhet, se **Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin.** Gjithashtu, nuk ka kërkuar asnjë sqarim apo informacion në përputhje me pikën 7 të nenit 26 të VKM, sipas së cilës në çdo rast, autoriteti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik ose t’i kërkojë sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.

Autoriteti kontraktor Drejtoria e Spitalit Rajonal Dibër, nuk i ka kërkuar ofertuesit dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjën “h” pika 2 e nenit 26 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit” të Vendimit Nr. 285, datë 19.05.2021, të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, ku parashikohet shprehimisht se: “1. ***Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla.*** 2. *Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit përmban informacion dhe deklarimin, si më poshtë vijon :[...]*h)operatori ekonomik disponon fuqinë punëtore, të nevojshme për ekzekutimin e kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor (kur është rasti); i) operatori ekonomik disponon mjetet dhe makineritë e nevojshme për ekzekutimin e kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor, kur është rasti, për

arritjen në një përfundimi të saktë, që operatori ekonomik ankimes nuk e plotëson këtë kriter. Komisioni gjykon, se autoriteti kontraktor në fazën e vlerësimit procedural në të cilën ndodhet aktualisht procedura e prokurimit objekt-ankimi, për përmbushjen e kritereve të kualifikimit, objekt - ankimimi, duhet t'i referohet Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas rubrikave të aksesueshme elektronikisht nga autoriteti kontraktor dhe kërkesën për **dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të nenit 26 të VKM-së, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike**. Akoma më tej, Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon, se është me vend të theksojë rolin e posaçëm që ka autoriteti kontraktor, për vetëcilësimin e tij ligjor, si autoriteti me interes dhe përgjegjësi thelbësore për realizimin e suksesshëm të kontratës. KPP sjell në vëmendje, se referuar rregullave të prokurimit publik, është pikërisht autoriteti/enti kontraktor ai që duhet t'i kërkojë **ofertuesit të kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të nenit 26 të VKM-së 285**. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin, për t'u siguruar nëse cilësia e shërbimit, punës apo mallit është e njëjtë me cilësinë e premtuar në momentin apo fazën e ofertimit.

III.2.11. Konkretisht, referuar kriterit në pikën 2.3.9 për disponimin e stafit, konstatohet se autoriteti kontraktor ka kërkuar që operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar si staf teknik punonjës minimumi 1 (nje) Punonjës teknik ndërtimi; 1 (nje) Punonjës teknik elektroteknikë; 1 (nje) Punonjës teknik/Specialistë të inxhinierisë elektronike dhe/ose të teknologjisë së informacionit dhe komunikimit; 5 (pese) Punonjës Hidraulikë; 3 (tre) Punonjës Elektricistë; 5 (pesë) Punonjës instalues dhe riparues të kondicionerëve dhe sistemeve ftohëse-ngrohëse; 5 (pesë) Punonjës Hekurkthyes; 2 (dy) Punonjës Hekurpunim (Konstruksione Metalike); 5 (pesë) Punonjës Karpentier; 2 (dy) Punonjës Betonues; 3 (tre) Punonjës Saldator; 1 (një) Punonjës elektromekanik; 1 (një) Punonjës Mekanik; 5 (pesë) Punonjës Specialist gipsi (Sisteme të thata në ndërtesa); 4 (katër) Punonjës duro-alumini; 10 (dhjete) Punonjës Muratorë / Suvatues; 4 (katër) Punonjës Hidroizolues; 6 (gjashte) Punonjës Bojaxhi; 7 (shtate) Punonjës Shtrues pllakash. Nisur nga arsyet e skualifikimit, për plotësimin e këtij kriteri, operatori ekonomik “Alko Impex General Construction” SHPK ka dorëzuar, në sistemin e prokurimeve elektronike (SPE), Formularin e tij Përmbledhës të Vetëdeklarimit dhe Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit të mbështetësit në kapacitete operatorit ekonomik “Alko Impex Construction” SHPK ku në Pjesën III “Kriteret e Përzgjedhjes/Kualifikimit” të tyre, shkronja B – Deklaratë “Për disponimin e punonjësve dhe makinerive të nevojshme” (nëse kërkohen) kanë deklaruar disponimin e punonjësve sipas numrit të kërkuar nga autoriteti kontraktor në dokumentet standarde të tenderit kriteri 2.3.9, dhe profileve të kërkuara.

Referuar kriterit të sipërcituar, dhe nenit 26 të VKM 285, dokumentacioni i nevojshëm për këtë fazë është dorëzimi i Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, i cili është dorëzuar nga ana e operatorit ekonomik ofertues, duke deklaruar disponimin e numrit të punonjësve dhe profileve në përputhje me kriterin e kualifikimit, duke përmbushur në këtë mënyrë si numrin punonjësve të stafit teknik ashtu dhe profilet e tyre. Në rastin konkret, nga shqyrtimi i informacionit dhe dokumentacionit të dorëzuar nga autoriteti kontraktor, për këtë procedurë prokurimi, nuk vërtetohet në asnjë moment që autoriteti kontraktor, në lidhje me arsyen e mësipërme të

skualifikimit të ketë kryer veprimet procedurale të parashikuara në pikën 6 të nenit 26 të LPP-së, duke i kërkuar operatorit ekonomik *dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të nenit 26 të VKM-së 285,* pavarsisht që vetë autoriteti në përfundim të kriterit 2.3.9 ka përcaktuar, se në momentin e vlerësimit dhe shqyrtimit të kriterëve kualifikuese, ky kriter do të konsiderohet i përmbushur me dorëzimin e vetëdeklarimit përmbledhës sipas Shtojcës 8, bazuar në nenin 82 të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” si dhe në gërmën dh) të pikës 2 të nenit 26 të Vendimit nr. 285 datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar. Për këtë arsye, për sa kohë, nga vetë autoriteti kontraktor është specifikuar në dokumentet standarde të tenderit, se ky kriter do të quhet i përmbushur me dorëzimin e shtojcës 8, pra Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit dhe akoma më tej nuk janë respektuar të gjitha hapat procedurale, të parashikuara në ligj dhe VKM si më sipër cituar, atëherë skualifikimi i operatorit ekonomik ankimues, për arsyen e mësipërme nuk është i drejtë. Vlen të theksojmë, se autoriteti kontraktor, ka detyrimin që në zhvillimin e procedurave të prokurimit të zbatojë me përpikëri të gjitha parashikimet ligjore, më qëllim mosdiskriminimin dhe trajtimin e barabartë të operatorëve ekonomikë.

Gjithashtu, vlen të theksojmë, se legjislacioni i prokurimit publik i njeh të drejtën autoritetit kontraktor, por dhe vetë ky i fundit ka rezervuar në kriterin e veçantë të kualifikimit edhe të drejtën e verifikimit apo sqarimit nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës lidhur me vërtetësinë dhe saktësinë e informacionit që përmbajnë dokumentet e paraqitura nga ata dhe më pas të marrë vendim lidhur me to. Në këto kushte, Komisioni gjykon, se skualifikimi i operatorit ekonomik ankimues nga ana e autoritetit kontraktor nuk është i drejtë. Në përfundim të analizës së fakteve përkatëse, Komisioni arrin në konkluzionin, se dokumentacioni i paraqitur nga operatori ekonomik ankimues në procedurën e prokurimit objekt - shqyrtimi, plotëson kërkesat e autoritetit kontraktor dhe konsiderohet i vlefshëm për këtë fazë. KPP gjykon, se arsyeja e skualifikimit për operatorin ekonomik në rastin konkret, nuk është në përputhje me kriteret e kualifikimit të vendosura nga autoriteti kontraktor për plotësimin e këtyre kapaciteteve, pasi nga shqyrtimi i dokumentacionit dhe informacionit të ardhur nga autoriteti kontraktor për procedurën e prokurimit objekt-ankimi, nuk rezulton që ky i fundit të ketë bërë një hetim apo verifikim për punonjësit. Për më tepër, KPP vëren, se legjislacioni i prokurimit publik i njeh të drejtën autoritetit kontraktor, por dhe vetë ky i fundit ka rezervuar në dokumentet standarde të tenderit edhe të drejtën e verifikimit apo sqarimit nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës lidhur me vërtetësinë dhe saktësinë e informacionit që përmbajnë dokumentet e paraqitura nga ata dhe më pas të marrë vendim lidhur me to. Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon, se është me vend të theksojë rolin e posaçëm që ka autoriteti kontraktor, për vetëcilësimin e tij ligjor, si autoriteti me interes dhe përgjegjësi thelbësore për realizimin e suksesshëm të kontratës. KPP sjell në vëmendje, se referuar rregullave të prokurimit publik, është pikërisht autoriteti kontraktor ai që duhet të monitorojë zbatimin e kontratës, për t’u siguruar nëse cilësia e punëve/mallrave/shërbimeve është e njëjtë me cilësinë e premtuar në ofertë dhe të përcaktuar në kontratë.

Akoma më tej, Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon, se është me vend të theksojë rolin e posaçëm që ka autoriteti kontraktor, për vetëcilësimin e tij ligjor, si autoriteti me interes dhe

përgjegjësi thelbësore për realizimin e suksesshëm të kontratës. KPP sjell në vëmendje, se referuar rregullave të prokurimit publik, është pikërisht autoriteti kontraktor ai që duhet t'i kërkojë ofertuesit të kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit dorëzimit e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat "a", "b", "d", "dh", "e", "h", "i", "j" të pikës 2 të nenit 26 të VKM-së 285, si dhe dokumentet e paraqitura si pjesë e ofertës në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin, për t'u siguruar nëse cilësia e shërbimit, punës apo mallit është e njëjtë me cilësinë e premtuar në momentin apo fazën e ofertimit. Në përfundim të analizës së fakteve përkatëse, Komisioni arrin në konkluzionin, se dokumentacioni i paraqitur nga operatori ekonomik ankimues në procedurën e prokurimit, plotëson kërkesat e autoritetit kontraktor dhe konsiderohet i vlefshëm për këtë fazë.

Komisioni i Prokurimit Publik konstaton, se arsyeja e skualifikimit lidhet me faktin se operatori ekonomik ankimues nuk ka arritur të provojë se disponon 71 punonjës të kualifikuar me shkollë të mesme profesionale ose kurse profesionale nga 75 punonjës të kërkuar total për kryerjen e punimeve objekt i procedurës së prokurimit. Këtë verifikim autoriteti kontraktor e ka mbështetur mbi një kriter i cili është vendosur në tejkallim të parashikimeve të ligjit të prokurimit publik, pasi ligji dhe aktet nënligjore qartësisht normojnë mënyrën se si do të përmbushet ky kriter, përmes formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, pjesë e dokumenteve standarde të tenderit miratuar me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik. Gjithashtu, nga një korrespondencë e mëparshme midis Komisionit të Prokurimit Publik dhe Agjencisë së Prokurimit Publik, me shkresën nr. 319/1 prot., datë 19.01.2022, protokolluar me tonën nr. 2472/5 prot., 21.01.2022, Agjencia Prokurimit Publik njofton Komisionin e Prokurimit Publik ndër të tjera se: [...] Kriteri për kualifikim mbi disponimin e punonjësve, duhet të përmbushet, nëpërmjet paraqitjes së Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit nga operatori ekonomik, sipas shtojcës 8 të DST. Qëllimi i paraqitjes së deklaratës "Mbi disponimin e punonjësve dhe makinerive të nevojshme" në këtë shtojcë, është garantimi i ekzekutimit të kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor, pra që operatori ekonomik ka stafin teknik sipas të dhënave të kërkuara. Referuar sa më sipër, plotësimi i kësaj deklarate do të jetë në lidhje me numrin e punonjësve, nëse do të jetë kërkuar, dhe profilin e tyre, sipas kërkesave specifike të vendosura nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit të një procedure prokurimi [...].

KPP vlerëson, se ligjvënësi ka parashikuar dy momente të përcaktimit të kriterëve të veçanta të kualifikimit referuar nenit 77 të ligjit nr. 162/2020, datë 23.12.2020 "*Për prokurimin publik*". Momenti i parë lidhet me kriteret e kualifikimit, si përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, gjendjen ekonomike dhe financiare, aftësinë teknike dhe profesionale., në të cilat ligjvënësi i ka lënë në diskrecion të autoritetit kontraktor për përcaktimin e tyre, diskrecion, i cili edhe në kuptim të nenit 11 të ligjit nr. 44/2015 "*Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë*", nuk mund të tejkalojë kufijtë e vendosur nga ligji dhe konkretisht, atë të vendosur në nenin 77 të ligjit për prokurimin publik, pra të jenë në proporcion me natyrën, volumin dhe përmasat e kontratës, si edhe të mos jenë diskriminuese. Së dyti, është grupi i kriterëve të kualifikimit të cilat janë të shprehura qartësisht në ligj ose në akt nënligjor dhe që janë detyruese për të gjithë autoritetet kontraktore.

Pra, elementët që janë të domosdoshme për të përmbushur fazën e parë të vetëdeklarimit në drejtim të disponueshmërisë së stafit teknik në rastin konkret, është vetëm plotësimi i Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, duke dhënë informacionin e nevojshëm sipas edhe komunikimit të Agjencisë së Prokurimit Publik. Ndërkohë në rastin konkret autoriteti kontraktor e ka skualifikuar mbi një kriter i cili nuk parashikohet nga ligji i prokurimit publik, duke dublikuar formatin dhe përmbajtjen e formularit përmbledhës të vetëdeklarimit.

Komisioni i Prokurimit Publik shfaqet në cilësinë e një organi quasi gjyqësor, i krijuar në përputhje me Direktivën 89/665, datë 21 dhjetor 1989, krijuar me ligj për të mbrojtur interesin e ligjshëm të operatorëve ekonomikë në një procedurë prokurimi. Në zbatim të nenit 24 pika 3 të Ligjit nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “*Për Prokurimin Publik*” në të cilin përcaktohet se: “*Komisioni i Prokurimit Publik merr vendime për ankesat e paraqitura para tij dhe nxjerr interpretim për rregullat ose parimet ligjore, që duhet të zbatohen për objektin e ankesës, të cilat zbatohen për sa janë të vlefshme në vendimmarrjet e ardhshme. Në marrjen e vendimeve mban parasysh, përveç parimeve të përgjithshme të përmendura në nenin 3 të këtij ligji, edhe parimet e mëposhtme: paanshmërinë në shqyrtimin e ankesave, qëndrueshmërinë në vendimmarrje, ligjshmërinë, shpejtësinë dhe efikasitetin, aksesin, karakterin publik, si edhe parimin e kontradiktoritetit*”, Komisioni thekson se qëndrueshmëria në vendimmarrje tashmë e konsoliduar prej tij, është një prej elementeve thelbësore të shqyrtimit të ankesave, për arsye se ka lidhje të drejtpërdrejtë me zbatimin dhe respektimin e parimit të ligjshmërisë, transparencës, barazisë dhe mbi të gjitha të sigurisë juridike, të cilat KPP gjatë kryerjes së detyrave të saj zbaton me profesionalizëm, integritet dhe korrektësi, kuadrin ligjor të prokurimeve publike. Konkretisht Komisioni i Prokurimit Publik, në vendimmarrjen e tij ka krijuar një qëndrueshmëri edhe për sa i përket rastit konkret, arsyes së skualifikimit të operatorit ekonomik ankimues, mjafton të citojmë këtu vendimet nr. 1148/2023, datë 14.11.2023, nr. 1256/2023, datë 05.12.2023, nr. 1338/2023, datë 20.12.2023, nr. 1100/2023, datë 30.10.2023, nr. 1119/2023, datë 02.11.2023, nr. 711/2022, datë 25.07.2022, nr. 1018/2021, datë 20.12.2021, vendime në të cilat Komisioni ka mbajtur të njëjtin qëndrim si në rastin konkret, pra duke konsoliduar vendimmarrjen e tij për raste të ngjashme, vendime këto jo vetëm që janë të publikuara në faqen e tij zyrtare dhe në buletinet mujore, por gjenden dhe në një seksion të posaçëm të faqes zyrtare të Komisionit Prokurimit Publik në seksion Praktika Gjyqësore dhe Vendime mbi Interpretimin e dispozitave të zbatueshme për sa janë të vlefshme në vendimmarrjet e ardhshme, të cilat iu drejtohen jo vetëm operatorëve ekonomikë dhe subjekteve të interesuara, por edhe autoriteteve kontraktore.

Për sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues “*Alko Impex General Construction*” SHPK qëndron.

III.3. Lidhur me arsyen e skualifikimit të operatorit ekonomik “*Alko Impex General Construction*” SHPK se: “*Në DST te publikuar ne SPE per kete procedure prokurimi ne kriteret e vecanta per kualifikim konkretisht: **2.3 “Kapaciteti teknik”, pika 2.3.1)** eshte kerkuar: Për përmbushjen e kësaj kërkesë, operatori ekonomik “*Alko Impex General Construction*” SHPK , ka paraqitur në sistemin e prokurimit elektronik, dokumentacionin si më poshtë: Kontrata me Nr.3890/8 date 07.09.2017 me objekt Masat mbrojtese ne anen e majte*

te rrjedhjes se lumit Drin ne biefin e poshtem te diges se Fierzes me vlere 56,8609,805 pa TVSh, kontrate e cila nuk është as në natyrë as në kompleksitet as në metodologji punimesh e ngjashme me objektin që prokurohet, kjo referuar dhe zërave të punimeve që ka kryer OE “Alko Impex General Construction” SHPK, në objektin e paraqitur, si rrjedhoje nuk mund të konsiderohen punime të ngjashme me objektin që prokurohet. Nga shqyrtimi i dokumentacionit i paraqitur nga OE “Alko Impex General Construction” SHPK, në përmbushje të kriterit për punime të ngjashme, nga krahasimi i situacioneve përfundimtare të punimeve në zbatim të kontrates të sipërcituara, të realizuara nga OE “Alko Impex General Construction” SHPK, me preventivin dhe relacionin teknik të objektit të prokurimit konstatohet se operatori ekonomik ka kryer punime të ngjashme për punime dhe mbrojtje lumore sisteme hidraulike dhe bonifikime etj, por në asnjë rast nuk dëshmon se disponon eksperiencën e nevojshme për Rikonstruksion dhe mirëmbajtje godinash civile e industriale, të cilat kërkojnë ekspertizë dhe eksperiencë të ndryshme nga ato të dëshmuara nga operatori ekonomik me anë të kontratës së sipërcituara, pasi edhe metodologjia e ndërtimit të tyre është e ndryshme etj. KVO gjykon se krahasueshmëria e kontrates nëse janë të ngjashme nuk ka të bëjë vetëm me natyrën e kontratës nëse ajo është një kontratë pune publike, por duhet parë në lidhje me të gjithë zërat konkretë të punimeve të kryera. Në rastin konkret, pavarësisht se kontratat janë punë publike me objekte të gjëra veprimtarie, në zbatimin e këtyre kontratave nuk ka patur punime të ngjashme me një pjesë të rëndësishme të punimeve objekt prokurimi dhe për rrjedhoje kontrata e mësipërme nuk do të merret parasysh. - Kontrata me Nr.37/8 date 28.09.2020 me objekt Permiresim i banesave ekzistuese për komunitetet të varfëra dhe të pafavorizuara (Rikonstruksion) me vlere 26876125 pa TVSh i mungon -Formular vleresimi për realizimin e punimeve sipas shtojcës Nr. 9. Kjo Kontrate nuk do të merret parasysh pasi nuk plotëson kërkesat e kriterëve të vecanta të kualifikimit Kapaciteti teknik 2.3.1. - Kontrata me Nr.2832/5 date 11.06.2019 me objekt “Rikonstruksion i shkollës së mesme profesionale 26 Marsi” me vlere 106,395,557 pa TVSh konstatohet se formulari i vlerësimit nuk është plotësuar sipas kërkesave të dokumenteve standarde të tenderit, nuk dëshmon që OE “Alko Impex General Construction” SHPK ka qenë Bashkimi Operatorësh Ekonomik me shoqërinë “2T” SHPK. Në shtojcën 9 të dokumenteve standarde të tenderit duket qartë se kur një kontratë e është kryer nga një bashkim operatorësh ekonomik duhet të plotësohet Bashkimit të operatorëve NIP/TET/ dhe % e bashkimit të O.E. Kontrata për bashkimin e përkohshëm të shoqërive Nr.2703.Rep Nr.2050.Kol date 16.04.2019 është fotokopje në kundërshtim me kërkesën në kriteret e veçanta të kualifikimit paragrafi I fundit, ku cilësohet: **“Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara...”**. Kontrata me Nr.2317/4 date 27.12.2017 me objekt “Realizim i rehabilitimit të kullës së Kontigjences” me vlere të realizuar: 36,805,018 pa TVSh,; Kontrata me Nr.5196 date 24.02.2020 me objekt: “Rikonceptim dhe unifikim i veshjeve strukturore dhe shesheve funksionale në disa Drejtori Rajonale e ndare në 2 lote” me vlere të realizuar: 23,552,692 pa TVSh,; Kontrata me Nr.1643/6 date 22.05.2017 me objekt: “Rikonstruksion i shkollës Ali Myftiu Elbasan” me vlere të realizuar: 80896117 pa TVSh dhe Kontrata me Nr.1195 date 09.06.2020 me objekt: “Rindërtimi i kopshtit Niko Hoxha Kamez”, me vlere të realizuar: 30,222,222 pa TVSh. Në lidhje me këto kontrata të vlefshme OE “Alko Impex General Construction” SHPK ka paraqitur punë të ngjashme me vlere totale: 171,476,048 lekë pa TVSh, nga **650,099,968** lekë që duhet të paraqiste në përmbushje të pikës 2.3.1” Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.3.1. Para shqyrtimit në themel të pretendimeve të operatorit ekonomik ankimues “Alko Impex General Construction” SHPK, në zbatim të nenit 29, pika 2 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, në të cilin parashikohet se “1. Komisioni shqyrtton ankesën brenda objektit dhe shkaqeve të parashtruara në ankesë. 2. Përjashtimisht, kur ka lidhje midis objektit të ankesës dhe vendimeve apo veprimeve të tjera të autoritetit kontraktor gjatë procedurës së prokurimit, Komisioni vendos edhe për ligjshmërinë e tyre”, nisur nga arsyeja e skualifikimit të operatorit ekonomik ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon të ndalet fillimisht në ligjshmërinë e veprimeve të autoritetit kontraktor, për sa kohë që objekti i ankesës ka lidhje me vendimet dhe veprimet e ndërmarra kryesisht nga autoritetit kontraktor gjatë zbatimit të hapave të mëtejshëm të procedurës së prokurimit objekt-ankimi.

III.3.2. Marrë shkas nga arsyeja e skualifikimit të operatorit ekonomik ankimues “Alko Impex General Construction” SHPK, nga verifikimi i kriterit të përcaktuar nga autoriteti kontraktor, në bazë të të cilit është bërë më pas edhe shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertës, Komisioni i Prokurimit Publik, konstaton, se ky kriter është hartuar në kundërshtim me legjislacionin në fuqi, pasi shkakton konfuzion e paqartësi në mënyrën e përmbushjes së tij, si dhe në vlerësimin e ofertave, konkretisht vëren se:

III.3.3. Në shtojcën 7/2 “Kriteret e veçanta të kualifikimit”, “Kapaciteti Teknik”, pika 2.3.1 të dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt-ankimi përcaktohet kriteri si më poshtë:

2.3.1 Operatorët ekonomikë duhet të kenë përvojë të suksesshme në kontrata të mëparshme dhe për këtë duhet të paraqesin:

- dokumentacion për punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të ulët se 40% e vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës;
- dokumentacion për punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e ulët se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet.
- **Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.**
- **Ne rast se oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, kushti i përcaktuar në shkronjën “a”, plotësohet nga anëtari, i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontrata të ngjashme, në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Në rastin kur operatorët ekonomikë, anëtarë të një bashkimi, kanë të njëjtën përqindje pjesëmarrjeje në bashkim, vendosin me marrëveshje në kontratën e bashkëpunimit se cila prej tyre do të përmbushë këtë kusht.**

Vlerësimi i përvojës së suksesshme të Operatorit Ekonomik do të kryhet bazuar në deklaratat e dokumentet e mëposhtme:

- *Për kontrata të realizuara me ente publike operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:*
 - *Formular vlerësimi për realizimin e punimeve sipas shtojcës Nr. 9 (ku të përcaktohet qartazi vlera, afati i përfundimit të kontratës si dhe natyra e punës së kryer);*
 - *Kontratë Sipërmarrje;*
 - *Situacionin përfundimtar;*
 - *Fatura tatimore perkatëse.*
 - *Aktin e kolaudit;*
 - *certifikata e marrjes në dorezim*

- *Për kontrata të realizuara me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm :*
 - *Formular vlerësimi për realizimin e punimeve sipas shtojcës Nr. 9 (ku të përcaktohet qartazi vlera, afati i përfundimit të kontratës si dhe natyra e punës së kryer);*
 - *Kontrate Sipërmarrje;*
 - *Situacionin përfundimtar;*
 - *Fatura tatimore perkatëse.*
 - *Aktin e kolaudit;*
 - *certifikatë përdorimi / marrjes në dorezim*

- *Për kontratat e realizuara si Bashkim Operatoresh, operatori ekonomik ofertues, krahas dokumentacionit të sipërcituar për secilin rast respektivisht, duhet të paraqesë edhe Kontraten e bashkimit të operatoreve shoqëruar me tabelën e ndarjes së punimeve, ku të cilësohen punimet që ka marrë përsiper të kryejë secili anëtar i BOE.*

III.3.4. Në përmbushje të kriterit më sipër cituar, operatori ekonomik “Alko Impex General Construction” SHPK ka paraqitur në sistemin e prokurimit elektronik SPE dokumentacionin si më poshtë:

1- Aktë Marrëveshje datë 23.10.2023, lidhur midis “2T” SHPK dhe “Alko Impex General Construction” SHPK. Meqënëse shoqëria “Alko Impex General Construction” SHPK ka shprehur vullnetin e saj të lirë e të plotë, për të marrë pjesë konform procedurave përkatëse në procedurat e prokurimit që organizon “Drejtoria e Spitalit Rajonal Dibër”, me objekt “Rikonstruksion i Spitalit Rajonal Dibër Rahim Xhika”, kërkon mbështetje në aftësitë teknike, profesionale nga shoqëria 2T SHPK. Nëpërmjet kësaj kontrate, operatori ekonomik, në plotësim të kriterëve të përcaktuara në DST nga AK në procedurën e prokurimit e konkretisht atë të kapacitetit teknik dhe profesional, si dhe realizimit me sukses të kontratës në rast të shpalljes fituese do të mbështetet në kapacitetet teknike dhe profesionale të shoqërisë “2T” SHPK. Ky i fundit deklaron dhe bie dakort se do të mbështesë operatorin ekonomik “Alko Impex General Construction” SHPK për pikën 2.3.1 në lidhje me kapacitetin teknik.

2- Deklaratë datë 25.10.2023 nga mbështetësi i kapaciteteve “2T” SHPK.

3- Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit “Alko Impex General Construction” SHPK. Në Pjesën III: “Kriteret e Përzgjedhjes/Kualifikimit”, gërma “B”: “DEKLARATË “Për disponimin e punonjësve të nevojshëm për realizimin e punimeve objekt kontrate”, operatori ekonomik “Alko Impex General Construction” SHPK deklaron:

Shtojca 8.

FORMULARI PËRMBLEDHËS I VETËDEKLARIMIT

Unë i nënshkruari Arbër Abazi në cilësinë e perfaqësuesit të operatorit ekonomik Alko Impex General Construction dshh deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë që:

A. Pjesa I: Informacion në lidhje me Operatorin Ekonomik

Identifikimi	Përgjigjja
Emri i operatorit ekonomik: (Ju lutemi renditni të gjithë operatorët ekonomikë nëse jeni një BOE. Ju lutemi tregoni rolin e operatorit ekonomik në BOE)	Alko Impex General Construction dshh
Numri NIPT/et:	K 91326028I
Adresa postare: Qyteti / qyteti; Kodi postar	Rruga “ Reshit Petrela”, Kompleksi Usluga, Tirane
Përfaqësuesi (emri):	Arbër Abazi

- Informacion mbi subjektet mbi kapacitetin, e të cilëve do të mbështetet operatori ekonomik

Emri (at) e subjekteve	NIPT-i	Lloji i kapacitetit për të cilin do të mbështetet operatori ekonomik	Specifiko konkretisht kapacitetin/et
ALKO IMPEX CONSTRUCTION	K91628013D	Kapaciteti teknik	Pika 2.3.9(STAFI Teknik)2.3.10(mjetet dhe pajisjet)
ARKONSTUDIO	L42019004I	Kapaciteti teknik	Pika 2.3.4, (Arkitekti)2.3.7(Auditues Energjie)
“2 T”shpk	K01731001M	Kapaciteti teknik	2.3.1, ne lidhje me Kapacitetin teknik

3- Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit “2T” SHPK.

Alko Impex General Construction SHPK

- Kontratë nr. 2832/5 prot, datë 11.06.2019, lidhur ndërmjet Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë dhe bashkimit të operatorëve ekonomik “Alko Impex General Construction” SHPK me 86.5% të punimeve dhe “2T” SHPK me 13.5 % të punimeve, me objekt: Loti II “*Rikonstrukcion i shkollës së mesme profesionale 26 Marsi Kavaj*”, me vlerë të realizuar 147.600.772.76 lekë me TVSH, shoqëruar me formular vlerësimi, situacione, akt kolaudim, certifikate e marrjes në dorëzim dhe fatura tatimore.
- Kontratë nr. 5196 prot., datë 24.02.2020, lidhur ndërmjet Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor dhe bashkimit të operatorëve ekonomik “Alko Impex General Construction” SHPK me 79 % dhe “Arkonstudio” SHPK 21 % të punimeve me objekt: “*Rikonceptim dhe unifikim i veshjeve strukturore dhe shesheve funksionale në Drejtoritë Rajonale Durrës, Elbasan dhe Vlorë*” me vlerë të realizuar 35.776.241.42 lekë me TVSH, shoqëruar me formular vlerësimi, situacion, akt kolaudimi, certifikate e marrjes në dorëzim dhe fatura tatimore.
- Kontratë nr. 3890/8 prot., datë 07.09.2017, lidhur ndërmjet Korporatës Elektroenergjitike Shqiptare dhe operatorit ekonomik “Alko Impex general Construction” SHPK me objekt: “*Masat mbrojtëse në anën e majtë të rrjedhës së lumit drin, në biefin e poshtëm të digës së Fierzës*” me vlerë të realizuar 682.331.766 lekë me TVSH, shoqëruar me formular vlerësimi, situacion, akt kolaudimi, certifikate e marrjes në dorëzim dhe fatura tatimore.
- Kontratë nr. 2317/4 prot., datë 27.12.2017, lidhur ndërmjet Albcontrol SHA dhe operatorit ekonomik “Alko Impex general Construction” SHPK me objekt: “*Realizimi i rehabilitimit të Kullës së Kontigjencës*” me vlerë të realizuar 37.294.821 lekë me TVSH, shtesë Kontrate nr. 2611/4 prot, datë 31.12.2018, lidhur ndërmjet Albcontrol SHA dhe operatorit ekonomik “Alko Impex General Construction” SHPK me objekt: “*Shtesë kontrate realizimi i rehabilitimit të Kullës së Kontigjencës*” me vlerë të realizuar 4.742.340 lekë me TVSH shoqëruar me formular vlerësimi, situacion, akt kolaudimi, certifikate e marrjes në dorëzim dhe fatura tatimore.
- Kontratë nr. 1643/6prot., datë 22.05.2017, lidhur ndërmjet Ministrisë së Mirëqenies Sociale dhe Rinisë dhe operatorit ekonomik “Alko Impex General Construction” SHPK me objekt: “*Rikonstrukcion i Shkollës “Ali Myftiu” Elbasan*” me vlerë të realizuar 97.075.340 lekë me TVSH, shoqëruar me formular vlerësimi, situacion, akt kolaudimi, certifikate e marrjes në dorëzim dhe fatura tatimore.
- Kontratë nr. 1195 prot., datë 09.06.2020, lidhur ndërmjet Fondit Shqiptar të Zhvillimit dhe bashkimit të operatorëve ekonomik “Sireta 2F” SHPK me 31 % të punimeve dhe “IBN” SHPK me 35 % të punimeve dhe “Alko Impex General Construction” SHPK me 34 % të punimeve me objekt: “*Rindërtim i kopshtit Niko Hoxha Kamëz*” me vlerë të realizuar 88,888,888 lekë pa TVSH, shoqëruar me formular vlerësimi, situacion, akt i marrjes në dorëzim dhe fatura tatimore.

- Kontratë nr. 37/8 prot., datë 28.09.2020, lidhur ndërmjet Bashkisë Vau Dejës dhe operatorit ekonomik “Alko Impex General Construction” SHPK me objekt: “Përmirësim i banesave ekzistuese për komunitete të varfëra dhe të pafavorizuara (Rikonstruksion)” me vlerë të realizuar 26.891.566 lekë pa TVSH, shoqëruar me, situacion, akt kolaudim, akt i marrjes në dorëzim dhe fatura tatimore.

2T SHPK

- Kontratë Sipërmarrje e lidhur me datë 13.02.2017 me palë porositës shoqëria “Globalsher” SHPK dhe sipërmarrës shoqëria “ P/Punë/2018/GOA/P-14, datë 13.12.2018, lidhur ndërmjet Fondit Shqiptar të T” SHPK me objekt: “Rikonstruksion i Qendrave të Sterilizimit”, me vlerë të realizuar 3.109.779 euro pa TVSH, shoqëruar me formular vlerësimi, akt kolaudimi, situacione dhe fatura tatimore.
- Kontratë nr. 2046/15 prot., datë 01.10.2020, lidhur ndërmjet Bashkisë Drejtorisë Rajonale e OSSH Durrës dhe bashkimit të operatorëve ekonomikë “2T” SHPK me 90.1 % të punimeve dhe “Rafin Company” SHPK me 5.2 % të punimeve dhe “Ad Star” SHPK me 4.7 % të punimeve me objekt: “Ndërtim i zyrave të Drejtorisë Rajonale Durrës” me vlerë të realizuar 251.658.111.5 lekë me TVSH, shoqëruar formular vlerësimi, situacion, akt kolaudim, akt i marrjes në dorëzim dhe fatura tatimore.

III.3.5. Në nenin 77 te ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: 1. *Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:*

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;*
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;*
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.*

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.

Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvojë që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.

Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.

III.3.6. Në nenin 39 “Kërkesa të veçanta për kontratat për punë publike” pika 5 e VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, e ndryshuar, parashikohet se:

“5. Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon:

a) punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të madhe se 50% e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës;

b) punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e madhe se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet.

Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

Autoriteti/enti kontraktor, si dëshmi për përvojën e mëparshme, kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, për të vërtetuar përmbushjen e suksesshme të punëve.

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, autoriteti/enti kontraktor kërkon si dëshmi, vërtetime, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, e shoqëruar me fatura tatimore dhe çdo lloj dokumenti tjetër, që parashikohet nga legjislacioni në fuqi, që provon realizimin me sukses të punëve.”

III.3.7. KPP gjykon, se kriteret për kualifikim vendosen që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit ekonomik për përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Gjithashtu një ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurës së prokurimit është ai barazisë në trajtimin e kërkesave dhe të detyrimeve, që u ngarkohen ofertuesve ose kandidatëve, parashikuar nga neni 3 i ligjit nr. Nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar. Zbatimi i parimit të transparencës, barazisë dhe mosdiskriminimit, janë garancitë kyçe ndaj ofertuesve që ofron kuadri ligjor në fuqi. Këto parime ndër të tjera nënkuptojnë se operatorët ekonomikë duhej të jenë në një pozicion barazie, si kur përgatisin ofertat e tyre, ashtu dhe kur të vlerësohen ato. KPP gjykon, se autoriteti kontraktor në përputhje me nenin 2 dhe 3 të ligjit 162/2021 “Për prokurimin publik” ka për detyrë d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik; dhe të garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale.

Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se në përcaktimin apo vendosjen e kriterëve specifike, që në thelb konsiderohen si kritere fituese, për shkak të rëndësisë që kanë, ligjvënësi i ka parashikuar kufizime autoriteteve kontraktore brenda diskrecionit që ka në përzgjedhjen e tyre.

Në këtë mënyrë, dispozitat e sipërpërmendura, urdhërojnë, se përcaktimi i këtyre kriterëve duhet të jetë: (i) në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës (ii) Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve. Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t'i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Autoriteti kontraktues është organi përgjegjës për prokurimin e fondeve publike, në përputhje me dispozitat ligjore e nënligjore në fuqi. Në këtë kuadër, përcaktimi i kriterëve të veçanta për kualifikim është lënë nën përgjegjësinë e autoritetit kontraktues, gjithnjë në përputhje e përpjesëtim me objektin e natyrën e kontratës objekt - prokurimi. Autoriteti kontraktues është në të drejtën e tij për të përcaktuar kriteret për kualifikim, mjafton që ato të mos jenë diskriminuese e përjashtuese

III.3.8. Sa më sipër, KPP gjykon, se autoriteti kontraktor është organi përgjegjës për prokurimin e fondeve publike, në përputhje me dispozitat ligjore e nënligjore në fuqi. Në këtë kuadër, përcaktimi i kriterëve të veçanta për kualifikim është lënë nën përgjegjësinë e autoritetit kontraktues, gjithnjë në përputhje e përpjesëtim me objektin e natyrën e kontratës objekt - prokurimi. Marrë shkas nga pretendimet e ankimuesit, i cili kundërshton skualifikimin e ofertës së tij nga procedura e prokurimit me arsyetimin se plotëson kriterin e veçantë të kualifikimit lidhur me kontratat e ngjashme (pika 2.3.1 të kapacitetit teknik), KPP vëren se në kriterin e veçantë të kualifikimit pika 2.3.1, autoriteti kontraktor ka kërkuar nga operatorët ekonomikë, *duhet të paraqesin dëshmi për përvojën e mëparshme të ngjashme:*

a) *dokumentacion për punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të ulët se 40% e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës;*

b) *dokumentacion për punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e ulët se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet.*

Referuar pretendimeve të operatorit ekonomik ankimues të paraqitura në ankesë për përmbushjen e kriterit të përcaktuar në pikën 2.3.1 të kapacitetit teknik si dhe arsyen e skualifikimit të dhënë nga autoriteti kontraktor, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se është me vend të ndalet në faktin nëse kërkesa për vlerën limit të kontratave-pune të ngjashme, të realizuara, është në përputhje me parashikimet e dispozitave ligjore dhe nënligjore në fuqi në fushën e prokurimit publik apo jo. Referuar parashikimeve të nenit 77 të lex specialis si dhe nenit 39, pika 5 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” e ndryshuar, është lënë në të drejtën e autoritetit kontraktor, që për të verifikuar përmbushjen e aftësive teknike, të mund të kërkojë nga operatorët ekonomikë, që për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor të kërkojë dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave-pune të mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, ku në çdo rast, vlera totale e kërkuar duhet të jetë

punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë *jo më të madhe se 50% e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit*, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, *ose punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e madhe se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet*. Nga verifikimet rezulton, se kriteri i përcaktuar në pikën 2.3.1 të kapacitetit teknik në lidhje me vlerën limit të kontratave-punë të ngjashme të kryera, nuk është në përputhje me parashikimet e nenit 39, pika 5 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2022, e ndryshuar. Sa më sipër, autoriteti kontraktor duhet të marrë masa për anulimin e procedurës së prokurimit objekt – ankimi, si dhe në rishpalljen e saj të mbajë në konsideratë, në lidhje me vlerën limit të kontratave të ngjashme, parashikimet e nenit 39, pika 5 të aktit nënligjor të mësipërm, pasi është në të drejtën e autoritetit kontraktor, hartimi i kriterëve për kualifikimin, por këto të fundit duhet të jenë jodiskriminuese, si dhe në përputhje me aktet ligjore e nënligjore në fuqi për prokurimin publik dhe legjislacionin sektorial në fuqi.

III.3.9. Sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik bazuar në nenin 118, pika 2, gërma “b” të Ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Përpara lidhjes së kontratës, Komisioni i Prokurimit Publik ka të drejtë: *të pranojë ankesën dhe të urdhërojë autoritetin ose entin kontraktor të anulojë plotësisht ose pjesërisht një veprim ose vendim, të nxjerrë në kundërshtim me ligjin*; nenin 98, pika 1, gërma “d” të këtij ligji ku thuhet shprehimisht: “Autoriteti ose enti kontraktor anulon procedurën e prokurimit në rastet kur Komisioni i Prokurimit Publik vendos anulimin sipas parashikimeve në këtë ligj”, si dhe në nenin 45, pika 1 gërma “b” të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, ku parashikohet se: “[...] Komisioni i Prokurimit Publik në kuadër të veprimtarisë së shqyrtimit të ankesave para lidhjes së kontratës procedon me: b) Vendim për pranimin e ankesës dhe urdhërimin e autoritetit/entit kontraktor, që të anulojë plotësisht ose pjesërisht një veprim ose vendim, të nxjerrë në kundërshtim me ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” [...]”, gjykon se hartimi i kriterit të kualifikimit, jo në përputhje me aktet ligjore/nënligjore në fuqi, përbën shkak për anulimin e kësaj procedure prokurimi. Në këtë kuptim, autoriteti kontraktor duhet të anulojë procedurën e prokurimit objekt - ankimi dhe në rishpalljen e saj të mbajë në konsideratë parashikimet e këtij vendimi për sa i përket gërmës b të pikës 5, të nenit 39 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, e ndryshuar.

Komisioni i Prokurimit Publik shfaqet në cilësinë e një organi quasi gjyqësor, i krijuar në përputhje me Direktivën 89/665, datë 21 dhjetor 1989, krijuar me ligj për të mbrojtur interesin e ligjshëm të operatorëve ekonomikë në një procedurë prokurimi. Në zbatim të nenit 24 pika 3 të Ligjit nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” në të cilin përcaktohet se: “Komisioni i Prokurimit Publik merr vendime për ankesat e paraqitura para tij dhe nxjerr interpretim për rregullat ose parimet ligjore, që duhet të zbatohen për objektin e ankesës, të cilat zbatohen për sa janë të vlefshme në vendimmarrjet e ardhshme. Në marrjen e vendimeve mban parasysh, përveç parimeve të përgjithshme të përmendura në nenin 3 të këtij ligji, edhe parimet e mëposhtme: paanshmërinë në shqyrtimin e ankesave, qëndrueshmërinë në vendimmarrje, ligjshmërinë, shpejtësinë dhe efikasitetin, aksesin, karakterin publik, si edhe parimin e kontradiktoritetit”. Komisioni thekson, se qëndrueshmëria në vendimmarrje tashmë

e konsoliduar prej tij, është një prej elementeve thelbësore të shqyrtimit të ankesave, për arsye se ka lidhje të drejtpërdrejtë me zbatimin dhe respektimin e parimit të ligjshmërisë, transparencës, barazisë dhe mbi të gjitha të sigurisë juridike, për të cilat KPP gjatë kryerjes së detyrave të saj, zbaton me profesionalizëm, integritet dhe korrektësi, kuadrin ligjor të prokurimeve publike. Konkretisht Komisioni i Prokurimit Publik, në vendimmarrjen e tij ka krijuar një qendrushmëri edhe për sa i përket rastit konkret, arsyes së skualifikimit të operatorit ekonomik ankimues, mjafton të citojmë këtu vendimet nr. 1178/2023, datë 17.11.2023, nr. 1235/2023, datë 30.11.2023, nr. 1336/2023, datë 20.12.2023, vendime në të cilat Komisioni ka mbajtur të njëjtin qëndrim si në rastin konkret, pra duke konsoliduar vendimmarrjen e tij për raste të ngjashme, vendime këto jo vetëm që janë të publikuara në faqen e tij zyrtare dhe në buletinet mujore, por gjenden dhe në një seksion të posacëm të faqes zyrtare të Komisionit Prokurimit Publik në seksion Praktika Gjyqësore dhe Vendime mbi Interpretimin e dispozitave të zbatueshme për sa janë të vlefshme në vendimmarrjet e ardhshme, të cilat u drejtohen jo vetëm operatorëve ekonomik dhe subjekteve të interesuara, por edhe autoriteteve kontraktore.

III.4. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “*Alko Impex General Construction*” SHPK, mbi kundërshtimin e vendimit të komisionit të vlerësimit të ofertave në lidhje me skualifikimin e ofertës së tij me arsyen se: “*OE “Alko Impex General Construction” bazuar dokumentacionit të paraqitur në SPE rezulton që mbështetet në më shumë se 50% të kapaciteteve teknike subjekti “2 T” Shpk në lidhje me plotësimin e pikës 2.3.1 të kapacitetit teknik, kjo në kundërshtim me VKM 285, datë 19.05.2021 “Rregullat e Prokurimit Publik”, të ndryshuar, Neni 90 “Mbështetja në kapacitetet e subjekteve të tjera”, pika 2 ku citohet: [...] Në çdo rast, operatori ekonomik ofertues që dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, duhet të provojë se plotëson të paktën 50% të kërkesave të përcaktuara nga autoriteti ose enti kontraktor [...]”*”, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se duke qenë se pretendimi në lidhje me përmbushjen e kriterit për punë të ngjashme nuk do të merret në shqyrtim për shkak se autoriteti kontraktor kriterin në fjalë nuk e ka hartuar në përputhje me gërmës b të pikës 5 të nenit 39 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, e ndryshuar, ku për këtë arsye ka vendosur anulimin e procedurës së prokurimit, rrjedhimisht nuk mund të marrë në shqyrtim edhe pretendimin e sipërcituar në lidhje me përmbushjen e kriterit 2.3.1 për punët e ngjashme kriter për të cilin operatori ekonomik është mbështetur në kapacitetet e operatorit ekonomik “2T” SHPK, pasi përlllogaritja e përmbushjes së këtij kriteri lidhet drejtpërdrejtë me mënyrën e hartimit e kriterit 2.3.1.

III.5. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “*Alko Impex General Construction*” SHPK, mbi kundërshtimin e vendimit të komisionit të vlerësimit të ofertave në lidhje me skualifikimin e ofertës së tij me arsyen se: “*OE “Alko-Impex General Construcion” mbështetet në më shumë se 50% të kapaciteteve teknike nga OE “Alko-Impex General Construcion” me nipt K91628013D, në lidhje me plotësimin e pikës 2.3.9 të kapacitetit teknik (“Alko Impex General Construction” disponon 35 punonjes, ndersa shoqëria mbështetese “Alko Impex Construcion” sipas dokumentacionit të paraqitur në SPE e mbështet me 37 punonjes), kjo në kundërshtim me VKM 285, datë 19.05.2021 “Rregullat e Prokurimit Publik”, të ndryshuar, Neni 90 “Mbështetja në kapacitetet e subjekteve të tjera”, pika 2 ku citohet: [...] Në çdo rast, operatori ekonomik ofertues që dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve*

të tjera, duhet të provojë se plotëson të paktën 50% të kërkesave të përcaktuara nga autoriteti ose enti kontraktor [...]”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.5.1. Në shtojcën 7/2 “Kriteret e veçanta të kualifikimit”, pika 2.3.9 “Kapaciteti teknik”, të dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt - ankimi, të publikuara nga autoriteti kontraktor në SPE, është parashikuar plotësimi i kriterit si më poshtë vijon:

2.3.4 Dëshmi për fuqinë punëtore të operatorit ekonomik:

Operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet te kenë të punësuar staf inxhinierik për kryerjen e të gjitha punimeve në objekt , te përfshirë ne licensen e shoqërisë , të vërtetuar me kontratë pune të vlefshme, diplomë përkatëse, si dhe të figurojnë në listpagesat e shoqërisë minimumi për periudhën Qeshor – Gusht 2023, konkretisht:

- Arkitekt	1 (një)
- Inxhinier Ndërtimi	1 (një)
- Inxhinier Hidroteknik	1 (një)
- Inxhinier Mekanik	1 (një)
- Inxhinier Elektrik	1 (një)
- Inxhinier Gjeodet	1 (një)

Shënim: Në momentin e vlerësimit dhe shqyrtimit të kriterëve kualifikuese ky kriter do të konsiderohet i përmbushur me dorëzimin e vetdeklarimit përmbledhës sipas Shtojcës 8, bazuar në nenin 82 të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” si dhe në gjurmën dh) të pikës 2 të nenit 26 të Vendimit nr. 285 datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për tu kërkuar sqarime nga AK.

2.3.6 *Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë të punësuar mjekun e shoqërisë i cili të ketë kontratë pune, diplomë, licensë Urdhër Mjeku dhe të figurojë në listëpagesat e operatorit ekonomik ofertues minimumi për periudhën Qeshor – Gusht 2023, ose duhet të paraqitet një kontratë e vlefshme për ofrimin e këtij shërbimi me një subjekt të licensuar, sipas ligjit ne fuqi. Në rast bashkimi operatorësh ekonomikë, secili nga operatorët ekonomikë duhet ta plotësojë këtë kusht në përputhje me numrin respektiv të punonjësve sipas kërkesave ligjore.*

Shënim: Në momentin e vlerësimit dhe shqyrtimit të kriterëve kualifikuese ky kriter do të konsiderohet i përmbushur me dorëzimin e vetdeklarimit përmbledhës sipas Shtojcës 8, bazuar në nenin 82 të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” si dhe në gjurmën h) të pikës 2 të nenit 26 të Vendimit Nr. 285 datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për tu kërkuar sqarime nga AK.

2.3.7 Operatori ekonomik duhet të disponojë punonjës të specializuar/të kualifikuar, si më poshtë:

- a) *Operatorët ekonomikë duhet kenë të punësuar në stafin e tyre 1 (një) “Auditues energjie”, bazuar në ligjin nr. 124/2015 “Për efikasitetin e energjisë”, i ndryshuar, i cili duhet të jetë i pajisur me “Çertifikatë për Auditues Energjitik në ndertesa”, lëshuar nga Agjencia per Eficencën e Energjisë.*

Për këto operatorët ekonomikë duhet të paraqesin :

- *kontratën e punës,*
- *diplomën/certifikatën përkatëse.*
- *Të figurojë në listëpagesat e operatorit ekonomik ofertues minimum për periudhën Qeshor – Gusht 2023*

Shënim: Në momentin e vlerësimit dhe shqyrtimit të kriterëve kualifikuese ky kriter do të konsiderohet i përmbushur me dorëzimin e vetdeklarimit përmbledhës sipas Shtojcës 8, bazuar në nenin 82 të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” si dhe në germën h) të pikës 2 të nenit 26 të Vendimit nr. 285 datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për tu kërkuar sqarime nga AK.

2.3.9 Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë të punësuar si staf teknik punonjës minimumi:

- *Punonjës teknik ndërtimi 1 (nje)*
- *Punonjës teknik elektroteknikë 1 (nje)*
- *Punonjë teknikë/Specialistë të inxhinierisë elektronike dhe/ose të teknologjisë së informacionit dhe komunikimit 1 (nje)*
- *Punonjë Hidraulikë 5 (pese)*
- *Punonjë Elektracistë 3 (tre)*
- *Punonjë instalues dhe riparues të kondicionerëve dhe sistemeve ftohëse-ngrohëse 5 (pese)*
- *Punonjë Hekurkthyes 5 (pese)*
- *Punonjë Hekurpunim (Konstruksione Metalike) 2 (dy)*
- *Punonjë Karpentier 5 (pese)*
- *Punonjë Betonues 2 (dy)*
- *Punonjë Saldator 3 (tre)*
- *Punonjë elektromekanik 1 (nje)*
- *Punonjë Mekanik 1 (një)*
- *Punonjë Specialist gipsi (Sisteme te thata në ndërtesa) 5 (pese)*
- *Punonjës duro-alumini 4 (kater)*
- *Punonjë Muratorë / Suvatues 10 (Dhjete)*
- *Punonjë Hidroizolues 4 (kater)*
- *Punonjë Bojaxhi 6 (gjashte)*
- *Punonjë Shtrues pllakash 7 (shtate)*

të vertetuar me diploma/çertifikata të arsimit profesional të lëshuara nga institucionet të akredituara sipas Ligjit Nr.15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë” ose ekuivalente, kontratë pune të vlefshme, si dhe të rezultojnë në listëpagesat e shoqërisë për periudhën Qeshor – Gusht 2023.

Për punonjësit me profesionet si më sipër, operatorët ekonomikë duhet të plotësojnë dhe të paraqesin tabelën me të dhënat si më poshtë:

Nr	Emër Mbiemër i punonjësit	Profesioni	Institucioni publik/privat lëshues i certifikatës/diplomës	Nr NIPT (Në rast se lëshuesi është institucion privat)	Numri i regjistrimit të çertifikates së Akreditimit (Në rast se lëshuesi është institucion privat)
1					
2					
etj					

Shënim: Në momentin e vlerësimit dhe shqyrtimit të kriterëve kualifikuese ky kriter do të konsiderohet i përmbushur me dorëzimin e vetdeklarimit përmbledhës sipas Shtojcës 8, bazuar në nenin 82 të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” si dhe në gjurmën dh) të pikës 2 të nenit 26 të Vendimit nr. 285 datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për tu kërkuar sqarime nga AK.

III.5.2. Në shtojcën 8 “Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit” në dokumentet standarde të tenderit të procedurës së prokurimit objekt-ankimi, autoriteti kontraktor ka përcaktuar si më poshtë vijon:

Shtojca 8

(Shtojcë për tu paraqitur nga operatori ekonomik)

FORMULARI PËRMBLEDHËS I VETËDEKLARIMIT

I. Unë i nënshkruari _____ në cilësinë e _____ të operatorit ekonomik _____ deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë që:

PJESA I: A. INFORMACION NË LIDHJE ME OPERATORIN EKONOMIK

Identifikimi	Përgjigja
Emri i operatorit ekonomik: (Ju lutemi renditni të gjithë operatorët ekonomikë nëse jeni një BOE. Ju lutemi tregoni rolin e operatorit ekonomik në BOE)	----- -

Numri NIPT/et:	----- ----
Adresa postare: Qyteti / qyteti; Kodi postar	----- -----
Përfaqësuesi (emri):	-----
Telefoni:	----- -----
E-mail:	----- -----

B: DEKLARATË

Për nënkontraktorët dhe subjektet në kapacitetet, e të cilave do të mbështetet Operatori Ekonomik (nëse është e zbatueshme)

Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se:

- **Informacione për nënkontraktorin**

Emri i nënkontraktorit të propozuar	NIPT -i	Përqindja e nënkontraktimit	Mallrat/ shërbimet e lidhura me to për t'u nënkontraktuar

- **Informacion mbi subjektet mbi kapacitetin, e të cilëve do të mbështetet operatori ekonomik**

Emri (at) e subjekteve	NIPT-i	Lloji i kapacitetit për të cilin do të mbështetet operatori ekonomik	Specifiko konkretisht kapacitetin/et

Pjesa II: Shkaqet e përjashtimit

A: DEKLARATA PËR PËRMBUSHJEN E KRITEREVE TË PËRGJITHSHME TË

KUALIFIKIMIT

Deklarata
<p>Operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv.</p> <p><i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i></p> <hr/>
<p>Operatori ekonomik nuk është dënuar për ndonjë nga veprat penale të parashikuara në nenin 76/1 të LPP-së ose ka qenë i dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së.</p> <p><i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i></p> <hr/>
<p>Personi / personat në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtorit ose mbikëqyrësit, si aksionar ose si ortak, ka ose kompetenca përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, si më poshtë:</p> <hr/>
<p>etj.</p> <p>nuk janë të dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për ndonjë nga veprat penale të përcaktuara në nenin 76/1 të LPP-së ose kanë qenë i dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së, etj.</p> <p><i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i></p> <hr/>
<p>Operatori ekonomik nuk është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale.</p> <p><i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i></p> <hr/>
<p>Operatori ekonomik nuk është në proces falimentimi (statusi aktiv).</p> <p><i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i></p> <hr/>
<p>Operatori Ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për taksat dhe kontributet e sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi, ose ndodhet në një nga rastet e parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së</p>

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme

Operatori ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet e energjisë elektrike, për të gjitha adresat e ushtrimit të aktivitetit, sipas legjislacionit përkatës në fuqi.

Ky informacion kërkohet për operatorët ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme

Operatori ekonomik ushtron aktivitetin e tij në zbatimin e kërkesave ligjore në fuqi.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme

Operatori ekonomik nuk është në listën e operatorëve ekonomikë të ndaluar për të fituar kontrata publike në përputhje me nenin 78 të LPP-së.

Operatori ekonomik nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë /kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të përfituar fonde publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme

B: DEKLARATA

Ne cilësinë e përfaqësuesit të operatorit ekonomik, në mbështetje të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, si dhe në mbështetje të Ligjit Nr.9121/2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, bëj këtë deklaram dhe garantoj se deklaratat e mëposhtme janë të vërteta dhe të plota në çdo aspekt:

10. Unë kam lexuar dhe kuptuar përmbajtjen e kësaj Deklarate;
11. Unë kuptoj që oferta e paraqitur do të s’kualifikohet dhe/ose përjashtohet nga fitimi i kontratave publike, nëse kjo Deklaratë vërtetohet se nuk është e plotë dhe / ose e saktë në çdo aspekt;
12. Unë jam i autorizuar nga Ofertuesi të firmos këtë Deklaratë dhe të paraqes ofertë në interes të Ofertuesit;

13. Çdo person, firma e të cilit shfaqet në dokumentacionin e ofertës, është i autorizuar nga Ofertuesi për të përgatitur dhe për të nënshkruar ofertën në interes të Ofertuesit;
14. Për qëllim të kësaj deklaratë dhe ofertës së paraqitur, unë kuptoj që fjala “konkurrentë” nënkupton çdo operator tjetër ekonomik, të ndryshëm nga Ofertuesi, të paraqitur ose jo si bashkim operatorësh ekonomik, që:
- c) paraqesin një ofertë në përgjigje të Njoftimit të Kontratës dhe/ose të Ftesës për Ofertë, të bërë nga Autoriteti Kontraktor;
 - d) është një ofertues i mundshëm, i cili bazuar në kualifikimin, aftësitë ose përvojat e tij, mundet të dorëzojë një ofertë në përgjigje, të Njoftimit të Kontratës dhe/ose të Ftesës për Ofertë.
15. Ofertuesi deklaron se: (kliko një nga alternativat e mëposhtme):
- a) Ofertuesi ka përgatitur ofertën e tij në mënyrë të pavarur, pa u konsultuar, pa komunikuar dhe pa bërë marrëveshje apo pa rënë dakord me asnjë konkurrent tjetër;
 - b) Ofertuesi është konsultuar, ka komunikuar, ka bërë marrëveshje me një ose më shumë konkurrentë në lidhje me këtë procedurë prokurimi. Ofertuesi deklaron se në dokumentet bashkangjitur, në detajet e kësaj oferte, janë përfshirë emrat e konkurrentëve, natyra dhe shkaqet e konsultimit, komunikimit, marrëveshjes apo angazhimit (rasti i bashkimit të operatorëve ekonomikë ose nënkontraktimit).
16. Në veçanti, pa kufizuar paragrafët 6. a) dhe 6. b), të përmendur më lart, nuk ka pasur konsultime, komunikime, kontratë apo marrëveshje me ndonjë konkurrent në lidhje me:
- e) çmimet ;
 - f) metodat, faktorët ose formulat e përdorura për llogaritjen e çmimit;
 - g) qëllimin apo vendimin për të paraqitur apo jo një ofertë; ose,
 - h) paraqitjen e një oferte që nuk i plotëson specifikimet e kërkesës për ofertë.
17. Përveç kësaj, nuk ka pasur konsultime, komunikime, marrëveshje apo kontrata me ndonjë konkurrent në lidhje me cilësinë, sasinë, specifikimet apo dërgesa të veçanta të

produkteve apo shërbimeve të cilat lidhen me prokurimin në fjalë, përveç se kur janë deklaruar sipas paragrafit të mësipërm 6. b).

18. Kushtet e ofertës nuk u janë bërë të njohura dhe as nuk do t'u bëhen të njohura me qëllim nga Ofertuesi konkurrentëve të tjerë, në çdo mënyrë qoftë, para datës dhe kohës së hapjes zyrtare të ofertave, shpalljes fitues dhe lidhjes së kontratës, vetëm nëse kërkohet me ligj ose nëse deklarohen në mënyrë specifike sipas paragrafit 6.b).

C: DEKLARATA MBI KONFLIKTIN E INTERESIT

Deklarata

Në cilësinë e operatorit ekonomik, ne deklarojmë se jemi të vetëdijshëm për sa vijon: Konflikti i interesit është një situatë e konfliktit midis detyrës publike dhe interesit privat të një zyrtari, në të cilën ai / ajo ka interesa private direkte ose indirekte që ndikojnë, ose që mund të ndikojë ose që duket se ndikojnë në kryerjen e padrejtë të detyrave dhe detyrimeve publike.

Në përputhje me nenin 21, paragrafi 1, Ligji Nr. 9367, datë 07.04.2005, kategoritë e zyrtarëve siç parashikohen në Kapitullin III, Seksioni II, që janë absolutisht të ndaluara të përfitojnë drejtpërdrejt ose indirekt nga nënshkrimi i kontratave midis një pale dhe institucionit publik janë:

Presidenti i Republikës, Kryeministri, Zëvendës Kryeministri, Ministrat, ose Zëvendësministrat, Deputetët, Gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese, Gjyqtarët e Gjykatës së Lartë, Kreu i Kontrollit të Lartë të Shtetit, Prokurori i Përgjithshëm, Gjyqtarët dhe Prokurorët në nivelin e Gjykatës së Shkallës së Parë dhe Gjykatës së Apelit, Avokati i Popullit, Anëtarët e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Anëtarët e Këshillit të Lartë të Drejtësisë, Inspektori i Përgjithshëm i Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesit, Anëtarët e Enteve Rregullatore (Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë, përfshirë Guvernatorin dhe Zëvendësguvernatorin; konkurrenca; telekomunikacioni; energjia elektrike; furnizimi me ujë; sigurimi; bonot; autoritetet e medias), sekretarët e përgjithshëm të institucioneve qendrore si dhe çdo zyrtar publik në çdo institucion publik pozicioni i të cilit është i barabartë me atë të Drejtorit i Përgjithshëm, drejtuesit e organeve të administratës publike që nuk janë pjesë e shërbimit civil.

Për nëpunësit civilë të nivelit të mesëm, sipas nenit 31 dhe zyrtarët sipas nenit 32 të kreut III, seksionit 2 të këtij ligji, ndalimi në paragrafin 1 të këtij neni, për shkak të interesave private të zyrtarit, siç përcaktohet këtu të zbatohet vetëm në rast të lidhjes së kontratave brenda fushës dhe territorit të institucionit dhe juridiksionit të institucionit, ku punon zyrtari. Ky ndalim do të zbatohet edhe kur pala në kontratë është një institucion varësie.

Kur zyrtari është kryetar bashkie ose nënkryetar i një bashkie ose komune, ose kryetar i një këshilli rajonal, anëtar i këshillit përkatës, ose një zyrtar i lartë i menaxhimit të një njësie të qeverisjes vendore, ndalimi për shkak të interesave private të zyrtarit, specifikuar këtu, do të zbatohet vetëm në rastin e lidhjes së kontratave, nëse ka, me bashkinë, komunën ose rajonin ku zyrtari ushtron një detyrë të tillë. Ky ndalim do të zbatohet gjithashtu kur pala në kontratë

është një institucion publik në varësi të kësaj njësie (neni 21, paragrafi 2, Ligji Nr. 9367, datë 07.04.2005).

Ndalimet e parashikuara në nenin 21, paragrafët 1, 2 të Ligjit Nr. 9367, datë 07.04.2005, me përjashtimet përkatëse, do të zbatohen në të njëjtën masë edhe për personat e lidhur me zyrtarin, d.m.th. bashkëshortin, bashkëjetuesin, fëmijët madhorë e prindërit e zyrtarit dhe të bashkëshortit dhe bashkëjetuesit.

Unë jam në dijeni të kërkesave dhe ndalimeve të parashikuara në Ligjin Nr. 9367, datë 07.04.2005 "Për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksioneve Publike", të ndryshuar, dhe aktet nënligjore të miratuara në bazë të tij nga Inspektorati i Lartë i Deklarimi dhe Kontrolli i Pasurive, si dhe Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik". Në përputhje me to, unë deklaroj këtu se asnjë zyrtar publik, siç përcaktohet në Kapitullin III, Seksioni II të Ligjit Nr. 9367, datë 07.04.2005, dhe në këtë deklaratë, nuk ka ndonjë interes privat, direkt ose indirekt, me personin juridik që unë përfaqësoj këtu.

D: DEKLARATA “Për zbatimin e dispozitave ligjore në marrëdhëniet e punës”

Deklarata

Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time se:

- Operatori ekonomik _____garanton mbrojtjen e të drejtës së punësimit dhe profesionit nga çdo formë diskriminimi, të parashikuar nga legjislacioni i punës në fuqi.
- Operatori ekonomik _____lidh me punëmarrësit kontratat përkatëse të punës dhe garanton masat në drejtim të sigurisë dhe shëndetit në punë për të Gjithë dhe, në mënyrë të veçantë, për grupet e rrezikuara, bazuar në legjislacionin e punës në fuqi.
- Operatori ekonomik _____nuk ka masë Ligjore në fuqi, të vendosur nga Inspektoriati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore (ISHPSHSH). Në rastet kur janë konstatuar shkelje ligjore, operatori ekonomik ka marrë masat e nevojshme për adresimin e tyre, brenda afateve të përcaktuara nga ISHPSHSH.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme

Pjesa III: Kriteret e Përzgjedhjes/Kualifikimit

A: DEKLARATË

“Per permbushjen e specifikimeve teknike dhe grafikut e realizimit të objektit të kontratës”

Deklarata	Përgjigje
Në cilësinë e operatorit ekonomik, ne deklarojmë se plotësojnë të gjitha specifikimet	Po [] Jo []

<p>teknike, siç udhëzohet në dokumentet e tenderit, dhe këtë e provojmë përmes certifikatave dhe dokumenteve të paraqitura me këtë deklaratë (nëse kërkohet nga Autoriteti/Enti Kontraktor), dhe marrim përsipër të realizojmë objektin në përputhje me preventivin e punimeve dhe grafikun e zbatimit të punimeve të përcaktuar nga Autoriteti/Enti kontraktor.</p>	
--	--

B: DEKLARATË “Për disponimin e punonjësve të nevojshëm për realizimin e punimeve objekt kontrate”

Deklarata	Përgjigje
<p>Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time se: Unë kam punonjësit e nevojshëm siç përcaktohet në dokumentet e tenderit, dhe e vërtetoj këtë me dokumentacionin përkatës, të cilin do ta paraqes në kopje origjinale ose të noterizuar, nëse fitoj, ose nëse më kërkohen sqarime nga autoriteti/enti kontraktor.</p>	<p>Punonjës Po [] Jo [] Nëse, po, numri i punonjësve Gjithashtu, disponoj personelin kryesor të poshtëshënuar, sipas profileve (profesioneve/kualifikimeve) përkatëse: Z. _____, me profesion _____, i punësuar pranë shoqërisë sonë, në rolin e _____, Z. _____, me profesion _____, i punësuar pranë shoqërisë sonë, në rolin e _____, Z. _____, me profesion _____, i punësuar pranë shoqërisë sonë, në rolin e _____, Makineri e mjete Po [] Jo [] Nëse, po, të listohen me të dhënat konkrete</p>

C: DEKLARATË “Për disponimin e mjeteve/pajisje/makinerve të nevojshme për realizimin e punimeve objekt kontrate”

Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time se, kam në dispozicion dhe/ose do te me vihen ne dispozicion mjetet, pajisjet teknike dhe asetet e tjera fizike për të realizuar këtë kontratën, si me poshte:

Në pronësi				
Lloji i Mjetit	Targa	Nr. Lejes qarkullimit	Nr. Shasisë	Të tjera
1				
2				
3				
4				
5				

Me qira					
Lloji i Mjetit	Targa e mjetit	Nr. Lejes qarkullimit të mjetit	Nr. Shasisë së mjetit	Nr. Kont së qerasë (noterisë)	Afati i kontratës qerasë (data e fillimit dhe mbarimit)
1					
2					
3					
4					
5					
6					

Kontratë furnizimi				
Materiali/produkti për të cilin paraqitet kontrata e furnizimit	Nr. Kont së furnizimit (noterisë)	Afati i kontratës furnizimit (data e fillimit dhe mbarimit)	Të tjera	
1.				
2				
3				
4				

D. Deklaratë mbi Mosangazhimin e Kapaciteteve Teknike në Kontrata Te Tjera

Deklarata

Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time se:

Mjetet/pajisjet/makineritë e deklaruar në këtë procedurë prokurimi, pavarësisht formës së disponimit të tyre, do të jene ne dispozicion gjatë zbatimit të kontratës sipas grafikut të punimeve.

Nëse kërkohet, stafi teknik i poshtëshënuar:

Z. _____, me profesion _____, i punësuar pranë shoqërisë sonë, në rolin e _____, etj .,

i deklaruar në këtë procedurë prokurimi, nuk është i angazhuar në asnjë kontratë apo punëmarrje tjetër publike, që bie ndesh me legjislacionin e fushës së ndërtimit, dhe do të angazhohet vetëm për realizimin e këtij objekti.

Emri, Mbiemri _____

Firma _____

Vula _____

Data e dorëzimit të deklaratës _____

Ju lutemi sigurohuni që:

- **Secili pjesëmarrës i renditur në një bashkim operatorësh ekonomikë të paraqesë një Formular të veçantë të Vetëdeklarimit.**
- **Në rast se, operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, një Formular i veçantë i Vetëdeklarimit duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.**
- **Çdo vetdeklarim i pavërtetë/pasaktë nga ana e operatorëve ekonomikë jo vetëm që përbën shkak për skualifikimin nga procedura konkrete, por përbën shkak edhe për përjashtimin e tyre nga e drejta për të fituar kontrata publike deri në 3 vjet, sipas parashikimeve të ligjit për prokurimin publik.**
- **Operatorët ekonomikë që ofertojnë në procedurat e prokurimit të vetdeklarojnë në çdo rast informacionin e saktë që i korrespondon gjendjes së tyre faktike.**

Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik për sa më sipër.

- *Në çdo rast, përpara publikimit të njoftimit të fituesit paraprak dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor duhet t'i kërkojë ofertuesit fitues që të dorëzojë dokumentet provuese për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të*

vetëdeklarimit, si dhe dokumentet e paraqitura si pjesë e ofertës në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin.

- *Informacioni i pasqyruar në formularin e vetëdeklarimit, i cili gjendet në një bazë të dhënash, ku autoriteti/enti kontraktor mund të aksesojë direkt këtë informacion dhe /ose dokumentin, duhet të shoqërohet me adresën përkatëse për këtë bazë të dhënash.*

III.5.3. Në përmbushje të kriterit më sipër cituar, operatori ekonomik “Alko Impex General Construction” SHPK ka paraqitur në sistemin e prokurimit elektronik SPE dokumentacionin si më poshtë:

1- Aktë Marrëveshje datë 25.10.2023 lidhur midis “Alko Impex Construction” SHPK dhe “Alko Impex General Construction” SHPK “Meqënëse shoqëria “Alko Impex General Construction” SHPK ka shprehur vullnetin e saj të lirë e të plotë, për të marrë pjesë konformë procedurave përkatëse në procedurat e prokurimit që organizon Drejtoria e Spitalit Rajonal Dibër, me objekt Rikonstruksion i Spitalit Rajonal Dibër Rahim Xhika”, kërkon mbështetje në aftësitë teknike, profesionale nga shoqëria Alko Impex Construction shpk. Nëpërmjetë kësaj kontrate, operatori ekonomik në plotësim të kriterëve të përcaktuara në DST nga AK në procedurën e prokurimit e konkretisht atë të kapacitetit teknik dhe profesional si dhe realizimit me sukses të kontratës në rast të shpalljes fituese do të mbështeten në kapacitetet teknike dhe profesionale të shoqërisë “Alko Impex Construction” SHPK. Ky i fundit deklaron dhe bie dakort se do të mbështes operatori ekonomik “Alko Impex General Construction” SHPK për pikën 2.3.9 (stafi teknik) 2.3.10 (mjetet dhe pajisjet).

2- Deklaratë datë 25.10.2023 nga mbështetësi i kapaciteteve “Alko Impex Construction” SHPK.

3- Aktë Marrëveshje datë 25.10.2023 lidhur midis “Arkonstudio” SHPK dhe “Alko Impex General Construction” SHPK “Meqënëse shoqëria “Alko Impex General Construction” SHPK ka shprehur vullnetin e saj të lirë e të plotë, për të marrë pjesë konformë procedurave përkatëse në procedurat e prokurimit që organizon Drejtoria e Spitalit Rajonal Dibër, me objekt Rikonstruksion i Spitalit Rajonal Dibër Rahim Xhika”, kërkon mbështetje në aftësitë teknike, profesionale nga shoqëria Arkonstudio SHPK. Nëpërmjetë kësaj kontrate, operatori ekonomik në plotësim të kriterëve të përcaktuara në DST nga AK në procedurën e prokurimit e konkretisht atë të kapacitetit teknik dhe profesional si dhe realizimit me sukses të kontratës në rast të shpalljes fituese do të mbështeten në kapacitetet teknike dhe profesionale të shoqërisë “Arkonstudio” SHPK. Ky i fundit deklaron dhe bie dakort se do të mbështes operatori ekonomik “Alko Impex General Construction” SHPK për pikën 2.3.4 (stafi inxhinierik) 2.3.7 (staf teknik).

4- Deklaratë datë 25.10.2023 nga mbështetësi i kapaciteteve “Arkonstudio” SHPK.

5- Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit “Alko Impex General Construction” SHPK. Në Pjesën III: “Kriteret e Përzgjedhjes/Kualifikimit”, gërma “B”: “DEKLARATË “Për disponimin e punonjësve të nevojshëm për realizimin e punimeve objekt kontrate”, operatori ekonomik “Alko Impex General Construction” SHPK deklaron:

Shtojca 8.

FORMULARI PËRMBLEDHËS I VETËDEKLARIMIT

Unë i nënshkruari Arbër Abazi në cilësinë e perfaqësuesit të operatorit ekonomik Alko Impex General Construction dshh deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë që:

A. Pjesa I: Informacion në lidhje me Operatorin Ekonomik

Identifikimi	Përgjigjja
Emri i operatorit ekonomik: (Ju lutemi renditni të gjithë operatorët ekonomikë nëse jeni një BOE. Ju lutemi tregoni rolin e operatorit ekonomik në BOE)	Alko Impex General Construction dshh
Numri NIPT/et:	K 91326028I
Adresa postare: Qyteti / qyteti; Kodi postar	Rruga “ Reshit Petrela”, Kompleksi Usluga, Tirane
Përfaqësuesi (emri):	Arbër Abazi

- Informacion mbi subjektet mbi kapacitetin, e të cilëve do të mbështetet operatori ekonomik

Emri (at) e subjekteve	NIPT-i	Lloji i kapacitetit për të cilin do të mbështetet operatori ekonomik	Specifiko konkretisht kapacitetin/et
ALKO IMPEX CONSTRUCTION	K91628013D	Kapaciteti teknik	Pika 2.3.9(STAFI Teknik)2.3.10(mjetet dhe pajisjet)
ARKONSTUDIO	L42019004I	Kapaciteti teknik	Pika 2.3.4, (Arkitekti)2.3.7(Auditues Energjie)
“2 T”shpk	K01731001M	Kapaciteti teknik	2.3.1, ne lidhje me Kapacitetin teknik

B: DEKLARATË “Për disponimin e punonjësve të nevojshëm për realizimin e punimeve objekt kontrate”

Deklarata	Përgjigje
<p>Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time se:</p> <p>Unë kam punonjësit e nevojshëm siç përcaktohet në dokumentet e tenderit, dhe e vërtetoj këtë me dokumentacionin përkatës, të cilin do ta paraqes në kopje origjinale ose të noterizuar, nëse fitoj, ose nëse më kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.</p>	<p>Punonjës</p> <p>Po [X] Jo []</p> <p>Nëse, po, numri i punonjësve Alko Impex General Constrction ka te punesuar mesatarisht 338 punonjes per periudhen Qershor-Gusht 2023</p> <p>Gjithashtu, disponoj personelin kryesor të poshtëshënuar, sipas profileve (profesioneve/kualifikimeve) përkatëse:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. _____ me profesion Inxhinier Ndertimi, i punesuar prane shoqerise sone,ne rolin drejtues teknik. 2. _____ me profesion Inxhinier gjeodet, i punësuar pranë shoqërisë sonë, në rolin e drejtuesit teknik, 3. _____, me profesion Inxhinier hidroteknik, i punesuar prane shoqerise sone, ne rolin e drejtuesit Teknik. Inxhinier i pajisur me certifikate “Pergjegjes per sigurine dhe mbrojtjene shendetit ne pune”

	<ol style="list-style-type: none"> 4. _____ me profesion Inxhinier mekanike, e punesuar prane shoqerise sone, ne rolin e drejtuesit Teknik 5. _____ me profesion Inxhinier elektrik, i punesuar prane shoqerise sone, ne rolin e drejtuesit Tekni. 6. _____ me profesion Mjek i pergjitheshem i punesuar prane shoqerise sone, 7. _____ me profesion Teknik ndertimi i punesuar prane shoqerise sone. 8. _____ ne profesion Teknik elektroteknike i punesuar prane shoqerise sone. 9. _____ me profesion Inxhinier Elektronike i punesuar prane shoqerise sone. 10. _____ me profesion Hidraulik i punesuar prane shoqerise sone. 11. _____ me profesion Hidraulik i punesuar prane shoqerise sone. 12. _____ me profesion Elektricist, i punësuar pranë shoqërisë sone 13. _____ me profesion Elektricist, i punësuar pranë shoqërisë sone. 14. _____ me profesion Instalues te kondicionereve dhe sistemeve ftohes ngrohes i punësuar pranë shoqërisë sone. 15. _____ me profesion Instalues te kondicionereve dhe sistemeve ftohes ngrohes i punësuar pranë shoqërisë sone. 16. _____ me profesion Instalues te kondicionereve dhe sistemeve ftohes ngrohes i punësuar pranë shoqërisë sone. 17. _____ me profesion Instalues te kondicionereve dhe sistemeve ftohes ngrohes i punësuar pranë shoqërisë sone. 18. _____ me profesion Hekurkthyes, i punësuar pranë shoqërisë sone.
--	--

	<p>19. me profesion Hekurkthyes, i punësuar pranë shoqërisë sone</p> <p>20. me profesion Karpentier , i punësuar pranë shoqërisë sone.</p> <p>21. me profesion Betonues , i punësuar pranë shoqërisë sone.</p> <p>22. me profesion Betonues , i punësuar pranë shoqërisë sone.</p> <p>23. me profesion Saldator, i punësuar pranë shoqërisë sone.</p> <p>24. me profesion Mekanik, i punësuar pranë shoqërisë sone.</p> <p>25. me profesion Specialist Gipsi/sisteme te thata , i punësuar pranë shoqërisë sone.</p> <p>26. me profesion Specialist Gipsi/sisteme te thata , i punësuar pranë shoqërisë sone.</p> <p>27. me profesion Specialist Gipsi/sisteme te thata , i punësuar pranë shoqërisë sone.</p> <p>28. me profesion Specialist Gipsi/sisteme te thata , i punësuar pranë shoqërisë sone.</p> <p>29. me profesion Punonjes Duro-alumini , i punësuar pranë shoqërisë sone.</p> <p>30. me profesion Punonjes Duro-alumini , i punësuar pranë shoqërisë sone.</p> <p>31. me profesion Suvatues/murator, i punësuar pranë shoqërisë sone.</p> <p>32. me profesion Suvatues/murator, i punësuar pranë shoqërisë sone.</p> <p>33. me profesion Suvatues/Muratore, i punësuar pranë shoqërisë sone.</p> <p>34. me profesion Suvatues/Muratore, i punësuar pranë shoqërisë sone.</p> <p>35. me profesion Hidroizolues, i punësuar pranë shoqërisë sone.</p> <p>36. me profesion Bojaxhi, i punësuar pranë shoqërisë sone.</p>
--	--

	<p>37. me profesion Bojaxhi, i punësuar pranë shoqërisë sone.</p> <p>38. me profesion Pllakashtrues, i punësuar pranë shoqërisë sone.</p> <p>39. me profesion Pllakashtrues, i punësuar pranë shoqërisë sone.</p> <p>40. me profesion Pllakashtrues, i punësuar pranë shoqërisë sone.</p> <p>41. me profesion Pllakashtrues, i punësuar pranë shoqërisë sone.</p> <p>Makineri e mjete</p> <p>Po [<input checked="" type="checkbox"/>] Jo [<input type="checkbox"/>]</p> <p>Nëse, po, të listohen me të dhënat konkrete</p>

4- Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit “Alko Impex Construction” SHPK. Në Pjesën III: “Kriteret e Përzgjedhjes/Kualifikimit”, gërma “B”: “DEKLARATË “Për disponimin e punonjësve të nevojshëm për realizimin e punimeve objekt kontrate”, operatori ekonomik “Alko Impex Construction” SHPK deklaron:

B: DEKLARATË “Për disponimin e punonjësve të nevojshëm për realizimin e punimeve objekt kontrate”

Deklarata	Përgjigje
<p>Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time se:</p> <p>Unë kam punonjësit e nevojshëm siç përcaktohet në dokumentet e tenderit, dhe e vërtetoj këtë me dokumentacionin përkatës, të cilin do ta paraqes në kopje origjinale ose të noterizuar, nëse fitoj, ose nëse më kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.</p>	<p>Punonjës</p> <p>Po [X] Jo []</p> <p>Nëse, po, numri i punonjësve Alko Impex Constrcution ka te punësuar mesatarisht 339 punonjes per periudhen Qershor-Gusht</p> <p>Gjithashtu, disponoj personelin kryesor të poshtëshënuar, sipas profileve (profesioneve/kualifikimeve) përkatëse:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. _____ me profesion Hidraulik, i punësuar pranë shoqërisë sone. 2. _____ me profesion Hidraulik, i punësuar pranë shoqërisë sone. 3. _____ me profesion Hidraulik, i punësuar pranë shoqërisë sone. 4. _____ me profesion Elektracist, i punësuar pranë shoqërisë sone. 5. _____ me profesion Instalues te kondicionereve dhe sistemeve ftohese-ngrohese i punësuar pranë shoqërisë sone. 6. _____ me profesion Hekurkthyes, i punësuar pranë shoqërisë sone 7. _____ me profesion Hekurkthyes, i punësuar pranë shoqërisë sone 8. _____ me profesion Hekurkthyes, i punësuar pranë shoqërisë sone 9. _____ me profesion Hekurpunues, i punësuar pranë shoqërisë sone 10. _____ me profesion Hekurpunues, i punësuar pranë shoqërisë sone 11. _____ me profesion Karpentier , i punësuar pranë shoqërisë sone. 12. _____ me profesion Karpentier , i punësuar pranë shoqërisë sone. 13. _____ me profesion Karpentier , i punësuar pranë shoqërisë sone. 14. _____ me profesion Karpentier , i punësuar pranë shoqërisë sone. 15. _____ me profesion Saldator, i punësuar prane shoqerise sone.

	<p>16. me profesion Saldator, i punesuar prane shoqerise sone.</p> <p>17. me profesion Elektromekanik , i punësuar pranë shoqërisë sone.</p> <p>18. me profesion Specialist Gipsi , i punësuar pranë shoqërisë sone.</p> <p>19. me profesion Punonjes Duro-alumini , i punësuar pranë shoqërisë sone.</p> <p>20. me profesion Punonjes Duro-alumini , i punësuar pranë shoqërisë sone.</p> <p>21. me profesion Suvatues, i punesuar prane shoqerise sone.</p> <p>22. me profesion Suvatues, i punesuar prane shoqerise sone</p> <p>23. me profesion Muratore, i punesuar prane shoqerise sone.</p> <p>24. me profesion Muratore, i punesuar prane shoqerise sone.</p> <p>25. me profesion Muratore, i punesuar prane shoqerise sone.</p> <p>26. me profesion Muratore, i punesuar prane shoqerise sone.</p> <p>27. me profesion Hidroizolues, i punesuar prane shoqerise sone.</p> <p>28. me profesion Hidroizolues, i punesuar prane shoqerise sone.</p> <p>29. me profesion Hidroizolues, i punesuar prane shoqerise sone.</p> <p>30. me profesion Bojaxhi, i punesuar prane shoqerise sone.</p> <p>31. me profesion Bojaxhi, i punesuar prane shoqerise sone.</p> <p>32. me profesion Bojaxhi, i punesuar prane shoqerise sone.</p> <p>33. me profesion Bojaxhi, i punesuar prane shoqerise sone.</p> <p>34. me profesion Pllakashtrues, i punesuar prane shoqerise sone.</p> <p>35. me profesion Pllakashtrues, i punesuar prane shoqerise sone.</p> <p>36. me profesion Pllakashtrues, i punesuar prane shoqerise sone.</p>
	<p>37. me profesion Elektromekanik, i punesuar prane shoqerise sone.</p> <p>.Makineri e mjete</p> <p>Po [X] Jo []</p> <p>Nëse, po, të listohen me të dhënat konkrete</p>

5- Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit “Arkonstudio” SHPK. Në Pjesën III: “Kriteret e Përzgjedhjes/Kualifikimit”, gërma “B”: “DEKLARATË “Për disponimin e punonjësve të nevojshëm për realizimin e punimeve objekt kontrate”, operatori ekonomik “Arkonstudio” SHPK deklaroi:

Shtojca 8.

FORMULARI PËRMBLEDHËS I VETËDEKLARIMIT

Unë i nënshkruari në cilësinë e përfaqësuesit të operatorit ekonomik “**ARKONSTUDIO**” deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë që:

A. Pjesa I: Informacion në lidhje me Operatorin Ekonomik

Identifikimi	Përgjigja
Emri i operatorit ekonomik: (Ju lutemi renditni të gjithë operatorët ekonomikë nëse jeni një BOE. Ju lutemi tregoni rolin e operatorit ekonomik në BOE)	“ ARKONSTUDIO ”
Numri NIPT/et:	L42019004I
Adresa postare: Qyteti / qyteti; Kodi postar	Tiranë, Rruga “Mihal Duri”, Objekti 33 Tirane, 1016
Përfaqësuesi (emri):	
Telefoni:	
E-mail:	

B: DEKLARATË “Për disponimin e punonjësve të nevojshëm për realizimin e punimeve objekt kontrate”

Deklarata	Përgjigje
Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time se: Unë kam punonjësit e nevojshëm siç përcaktohet në dokumentet e tenderit, dhe	Punonjës Po [<input checked="" type="checkbox"/>] Jo [<input type="checkbox"/>]

e vërtetoj këtë me dokumentacionin përkatës, të cilin do ta paraqes në kopje origjinale ose të noterizuar, nëse fitoj, ose nëse më kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.	Gjithashtu, disponoj personelin kryesor të poshtëshënuar, sipas profileve (profesioneve/kualifikimeve) përkatëse: 1. me profesion Arkitekt i punësuar pranë shoqërisë sone, në rolin e drejtuesit Teknik 2. me profesion Inxhinier Ndertimi i pajisur me Certificate per Audituesin Energjistik i punësuar pranë shoqërisë sone. Makineri e mjete Po [<input type="checkbox"/>] Jo [<input type="checkbox"/>] Nëse, po, të listohen me të dhënat konkrete
--	---

III.5.4. Në nenin 2 “Qëllimi i ligjit” të ligjit nr. 162/2021 “Për prokurimin publik” parashikohet se: Qëllim i këtij ligji është: a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit

publik; b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale; c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik; ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë; d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik; dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.

III.5.5. Në nenin 3 “Parime të përgjithshme” të ligjit nr. 162/2021 “Për prokurimin publik” parashikohet se 1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale. 2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar. 3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.

III.5.6. Në nenin 77 të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: 1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

2. Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionalë ose tregtarë.

Në procedurat e prokurimit për shërbime, ku është e nevojshme që operatorët ekonomikë të kenë një autorizim të veçantë ose të jenë anëtarë të një organizate të veçantë për të kryer shërbimin në fjalë në shtetin e tyre të origjinës, autoriteti ose enti kontraktor mund t'u kërkojë atyre të vërtetojnë se e kanë këtë autorizim ose anëtarësim.

3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën.

Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Xhiroja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës.

Kur një kontratë ndahet në lote, ky nen zbatohet për çdo lot individual. Megjithatë, autoriteti ose enti kontraktor mund të përcaktojë xhiron vjetore minimale që u kërkohet operatorëve, duke iu referuar grupeve të loteve, në rast se ofertuesi i suksesshëm merr disa lote që duhet të zbatohen në të njëjtën kohë.

Në rastin e kontratave që bazohen në një marrëveshje kuadër, kërkesa për xhiron minimale llogaritet mbi bazën e përmasave maksimale të kontratave specifike që do të zbatohen në të njëjtën kohë ose, kur përmasat nuk dihen, mbi bazën e vlerës së parashikuar të marrëveshjes kuadër.

4. *Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.*

Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.

Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.

5. *Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.”*

III.5.7. Neni 39 “Kërkesa të vecanta për kontratat për punë publike”, të VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, parashikon shprehimisht se:

“Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon:

a) licenca profesionale të shoqërisë për realizimin e punimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe/ose

b) që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionalë ose tregtarë, kur një gjë e tillë është e detyrueshme nga legjislacioni përkatës; dhe/ose

c) një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla sipas legjislacionit përkatës; dhe/ose

ç) fuqinë minimale punëtore të operatorit ekonomik, të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit; dhe/ose

d) mjetet e pajisjet teknike, të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

III.5.8. Në nenin 82 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit” pika 1 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, parashikohet shprehimisht : ““1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave

për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si provë paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik. Kur autoriteti ose enti kontraktor mund t'i marrë dokumentet mbështetëse duke u futur direkt në një bazë të aksesueshme të dhënash shtetërore, në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit përcaktohet edhe informacioni që kërkohet për këtë qëllim, siç është adresa në internet e bazës të të dhënave, çdo e dhënë identifikimi dhe, sipas rastit, në deklaratën e nevojshme për dhënien e pëlqimit. Operatorët ekonomikë mund të përdorin një formular vetëdeklarimi që është përdorur gjatë një procedure prokurimi të mëparshme, nëse informacioni që ajo përmban vazhdon të jetë i saktë dhe i vlefshëm. 2. Në çdo kohë gjatë procedurës, autoriteti ose enti kontraktor mund t'u kërkojë ofertuesve dhe kandidatëve sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime, kur kjo është e nevojshme për të garantuar zbatimin korrekt të procedurës.”

Ndërsa në nenin 92/3 të LPP-së përcaktohet se: “3. Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji...”

III.5.9. Në nenin 84 “Mbështetja në kapacitetet e subjekteve të tjera”, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” përcaktohet se:

“1. Operatori ekonomik, me qëllim plotësimin e kërkesave të përcaktuara nga autoriteti ose enti kontraktor në dokumentet e tenderit, mund të mbështetet në kapacitetet ekonomike e financiare, aftësinë teknike ose profesionale të subjekteve të tjera, pavarësisht natyrës juridike të lidhjeve që ai ka me ta.

2. Operatori ekonomik mund ta shfrytëzojë aftësinë e ndonjë subjekti tjetër për të dëshmuar plotësimin e kushteve në lidhje me kualifikimet arsimore dhe profesionale vetëm nëse subjekti tjetër i kryen punët ose do t'i sigurojë shërbimet për të cilat kërkohet aftësi e tillë.

3. Kur një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit ose entit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.

4. Autoriteti ose enti kontraktor duhet të sigurohet se për subjektin, aftësinë e të cilit e shfrytëzon operatori ekonomik, nuk ekzistojnë shkaqet për skualifikimin ose përjashtimin e tij. Autoriteti ose enti kontraktor duhet t'i kërkojë operatorit ekonomik që të zëvendësojë subjektin që ndodhet në kushtet e skualifikimit apo të përjashtimit.

5. Nëse operatori ekonomik shfrytëzon aftësi nga subjekti tjetër në lidhje me kushtet që kanë të bëjnë me gjendjen ekonomike dhe financiare, autoriteti ose enti kontraktor mund të kërkojë që operatori ekonomik dhe subjekti të ndërmarrin përgjegjësi solidare për zbatimin e marrëveshjes.

6. Ndërkohë, në rastin kur operatorët ekonomikë mbështeten në kapacitetet e subjekteve të tjera, pasi këta të fundit do të kryejnë furnizimet, punët ose shërbimet, për të cilat kërkohen

këto kapacitete, atëherë grupi i operatorëve ekonomikë mund të dorëzojë oferta ose të paraqitet si një kandidat i vetëm.

7. Në rastin e kontratave të punëve, shërbimeve dhe vendosjes ose instalimit në kuadër të një kontrate furnizimi, autoriteti ose enti kontraktor mund të kërkojë që detyra/punë/aspekte kritike të kontratës të përmbushen nga vetë operatori ekonomik ose nga ndonjëri prej anëtarëve të bashkimit të operatorëve ofertues.”

III.5.10. Në nenin 26 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit” të Vendimit Nr. 285 datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, parashikohet se: “1. **Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla.**

2. Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit përmban informacion dhe deklarimin, si më poshtë vijon:

a) operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin ose sipas legjislacionit të posaçëm, në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;

b) operatori ekonomik nuk është dënuar për asnjë nga veprat penale, të parashikuara në pikën 1, të nenit 76, të LPP-së;

c) personi/at në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtuesit ose mbikëqyrësit, aksionerit ose ortakut, ose që ka kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, nuk është ose ka qenë i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për asnjë nga veprat penale, të përcaktuara në pikën 1, të nenit 76, të LPP-së;

ç) operatori ekonomik nuk është dënuar me vendim të gjykatës së formës së prerë, për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale;

d) operatori ekonomik nuk është në proces falimentimi;

dh) operatori ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e taksave dhe tatimeve³ të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas parashikimeve të pikës 2, të nenit 76, të LPP-së;

e) operatori ekonomik ka shlyer të gjitha detyrimet e maturuara të energjisë elektrike, dhe përmbush kërkesat që rrjedhin nga legjislacioni i fushës në fuqi. Ky informacion kërkohet për operatorët ekonomikë, të cilët ushtrojnë veprimtarinë në territorin e Republikës së Shqipërisë;

ë) operatori ekonomik nuk ndodhet në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;

f) operatori ekonomik ushtron aktivitetin në zbatim të kërkesave ligjore të legjislacionit mjedisor, social dhe të punës;

g) operatori ekonomik ka paraqitur ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;

³ Ndryshuar me Vendimin Nr. 710 datë 24.11.2021

gj)operatori ekonomik përmbush specififikimet teknike, sipas kërkesave të përcaktuara nga autoriteti/enti kontraktor;

h)operatori ekonomik disponon fuqinë punëtore, të nevojshme për ekzekutimin e kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor (kur është rasti);

i)operatori ekonomik disponon mjetet dhe makineritë e nevojshme për ekzekutimin e kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor, kur është rasti;

j)informacion mbi subjektet, mbi kapacitetet e të cilave, operatori ekonomik do të mbështetet, nëse është rasti dhe nënkontraktorët e mundshëm, nëse është rasti;

k)operatori ekonomik ushtron aktivitetin konform kërkesave të legjislacionit në fuqi.

3. Informacioni i pasqyruar në formularin e vetëdeklarimit, i cili gjendet në një bazë të dhënash, ku autoriteti/enti kontraktor mund të aksesojë direkt këtë informacion dhe /ose dokumentin, duhet të shoqërohet me adresën përkatëse për këtë bazë të dhënash.

4. Për përmbushjen e detyrimit sipas këtij neni, operatorët ekonomikë mund të përdorin një formular vetëdeklarimi që është përdorur gjatë një procedure prokurimi të mëparshme, nëse informacioni që ajo përmban vazhdon të jetë i saktë dhe i vlefshëm.

5. Operatorëve ekonomikë nuk u kërkohet të dorëzojnë dokumente mbështetëse, kur autoriteti ose enti kontraktor që ka dhënë kontratën ose ka lidhur marrëveshjen kuadër, i ka këto dokumente.

6. Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të nenit 26 të V, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike⁴. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin.

Autoriteti/enti kontraktor pranon një dokument të lëshuar nga i njëjti institucion ose palë e tretë dhe që ka të njëjtin informacion me atë të paraqitur në procedurën e zhvilluar në mënyrë elektronike.

Operatorët ekonomikë të huaj duhet të paraqesin dokumentet në formën e kërkuar nga legjislacioni në fuqi për njohjen e dokumentacionit të lëshuar në një shtet të huaj.

Për dokumentet që nuk lëshohen në vendin e origjinës, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë këtë fakt, përndryshe dokumentacioni do të konsiderohet i paparaqitur.

7.Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër, ose t'i kërkojë operatorit sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.”.

III.5.11. Në nenin 90 “Mbështetja në kapacitetet e subjekteve të tjera” të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

“1. Operatori ekonomik, me qëllim plotësimin e kërkesave të përcaktuara nga autoriteti ose enti kontraktor në dokumentet e tenderit, mund të mbështetet në kapacitetet ekonomike e financiare, aftësinë teknike ose profesionale të subjekteve të tjera, pavarësisht natyrës juridike të lidhjeve që ai ka me ta, sipas përcaktimit në nenin 84, të LPP-së.

2. Kur një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai duhet:

- ta deklarojë një gjë të tillë që në dokumentet e ofertës;

- t'i vërtetojë me dokumentacion provues autoritetit/entit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme.

- t'i provojë autoritetit/entit kontraktor se për subjektin, aftësinë, e të cilit e shfrytëzon operatori ekonomik, nuk ekzistojnë shkaqet për skualifikimin ose përjashtimin e tij nga procedura, sipas parashikimeve të nenit 76, të LPP-së.

- Në çdo rast, operatori ekonomik ofertues që dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, duhet të provojë se plotëson të paktën 50% të kërkesave të përcaktuara nga autoriteti ose enti kontraktor.

3. Kur operatori ekonomik kërkon të mbështetet në aftësinë e ndonjë subjekti tjetër për të dëshmuar plotësimin e kushteve në lidhje me kualifikimet arsimore dhe profesionale, atëherë shërbimet, për të cilat kërkohet një aftësi e tillë ose punët do të kryhen nga subjekti tjetër.

4. Kur operatori ekonomik kërkon të mbështetet në aftësinë e një subjekti tjetër në lidhje me kushtet që kanë të bëjnë me gjendjen ekonomike dhe financiare, autoriteti ose enti kontraktor mund të kërkojë që operatori ekonomik dhe subjekti të ndërmarrin përgjegjësi solidare për zbatimin e kontratës.

5. Kur operatori ekonomik kërkon të mbështetet në aftësinë e subjekteve të tjera, pasi këta të fundit do të kryejnë furnizimet, punët ose shërbimet, për të cilat kërkohen këto kapacitete, atëherë grupi i operatorëve ekonomikë mund të dorëzojnë oferta ose të paraqiten si një kandidat i vetëm.

6. Në rastin e kontratave të punëve, shërbimeve dhe vendosjes ose instalimit në kuadër të një kontrate furnizimi, autoriteti/enti kontraktor, mund të kërkojë që për kryerjen e detyrave/punëve/aspekteve kritike të kontratës të mos mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera por të përmbushen nga vetë ofertuesi. Ky informacion publikohet në dokumentet e tenderit.

7. Subjekti mbështetës nuk mund të jetë njëkohësisht edhe ofertues në procedurën e prokurimit. Subjekti mbështetës nuk mund të mbështesë më shumë se një operator ekonomik në të njëjtën procedurë prokurimi.”

III.5.12. Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim, ka si synim kryesor që t'i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale,

kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor, janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të vërtetojnë se zotërojnë reputacionin, besueshmërinë, kapacitetet e konsideruara të nevojshme nga autoriteti kontraktor, për të zbatuar kontratën objekt-prokurimi. KPP sqaron, se në një procedurë prokurimi, subjekti i parë i interesuar është operatori ekonomik, i cili e përgatit ofertën e tij në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, dhe nga ana tjetër, është autoriteti kontraktor, i cili përzgjedh operatorin ekonomik që plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit, si dhe që ka përgatitur ofertën në përputhje me legjislacionin në fuqi. Autoriteti kontraktor do të konsiderojë një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit. Për pasojë, Komisioni gjykon, se operatorët ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi duhet të plotësojnë vetëm kërkesat e vendosura në dokumentet e tenderit, e rrjedhimisht, vlerësimi e kualifikimi i tyre duhet të bëhet në përputhje vetëm me këto kërkesa. Në pikën 1 dhe 6 të nenit 26 “*Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit*”, të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*” i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: “*Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla.* 2. *Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit përmban informacion dhe deklarimin, si më poshtë vijon: i) operatori ekonomik disponon mjetet dhe makineritë e nevojshme për ekzekutimin e kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor, kur është rasti; 6. Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin.*

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të administruar, Komisioni i Prokurimit Publik, konstaton, se për përmbushjen e kriterit 2.3.9 të kriterëve të veçanta të kualifikimit, si më sipër cituar, operatori ekonomik ankimes ka dorëzuar formularin e tij përmbledhës të vetëdeklarimit si dhe formularin përmbledhës të vetëdeklarimit të operatorit ekonomik mbi kapacitetet e të cilit do të mbështetet në lidhje me këtë kriter, dokument të cilin në zbatim të parashikimeve ligjore në fuqi, autoriteti/enti kontraktor e pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, dhe vetëm përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të

kualifikuar i pari, dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të nenit 26, të Vendimit Nr. 285 datë 19.05.2021, të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike, duke i rezervuar në këtë mënyrë të drejtën autoritetit kontrator të kryejë verifikime në rast nevojë apo të dërgojë kërkesa për sqarim mbi dokumentacionin e paraqitur nga operatorët ekonomikë.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar në SPE në përmbushje të kriterit 2.3.9, Komisioni konstaton, se operatori ekonomik ankimues “Alko Impex General Construction” SHPK ka dorëzuar Formularit e tij Përmbledhës të Vetëdeklarimit, Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit të mbështetësit në kapacitete “Alko Impex Construction” SHPK, si dhe Marrëveshjen e Angazhimit të datës 25.10.2023, midis palës mbështetëse “Alko Impex Construction” SHPK dhe palës së mbështetur “Alko Impex General Construction” SHPK, në të cilën citohet se pala mbështetëse do të mbështesë me kapacitete njerëzore dhe teknike, shoqërinë “Alko Impex General Construction” SHPK për kriterin 2.3.9 dhe kjo e fundit pranon këtë mbështetje”, Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit të mbështetësit në kapacitete “Arkonstudio” SHPK si dhe Marrëveshjen e Angazhimit të datës 25.10.2023, midis palës mbështetëse “Arkonstudio” SHPK dhe palës së mbështetur “Alko Impex General Construction” SHPK, në të cilën citohet se pala mbështetëse do të mbështesë me kapacitete njerëzore dhe teknike, shoqërinë “Alko Impex General Construction” SHPK për kriterin 2.3.4 dhe 2.37 dhe kjo e fundit pranon këtë mbështetje. Nga verifikimi i kriterëve kualifikues në lidhje me dëshminë për punonjësit e kërkuar për realizimin e kontratës, konkretisht pikës 2.3.4 (kërkesë për staf inxhinierik), pikës 2.3.6 (kërkesë për mjekun e shoqërisë), pikës 2.3.7/b (kërkesa për punonjës auditues energjie), si dhe kriterit 2.3.9 (kërkesa për staf teknik), rezulton se operatori ekonomik ankimues kryesues është mbështetur mbi kapacitetet e operatorëve ekonomik “Alko Impex Construction” SHPK dhe “Arkonstudio” SHPK. Konkretisht për sa i përket kriterit 2.3.4, nga 6 inxhinierë të kërkuar, 5 prej tyre i disponon vetë si kryesues ndërsa për punonjësin arkitekt është mbështetur te operatori ekonomik “Arkonstudio” SHPK, dhe për punonjësin Auditues Energjie të parashikuar tek kriteri 2.3.7/b, për sa i përket kriterit 2.3.6 në lidhje me mjekun e shoqërisë këtë kriter e plotëson me kapacitetet e tij duke e disponuar vetë, ndërsa në lidhje me kriterin 2.3.9 sa i përket stafit teknik, nga 71 punonjës të profileve të ndryshme të kërkuar, rezulton se 35 punonjës plotësohen nga vetë operatori ekonomik ankimues. Komisioni gjykon, se referuar nenit 84, “Mbështetja në kapacitetet e subjekteve të tjera”, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, përcaktohen kapacitetet mbi të cilat mund të mbështetesh te një operator ekonomik, konkretisht parashikohet se: **“1. Operatori ekonomik, me qëllim plotësimin e kërkesave të përcaktuara nga autoriteti ose enti kontraktor në dokumentet e tenderit, mund të mbështetet në kapacitetet ekonomike e financiare, aftësinë teknike ose profesionale të subjekteve të tjera, pavarësisht natyrës juridike të lidhjeve që ai ka me ta. 2. Operatori ekonomik mund ta shfrytëzojë aftësinë e ndonjë subjekti tjetër për të dëshmuar plotësimin e kushteve në lidhje me kualifikimet arsimore dhe profesionale vetëm nëse subjekti tjetër i kryen punët ose do t’i sigurojë shërbimet për të cilat kërkohet aftësi e tillë. 3. Kur një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit ose entit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim. 4. Autoriteti ose**

enti kontraktor duhet të sigurohet se për subjektin, aftësinë e të cilit e shfrytëzon operatori ekonomik, nuk ekzistojnë shkaqet për skualifikimin ose përjashtimin e tij. Ndërsa në nenin 90 “Mbështetja në kapacitetet e subjekteve të tjera” të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se **1. Operatori ekonomik, me qëllim plotësimin e kërkesave të përcaktuara nga autoriteti ose enti kontraktor në dokumentet e tenderit, mund të mbështetet në kapacitetet ekonomike e financiare, aftësinë teknike ose profesionale të subjekteve të tjera, pavarësisht natyrës juridike të lidhjeve që ai ka me ta, sipas përcaktimit në nenin 84, të LPP-së. 2. Kur një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai duhet: - ta deklarojë një gjë të tillë që në dokumentet e ofertës; - t’i vërtetojë me dokumentacion provues autoritetit/entit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme; - t’i provojë autoritetit/entit kontraktor se për subjektin, aftësinë, e të cilit e shfrytëzon operatori ekonomik, nuk ekzistojnë shkaqet për skualifikimin ose përjashtimin e tij nga procedura, sipas parashikimeve të nenit 76, të LPP-së; - Në çdo rast, operatori ekonomik ofertues që dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, duhet të provojë se plotëson të paktën 50% të kërkesave të përcaktuara nga autoriteti ose enti kontraktor.** KPP në funksion të një hetimi të thelluar administrativ dhe të shqyrtimit në mënyrë shterruese të gjitha rrethanave e fakteve që lidhen me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues rezulton, se nga ana e autoritetit kontraktor, në total për realizimin e kësaj kontrate janë kërkuar 79 punonjës të profileve të ndryshme inxhinierike dhe teknike, nga ky numër total punonjësish konstatohet se operatori ekonomik ankimues kryesues “Alko Impex General Construction” SHPK vertëton nëpërmjet formularit përmbledhës të vetëdeklarimit se disponon 41 punonjës. Pra referuar nenit 90 pika 2, të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, parashikohet se: “2. Kur një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai duhet: Në çdo rast, operatori ekonomik ofertues që dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, duhet të provojë se plotëson të paktën 50% të kërkesave të përcaktuara nga autoriteti ose enti kontraktor.” Në këtë rast, referuar kontributit në total në pjesëmarrje të operatorit ekonomik ankimues kryesues “Alko Impex General Construction” SHPK, i cili ka deklaruar operatorët ekonomikë “Alko Impex Construction” SHPK dhe “Arkonstudio” SHPK si subjekt mbi kapacitetet e të cilëve do të mbështetet, arrin të plotësojë dhe tejkalon të paktën 50% të kërkesave të autoritetit kontraktor në lidhje me fuqinë puntore të kërkuar nga autoriteti kontraktor për realizimin e kësaj kontrate. Në përfundim të analizës së fakteve përkatëse, Komisioni arrin në konkluzionin, se dokumentacioni i paraqitur nga operatori ekonomik ankimues “Alko Impex General Construction” SHPK, si operator kryesues në procedurën e prokurimit, i plotëson kërkesat e autoritetit kontraktor dhe konsiderohet i vlefshëm, pasi nga 79 punonjës (staf inxhinierik, mjek dhe staf teknik) në total, të kërkuar në dokumentet standarde të tenderit nga autoriteti kontraktor për realizimin e kontratës objekt - shqyrtimi, operatori ekonomik kryesues ankimues disponon 41 punonjës në total më shumë se 50% të stafit, sikurse përcaktohet dhe në nenin 90 pika 2 “Mbështetja në kapacitetet e subjekteve të tjera” të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Për sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimes “Alko Impex General Construction” SHPK qëndron.

III.6. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimes “Alko Impex General Construction” SHPK, mbi kundërshtimin e vendimit të komisionit të vlerësimit të ofertave në lidhje me skualifikimin e ofertës së tij me arsyen se: “OE Alko Impex General Construction SHPK sipas dokumentacionit të dorëzuar në SPE në lidhje me këto pike (në kriteret e veçanta për kualifikim 2.4 “Kërkesa të tjera të veçanta për kualifikim pika”, pika 2.4.2), ka këto mangësi si më poshtë: - Per pajisjet mjekesore mungon katalogu ose skedat teknike sipas kërkesave të DST 2.4.2 të dokumenteve standarde të tenderit; - Per materialin hidroizolues ka paraqitur Test raporte në gjuhën angleze (të paperkthyer dhe noterizuar); - Per materialet pajisje fikje zjarrit nuk ka paraqitur autorizim prodhuesi ose distributori me Boccione Antincendio S.p.a., disponon vetëm katalog në gjuhën Italiane (të paperkthyer dhe noterizuar); - Per materialet shtrese pvc antibakteriale ka paraqitur autorizim nga distributori Teknoedil, Katalogu në gjuhën angleze dhe certifikata në gjuhën angleze (të paperkthyer dhe noterizuar); - Nuk ka paraqitur autorizim prodhuesi ose distributori, Katalog ose Skedat teknike për Dyer të brendshme laminat me kase alumini e pajisur me aksesore "heavy duty", me një ose dy kanata sipas vizatimeve; - Per materialin gips ka paraqitur autorizim prodhuesi nga Dekoll Sh.a shoqëruar me katalog të weber saint gobain, Dekoll Sh.a nuk verteton se prodhon materjale gipsi, mungon katalogu ose skedat teknike si dhe certifikata/deklarata konformitetit CE; - Per materialin bojë autorizimi prodhuesit Colorificio Sammarinese s.p.a është në gjuhën Italiane, Skeda teknike në gjuhën italyane dhe certifikat në gjuhën italyane (të paperkthyer dhe noterizuara); - Pajisjet e sistemit HVAC, ka paraqitur kontrat furnizimi nga Haki Sianani, mungon autorizim prodhuesit, mungojnë kataloget për (Pompe Nxehtesie, Njesi Trajtimi Ajri Dergim, Njesi Trajtimi Ajri Rikthim, Njesi Trajtimi Ajri Rikuperator Nxetesie, Fan Coil Dyshemje, Mono Split Mural, Radiator çeliku) si dhe certifikata/deklarata konformitetit CE; - Pajisjet e sistemit HVAC, ka paraqitur Kaldaje nga prodhuesi Centrometac d.o.o në gjuhën angleze, katalog /Skedat teknike në gjuhën angleze (të paperkthyer dhe noterizuara); - Nuk ka paraqitur autorizim prodhuesi ose distributori për Pompe karburanti; - Nuk ka paraqitur autorizim prodhuesi ose distributori për Rezervuari të lëndës djegëse”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.6.1. Në shtojcën 7/2, të modifikuar tek “Kriteret e veçanta të kualifikimit”, pika 2.4.2 autoriteti kontraktor ka përcaktuar:

ISHTE:

2.4.2 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë autorizim prodhuesi ose distributori. Në rast paraqitje autorizim distributori duhet të paraqitet kontrata ose dokumenti i angazhimit midis prodhuesit dhe distributorit, për materialet (pajisjet mjekesore, pajisjet elektrike, hidroizolues, pajisjet mekanike, pajisjet, hidro-sanitare, shtrese pvc antibakteriale, dyer/dritare, gipse, bojrat, pajisjet e zjarrit, pajisjet e sistemit HVAC, ashensori,). Per materialet e kerkuara OE duhet te paraqese katalogun/et ose skedat teknike të prodhuesit/ve, ku të specifikohen

materialet që do të ofrohen si dhe te paraqiten çertifikatë/deklaratë konfirmimit CE ose ekuivalente, me qëllim përmbushjen e standarteve të kërkuara ne Specifikimet teknike. Operatori ekonomik duhet të paraqesë ofertën teknike, në formën e një tabele sipas modelit të mëposhtëm, e cila duhet të plotësohet në mënyrë rigoroze. Oferta teknike duhet të përmbajë të dhënat si më poshtë;

Nr.	Emri i kompanisë prodhuese	Emërtimi i katalogut të prodhuesit	Nr.i faqes	Nr. rep &Nr.kol (njehesim origjinali-Vertetim perkthimi)
1.				

Të dhënat e deklaruara në ofertën teknike duhet të korespondojnë me të dhënat për artikujt në katalogët/skedat teknike të dorëzuara ne SPE. Moskorespondimi i këtyre të dhënave do të sjellë pavlefshmëri të ofertës.

BEHET:

2.4.2 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë autorizim prodhuesi ose distributori. Në rast paraqitje autorizim distributori duhet të paraqitet kontrata ose dokumenti i angazhimit midis prodhuesit dhe distributorit, për materialet (paisjet mjekesore, hidroizolues, paisjet mekanike, paisjet hidrosanitare, shtrese pvc antibakteriale, dyer/dritare, gipse, bojrat, paisjet e zjarri, paisjet e sistemin HVAC, ashensori) per objektet shendetesore. Per materialet e kerkuara OE duhet te paraqese katalogun/et ose skedat teknike të prodhuesit/ve, ku të specifikohen materialet që do të ofrohen si dhe te paraqiten çertifikatë/deklaratë konfirmimit CE ose ekuivalente, me qëllim përmbushjen e standarteve të kërkuara ne Specifikimet teknike. Operatori ekonomik duhet të paraqesë ofertën teknike, në formën e një tabele sipas modelit të mëposhtëm, e cila duhet të plotësohet në mënyrë rigoroze. Oferta teknike duhet të përmbajë të dhënat si më poshtë;

Nr.	Emri i kompanisë prodhuese	Emërtimi i katalogut të prodhuesit	Nr.i faqes	Nr. rep &Nr.kol (njehesim origjinali-Vertetim perkthimi)
1.				

Të dhënat e deklaruara në ofertën teknike duhet të korespondojnë me të dhënat për artikujt në katalogët/skedat teknike të dorëzuara ne SPE. Moskorespondimi i këtyre të dhënave do të sjellë pavlefshmëri të ofertës.

III.6.2. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar në Sistemin e Prokurimit Elektronik nga operatori ekonomik “Alko Impex General Construction” SHPK, për përmbushjen të kriterit të mësipërm, rezulton, se ky i fundit ka paraqitur dokumentacion si më poshtë vijon:

- Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit “Alko Impex General Construction” SHPK. Në Pjesën III: “Kriteret e Përzgjedhjes/Kualifikimit”, gërma “C”: “DEKLARATË “Për disponimin e mjeteve/pajisjeve/makinerive të nevojshme për realizimin e punimeve objekt - kontrate”, operatori ekonomik “Alko Impex General Construction” SHPK deklaroi:

Kontratë furnizimi			
Materiali/prod ukti për të cilin paraqitet kontrata e furnizimit	Nr. Kont së furnizimit (noterisë)	Afati i kontratës furnizimit (data e fillimit dhe mbarimit)	Të tjera

Nr.	Emri i kompanisë prodhuese	Emertim i katalogut të prodhuesit	Nr. Rep &Nr. Kol(njehesim me origjinalin - Vertetim perkthimi)
Paisjet mjekesore			Vertetim njesim me origjinalin Nr. Rep 20015 Vertetim njesim me perkthimin Nr, Rep 20014
Paisjet hidroizoluese			Vertetim njesim me origjinalin Nr. Rep 20015 Vertetim njesim me perkthimin Nr, Rep 20014
Paisjet mekanike			Vertetim njesim me origjinalin Nr. Rep 20015 Vertetim njesim me perkthimin Nr, Rep 20014
Paisjet Hidrosanitare			Vertetim njesim me origjinalin Nr. Rep 20015 Vertetim njesim me perkthimin Nr, Rep 20014
Shtresa pvc antibakteriale			Vertetim njesim me origjinalin Nr. Rep 20015 Vertetim njesim me perkthimin Nr, Rep 20014

Dyer/ dritare			Vertetim njesim me origjinalin Nr. Rep 20015 Vertetim njesim me perkthimin Nr, Rep 20014
Gipse			Vertetim njesim me origjinalin Nr. Rep 20015 Vertetim njesim me perkthimin Nr, Rep 20014
Bojra			Vertetim njesim me origjinalin Nr. Rep 20015 Vertetim njesim me perkthimin Nr, Rep 20014
Paisjet e zjarrit			Vertetim njesim me origjinalin Nr. Rep 20015 Vertetim njesim me perkthimin Nr, Rep 20014
Paisjet e sistemit HVAC			Vertetim njesim me origjinalin Nr. Rep 20015 Vertetim njesim me perkthimin Nr, Rep 20014
Ashensori			Vertetim njesim me origjinalin Nr. Rep 20015 Vertetim njesim me perkthimin Nr, Rep 20014

- Autorizim pdf. 69.8 KB
- Katalog pajisjet HVAC pjesa 3 pdf 19.26 MB
- Dyer – Dritare pdf 4.17 MB
- Autorizim + dokumentacion bojra pdf 562.2 KB
- Ashensori pdf 5.33 MB
- Hidroizolues pdf 17.64 MB
- Përkthimet pdf 23.89 MB
- Katalog Profilesh everest 2015 (1) pdf 20.44 MB
- Autorizim pajisje zjarri pdf 450 KB
- Gipse compressed pdf 20.3 MB
- Pajisjet Mjeksore pdf 3.21 MB
- Shtrese pvc antibakteriale pdf 8.2 MB
- Pajisjet HVAC pjesa 1 pdf 17 MB

III.6.3. Në nenin 2 “Qëllimi i ligjit” 162/2021 “Për prokurimin publik” parashikohet se: *Qëllim i këtij ligji është: a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik; b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale; c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik; ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë; d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik; dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.*

III.6.4. Në nenin 3 “Parime të përgjithshme”: *“1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale. 2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar. 3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.*

III.6.5. Në nenin 77 të ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: *1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:*

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;*
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;*
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.*

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

2. Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionalë ose tregtarë.

Në procedurat e prokurimit për shërbime, ku është e nevojshme që operatorët ekonomikë të kenë një autorizim të veçantë ose të jenë anëtarë të një organizate të veçantë për të kryer shërbimin në fjalë në shtetin e tyre të origjinës, autoriteti ose enti kontraktor mund t'u kërkojë atyre të vërtetojnë se e kanë këtë autorizim ose anëtarësim.

3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën.

Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Xhironja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës.

Kur një kontratë ndahet në lote, ky nen zbatohet për çdo lot individual. Megjithatë, autoriteti ose enti kontraktor mund të përcaktojë xhiron vjetore minimale që u kërkohet operatorëve, duke iu referuar grupeve të loteve, në rast se ofertuesi i suksesshëm merr disa lote që duhet të zbatohen në të njëjtën kohë.

Në rastin e kontratave që bazohen në një marrëveshje kuadër, kërkesa për xhiron minimale llogaritet mbi bazën e përmasave maksimale të kontratave specifike që do të zbatohen në të njëjtën kohë ose, kur përmasat nuk dihen, mbi bazën e vlerës së parashikuar të marrëveshjes kuadër.

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.

Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoje që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.

Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.

5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.

Ndërsa në nenin 79, po këtu thuhet se:

1. Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t'u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Kjo dispozitë zbatohet edhe kur kërkesat teknike u referohen kualifikimeve të kandidatit ose të ofertuesit.

2. Autoriteti ose enti kontraktor mund t'u kërkojë ofertuesve dorëzimin e certifikatave ose dokumenteve të ngjashme, të lëshuara nga organe të pavarura, që vërtetojnë pajtueshmërinë e tyre me standardet e kërkuara të cilësisë, veçanërisht sa i takon:

- a) garantimit të aksesit të personave me aftësi të kufizuara;*
- b) efikasitetit të energjisë;*
- c) sistemeve të menaxhimit mjedisor.*

3. Në rastet kur operatori ekonomik provon se nuk mund të pajiset me një certifikatë të tillë brenda një kohe të arsyeshme për arsye që nuk varen prej tij, autoriteti ose enti kontraktor mund të pranojë dokumente të tjera, nëpërmjet të cilave mund të provohet garantimi i standardeve të kërkuara.

4. Në çdo rast, certifikatat e kërkuara duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës, duke respektuar edhe parimin e mosdiskriminimit.

III.6.6. Në nenin 92 të ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

1. Autoriteti ose enti kontraktor, kur e shikon të arsyeshme, u kërkon ofertuesve sqarime për ofertat e tyre, për shqyrtimin, vlerësimin dhe krahasimin sa më të drejtë të këtyre ofertave. Pa cenuar dispozitat e parashikuara në këtë ligj, nuk duhet të kërkohet, të ofrohet ose të lejohet asnjë ndryshim në përmbajtjen e ofertës, përfshirë ndryshimet në vlerë apo ndryshime që synojnë të kthejnë një ofertë të pavlefshme në të vlefshme.

2. Autoriteti ose enti kontraktor, pavarësisht nga përcaktimi i pikës 1 të këtij neni, duhet të korrigjojë vetëm gabimet aritmetike, që zbulohen gjatë shqyrtimit të ofertave. Autoriteti ose enti kontraktor njofton menjëherë për këto korrigjime ofertuesin që ka paraqitur ofertën. Kur ofertuesi nuk pranon korrigjimin e një gabimi aritmetik, oferta e tij do të skualifikohet.

3. Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji.

Oferta konsiderohet e vlefshme edhe nëse ajo përmban devijime të vogla, të cilat nuk ndryshojnë thelbësisht karakteristikat, kushtet dhe kërkesat e tjera, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, gabime shtypi, të cilat mund të korrigjohen pa prekur përmbajtjen e saj, si edhe ato të lidhura me informacionet që merren lehtësisht nga dokumente faktike, që tregojnë gjendjen e operatorit ekonomik në kohën e ofertimit.

III.6.7. Në nenin 40, pika 6 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

6. Autoriteti/enti kontraktor mund t’u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si:

a) mostra të mallit, kur e gjykon se kjo ka rëndësi për vlerësimin e ofertës teknike. Në këtë rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të argumentojë kërkesën për mostrat. Mostrat duhet të trajtohen si informacion konfidencial tregtar dhe duhet të jenë në kontroll të autoritetit/entit kontraktor. Në rastin e procedurave të zhvilluara me mjete elektronike, autoriteti ose enti kontraktor përcakton qartë procedurën për dorëzimin e mostrave, duke garantuar aksesin e çdo operatori të interesuar si dhe konfidencialitetin për pjesëmarrjen në proces. Mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve pas nënshkrimit të kontratës, me kusht që kontrata në fjalë të mos jetë objekt i shqyrtimit administrativ apo gjyqësor. Në rastin kur procedura e prokurimit anulohet, mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e marrjes së vendimit përfundimtar të anulimit; dhe/ose

b) fotografitë apo katalogët teknikë; dhe/ose

c) dëshmi për rezultatet e testeve zyrtare, të lëshuara nga institucione të autorizuar, që vërtetojnë pajtueshmërinë e produkteve me specifikimet teknike.

III.6.8. Në nenin 44 “Kërkesat e cilësisë” të VKM nr. 285 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik”, e ndryshuar parashikohet se: “1. Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të

konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit”.

III.6.9. Në nenin 36 “Specifikimet teknike” të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik” parashikohet shprehimisht se:

“1. Specifikimet teknike, siç përcaktohen në nenin 4 të këtij ligji, duhet të përshkruhen në dokumentet e tenderit. Në specifikimet teknike përcaktohen qartë karakteristikat e punëve, shërbimit ose furnizimit që do të prokurohet.

Këto karakteristika mund të lidhen edhe me procesin specifik ose metodën e prodhimit ose ofrimit të punëve, furnizimeve ose shërbimeve të kërkuara ose me një proces specifik për një fazë tjetër të ciklit jetësor edhe kur këta faktorë nuk përbëjnë përmbajtjen e saj thelbësore nëse ato janë të lidhura me objektin e kontratës dhe proporcionale me vlerën dhe objektivat e saj. Në specifikimet teknike mund të specifikohet edhe nëse do të jetë i nevojshëm transferimi i të drejtave të pronësisë intelektuale.

Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve të justifikuara plotësisht, hartohen në mënyrë të tillë që të marrin në konsideratë kriteret e aksesueshmërisë për personat me aftësi të kufizuar ose projektimit për të gjithë përdoruesit, sipas kërkesave në legjislacionin në fuqi.

2. Specifikimet teknike duhet të mundësojnë trajtim të barabartë për të gjithë kandidatët dhe ofertuesit dhe të mos shërbejnë si pengesa për konkurrencën e hapur në prokurimin publik.

3. Specifikimet teknike duhet të përshkruajnë qartë kërkesat e autoritetit ose entit kontraktor, duke iu referuar:

a) kërkesave funksionale ose të performancës, përfshirë karakteristikat mjedisore, me kusht që parametrat të jenë të saktë në mënyrë që t’u japin mundësi ofertuesve të përcaktojnë objektin e kontratës dhe autoriteteve ose enteve kontraktore të japin kontratën;

b) standardeve kombëtare, që mbështeten në ato ndërkombëtare, miratimeve teknike ndërkombëtare, specifikimeve teknike të përgjithshme, standardeve ndërkombëtare apo sistemeve të tjera teknike të referimit, të përcaktuara nga organet ndërkombëtare të standardizimit. Kur këto nuk ekzistojnë, ato u referohen standardeve kombëtare, miratimeve teknike kombëtare ose specifikimeve teknike kombëtare, që lidhen me projektimin, përlllogaritjen dhe ekzekutimin e punëve ose përdorimin e produkteve;

c) kërkesave në terma funksionalë sipas shkronjës “a”, referuar specifikimeve teknike sipas shkronjës “b” të kësaj pike, si mënyrë që nënkupton pajtueshmëri me kërkesat funksionale;

ç) të dyja metodave të përcaktuara në shkronjat “a” dhe “b” të pikës 3 të këtij neni, për mallra, shërbime ose punë të ndryshme, të përfshira në të njëjtin objekt kontrate. Çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.

4. Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të këtij neni. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

5. Në rast se autoriteti ose enti kontraktor përcakton specifikimet teknike në bazë të shkronjës “b” të pikës 3 të këtij neni, nuk mund të refuzojë një ofertë me argumentin se punët, furnizimet apo shërbimet për të cilat është dorëzuar oferta nuk plotësojnë specifikimet teknike, të cilave u referohen, për sa kohë që ofertuesi provon në ofertën e tij me çdo mjet të përshtatshëm që zgjidhjet e propozuara përmbushin kërkesat e përcaktuara në specifikimet teknike në mënyrë ekuivalente.

6. Në rast se autoriteti ose enti kontraktor përcakton specifikimet teknike në bazë të shkronjës “a” të pikës 3 të këtij neni, ai nuk mund të refuzojë një ofertë për punë, mallra apo shërbime, e cila është në përputhje me standardet kombëtare, që mbështeten në ato ndërkombëtare, miratimet teknike ndërkombëtare, specifikimet teknike të përgjithshme, standardet ndërkombëtare apo sistemet e tjera teknike të referimit, të përcaktuara nga organet ndërkombëtare të standardizimit kur këto specifikime teknike përmbushin kriteret funksionale, të përcaktuara nga autoriteti/enti kontraktor”

III.6.10. KPP gjykon, se kriteret për kualifikim vendosen që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente, duhet të refuzohen si të papranueshme. Autoriteti kontraktor, duke qenë se është përfituesi direkt i kontratës objekt-prokurimi, është në të drejtën e tij të garantohet se operatorët ekonomikë pjesëmarrës i plotësojnë kërkesat e cilësisë për produktet që do të ofrojnë, e rrjedhimisht është e drejtë e këtij të fundit t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikatat e cilësisë. Gjithashtu, një ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurës së prokurimit është ai barazisë në trajtimin e kërkesave dhe të detyrimeve, që u ngarkohen ofertuesve ose kandidatëve, parashikuar nga neni 3 i ligjit nr. Nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”. Zbatimi i parimit të transparencës, barazisë dhe mosdiskriminimit, janë garancitë kyçe ndaj ofertuesve që ofron kuadri ligjor në fuqi. Këto parime ndër të tjera nënkuptojnë, se operatorët ekonomikë duhet të jenë në një pozicion barazie, si kur përgatisin ofertat e tyre, ashtu dhe kur të vlerësohen ato. Operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit, me dokumentacionin e dorëzuar, duhet të vërtetojnë, që produkti i ofruar është në përputhje me parametrat dhe specifikimet teknike e kërkuara nga autoriteti kontraktor. Operatorët ekonomikë ofertues marrin përsipër përmbushjen e specifikimeve teknike/ kriterëve të përcaktuara në dokumentet e tenderit nga ana e autoriteteve kontraktore, nëpërmjet deklaratave dhe dokumentacionit provues në të cilin duhet të faktojnë përputhshmërinë e dokumentacionit me kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor, në mënyrë që nga ana e këtij të fundit të mund të kryhet me lehtësi e saktësi vlerësimi i mallrave apo shërbimeve të ofertuara nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës, duke përzgjedhur atë ofertues, i cili me dokumentacionin e dorëzuar garanton përputhshmërinë me kriteret e përcaktuara në DT, e rrjedhimisht realizimin me sukses të kontratës objekt - prokurimi.

III.6.11. Në rastin konkret, referuar dokumentacionit të ngarkuar në sistemin e prokurimit elektronik nga operatori ekonomik ankimues, me qëllim përmbushjen e kriterit lidhur me paraqitjen e katalogëve ose skedat teknike të prodhuesit/ve, ku të specifikohen materialet që do të ofrohen për sa i përket paisjeve mjekësore sipas kërkesave të autoritetit kontraktor në pikën 2.4.2 të kriterëve të veçanta të kualifikimit të dokumenteve standarde të tenderit, Komisioni i Prokurimit Publik konstaton, se ky i fundit ka paraqitur dokumentacionin e përcaktuar në pikën III.6.2 të këtij vendimi. Nisur nga arsyeja e skualifikimit të operatorit ekonomik ankimues, si dhe nga verifikimi i dokumentacionit të dorëzuar prej tij në sistemin e prokurimeve elektronike për përmbushjen e këtij kriteri, KPP konstaton, se me dokumentacionin e paraqitur, operatori ekonomik anikumes “Alko Impex General Construction” SHPK nuk ka përmbushur plotësisht kriterin e mësipërm. Konkretisht, KPP vëren, se nga dokumentacioni i ngarkuar në sistem, nga operatori ekonomik ankimues si autorizim prodhuesi, autorizim distributori, dhe Certifikatë regjistrimi me nr. 3603/2 prot, datë 21.06.2022, lëshuar nga Agjencia Kombëtare e Barnave dhe e Pajisjeve Mjekësore, bashkëlidhur lista e artikujve të aplikimit për regjistrim certifikate nr. 12180, lëshuar në emër të shoqërisë “GTS- Gazra Teknik Shqiptarë” SHPK nuk mund të konsiderohet si skedë teknike apo katalog për pajisjet mjekësore pasi nuk pasqyron të dhëna të specifikimeve teknike për pajisjet e ofruara. KPP gjykon, se mungesa fizike e dokumentacionit të kërkuar shprehimisht në kriterin e kualifikimit, përbën shkak për skualifikim në kuptim të nenit 82 të Vendimit Nr. 285 datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, në të cilën përcaktohet se Komisioni i Vlerësimit të Ofertave verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta, që përmbushin kërkesat për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe janë të përgjegjshme/vlefshme. Është detyrim ligjor i subjektit ofertues të provojë me dokumentacion të plotë dhe në përputhje me kërkesat e autoritetit kontraktor plotësimin e kriterëve të kërkuara në dokumentet e tenderit, pasi ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Akoma më tej KPP sqaron, se në një procedurë prokurimi, subjekti i parë i interesuar është operatori ekonomik, i cili e përgatit ofertën e tij në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi dhe nga ana tjetër, është autoriteti kontraktor, i cili përzgjedh operatorin ekonomik që plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit. Sa më sipër operatori ekonomik ankimues nuk ka përmbushur kriterin e përcaktuar në pikën 2.4.2 të kriterëve të veçanta të kualifikimit në lidhje me paraqitjen e katalogëve/skedave teknike për pajisjet mjekësore.

III.6.12. Referuar arsyes së skualifikimit të operatorit ekonomik ankimues, se ky i fundit për materialin hidroizolues ka paraqitur Test - raporte në gjuhën angleze (të papërkthyer dhe noterizuar), Komisioni gjykon, që t’i referohet përmbajtjes së kriterit për të cilën ky operator është skualifikuar. Në kriterin e përcaktuar nga autoriteti kontraktor në pikën 2.4.2 të kriterëve të veçanta të kualifikimit, është kërkuar që për materialet e kërkuara, OE duhet të paraqesë katalogun/ët ose skedat teknike të prodhuesit/ve, ku të specifikohen materialet që do të ofrohen si dhe të paraqiten certifikatë/deklaratë konfirmimit CE ose ekuivalente, me qëllim përmbushjen e standardeve të kërkuara në specifikimet teknike. Referuar kërkesës së autoritetit kontraktor, KPP gjykon, se operatorët ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi

duhet të plotësojnë vetëm kërkesat e vendosura në dokumentet e tenderit, e rrjedhimisht, vlerësimi e kualifikimi i tyre duhet të bëhet në përputhje vetëm me këto kërkesa. Komisioni i Prokurimit Publik konstaton, se operatori ekonomik ankimues, për të vërtetuar përmbushjen e këtij kriteri për materialin hidroizolues, ka dorëzuar në sistemin e prokurimeve elektronike dokumentacion e përcaktuar në pikën III.6.2 për përmbushjen e këtij kriteri. Ndërkohë nga shqyrtimi i dokumenteve të tenderit sikurse përmendëm edhe më sipër, nga ana e autoritetit kontraktor nuk është kërkuar që të paraqitet ndonjë test raport për materialet e kërkuara. Autoriteti kontraktor ka kërkuar nga OE të paraqesin katalogun/ët ose skedat teknike të prodhuesit/ve, ku të specifikohen materialet që do të ofrohen si dhe të paraqiten certifikatë/deklaratë konfirmimit CE ose ekuivalente. Pra, nga ana e autoritetit kontraktor në kriteret e veçanta të kualifikimit nuk është kërkuar në asnjë rast që ofertuesit të paraqesin test raporte, kërkesë e cila do të përbënte detyrim për t'u përmbushur nga ofertuesit. Në mënyrë eksplicite, ligji për prokurimin publik parashikon, se vlerësimi i ofertave duhet bërë vetëm në përputhje me kriteret e kualifikimit të parashikuara në dokumentet e procedurës përkatëse. Vlerësimi i ofertave referuar kriterëve të tjera të kualifikimit, të cilat në asnjë rast nuk janë parashikuar në dokumentet e procedurës së prokurimit, jo vetëm që është në kundërshtim me legjislacionin e prokurimit publik, por cenon gjithashtu parimet kryesore të zhvillimit të procedurës së prokurimit, parashikuar nga neni 3 i *lex specialis*, atë të barazisë në trajtimin e kërkesave dhe detyrimeve që i ngarkohen ofertuesve.

III.6.13. Lidhur me arsyen e skualifikimit të operatorit ekonomik ankimues, se ky i fundit nuk ka paraqitur “për materialet pajisje fikje zjarri, autorizim prodhuesi ose distributori me Boccione Antincendio S.p.a., disponon vetëm katalog në gjuhën Italiane (të papërkthyer dhe noterizuar)”. Nga shqyrtimi i dokumenteve të tenderit, vërejmë se autoriteti kontraktor në kriteret e veçanta të kualifikimit pika 2.4.2 ka kërkuar shprehimisht që “*Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë autorizim prodhuesi ose distributori. Në rast paraqitje autorizim distributori duhet të paraqitet kontrata ose dokumenti i angazhimit midis prodhuesit dhe distributorit, për materialet (pajisjet mjekesore, hidroizolues, pajisjet mekanike, pajisjet hidrosanitare, shtrese pvc antibakteriale, dyer/dritare, gipse, bojrat, pajisjet e zjarri, pajisjet e sistemit HVAC, ashensori) per objektet shendetesore. Per materialet e kerkuara OE duhet te paraqese katalogun/et ose skedat teknike të prodhuesit/ve, ku të specifikohen materialet që do të ofrohen si dhe te paraqiten certifikatë/deklaratë konfirmimit CE ose ekuivalente*”. Nga verifikimi i dokumentacionit të dorëzuar në sistemin e prokurimit elektronik, nga operatori ekonomik ankimues, konstatohet, se ky i fundit ka paraqitur dokumentin Autorizim Distributori nga shoqëria “Haki Sinani” ndër të tjera edhe për pajisjet e sistemit HVAC, dhe dokumentin pajisjet HVAC pjesa 3 pdf 19.26 MB, në të cilin konstatohet katalogu nga Boccione Antincendio, i cili fillon me faqen 15 dhe përfundon me faqen 170 në gjuhën italiane, i papërkthyer dhe noterizuar. KPP vëren, se operatori ekonomik ankimues për përmbushjen e këtij kriteri kualifikues të sipërpërmendur dhe për pajisjen e ofruar të prodhuesit, ka dorëzuar autorizim distributori të lëshuar nga shoqëria “Haki Sinani” SHPK, por në asnjë rast nuk vërtetohet, se është prodhues i pajisjes së zjarrit, ndërkohë që prodhues sipas katalogut të dorëzuar, rezulton shoqëria Boccione Antincendio, ndërkohë që kriteri kualifikues ka përcaktuar qartë se *operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë autorizim prodhuesi ose distributori. Në rast paraqitje autorizimi distributori duhet të paraqitet kontrata ose dokumenti*

i angazhimit midis prodhuesit dhe distributorit. Nisur nga sa parashtruam më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se operatori ekonomik ankimues nuk plotëson kriterin kualifikues të përcaktuar në pikën 2.4.2 të duke dështuar që të dorëzojë autorizim prodhuesi apo lidhjen midis prodhuesit dhe distributorit të autorizuar. Gjithashtu, nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur nga operatori ekonomik ankimues në Sistemin e Prokurimeve Elektronike, KPP-ja konstaton, se në përmbushje të kriterëve të vendosura nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit, operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ndër të tjera dokumentin pajisjet HVAC pjesa 3 pdf 19.26 MB, në të cilën konstatohet katalogu nga Boccione Antincendio, i cili fillon me faqen 15 dhe përfundon me faqen 170, të cilat rezultojnë të jenë, në gjuhë të huaj dhe të pashoqëruara me përkthim të noterizuar, në kundërshtim me përcaktimet e autoritetit kontraktor në dokumentet e tenderit. Në pikën 4.5 të seksionit IV të dokumenteve të tenderit, “Procedura”, si dhe në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, është përcaktuar qartë, që gjuha e përdorur është gjuha shqipe dhe rrjedhimisht çdo dokument i paraqitur në gjuhë të huaj duhet të jetë i përkthyer dhe noterizuar në gjuhën shqipe. Sqarojmë, se përkufizimi ligjor i mësipërm është gjithëpërfshirës, pra për të gjithë dokumentacionin përkatës, që paraqitet në këtë procedurë prokurimi. Në kushtet kur, në dokumentet e tenderit të hartuara e të miratuara nga Agjencia e Prokurimit Publik, e konkretisht në kriteret e përgjithshme të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë, si dhe nuk duhet të ndryshohen për asnjë arsye nga autoriteti kontraktor gjatë hartimit të dokumenteve të tenderit, është përcaktuar qartësisht se “Nëse gjuha e përdorur në procedurë është gjuha shqipe, atëherë dokumentet në gjuhë të huaj duhet të shoqërohen me një përkthim të noterizuar në gjuhën shqipe” në këtë kuadër, i gjithë dokumentacioni i paraqitur në procedurën e prokurimit në sistem elektronik duhet të jetë në gjuhën shqipe ose i shoqëruar me përkthim të noterizuar në gjuhën shqipe. Gjithashtu, duke u referuar në DST e procedurës objekt-ankimi, konkretisht në kreun “Udhëzime për operatorët ekonomikë” Seksioni 1, “B Përgatitja e ofertave” pika 2 ‘Gjuha e ofertës’ ku përcaktohet se: *Oferta, si dhe të gjitha korrespondencat dhe dokumentet në lidhje me procedurën e prokurimit do të paraqiten në gjuhën/gjuhët e specifikuar në njoftimin e kontratës. Dokumentet mbështetëse dhe literatura e printuar që janë pjesë e Ofertës mund të jenë në një gjuhë tjetër me kusht që ato të shoqërohen nga një përkthim zyrtar i fragmenteve përkatëse në gjuhën e specifikuar në njoftim*”, duhet që të gjithë dokumentet e paraqitura në rrugë elektronike të jenë në gjuhën shqipe siç autoriteti kontraktor ka përcaktuar në njoftimin e kontratës ose nëse janë në gjuhë të huaj duhet të shoqërohen me një përkthim të noterizuar në gjuhën shqipe. Në rastin konkret në sistemin e prokurimit elektronik, operatori ekonomik ankimues ka paraqitur, në gjuhë të huaj, katalogon e sipërcituar dhe të pashoqëruar me përkthim të noterizuar në gjuhën shqipe në kundërshtim me atë që autoriteti kontraktor ka përcaktuar në përmbajtjen e dokumenteve të tenderit. Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin oferta, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit, pasi ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente do të refuzohen si të papranueshme. Akoma më tej, Komisioni gjykon, se nuk jemi përballë devijimeve të vogla në ofertë sikundër operatori ekonomik ankimues pretendon, sepse modifikime të tilla do të ndryshonin përmbajtjen e ofertës, duke synuar të kthejnë një ofertë nga e pavlefshme në të vlefshme, në kundërshtim kjo me nenin 92 pika 1 të *lex specialis*. Në këtë kuadër, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se nga ana e ankimuesit nuk janë përmbushur të gjitha kërkesat që autoriteti kontraktor ka përcaktuar në

dokumentet e tenderit, duke dorëzuar dokumente në gjuhë të huaj të pashoqëruara me përkthim të noterizuar, një kusht ky i detyrueshëm për ankimuesin, pasi ai duhet të plotësojë çdo kërkesë dhe kriter të vendosur nga autoriteti kontraktor, si dhe të paraqesë çdo dokumentacion, që përmban të dhëna dhe elemente që janë gjykuar të nevojshme dhe të domosdoshme nga ana e këtij të fundit.

III.6.14. Lidhur me arsyen e skualifikimit të operatorit ekonomik ankimues se “për materialet shtrese pvc antibakteriale ka paraqitur autorizim nga distributori Teknoedil, Katalogun në gjuhën angleze dhe certifikata në gjuhën angleze (të papërkthyer dhe noterizuara)”, nga shqyrtimi i dokumenteve të tenderit, vërejmë se autoriteti kontraktor në kriteret e veçanta të kualifikimit pika 2.4.2 ka kërkuar shprehimisht që *“Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë autorizim prodhuesi ose distributori. Në rast paraqitje autorizim distributori duhet të paraqitet kontrata ose dokumenti i angazhimit midis prodhuesit dhe distributorit, për materialet (pajisjet mjekesore, hidroizolues, pajisjet mekanike, pajisjet hidrosanitare, shtrese pvc antibakteriale, dyer/dritare, gipse, bojrat, pajisjet e zjarri, pajisjet e sistemin HVAC, ashensori) për objektet shendetesore. Per materialet e kerkuara OE duhet te paraqese katalogun/et ose skedat teknike të prodhuesit/ve, ku të specifikohen materialet që do të ofrohen si dhe te paraqiten certifikatë/deklaratë konfirmimit CE ose ekuivalente”*. Nga verifikimi i dokumentacionit të dorëzuar në sistemin e prokurimit elektronik, nga operatori ekonomik ankimues, konstatohet se ky i fundit ka paraqitur dokumentin autorizim distributori “Teknoedil” SHPK, autorizim prodhuesi nga “Gerflor SAS”, certifikatë/vërtetim dhe katalog nga Gerflor për shtresat antibakteriale. Nga verifikimi i dokumentacionit të sipërcituar konstatohet, se katalogu nga Gerflor dhe certifikata/vërtetimi janë në gjuhën angleze të papërkthyer dhe noterizuara, në kundërshtim me përcaktimet e autoritetit kontraktor në dokumentet e tenderit. Në pikën 4.7 të seksionit IV të dokumenteve të tenderit, “Gjuha”, si dhe në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, është përcaktuar qartë që gjuha e përdorur është gjuha shqipe dhe rrjedhimisht çdo dokument i paraqitur në gjuhë të huaj duhet të jetë i përkthyer dhe noterizuar në gjuhën shqipe, për sa kohë që procedura e prokurimit është nën kufirin e lartë monetar. Sqarojmë, se përkufizimi ligjor i mësipërm është gjithpërfshirës, pra për të gjithë dokumentacionin përkatës, që paraqitet në këtë procedurë prokurimi. Në kushtet kur, në dokumentet e tenderit të hartuara e të miratuara nga Agjencia e Prokurimit Publik, e konkretisht në kriteret e përgjithshme të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë, si dhe nuk duhet të ndryshohen për asnjë arsye nga autoriteti kontraktor gjatë hartimit të dokumenteve të tenderit, është përcaktuar qartësisht se *“Nëse gjuha e përdorur në procedurë është gjuha shqipe, atëherë dokumentet në gjuhë të huaj duhet të shoqërohen me një përkthim të noterizuar në gjuhën shqipe”* në këtë kuadër i gjithë dokumentacioni i paraqitur në procedurën e prokurimit në sistem elektronik duhet të jetë në gjuhën shqipe ose i shoqëruar me përkthim të noterizuar në gjuhën shqipe. Gjithashtu, duke u referuar në DST e procedurës objekt-ankimi, konkretisht në kreun *“Udhëzime për operatorët ekonomikë”* Seksioni 1, *“B Përgatitja e ofertave”* pika 2 *‘Gjuha e ofertës’* ku përcaktohet se: *Oferta, si dhe të gjitha korrespondencat dhe dokumentet në lidhje me procedurën e prokurimit do të paraqiten në gjuhën/gjuhët e specifikuar në njoftimin e kontratës. Dokumentet mbështetëse dhe literatura e printuar që janë pjesë e Ofertës mund të jenë në një gjuhë tjetër me kusht që ato të shoqërohen*

nga një përkthim zyrtar i fragmenteve përkatëse në gjuhën e specifikuar në njoftim”, duhet që të gjithë dokumentet e paraqitura në rrugë elektronike të jenë në gjuhën shqipe siç autoriteti kontraktor ka përcaktuar në njoftimin e kontratës ose nëse janë në gjuhë të huaj duhet të shoqërohen me një përkthim të noterizuar në gjuhën shqipe. Në rastin konkret, në sistemin e prokurimit elektronik operatori ekonomik ankimues ka paraqitur në gjuhë të huaj, katalogon e sipërcituar dhe të pashoqëruar me përkthim të noterizuar në gjuhën shqipe në kundërshtim me atë që autoriteti kontraktor ka përcaktuar në përmbajtjen e dokumenteve të tenderit. Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin oferta, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit, pasi ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente do të refuzohen si të papranueshme. Akoma më tej, Komisioni gjykon, se nuk jemi përballë devijimeve të vogla në ofertë, sepse modifikime të tilla do të ndryshonin përmbajtjen e ofertës, duke synuar të kthejnë një ofertë nga e pavlefshme në të vlefshme, në kundërshtim kjo me nenin 92 pika 1 të *lex specialis*. Në këtë kuadër, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se nga ana e ankimuesit nuk janë përmbushur të gjitha kërkesat që autoriteti kontraktor ka përcaktuar në dokumentet e tenderit, duke dorëzuar dokumente në gjuhë të huaj të pashoqëruara me përkthim të noterizuar, një kusht ky i detyrueshëm për ankimuesin, pasi ai duhet të plotësojë çdo kërkesë dhe kriter të vendosur nga autoriteti kontraktor, si dhe të paraqesë çdo dokumentacion, që përmban të dhëna dhe elemente që janë gjykuar të nevojshme dhe të domosdoshme nga ana e këtij të fundit.

III.6.15. Lidhur me arsyen e skualifikimit të operatorit ekonomik ankimues se “për materialin bojë, autorizimi i prodhuesit Colorificio Sammarinese s.p.a është në gjuhën Italiane, Skeda teknike në gjuhën italiane dhe certifikata në gjuhën italiane (të papërkthyer dhe noterizuara).”, nga shqyrtimi i dokumenteve të tenderit, vërejmë se autoriteti kontraktor në kriteret e veçanta të kualifikimit pika 2.4.2 ka kërkuar shprehimisht që “*Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë autorizim prodhuesi ose distributori. Në rast paraqitje autorizim distributori duhet të paraqitet kontrata ose dokumenti i angazhimit midis prodhuesit dhe distributorit, për materialet (pajisjet mjekesore, hidroizolues, pajisjet mekanike, pajisjet hidrosanitare, shtrese pvc antibakteriale, dyer/dritare, gipse, bojrat, pajisjet e zjarri, pajisjet e sistemit HVAC, ashensori) per objektet shendetesore. Per materialet e kerkuara OE duhet te paraqese katalogun/et ose skedat teknike te prodhuesit/ve, ku te specifikohen materialet qe do te ofrohen si dhe te paraqiten certifikatë/deklaratë konfirmimiti CE ose ekuivalente*”. Nga verifikimi i dokumentacionit të dorëzuar në sistemin e prokurimit elektronik, nga operatori ekonomik ankimues, konstatohet se ky i fundit ka paraqitur dokumentin kontratë furnizimi të datës 08.05.2023 midis shoqërisë “Tolimo” SHPK furnizuesi dhe shoqërisë “Alko Impex General Construction” SHPK porositi, autorizim prodhuesi nga Colorificio Sammarinese s.p.a i cili autorizon shoqërinë “Tolimo” SHPK, certifikatë dhe skedë teknike. Prodhuesi Colorificio Sammarinese s.p.a për materialin bojra, nga verifikimi i dokumentacionit të sipërcituar konstatohet, se autorizimi prodhuesit, skeda teknike dhe certifikata janë në gjuhën italiane të papërkthyer dhe noterizuar, në kundërshtim me përcaktimet e autoritetit kontraktor në dokumentet e tenderit. Në pikën 4.7 të seksionit IV të dokumenteve të tenderit, “Gjuha”, si dhe në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, është përcaktuar qartë që gjuha e përdorur është gjuha shqipe dhe rrjedhimisht çdo dokument i paraqitur në gjuhë të huaj duhet të jetë i përkthyer dhe

noterizuar në gjuhën shqipe, për sa kohë që procedura e prokurimit është nën kufirin e lartë monetar. Sqarojmë, se përkufizimi ligjor i mësipërm është gjithpërfshirës, pra për të gjithë dokumentacionin përkatës, që paraqitet në këtë procedurë prokurimi. Në kushtet kur, në dokumentet e tenderit të hartuara e të miratuara nga Agjencia e Prokurimit Publik, e konkretisht në kriteret e përgjithshme të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë, si dhe nuk duhet të ndryshohen për asnjë arsye nga autoriteti kontraktor gjatë hartimit të dokumenteve të tenderit, është përcaktuar qartësisht se *“Nëse gjuha e përdorur në procedurë është gjuha shqipe, atëherë dokumentet në gjuhë të huaj duhet të shoqërohen me një përkthim të noterizuar në gjuhën shqipe”*, në këtë kuadër i gjithë dokumentacioni i paraqitur në procedurën e prokurimit në sistem elektronik duhet të jetë në gjuhën shqipe ose i shoqëruar me përkthim të noterizuar në gjuhën shqipe. Gjithashtu, duke u referuar në DST e procedurës objekt-ankimi, konkretisht në kreun *“Udhëzime për operatorët ekonomikë”* Seksioni 1, *“B Përgatitja e ofertave”* pika 2 *‘Gjuha e ofertës’* ku përcaktohet se: *Oferta, si dhe të gjitha korrespondencat dhe dokumentet në lidhje me procedurën e prokurimit do të paraqiten në gjuhën/gjuhët e specifikuar në njoftimin e kontratës. Dokumentet mbështetëse dhe literatura e printuar që janë pjesë e Ofertës mund të jenë në një gjuhë tjetër me kusht që ato të shoqërohen nga një përkthim zyrtar i fragmenteve përkatëse në gjuhën e specifikuar në njoftim*”, duhet që të gjitha dokumentet e paraqitura në rrugë elektronike të jenë në gjuhën shqipe siç autoriteti kontraktor ka përcaktuar në njoftimin e kontratës ose nëse janë në gjuhë të huaj duhet të shoqërohen me një përkthim të noterizuar në gjuhën shqipe. Në rastin konkret, në sistemin e prokurimit elektronik, operatori ekonomik ankimues ka paraqitur në gjuhë të huaj, katalogon e sipërcituar dhe të pashoqëruar me përkthim të noterizuar në gjuhën shqipe, në kundërshtim me atë që autoriteti kontraktor ka përcaktuar në përmbajtjen e dokumenteve të tenderit. Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin oferta, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit, pasi ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente do të refuzohen si të papranueshme. Akoma më tej, Komisioni gjykon, se nuk jemi përballë devijimeve të vogla në ofertë, sepse modifikime të tilla do të ndryshonin përmbajtjen e ofertës, duke synuar të kthejnë një ofertë nga e pavlefshme në të vlefshme, në kundërshtim kjo me nenin 92 pika 1 *të lex specialis*. Në këtë kuadër, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se nga ana e ankimuesit nuk janë përmbushur të gjitha kërkesat që autoriteti kontraktor ka përcaktuar në dokumentet e tenderit, duke dorëzuar dokumente në gjuhë të huaj të pashoqëruara me përkthim të noterizuar, një kusht ky i detyrueshëm për ankimuesin, pasi ai duhet të plotësojë çdo kërkesë dhe kriter të vendosur nga autoriteti kontraktor, si dhe të paraqesë çdo dokumentacion, që përmban të dhëna dhe elemente që janë gjykuar të nevojshme dhe të domosdoshme nga ana e këtij të fundit.

III.6.16. Lidhur me arsyen e skualifikimit të operatorit ekonomik ankimues se *“për paisjet e sistemit HVAC, ka paraqitur Kaldajë nga prodhuesi Centrometac d.o.o në gjuhën angleze, katalog /Sked teknike në gjuhën angleze (të papërkthyer dhe noterizuara).”*, nga shqyrtimi i dokumenteve të tenderit, vërejmë se autoriteti kontraktor në kriteret e veçanta të kualifikimit pika 2.4.2 ka kërkuar shprehimisht që *“Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë autorizim prodhuesi ose distributori. Në rast paraqitje autorizim distributori duhet të paraqitet kontrata ose dokumenti i angazhimit midis prodhuesit dhe distributorit, për materialet (pajisjet mjekesore, hidroizolues, pajisjet mekanike, pajisjet hidrosanitare, shtrese pvc antibakteriale,*

dyer/dritare, gipse, bojrat, pajisjet e zjarrit, pajisjet e sistemit HVAC, ashensori) për objektet shendetesore. Per materialet e kerkuara OE duhet te paraqese katalogun/et ose skedat teknike të prodhuesit/ve, ku të specifikohen materialet që do të ofrohen, si dhe te paraqiten certifikatë/deklaratë konfirmimit CE ose ekuivalente”. Nga verifikimi i dokumentacionit të dorëzuar në sistemin e prokurimit elektronik, nga operatori ekonomik ankimues, konstatohet se ky i fundit ka paraqitur dokumentin katalog të shoqërisë Centrometal d.o.o për pajisjen kaldajë. Nga verifikimi i dokumentacionit të sipërcituar konstatohet, se katalogu i paraqitur për pajisjen kaldajë nga shoqëria Centrometal d.o.o, është në gjuhën angleze, i papërkthyer dhe noterizuar, në kundërshtim me përcaktimet e autoritetit kontraktor në dokumentet e tenderit. Në pikën 4.7 të seksionit IV të dokumenteve të tenderit, “Gjuha”, si dhe në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, është përcaktuar qartë që gjuha e përdorur është gjuha shqipe dhe rrjedhimisht çdo dokument i paraqitur në gjuhë të huaj duhet të jetë i përkthyer dhe noterizuar në gjuhën shqipe, për sa kohë që procedura e prokurimit është nën kufirin e lartë monetar. Sqarojmë, se përkufizimi ligjor i mësipërm është gjithpërfshirës, pra për të gjithë dokumentacionin përkatës, që paraqitet në këtë procedurë prokurimi. Në kushtet kur, në dokumentet e tenderit të hartuara e të miratuara nga Agjencia e Prokurimit Publik, e konkretisht në kriteret e përgjithshme të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë, si dhe nuk duhet të ndryshohen për asnjë arsye nga autoriteti kontraktor gjatë hartimit të dokumenteve të tenderit, është përcaktuar qartësisht se “Nëse gjuha e përdorur në procedurë është gjuha shqipe, atëherë dokumentet në gjuhë të huaj duhet të shoqërohen me një përkthim të noterizuar në gjuhën shqipe”, në këtë kuadër i gjithë dokumentacioni i paraqitur në procedurën e prokurimit në sistem elektronik duhet të jetë në gjuhën shqipe ose i shoqëruar me përkthim të noterizuar në gjuhën shqipe. Gjithashtu, duke u referuar në DST e procedurës objekt-ankimi, konkretisht në kreun “Udhëzime për operatorët ekonomikë” Seksioni 1, “B Përgatitja e ofertave” pika 2 ‘Gjuha e ofertës’ ku përcaktohet se: *Oferta, si dhe të gjitha korrespondencat dhe dokumentet në lidhje me procedurën e prokurimit do të paraqiten në gjuhën/gjuhët e specifikuar në njoftimin e kontratës. Dokumentet mbështetëse dhe literatura e printuar që janë pjesë e Ofertës mund të jenë në një gjuhë tjetër me kusht që ato të shoqërohen nga një përkthim zyrtar i fragmenteve përkatëse në gjuhën e specifikuar në njoftim*”, duhet që të gjithë dokumentet e paraqitura në rrugë elektronike të jenë në gjuhën shqipe siç autoriteti kontraktor ka përcaktuar në njoftimin e kontratës ose nëse janë në gjuhë të huaj duhet të shoqërohen me një përkthim të noterizuar në gjuhën shqipe. Në rastin konkret në sistemin e prokurimit elektronik, operatori ekonomik ankimues ka paraqitur në gjuhë të huaj, katalogon e sipërcituar dhe të pashoqëruar me përkthim të noterizuar në gjuhën shqipe, në kundërshtim me atë që autoriteti kontraktor ka përcaktuar në përmbajtjen e dokumenteve të tenderit. Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin oferta, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit, pasi ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente do të refuzohen si të papranueshme. Akoma më tej, Komisioni gjykon, se nuk jemi përballë devijimeve të vogla në ofertë, sepse modifikime të tilla do të ndryshonin përmbajtjen e ofertës, duke synuar të kthejnë një ofertë nga e pavlefshme në të vlefshme, në kundërshtim kjo me nenin 92 pika 1 të *lex specialis*. Në këtë kuadër, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se nga ana e ankimuesit nuk janë përmbushur të gjitha kërkesat që autoriteti kontraktor ka përcaktuar në dokumentet e tenderit, duke dorëzuar dokumente në gjuhë të huaj të pashoqëruara me

përkthim të noterizuar, një kusht ky i detyrueshëm për ankimuesin, pasi ai duhet të plotësojë çdo kërkesë dhe kriter të vendosur nga autoriteti kontraktor, si dhe të paraqesë çdo dokumentacion, që përmban të dhëna dhe elemente që janë gjykuar të nevojshme dhe të domosdoshme nga ana e këtij të fundit.

III.6.17. Lidhur me arsyen e skualifikimit të operatorit ekonomik ankimues se “për materialin gips ka paraqitur autorizim prodhuesi nga Dekoll Sh.a shoqëruar me katalog të weber saint gobain, Dekoll Sh.a, nuk verteton se prodhon materiale gipsi, mungon katalogu ose skedat teknike si dhe certifikata/deklarata konformitetit CE”, nga shqyrtimi i kriterit kualifikues ë përcaktuar në pikën 2.4.2 të Shtojcës 7/2 të dokumenteve të tenderit, Komisioni i Prokurimit Publik konstaton, se autoriteti kontraktor ka përcaktuar se “*Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë autorizim prodhuesi ose distributori. Në rast paraqitje autorizim distributori duhet të paraqitet kontrata ose dokumenti i angazhimit midis prodhuesit dhe distributorit, për materialet (pajisjet mjekesore, hidroizolues, pajisjet mekanike, pajisjet hidrosanitare, shtrese pvc antibakteriale, dyer/dritare, gipse, bojrat, pajisjet e zjarrit, pajisjet e sistemit HVAC, ashensori) per objektet shendetesore. Per materialet e kerkuara OE duhet te paraqese katalogun/et ose skedat teknike të prodhuesit/ve, ku të specifikohen materialet që do të ofrohen si dhe te paraqiten certifikatë/deklaratë konfirmiteti CE ose ekuivalente*”. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të ofertës të dorëzuar nga ana e shoqërisë “*Alko Impex General Construction*” SHPK, Komisioni i Prokurimit Publik konstaton, se kjo shoqëri ka paraqitur ofertë në këtë procedurë prokurimi në cilësinë e operatorit ekonomik dhe ka dorëzuar në dokumentacionin e ofertës, dokumentet si në vijim, Kontratë Furnizimi midis shoqërisë Dekoll SHPK si furnizues dhe shoqërisë “*Alko Impex General Construction*” SHPK si porositës për materiale suvatimi, veshje, gipsi, termoizoluese, hidroizoluese, bojra dhe rifinitura, Aautorizim prodhuesi lëshuar nga Dekoll SHPK për shoqërinë “*Alko Impex General Construction*” SHPK, katalog dhe dokumentacion të Dekoll SHPK, katalog dhe dokumentacion të Saint-Gobain SHPK. Nga shqyrtimi i kriterit kualifikues të sipërpërmendur, dokumentacionit të ofertës së dorëzuar nga operatori ekonomik ankimues, si dhe nga përcaktimet e nenit 82 pika 2 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, i ndryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon se operatori ekonomik ankimues, për përmbushjen e kriterit kualifikues të sipërpërmendur të përcaktuar në pikën 2.4.2 të Shtojcës 7/2 të dokumenteve të tenderit duhej që të paraqiste autorizim nga prodhuesit e materialeve të gipsit si dhe katalog apo skedë teknike për materialet e gipsit, ose autorizim nga distributorë të autorizuar nga kompanitë prodhuese të matërialeve të gipsit, si dhe të vërtetojë dhe lidhjen midis distributorit të autorizuar dhe kompanisë prodhuese. Referuar autorizimit të lëshuar nga Dekoll SHA, në asnjë moment nuk vërtetohet se ky subjekt është prodhues i gipsit, gjithashtu edhe në katalogët e dorëzuar nga ky subjekt nuk evidentohet në asnjë moment materiali i gipsit në katalog. Komisioni i Prokurimit Publik, referuar dokumentacionit të sipërcituar të paraqitur nga ankimuesi në përmbushje të kriterit kualifikues, lidhur me autorizimin e prodhuesit për gips dhe katalogët për këtë material, konstaton se operatori ekonomik ankimues nuk arrin të dëshmojë me anë të dokumentacionit, se disponon autorizim nga prodhuesi për materialin gips dhe as të ketë dorëzuar katalog për këtë material. Në këto kushte, KPP gjykon, se operatori ekonomik ankimues është në kushtet e mospërmbushjes së kriterëve të veçanta të kualifikimit pasi ky i fundit nuk arrin të vërtetojë së është i autorizuar nga prodhuesi për materialet gips dhe

nuk ka paraqitur katalog për këtë material ashtu sikurse është kërkuar në dokumentet standarde të tenderit, duke dështuar që të dorëzojë autorizim prodhuesi nga kompania prodhuese e materialit gips, si dhe ka dështuar që të dorëzojë një dokument që të vërtetojë lidhjen midis kompanisë Dekoll SHPK dhe “Saint Gobain” SHPK. Gjithashtu ka dështuar të vërtetojë edhe paraqitjen e katalogut dhe certifikata/deklarata konformitetit CE për materialin e gipsit sikurse është kërkuar në DST. Sqarohet se, referuar rregullave të prokurimit publik, kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të vërtetojnë se zotërojnë reputacionin, besueshmërinë dhe përvojën e duhur, për të zbatuar kontratën objekt - prokurimi, si edhe janë të detyruar të përgatisin oferta, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit, në mënyrë që edhe vlerësimi të bëhet në përputhje me këtë dokumentacion, pasi ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumenta duhet të refuzohen si të papranueshme. Mosplotësimi goftë edhe i një kriteri të vendosur nga ana e autoritetit kontraktor e bën ofertën e operatorit ekonomik të pavlefshme, si edhe përbën kusht për skualifikimin e tij nga procedura e prokurimit. Dokumentacioni i paraqitur nga operatori ekonomik ankimues në procedurën e prokurimit, nuk plotëson kërkesat e autoritetit kontraktor dhe nuk mund të konsiderohet i vlefshëm. Operatori ekonomik ankimues, duhet të dorëzonte të gjithë dokumentacionin e ofertës në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit nga autoriteti kontraktor, në sistemin elektronik të prokurimeve.

III.6.18. Lidhur me arsyen e skualifikimit të operatorit ekonomik ankimues se “nuk ka paraqitur autorizim prodhuesi ose distributori, katalog ose skedë teknike për dyer të brendshme laminat me kase alumini, e pajisur me aksesore “heavy duty”, me nje ose dy kanata sipas vizatimeve”., nga shqyrtimi i kriterit kualifikues të përcaktuar në pikën 2.4.2 të Shtojcës 7/2 të dokumenteve të tenderit, Komisioni i Prokurimit Publik konstaton, se autoriteti kontraktor ka përcaktuar se *“Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë autorizim prodhuesi ose distributori. Në rast paraqitje autorizim distributori duhet të paraqitet kontrata ose dokumenti i angazhimit midis prodhuesit dhe distributorit, për materialet (pajisjet mjekesore, hidroizolues, pajisjet mekanike, pajisjet hidrosanitare, shtrese pvc antibakteriale, dyer/dritare, gipse, bojrat, pajisjet e zjarrit, pajisjet e sistemit HVAC, ashensori) per objektet shendetesore. Per materialet e kerkuara OE duhet te paraqese katalogun/et ose skedat teknike të prodhuesit/ve, ku të specifikohen materialet që do të ofrohen, si dhe te paraqiten çertifikatë/deklaratë konfirmimiti CE ose ekuivalente”*. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të ofertës të dorëzuar nga ana e shoqërisë “Alko Impex General Construction” SHPK, Komisioni i Prokurimit Publik konstaton se kjo shoqëri ka paraqitur ofertë në këtë procedurë prokurimi në cilësinë e operatorit ekonomik dhe ka dorëzuar në dokumentacionin e ofertës, dokumentet si në vijim, kontratë furnizimi midis shoqërisë Everest SHPK si furnizues dhe shoqërisë “Alko Impex General Construction” SHPK si porosites për produktet Dyer/Dritare, katalog dhe dokumentacion për profile. Nga shqyrtimi i kriterit kualifikues të sipërpërmendur, dokumentacionit të ofertës së dorëzuar nga operatori ekonomik ankimues, si dhe nga përcaktimet e nenit 82 pika 2 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 *“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”*, i ndryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon, se operatori ekonomik ankimues për përmbushjen e kriterit kualifikues të sipërpërmendur të përcaktuar në pikën 2.4.2 të Shtojcës 7/2 të dokumenteve të tenderit duhej

që të paraqiste autorizim nga prodhuesi dhe distributori për dyer, si dhe katalog os eskedë teknike për dyer. KPP gjykon, se mungesa fizike e dokumentacionit të kërkuar shprehimisht në kriterin e kualifikimit, përbën shkak për skualifikim në kuptim të nenit 82 të Vendimit Nr. 285 datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, në të cilin përcaktohet se Komisioni i Vlerësimit të Ofertave verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta, që përmbushin kërkesat për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe janë të përgjegjshme/vlefshme. Është detyrim ligjor i subjektit ofertues të provojë me dokumentacion të plotë dhe në përputhje me kërkesat e autoritetit kontraktor plotësimin e kriterëve të kërkuara në dokumentet e tenderit, pasi ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Akoma më tej KPP sqaron, se në një procedurë prokurimi, subjekti i parë i interesuar është operatori ekonomik, i cili e përgatit ofertën e tij në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi dhe nga ana tjetër, është autoriteti kontraktor, i cili përzgjedh operatorin ekonomik që plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit.

III.6.19. Lidhur me arsyen e skualifikimit të operatorit ekonomik ankimues se “për paisjet e sistemit HVAC, ka paraqitur kontratë furnizimi nga Haki Sianani, mungon autorizimi i prodhuesit, mungojnë katalogët për (Pompë Nxehtësie, Njësi Trajtimi Ajri Dërgim, Njësi Trajtimi Ajri Rikthim, Njësi Trajtimi Ajri Rikuperator Nxehtësie, Fan Coil DysHEMEJE, Mono Split Mural, Radiator çeliku) si dhe certifikata/deklarata konformitetit CE.”, gga shqyrtimi i kriterit kualifikues të përcaktuar në pikën 2.4.2 të Shtojcës 7/2 të dokumenteve të tenderit, Komisioni i Prokurimit Publik konstaton, se autoriteti kontraktor ka përcaktuar se “*Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë autorizim prodhuesi ose distributori. Në rast paraqitje autorizim distributori duhet të paraqitet kontrata ose dokumenti i angazhimit midis prodhuesit dhe distributorit, për materialet (pajisjet mjekesore, hidroizolues, pajisjet mekanike, pajisjet hidrosanitare, shtrese pvc antibakteriale, dyer/dritare, gipse, bojrat, pajisjet e zjarri, pajisjet e sistemit HVAC, ashensori) për objektet shendetesore. Për materialet e kerkuara OE duhet te paraqese katalogun/et ose skedat teknike të prodhuesit/ve, ku të specifikohen materialet që do të ofrohen si dhe te paraqiten certifikatë/deklaratë konfirmimiti CE ose ekuivalente*”. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të ofertës të dorëzuar nga ana e shoqërisë “Alko Impex General Construction” SHPK, Komisioni i Prokurimit Publik konstaton, se kjo shoqëri ka paraqitur ofertë në këtë procedurë prokurimi në cilësinë e operatorit ekonomik dhe ka dorëzuar në dokumentacionin e ofertës, dokumentet si në vijim, kontratë furnizimi midis shoqërisë Haki Sinani SHPK si furnizues dhe shoqërisë “Alko Impex General Construction” SHPK si porosites për materiale kaldaja, sisteme kondicionimi, tubacionet e ujit të pijshëm, pajisje hidrosanitare dhe hidraulike, pompat, Autorizim Prodhuessi lëshuar nga Haki Sinani SHPK për shoqërinë “Alko Impex General Construction” SHPK, katalog të Comisa, katalog të Boccione Antincendio, Centrometal d.o.o. Nga shqyrtimi i kriterit kualifikues të sipërpërmendur, dokumentacionit të ofertës së dorëzuar nga operatori ekonomik ankimues, si dhe nga përcaktimet e nenit 82 pika 2 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon, se operatori ekonomik ankimues, për përmbushjen e kriterit kualifikues të sipërpërmendur të përcaktuar në pikën 2.4.2 të Shtojcës 7/2 të dokumenteve të tenderit, duhej që të paraqiste autorizim nga prodhuesit e Pompë Nxehtësie, Njësi Trajtimi Ajri Dërgim, Njësi Trajtimi Ajri Rikthim, Njësi Trajtimi Ajri

Rikuperator Nxetësie, Fan Coil DysHEMEJE, Mono Split Mural, Radiator çeliku si dhe katalog apo skedë teknike për këto materiale ose autorizim nga distributorë të autorizuar nga kompanitë prodhuese të tyre, duke vërtetuar lidhjen midis distributorit të autorizuar dhe kompanisë prodhuese. Referuar autorizimit të lëshuar nga Haki Sinani SHPK, në asnjë moment nuk vërtetohet se ky subjekt është prodhues i materialeleve të sipërcituara, gjithashtu edhe në katalogët e dorëzuar nga ky subjekt nuk evidentohen në asnjë moment materialet e sipërcituara në katalog. Komisioni i Prokurimit Publik, referuar dokumentacionit të sipërcituar të paraqitur nga ankimuesi në përmbushje të kriterit kualifikues, lidhur me autorizimin e prodhuesit si dhe katalogët për materialet e sipërcituara, konstaton, se operatori ekonomik ankimues nuk arrin të dëshmojë me anë të dokumentacionit, se disponon autorizim nga prodhuesi apo distributori i autorizuar nga prodhuesi për këto materiale, si dhe të ketë dorëzuar katalog për këto materiale. KPP gjykon, se operatori ekonomik ankimues është në kushtet e mospërmbushjes së kriterëve të veçanta të kualifikimit, pasi ky i fundit nuk arrin të vërtetojë së është i autorizuar nga prodhuesi apo distributori i prodhuesit, si dhe nuk ka paraqitur katalog për këto materiale ashtu sikurse është kërkuar në dokumentet standarde të tenderit, duke dështuar që të dorëzojë autorizim prodhuesi nga kompania prodhuese apo një dokument që të vërtetojë lidhjen midis prodhuese dhe distributorit. Gjithashtu ka dështuar të vërtetojë edhe paraqitjen e katalogut dhe certifikatë/deklaratë konformiteti CE për këto materiale sikurse është kërkuar në DST. Sqarojmë, se referuar rregullave të prokurimit publik, kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të vërtetojnë se zotërojnë reputacionin, besueshmërinë dhe përvojën e duhur, për të zbatuar kontratën objekt prokurimi, si edhe janë të detyruar të përgatisin oferta, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit, në mënyrë që edhe vlerësimi të bëhet në përputhje me këtë dokumentacion, pasi ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumenta duhet të refuzohen si të papranueshme. Mosplotësimi qoftë edhe i një kriteri të vendosur nga ana e autoritetit kontraktor e bën ofertën e operatorit ekonomik të pavlefshme, si edhe përbën kusht për skualifikimin e tij nga procedura e prokurimit. Dokumentacioni i paraqitur nga operatori ekonomik ankimues në procedurën e prokurimit, nuk plotëson kërkesat e autoritetit kontraktor dhe nuk mund të konsiderohet i vlefshëm. Operatori ekonomik ankimues, duhet të dorëzonte të gjithë dokumentacionin e ofertës në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit nga autoriteti kontraktor, në sistemin elektronik të prokurimeve.

III.6.20. Lidhur me arsyen e skualifikimit të operatorit ekonomik ankimues se “nuk ka paraqitur autorizim prodhuesi ose distributori për Pompë karburanti dhe për Rezervuar të lëndës djegëse”, nga shqyrtimi i kriterit kualifikues të përcaktuar në pikën 2.4.2 të Shtojcës 7/2 të dokumenteve të tenderit, Komisioni i Prokurimit Publik konstaton, se autoriteti kontraktor ka përcaktuar se “*Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë autorizim prodhuesi ose distributori. Në rast paraqitje autorizim distributori duhet të paraqitet kontrata ose dokumenti i angazhimit midis prodhuesit dhe distributorit, për materialet (pajisjet mjekesore, hidroizolues, pajisjet mekanike, pajisjet hidrosanitare, shtrese pvc antibakteriale, dyer/dritare, gipse, bojrat, pajisjet e zjarrit, pajisjet e sistemit HVAC, ashensori) per objektet shendetesore. Per materialet e kerkuara OE duhet te paraqese katalogun/et ose skedat teknike të prodhuesit/ve, ku të specifikohen materialet që do të ofrohen si dhe te paraqiten*

certifikatë/deklaratë konfirmimit CE ose ekuivalente". Nga shqyrtimi i dokumentacionit të ofertës të dorëzuar nga ana e shoqërisë “Alko Impex General Construction” SHPK, kriterit kualifikues të sipërpërmendur, si dhe nga përcaktimet e nenit 82 pika 2 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon, se operatori ekonomik ankimues, për përmbushjen e kriterit kualifikues të sipërpërmendur të përcaktuar në pikën 2.4.2 të Shtojcës 7/2 të dokumenteve të tenderit, duhej që të paraqiste autorizim nga prodhuesi ose distributori i prodhuesit për pajisjet mekanike. KPP gjykon, se mungesa fizike e dokumentacionit të kërkuar shprehimisht në kriterin e kualifikimit, përbën shkak për skualifikim në kuptim të nenit 82 të Vendimit Nr. 285 datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, në të cilën përcaktohet, se Komisioni i Vlerësimit të Ofertave verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta, që përmbushin kërkesat për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe janë të përgjegjshme/vlefshme. Është detyrim ligjor i subjektit ofertues, të provojë me dokumentacion të plotë dhe në përputhje me kërkesat e autoritetit kontraktor, plotësimin e kriterëve të kërkuara në dokumentet e tenderit, pasi ofertat që nuk përkatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Akoma më tej KPP sqaron, se në një procedurë prokurimi, subjekti i parë i interesuar është operatori ekonomik, i cili e përgatit ofertën e tij në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi dhe nga ana tjetër, është autoriteti kontraktor, i cili përzgjedh operatorin ekonomik që plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit.

Për sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues “Alko Impex General Construction” SHPK qëndron pjesërisht.

III.7. Komisioni i Prokurimit Publik vëren, se kjo procedurë prokurimi është e rishpallur nga autoriteti kontraktor, pasi procedura e parë e prokurimit me numër REF-66182-04-14-2023 përmes vendimit KPP 716 datë 3.8.2023 është anuluar për shkeljet e konstatuara referuar edhe arsytimit të këtij vendimi. KPP konstaton, se në procedurën me numër REF- 66182-04-14-2023 kanë marrë pjesë gjashtë pjesëmarrës, pesë nga të cilët kanë paraqitur ofertë dhe vetëm një operator ekonomik i kualifikuar. Pas anulimit të procedurës së prokurimit për shkeljet e konstatuara nga ana e Komisionit të Prokurimit Publik, në procedurën aktuale me nr. REF-78915-09-04-2023 ka 10 pjesëmarrës, tetë nga të cilët kanë dorëzuar ofertë ekonomike edhe dy operatorë ekonomikë të kualifikuar. Pra, KPP konstaton, se pas korrigjimit të konstatimeve, shkeljeve të konstatuara nga KPP, ka patur një rritje me 2 herë të numrit të pjesëmarrësve, dyfishim të numrit të operatorëve ekonomikë të kualifikuar dhe rritje me 1.6 herë të operatorëve ekonomikë të cilët kanë dorëzuar ofertë në procedurën e prokurimit objekt - ankimi. Pra, KPP konstaton, se vetëm më ndryshimet e specifikimeve teknike ka pasur një dyfishim të konkurrencës në procedurën e prokurimit objekt - ankimi. Gjithashtu, KPP konstaton, se për të dytën herë kjo procedurë prokurimi anulohet për shkak të shkeljeve të bëra nga autoriteti kontraktor. Duke marrë shkas nga konstatimet e sipërcituara, Komisioni i Prokurimit Publik konstaton, se autoriteti kontraktor nëpërmjet veprimeve të tij, ka vepruar në kundërshtim të plotë me rregullat e prokurimit publik, duke hartuar kriteret dhe specifikime diskriminuese të ekzagjeruara dhe jo në funksion të procedurës së prokurimit objekt - ankimi, por në funksion të uljes së konkurrencës, ndaj në mbështetje të nenit 23 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin

Publik”, dhe në zbatim të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 618, datë 20.10.2021 “Për krijimin, organizimin, e funksionimin e rrjetit të koordinatorëve kundër korrupsionit” gjykon, se ky rast duhet t’iu referohet institucioneve të tjera të posaçme, konkretisht Agjencisë së Prokurimit Publik dhe Rrjetit të Koordinatorëve Kundër Korrupsionit. Gjithashtu, në nenin 21 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” parashikohet, se “*Autoriteti ose enti kontraktor është përgjegjës për prokurimin në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe të akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij, duke garantuar respektimin e parimeve të trajtimit të barabartë, transparencës, konkurrencës dhe mosdiskriminimit, të parashikuara në këtë ligj.*” Në rastin konkret, KPP vlerëson, se anulimi për herë të dytë i të së njëjtës procedurë për shkelje të ligjit të prokurimit publik nga ana e autoritetit kontraktor, ngarkon me përgjegjësi këtë të fundit për keqmenaxhim të fondeve publike, pasi referuar arsyetimit të këtij vendimi, nuk janë garantuar dhe respektuar parimet e zhvillimit të procedurave të prokurimit publik. Ndaj KPP gjykon t’ua referojë këtë çështje edhe për hetime të mëtejshme, organit epror të autoritetit kontraktor, Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, e ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023 “Për përcaktimin e rregullave dhe tarifës së pagesës për ankimin në një procedurë prokurimi pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, me shumicë votash,

Vendos:

1. Të pranojë pjesërisht ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “*Alko Impex General Construction*” SHPK për procedurën e prokurimit “*Procedurë e Hapur*”, me Nr. REF-78915-09-04-2023, me objekt: “*Rikonstrukcion i Spitalit Rajonal Diber ‘Rrahim Xhika’*”, me fond limit 325,049,984 (treqind e njëzet e pesë milionë e dyzetë e nëntë mijë e nëntëqind e tetëdhjetë e katër) leke pa TVSH, zhvilluar më datë 25.10.2023, nga autoriteti kontraktor, Drejtoria e Spitalit Rajonal Diber.
2. Autoriteti kontraktor të rishikojë arsyet e skualifikimit të operatorit ekonomik “*Alko Impex General Construction*” SHPK dhe të korrigjojë shkeljet e konstatuara si më sipër.
3. Autoriteti kontraktor të anulojë procedurën e mësipërme të prokurimit dhe me rihapjen e procedurës të ketë parasysh konstatimet e mësipërme, të bëra nga Komisioni i Prokurimit Publik.
4. Autoriteti kontraktor brenda 5 ditëve të vëre në dijëni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.

5. Ngarkohet zyra e financës, që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “*Alko Impex General Construction*” SHPK.
6. T’i propozojë Agjencisë së Prokurimit Publik, nisjen e hetimit administrativ për konstatimet e mësipërme, për shkeljet e kryera nga të gjithë zyrtarët përgjegjës.
7. Kopje e këtij vendimi, i dërgohet për njoftim Ministrisë së Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin.
8. Kopje e këtij vendimi, i dërgohet për njoftim Rrjetit të Koordinatorëve Kundër Korrupsionit.
9. Kopje e këtij vendimi, i dërgohet për njoftim Organit Epror, Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.
10. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
11. Kopje e këtij vendimi, i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar
Fiorent Zguro

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Anila Malaj

Kryetar
Jonaïd Myzyri



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

MENDIM KUNDËR

Mendim kundër i Anëtarit të Komisionit të Prokurimit Publik z. Kreshnik Ternova në lidhje me vendimin e shumicës.

Si Anëtar i Komisionit të Prokurimit Publik shpreh mendimin kundër përsa i përket arsytimit të vendimit mbi themelin e çështjes dhe rrjedhimisht dhe të dispozitivit të tij, për sa i përket ankesës së paraqitur nga operatori ekonomik “*Alko Impex General Construction*” SHPK për procedurën e prokurimit “*Procedurë e Hapur*”, me Nr. REF-78915-09-04-2023, me objekt: “*Rikonstruksion i Spitalit Rajonal Diber "Rrahim Xhika*”, me fond limit 325,049,984 (*treqind e njëzet e pesë milionë e dyzetë e nëntë mijë e nëntëqind e tetëdhjetë e katër*) leke pa TVSH, zhvilluar me datë 25.10.2023 nga autoriteti kontraktor, Drejtoria e Spitalit Rajonal Diber.

Pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur, dokumenteve të dërguara nga autoriteti kontraktor,

Arsyetoj

III.1. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “*Alko Impex General Construction*” SHPK, mbi kundërshtimin e vendimit të komisionit të vlerësimit të ofertave në lidhje me skualifikimin e ofertës së tij me arsyen se: “*OE Alko Impex General Construcion SHPK sipas dokumentacionit te dorezuar ne SPE ne lidhje me kete pike (ne kriteret e vecanta per kualifikim 2.4 “Kërkesa të tjera të veçanta për kualifikim pika”, pika 2.4.2), ka këto mangësi si më poshtë: - Per pajisjet mjekesore mungon katalogu ose skedat teknike sipas kerkesave te DST 2.4.2 te dokumenteve standarde te tenderit; - Per materialin hidroizolues ka paraqitur Test raporte ne gjuhen angleze (te paperkthyer dhe noterizuar); - Per materialet pajisje fikje zjarrit nuk ka paraqitur autorizim prodhuesi ose distributori me Bocciolone Antincendio S.p.a., disponon vetem katalog ne gjuhen Italiane (te paperkthyer dhe noterizuar); - Per materialet shtrese pvc antibakteriale ka paraqitur autorizim nga distributor Teknoedil, Katalogu ne gjuhen angleze dhe certifikata ne gjuhen angleze (te paperkthyer dhe noterizuar); - Nuk ka paraqitur autorizim prodhuesi ose distributori, Katalog ose Skedte teknike per Dyer te brendshme laminat me kase alumini e pajisur me aksesore "heavy duty", me nje ose dy kanata sipas vizatimeve; - Per materialin gips ka paraqitur autorizim prodhuesi nga Dekoll Sh.a shoqeruar me katalog te weber saint gobain, Dekoll Sh.a nuk verteton se prodhon materjale gipsi, mungon katalogu ose skedat teknike si dhe certifikata/deklarata konformitetit CE; - Per materialin boje autorizimi prodhuesit Colorificiio Sammarinese s.p.a eshte ne gjuhen Italiane, Skeda teknike ne gjuhen italjane dhe certifikat ne gjuhen italjane (te paperkthyer dhe*

noterizuara); - Paisjet e sistemit HVAC, ka paraqitur kontrat furnizimi nga Haki Sianani, mungon autorizim prodhuesit, mungojne kataloget per (Pompe Nxehtesie, Njesi Trajtimi Ajri Dergim, Njesi Trajtimi Ajri Rikthim, Njesi Trajtimi Ajri Rikuperator Nxetesie, Fan Coil Dyshemje, Mono Split Mural, Radiator çeliku) si dhe certifikata/deklarata konformitetit CE; - Paisjet e sistemit HVAC, ka paraqitur Kaldaje nga prodhuesi Centrometac d.o.o ne gjuhen angleze, katalog /Sked teknike ne gjuhen angleze (te paperkthyer dhe noterizuara); - Nuk ka paraqitur autorizim prodhuesi ose distributori per Pompe karburanti; - Nuk ka paraqitur autorizim prodhuesi ose distributori per Rezervuari i lendes djegese”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1. Në shtojcën 7/2, të modifikuar tek “Kriteret e veçanta të kualifikimit”, pika 2.4.2 autoriteti kontraktor ka përcaktuar:

ISHTE:

2.4.2 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë autorizim prodhuesi ose distributori. Në rast paraqitje autorizim distributori duhet të paraqitet kontrata ose dokumenti i angazhimit midis prodhuesit dhe distributorit, për materialet (paisjet mjekesore, paisjet elektrike , hidroizolues, paisjet mekanike, paisjet, hidrosanitare, shtrese pvc antibakteriale, dyer/dritare, gipse, bojrat, paisjet e zjarri, paisjet e sistemin HVAC, ashensori,). Per materialet e kerkuara OE duhet te paraqese katalogun/et ose skedat teknike të prodhuesit/ve, ku të specifikohen materialet që do të ofrohen si dhe te paraqiten çertifikatë/deklaratë konfirmimit CE ose ekuivalente, me qëllim përmbushjen e standarteve të kërkuara ne Specifikimet teknike. Operatori ekonomik duhet të paraqesë ofertën teknike, në formën e një table sipas modelit të mëposhtëm, e cila duhet të plotësohet në mënyrë rigoroze. Oferta teknike duhet të përmbajë të dhënat si më poshtë;

Nr.	Emri i kompanisë prodhuese	Emërtimi i katalogut të prodhuesit	Nr.i faqes	Nr. rep &Nr.kol (njehesim origjinali-Vertetim perkthimi
1.				

Të dhënat e deklaruara në ofertën teknike duhet të korespondojnë me të dhënat për artikujt në katalogët/skedat teknike të dorëzuara ne SPE. Moskorespondimi i këtyre të dhënave do të sjellë pavlefshmëri të ofertës.

BEHET:

2.4.2 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë autorizim prodhuesi ose distributori. Në rast paraqitje autorizim distributori duhet të paraqitet kontrata ose dokumenti i angazhimit midis prodhuesit dhe distributorit, për materialet (paisjet mjekesore, hidroizolues, paisjet mekanike, paisjet hidrosanitare, shtrese pvc antibakteriale, dyer/dritare, gipse, bojrat, paisjet e zjarri, paisjet e sistemin HVAC, ashensori) per objektet shendetesore. Per materialet e

kerkuara OE duhet te paraqese katalogun/et ose skedat teknike të prodhuesit/ve, ku të specifikohen materialet që do të ofrohen si dhe te paraqiten çertifikatë/deklaratë konfirmimiti CE ose ekuivalente, me qëllim përmbushjen e standarteve të kërkuara ne Specifikimet teknike. Operatori ekonomik duhet të paraqesë ofertën teknike, në formën e një tablele sipas modelit të mëposhtëm, e cila duhet të plotësohet në mënyrë rigoroze. Oferta teknike duhet të përmbajë të dhënat si më poshtë;

Nr.	Emri i kompanisë prodhuese	Emërtimi i katalogut të prodhuesit	Nr.i faqes	Nr. rep &Nr.kol (njehesim origjinali-Vertetim perkthimi)
I.				

Të dhënat e deklaruara në ofertën teknike duhet të korespondojnë me të dhënat për artikujt në katalogët/skedat teknike të dorëzuara ne SPE. Moskorespondimi i këtyre të dhënave do të sjellë pavlefshmëri të ofertës.

III.1.2. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar në Sistemin e Prokurimit Elektronik nga operatori ekonomik “Alko Impex General Construction” SHPK, për përmbushjen të kriterit të mësipërm, rezulton, se ky i fundit ka paraqitur dokumentacion si më poshtë vijon:

- Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit “Alko Impex General Construction” SHPK. Në Pjesën III: “Kriteret e Përzgjedhjes/Kualifikimit”, gërma “C”: “DEKLARATË “Për disponimin e mjeteve/pajisjeve/makinerive të nevojshme për realizimin e punimeve objekt - kontrate”, operatori ekonomik “Alko Impex General Construction” SHPK deklaron:

Kontratë furnizimi			
Materiali/prod ukti për të cilin paraqitet kontrata e furnizimit	Nr. Kont së furnizimit (noterisë)	Afati i kontratës furnizimit (data e fillimit dhe mbarimit)	Të tjera

Nr.	Emri i kompanise prodhuese	Emertim i katalogut te prodhuesit	Nr. Rep &Nr. Kol(njehesim me origjinalin - Vertetim perkthimi)
Paisjet mjekesore			Vertetim njesim me origjinalin Nr. Rep 20015 Vertetim njesim me perkthimin Nr, Rep 20014
Paisjet hidroizoluese			Vertetim njesim me origjinalin Nr. Rep 20015 Vertetim njesim me perkthimin Nr, Rep 20014
Paisjet mekanike			Vertetim njesim me origjinalin Nr. Rep 20015 Vertetim njesim me perkthimin Nr, Rep 20014
Paisjet Hidrosanitare			Vertetim njesim me origjinalin Nr. Rep 20015 Vertetim njesim me perkthimin Nr, Rep 20014
Shtresa pvc antibakteriale			Vertetim njesim me origjinalin Nr. Rep 20015 Vertetim njesim me perkthimin Nr, Rep 20014

Dyer/ dritare			Vertetim njesim me origjinalin Nr. Rep 20015 Vertetim njesim me perkthimin Nr, Rep 20014
Gipse			Vertetim njesim me origjinalin Nr. Rep 20015 Vertetim njesim me perkthimin Nr, Rep 20014
Bojra			Vertetim njesim me origjinalin Nr. Rep 20015 Vertetim njesim me perkthimin Nr, Rep 20014
Paisjet e zjarrit			Vertetim njesim me origjinalin Nr. Rep 20015 Vertetim njesim me perkthimin Nr, Rep 20014
Paisjet e sistemit HVAC			Vertetim njesim me origjinalin Nr. Rep 20015 Vertetim njesim me perkthimin Nr, Rep 20014
Ashensori			Vertetim njesim me origjinalin Nr. Rep 20015 Vertetim njesim me perkthimin Nr, Rep 20014

- Autorizim pdf. 69.8 KB

- Katalog pajisjet HVAC pjesa 3 pdf 19.26 MB
- Dyer – Dritare pdf 4.17 MB
- Autorizim + dokumentacion bojra pdf 562.2 KB
- Ashensori pdf 5.33 MB
- Hidroizolues pdf 17.64 MB
- Përkthimet pdf 23.89 MB
- Katalog Profilesh everest 2015 (1) pdf 20.44 MB
- Autorizim pajisje zjarri pdf 450 KB
- Gipse compressed pdf 20.3 MB
- Pajisjet Mjeksore pdf 3.21 MB
- Shtrese pvc antibakteriale pdf 8.2 MB
- Pajisjet HVAC pjesa 1 pdf 17 MB

III.1.3. Në nenin 2 “Qëllimi i ligjit” 162/2021 “Për prokurimin publik” parashikohet se: *Qëllim i këtij ligji është: a) të rrisë eficientën dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik; b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale; c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik; ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë; d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik; dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.*

III.1.4. Në nenin 3 “Parime të përgjithshme”: *“1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale. 2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar. 3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.*

III.1.5. Në nenin 77 të ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: *1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:*

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;*
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;*
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.*

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar

kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

2. Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionale ose tregtarë.

Në procedurat e prokurimit për shërbime, ku është e nevojshme që operatorët ekonomikë të kenë një autorizim të veçantë ose të jenë anëtarë të një organizate të veçantë për të kryer shërbimin në fjalë në shtetin e tyre të origjinës, autoriteti ose enti kontraktor mund t'u kërkojë atyre të vërtetojnë se e kanë këtë autorizim ose anëtarësim.

3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën.

Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Xhiron vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës.

Kur një kontratë ndahet në lote, ky nen zbatohet për çdo lot individual. Megjithatë, autoriteti ose enti kontraktor mund të përcaktojë xhiron vjetore minimale që u kërkohet operatorëve, duke iu referuar grupeve të loteve, në rast se ofertuesi i suksesshëm merr disa lote që duhet të zbatohen në të njëjtën kohë.

Në rastin e kontratave që bazohen në një marrëveshje kuadër, kërkesa për xhiron minimale llogaritet mbi bazën e përmasave maksimale të kontratave specifike që do të zbatohen në të njëjtën kohë ose, kur përmasat nuk dihen, mbi bazën e vlerës së parashikuar të marrëveshjes kuadër.

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.

Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.

Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.

5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.

Ndërsa në nenin 79, po këtu thuhet se:

1. Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t'u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata

të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Kjo dispozitë zbatohet edhe kur kërkesat teknike u referohen kualifikimeve të kandidatit ose të ofertuesit.

2. Autoriteti ose enti kontraktor mund t'u kërkojë ofertuesve dorëzimin e certifikatave ose dokumenteve të ngjashme, të lëshuara nga organe të pavarura, që vërtetojnë pajtueshmërinë e tyre me standardet e kërkuara të cilësisë, veçanërisht sa i takon:

- a) garantimit të aksesit të personave me aftësi të kufizuara;
- b) efikasitetit të energjisë;
- c) sistemeve të menaxhimit mjedisor.

3. Në rastet kur operatori ekonomik provon se nuk mund të pajiset me një certifikatë të tillë brenda një kohe të arsyeshme për arsye që nuk varen prej tij, autoriteti ose enti kontraktor mund të pranojë dokumente të tjera, nëpërmjet të cilave mund të provohet garantimi i standardeve të kërkuara.

4. Në çdo rast, certifikatat e kërkuara duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës, duke respektuar edhe parimin e mosdiskriminimit.

III.1.6. Në nenin 92 të ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

1. Autoriteti ose enti kontraktor, kur e shikon të arsyeshme, u kërkon ofertuesve sqarime për ofertat e tyre, për shqyrtimin, vlerësimin dhe krahasimin sa më të drejtë të këtyre ofertave. Pa cenuar dispozitat e parashikuara në këtë ligj, nuk duhet të kërkohet, të ofrohet ose të lejohet asnjë ndryshim në përmbajtjen e ofertës, përfshirë ndryshimet në vlerë apo ndryshime që synojnë të kthejnë një ofertë të pavlefshme në të vlefshme.

2. Autoriteti ose enti kontraktor, pavarësisht nga përcaktimi i pikës 1 të këtij neni, duhet të korrigjojë vetëm gabimet aritmetike, që zbulohen gjatë shqyrtimit të ofertave. Autoriteti ose enti kontraktor njofton menjëherë për këto korrigjime ofertuesin që ka paraqitur ofertën. Kur ofertuesi nuk pranon korrigjimin e një gabimi aritmetik, oferta e tij do të skualifikohet.

3. Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji.

Oferta konsiderohet e vlefshme edhe nëse ajo përmban devijime të vogla, të cilat nuk ndryshojnë thelbësisht karakteristikat, kushtet dhe kërkesat e tjera, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, gabime shtypi, të cilat mund të korrigjohen pa prekur përmbajtjen e saj, si edhe ato të lidhura me informacionet që merren lehtësisht nga dokumente faktike, që tregojnë gjendjen e operatorit ekonomik në kohën e ofertimit.

III.1.7. Në nenin 40, pika 6 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

6. Autoriteti/enti kontraktor mund t'u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si:

a) mostra të mallit, kur e gjykon se kjo ka rëndësi për vlerësimin e ofertës teknike. Në këtë rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të argumentojë kërkesën për mostrat. Mostrat duhet të trajtohen si informacion konfidencial tregtar dhe duhet të jenë në kontroll të autoritetit/entit kontraktor. Në rastin e procedurave të zhvilluara me mjete elektronike, autoriteti ose enti kontraktor përcakton qartë procedurën për dorëzimin e mostrave, duke garantuar aksesin e çdo operatori të interesuar si dhe konfidencialitetin për pjesëmarrjen në proces. Mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve pas nënshkrimit të kontratës, me kusht që kontrata në fjalë të mos jetë objekt i shqyrtimit administrativ apo gjyqësor. Në rastin kur procedura e prokurimit anulohet, mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e marrjes së vendimit përfundimtar të anulimit; dhe/ose

b) fotografitë apo katalogët teknikë; dhe/ose

c) dëshmi për rezultatet e testimeve zyrtare, të lëshuara nga institucione të autorizuar, që vërtetojnë pajtueshmërinë e produkteve me specifikimet teknike.

III.1.8. Në nenin 44 “Kërkesat e cilësisë” të VKM nr. 285 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik”, e ndryshuar parashikohet se: “1. Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit”.

III.1.9. Në nenin 36 “Specifikimet teknike” të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik” parashikohet shprehimisht se:

“1. Specifikimet teknike, siç përcaktohen në nenin 4 të këtij ligji, duhet të përshkruhen në dokumentet e tenderit. Në specifikimet teknike përcaktohen qartë karakteristikat e punëve, shërbimit ose furnizimit që do të prokurohet.

Këto karakteristika mund të lidhen edhe me procesin specifik ose metodën e prodhimit ose ofrimit të punëve, furnizimeve ose shërbimeve të kërkuara ose me një proces specifik për një fazë tjetër të ciklit jetësor edhe kur këta faktorë nuk përbëjnë përmbajtjen e saj thelbësore nëse ato janë të lidhura me objektin e kontratës dhe proporcionale me vlerën dhe objektivat e saj. Në specifikimet teknike mund të specifikohet edhe nëse do të jetë i nevojshëm transferimi i të drejtave të pronësisë intelektuale.

Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve të justifikuara plotësisht, hartohen në mënyrë të tillë që të marrin në konsideratë kriteret e aksesueshmërisë për personat me aftësi të kufizuara ose projektimit për të gjithë përdoruesit, sipas kërkesave në legjislacionin në fuqi.

2. Specifikimet teknike duhet të mundësojnë trajtim të barabartë për të gjithë kandidatët dhe ofertuesit dhe të mos shërbejnë si pengesa për konkurrencën e hapur në prokurimin publik.

3. Specifikimet teknike duhet të përshkruajnë qartë kërkesat e autoritetit ose entit kontraktor, duke iu referuar:

a) kërkesave funksionale ose të performancës, përfshirë karakteristikat mjedisore, me kusht që parametrat të jenë të saktë në mënyrë që t’u japin mundësi ofertuesve të përcaktojnë objektin e kontratës dhe autoriteteve ose enteve kontraktore të japin kontratën;

b) standardeve kombëtare, që mbështeten në ato ndërkombëtare, miratimeve teknike ndërkombëtare, specifikimeve teknike të përgjithshme, standardeve ndërkombëtare apo sistemeve të tjera teknike të referimit, të përcaktuara nga organet ndërkombëtare të standardizimit. Kur këto nuk ekzistojnë, ato u referohen standardeve kombëtare, miratimeve teknike kombëtare ose specifikimeve teknike kombëtare, që lidhen me projektimin, përlllogaritjen dhe ekzekutimin e punëve ose përdorimin e produkteve;

c) kërkesave në terma funksionalë sipas shkronjës “a”, referuar specifikimeve teknike sipas shkronjës “b” të kësaj pike, si mënyrë që nënkupton pajtueshmëri me kërkesat funksionale;

ç) të dyja metodave të përcaktuara në shkronjat “a” dhe “b” të pikës 3 të këtij neni, për mallra, shërbime ose punë të ndryshme, të përfshira në të njëjtin objekt kontrate. Çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.

4. Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të këtij neni. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

5. Në rast se autoriteti ose enti kontraktor përcakton specifikimet teknike në bazë të shkronjës “b” të pikës 3 të këtij neni, nuk mund të refuzojë një ofertë me argumentin se punët, furnizimet apo shërbimet për të cilat është dorëzuar oferta nuk plotësojnë specifikimet teknike, të cilave u referohen, për sa kohë që ofertuesi provon në ofertën e tij me çdo mjet të përshtatshëm që zgjidhjet e propozuara përmbushin kërkesat e përcaktuara në specifikimet teknike në mënyrë ekuivalente.

6. Në rast se autoriteti ose enti kontraktor përcakton specifikimet teknike në bazë të shkronjës “a” të pikës 3 të këtij neni, ai nuk mund të refuzojë një ofertë për punë, mallra apo shërbime, e cila është në përputhje me standardet kombëtare, që mbështeten në ato ndërkombëtare, miratimet teknike ndërkombëtare, specifikimet teknike të përgjithshme, standardet ndërkombëtare apo sistemet e tjera teknike të referimit, të përcaktuara nga organet ndërkombëtare të standardizimit kur këto specifikime teknike përmbushin kriteret funksionale, të përcaktuara nga autoriteti/enti kontraktor”

III.1.10. KPP gjykon, se kriteret për kualifikim vendosen që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente, duhet të refuzohen si të papranueshme. Autoriteti kontraktor, duke qenë se është përfituesi direkt i kontratës objekt-prokurimi, është në të drejtën e tij të garantohet se operatorët ekonomikë pjesëmarrës i plotësojnë kërkesat e cilësisë për produktet që do të ofrojnë, e rrjedhimisht është e drejtë e këtij të fundit t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikatat e cilësisë. Gjithashtu, një ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurës së prokurimit është ai barazisë në trajtimin

e kërkesave dhe të detyrimeve, që u ngarkohen ofertuesve ose kandidatëve, parashikuar nga neni 3 i ligjit nr. Nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”. Zbatimi i parimit të transparencës, barazisë dhe mosdiskriminimit, janë garancitë kyçe ndaj ofertuesve që ofron kuadri ligjor në fuqi. Këto parime ndër të tjera nënkuptojnë, se operatorët ekonomikë duhet të jenë në një pozicion barazie, si kur përgatisin ofertat e tyre, ashtu dhe kur të vlerësohen ato. Operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit, me dokumentacionin e dorëzuar, duhet të vërtetojnë, që produkti i ofruar është në përputhje me parametrat dhe specifikimet teknike e kërkuara nga autoriteti kontraktor. Operatorët ekonomikë ofertues marrin përsipër përmbushjen e specifikimeve teknike/ kriterëve të përcaktuara në dokumentet e tenderit nga ana e autoriteteve kontraktore, nëpërmjet deklaratave dhe dokumentacionit provues në të cilin duhet të faktojnë përputhshmërinë e dokumentacionit me kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor, në mënyrë që nga ana e këtij të fundit të mund të kryhet me lehtësi e saktësi vlerësimi i mallrave apo shërbimeve të ofertuara nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës, duke përzgjedhur atë ofertues, i cili me dokumentacionin e dorëzuar garanton përputhshmërinë me kriteret e përcaktuara në DT, e rrjedhimisht realizimin me sukses të kontratës objekt - prokurimi.

III.1.11. Në rastin konkret, referuar dokumentacionit të ngarkuar në sistemin e prokurimit elektronik nga operatori ekonomik ankimues, me qëllim përmbushjen e kriterit lidhur me paraqitjen e katalogëve ose skedat teknike të prodhuesit/ve, ku të specifikohen materialet që do të ofrohen për sa i përket paisjeve mjekësore sipas kërkesave të autoritetit kontraktor në pikën 2.4.2 të kriterëve të veçanta të kualifikimit të dokumenteve standarde të tenderit, Komisioni i Prokurimit Publik konstaton, se ky i fundit ka paraqitur dokumentacionin e përcaktuar në pikën III.6.2 të këtij vendimi. Nisur nga arsyeja e skualifikimit të operatorit ekonomik ankimues, si dhe nga verifikimi i dokumentacionit të dorëzuar prej tij në sistemin e prokurimeve elektronike për përmbushjen e këtij kriteri, KPP konstaton, se me dokumentacionin e paraqitur, operatori ekonomik anikumes “Alko Impex General Construction” SHPK nuk ka përmbushur plotësisht kriterin e mësipërm. Konkretisht, KPP vëren, se nga dokumentacioni i ngarkuar në sistem, nga operatori ekonomik ankimues si autorizim prodhuesi, autorizim distributori, dhe Certifikatë regjistrimi me nr. 3603/2 prot, datë 21.06.2022, lëshuar nga Agjencia Kombëtare e Barnave dhe e Pajisjeve Mjekësore, bashkëlidhur lista e artikujve të aplikimit për regjistrim certifikate nr. 12180, lëshuar në emër të shoqërisë “GTS- Gazra Teknik Shqiptarë” SHPK nuk mund të konsiderohet si skedë teknike apo katalog për pajisjet mjekësore pasi nuk pasqyron të dhëna të specifikimeve teknike për pajisjet e ofruara. KPP gjykon, se mungesa fizike e dokumentacionit të kërkuar shprehimisht në kriterin e kualifikimit, përbën shkak për skualifikim në kuptim të nenit 82 të Vendimit Nr. 285 datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, në të cilën përcaktohet se Komisioni i Vlerësimit të Ofertave verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta, që përmbushin kërkesat për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe janë të përgjegjshme/vlefshme. Është detyrim ligjor i subjektit ofertues të provojë me dokumentacion të plotë dhe në përputhje me kërkesat e autoritetit kontraktor plotësimin e kriterëve të kërkuara në dokumentet e tenderit, pasi ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Akoma më tej KPP sqaron, se në një procedurë prokurimi, subjekti i parë i

interesuar është operatori ekonomik, i cili e përgatit ofertën e tij në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi dhe nga ana tjetër, është autoriteti kontraktor, i cili përzgjedh operatorin ekonomik që plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit. Sa më sipër operatori ekonomik ankimues nuk ka përmbushur kriterin e përcaktuar në pikën 2.4.2 të kriteve të veçanta të kualifikimit në lidhje me paraqitjen e katalogëve/skedave teknike për pajisjet mjekësore.

III.1.12. Lidhur me arsyen e skualifikimit të operatorit ekonomik ankimues, se ky i fundit nuk ka paraqitur “për materialet pajisje fikje zjarri, autorizim prodhuesi ose distributori me Boccione Antincendio S.p.a., disponon vetëm katalog në gjuhën Italiane (të papërkthyer dhe noterizuar)”. Nga shqyrtimi i dokumenteve të tenderit, vërejmë se autoriteti kontraktor në kriteret e veçanta të kualifikimit pika 2.4.2 ka kërkuar shprehimisht që “*Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë autorizim prodhuesi ose distributori. Në rast paraqitje autorizim distributori duhet të paraqitet kontrata ose dokumenti i angazhimit midis prodhuesit dhe distributorit, për materialet (pajisjet mjekësore, hidroizolues, pajisjet mekanike, pajisjet hidrosanitare, shtrese pvc antibakteriale, dyer/dritare, gipse, bojrat, pajisjet e zjarri, pajisjet e sistemit HVAC, ashensori) per objektet shendetesore. Per materialet e kerkuara OE duhet te paraqese katalogun/et ose skedat teknike të prodhuesit/ve, ku të specifikohen materialet që do të ofrohen si dhe te paraqiten certifikatë/deklaratë konfirmimit CE ose ekuivalente*”. Nga verifikimi i dokumentacionit të dorëzuar në sistemin e prokurimit elektronik, nga operatori ekonomik ankimues, konstatohet, se ky i fundit ka paraqitur dokumentin Autorizim Distributori nga shoqëria “Haki Sinani” ndër të tjera edhe për pajisjet e sistemit HVAC, dhe dokumentin pajisjet HVAC pjesa 3 pdf 19.26 MB, në të cilin konstatohet katalogu nga Boccione Antincendio, i cili fillon me faqen 15 dhe përfundon me faqen 170 në gjuhën italiane, i papërkthyer dhe noterizuar. KPP vëren, se operatori ekonomik ankimues për përmbushjen e këtij kriteri kualifikues të sipërpërmendur dhe për pajisjen e ofruar të prodhuesit, ka dorëzuar autorizim distributori të lëshuar nga shoqëria “Haki Sinani” SHPK, por në asnjë rast nuk vërtetohet, se është prodhues i pajisjes së zjarrit, ndërkohë që prodhues sipas katalogut të dorëzuar, rezulton shoqëria Boccione Antincendio, ndërkohë që kriteri kualifikues ka përcaktuar qartë se *operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë autorizim prodhuesi ose distributori. Në rast paraqitje autorizimi distributori duhet të paraqitet kontrata ose dokumenti i angazhimit midis prodhuesit dhe distributorit*. Nisur nga sa parashtruar më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se operatori ekonomik ankimues nuk plotëson kriterin kualifikues të përcaktuar në pikën 2.4.2 të duke dështuar që të dorëzojë autorizim prodhuesi apo lidhjen midis prodhuesit dhe distributorit të autorizuar. Gjithashtu, nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur nga operatori ekonomik ankimues në Sistemin e Prokurimeve Elektronike, KPP-ja konstaton, se në përmbushje të kriteve të vendosura nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit, operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ndër të tjera dokumentin pajisjet HVAC pjesa 3 pdf 19.26 MB, në të cilin konstatohet katalogu nga Boccione Antincendio, i cili fillon me faqen 15 dhe përfundon me faqen 170, të cilat rezultojnë të jenë, në gjuhë të huaj dhe të pashoqëruara me përkthim të noterizuar, në kundërshtim me përcaktimet e autoritetit kontraktor në dokumentet e tenderit. Në pikën 4.5 të seksionit IV të dokumenteve të tenderit, “Procedura”, si dhe në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, është përcaktuar qartë, që gjuha e

përdorur është gjuha shqipe dhe rrjedhimisht çdo dokument i paraqitur në gjuhë të huaj duhet të jetë i përkthyer dhe noterizuar në gjuhën shqipe. Sqarojmë, se përkufizimi ligjor i mësipërm është gjithëpërfshirës, pra për të gjithë dokumentacionin përkatës, që paraqitet në këtë procedurë prokurimi. Në kushtet kur, në dokumentet e tenderit të hartuara e të miratuara nga Agjencia e Prokurimit Publik, e konkretisht në kriteret e përgjithshme të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë, si dhe nuk duhet të ndryshohen për asnjë arsye nga autoriteti kontraktor gjatë hartimit të dokumenteve të tenderit, është përcaktuar qartësisht se *“Nëse gjuha e përdorur në procedurë është gjuha shqipe, atëherë dokumentet në gjuhë të huaj duhet të shoqërohen me një përkthim të noterizuar në gjuhën shqipe”* në këtë kuadër, i gjithë dokumentacioni i paraqitur në procedurën e prokurimit në sistem elektronik duhet të jetë në gjuhën shqipe ose i shoqëruar me përkthim të noterizuar në gjuhën shqipe. Gjithashtu, duke u referuar në DST e procedurës objekt-ankimi, konkretisht në kreun *“Udhëzime për operatorët ekonomikë”* Seksioni 1, *“B Përgatitja e ofertave”* pika 2 *‘Gjuha e ofertës’* ku përcaktohet se: *Oferta, si dhe të gjitha korrespondencat dhe dokumentet në lidhje me procedurën e prokurimit do të paraqiten në gjuhën/gjuhët e specifikuar në njoftimin e kontratës. Dokumentet mbështetëse dhe literatura e printuar që janë pjesë e Ofertës mund të jenë në një gjuhë tjetër me kusht që ato të shoqërohen nga një përkthim zyrtar i fragmenteve përkatëse në gjuhën e specifikuar në njoftim”*, duhet që të gjithë dokumentet e paraqitura në rrugë elektronike të jenë në gjuhën shqipe siç autoriteti kontraktor ka përcaktuar në njoftimin e kontratës ose nëse janë në gjuhë të huaj duhet të shoqërohen me një përkthim të noterizuar në gjuhën shqipe. Në rastin konkret në sistemin e prokurimit elektronik, operatori ekonomik ankimues ka paraqitur, në gjuhë të huaj, katalogon e sipërcituar dhe të pashoqëruar me përkthim të noterizuar në gjuhën shqipe në kundërshtim me atë që autoriteti kontraktor ka përcaktuar në përmbajtjen e dokumenteve të tenderit. Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin oferta, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit, pasi ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente do të refuzohen si të papranueshme. Akoma më tej, Komisioni gjykon, se nuk jemi përballë devijimeve të vogla në ofertë sikundër operatori ekonomik ankimues pretendon, sepse modifikime të tilla do të ndryshonin përmbajtjen e ofertës, duke synuar të kthejnë një ofertë nga e pavlefshme në të vlefshme, në kundërshtim kjo me nenin 92 pika 1 të *lex specialis*. Në këtë kuadër, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se nga ana e ankimuesit nuk janë përmbushur të gjitha kërkesat që autoriteti kontraktor ka përcaktuar në dokumentet e tenderit, duke dorëzuar dokumente në gjuhë të huaj të pashoqëruara me përkthim të noterizuar, një kusht ky i detyrueshëm për ankimuesin, pasi ai duhet të plotësojë çdo kërkesë dhe kriter të vendosur nga autoriteti kontraktor, si dhe të paraqesë çdo dokumentacion, që përmban të dhëna dhe elemente që janë gjykuar të nevojshme dhe të domosdoshme nga ana e këtij të fundit.

III.1.13. Lidhur me arsyen e skualifikimit të operatorit ekonomik ankimues se *“për materialet shtrese pvc antibakteriale ka paraqitur autorizim nga distributori Teknoedil, Katalogun në gjuhën angleze dhe certifikata në gjuhën angleze (të papërkthyer dhe noterizuara)”*, nga shqyrtimi i dokumenteve të tenderit, vërejmë se autoriteti kontraktor në kriteret e veçanta të kualifikimit pika 2.4.2 ka kërkuar shprehimisht që *“Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë autorizim prodhuesi ose distributori. Në rast paraqitje autorizim distributori duhet të paraqitet kontrata ose dokumenti i angazhimit midis prodhuesit dhe distributorit, për*

materialet (pajisjet mjekesore, hidroizolues, pajisjet mekanike, pajisjet hidrosanitare, shtrese pvc antibakteriale, dyer/dritare, gipse, bojrat, pajisjet e zjarri, pajisjet e sistemin HVAC, ashensori) per objektet shendetesore. Per materialet e kerkuara OE duhet te paraqese katalogun/et ose skedat teknike te prodhuesit/ve, ku te specifikohen materialet qe do te ofrohen si dhe te paraqiten certifikatë/deklaratë konfirmimit CE ose ekuivalente". Nga verifikimi i dokumentacionit të dorëzuar në sistemin e prokurimit elektronik, nga operatori ekonomik ankimes, konstatohet se ky i fundit ka paraqitur dokumentin autorizim distributori "Teknoedil" SHPK, autorizim prodhuesi nga "Gerflor SAS", certifikatë/vërtetim dhe katalog nga Gerflor për shtresat antibakteriale. Nga verifikimi i dokumentacionit të sipërcituar konstatohet, se katalogu nga Gerflor dhe certifikata/vërtetimi janë në gjuhën angleze të papërkthyer dhe noterizuara, në kundërshtim me përcaktimet e autoritetit kontraktor në dokumentet e tenderit. Në pikën 4.7 të seksionit IV të dokumenteve të tenderit, "Gjuha", si dhe në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar, është përcaktuar qartë që gjuha e përdorur është gjuha shqipe dhe rrjedhimisht çdo dokument i paraqitur në gjuhë të huaj duhet të jetë i përkthyer dhe noterizuar në gjuhën shqipe, për sa kohë që procedura e prokurimit është nën kufirin e lartë monetar. Sqarojmë, se përkufizimi ligjor i mësipërm është gjithëpërfshirës, pra për të gjithë dokumentacionin përkatës, që paraqitet në këtë procedurë prokurimi. Në kushtet kur, në dokumentet e tenderit të hartuara e të miratuara nga Agjencia e Prokurimit Publik, e konkretisht në kriteret e përgjithshme të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë, si dhe nuk duhet të ndryshohen për asnjë arsye nga autoriteti kontraktor gjatë hartimit të dokumenteve të tenderit, është përcaktuar qartësisht se "Nëse gjuha e përdorur në procedurë është gjuha shqipe, atëherë dokumentet në gjuhë të huaj duhet të shoqërohen me një përkthim të noterizuar në gjuhën shqipe" në këtë kuadër i gjithë dokumentacioni i paraqitur në procedurën e prokurimit në sistem elektronik duhet të jetë në gjuhën shqipe ose i shoqëruar me përkthim të noterizuar në gjuhën shqipe. Gjithashtu, duke u referuar në DST e procedurës objekt-ankimi, konkretisht në kreun "Udhëzime për operatorët ekonomikë" Seksioni 1, "B Përgatitja e ofertave" pika 2 "Gjuha e ofertës" ku përcaktohet se: *Oferta, si dhe të gjitha korrespondencat dhe dokumentet në lidhje me procedurën e prokurimit do të paraqiten në gjuhën/gjuhët e specifikuar në njoftimin e kontratës. Dokumentet mbështetëse dhe literatura e printuar që janë pjesë e Ofertës mund të jenë në një gjuhë tjetër me kusht që ato të shoqërohen nga një përkthim zyrtar i fragmenteve përkatëse në gjuhën e specifikuar në njoftim*", duhet që të gjithë dokumentet e paraqitura në rrugë elektronike të jenë në gjuhën shqipe siç autoriteti kontraktor ka përcaktuar në njoftimin e kontratës ose nëse janë në gjuhë të huaj duhet të shoqërohen me një përkthim të noterizuar në gjuhën shqipe. Në rastin konkret, në sistemin e prokurimit elektronik operatori ekonomik ankimes ka paraqitur në gjuhë të huaj, katalogon e sipërcituar dhe të pashoqëruar me përkthim të noterizuar në gjuhën shqipe në kundërshtim me atë që autoriteti kontraktor ka përcaktuar në përmbajtjen e dokumenteve të tenderit. Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin oferta, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit, pasi ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente do të refuzohen si të papranueshme. Akoma më tej, Komisioni gjykon, se nuk jemi përballë devijimeve të vogla në ofertë, sepse modifikime të tilla do të ndryshonin përmbajtjen e ofertës, duke synuar të kthejnë një ofertë nga e pavlefshme në të vlefshme, në kundërshtim kjo me nenin 92 pika 1 të *lex specialis*. Në këtë kuadër, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se nga

ana e ankimuesit nuk janë përmbushur të gjitha kërkesat që autoriteti kontraktor ka përcaktuar në dokumentet e tenderit, duke dorëzuar dokumente në gjuhë të huaj të pashoqëruara me përkthim të noterizuar, një kusht ky i detyrueshëm për ankimuesin, pasi ai duhet të plotësojë çdo kërkesë dhe kriter të vendosur nga autoriteti kontraktor, si dhe të paraqesë çdo dokumentacion, që përmban të dhëna dhe elemente që janë gjykuar të nevojshme dhe të domosdoshme nga ana e këtij të fundit.

III.1.14. Lidhur me arsyen e skualifikimit të operatorit ekonomik ankimues se “për materialin bojë, autorizimi i prodhuesit Colorificio Sammarinese s.p.a është në gjuhën Italiane, Skeda teknike në gjuhën italiane dhe certifikata në gjuhën italiane (të papërkthyer dhe noterizuara).”, nga shqyrtimi i dokumenteve të tenderit, vërejmë se autoriteti kontraktor në kriteret e veçanta të kualifikimit pika 2.4.2 ka kërkuar shprehimisht që *“Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë autorizim prodhuesi ose distributori. Në rast paraqitje autorizim distributori duhet të paraqitet kontrata ose dokumenti i angazhimit midis prodhuesit dhe distributorit, për materialet (pajisjet mjekesore, hidroizolues, pajisjet mekanike, pajisjet hidrosanitare, shtrese pvc antibakteriale, dyer/dritare, gipse, bojrat, pajisjet e zjarri, pajisjet e sistemit HVAC, ashensori) per objektet shendetesore. Per materialet e kerkuara OE duhet te paraqese katalogun/et ose skedat teknike të prodhuesit/ve, ku të specifikohen materialet që do të ofrohen si dhe te paraqiten certifikatë/deklaratë konfirmimiti CE ose ekuivalente”*. Nga verifikimi i dokumentacionit të dorëzuar në sistemin e prokurimit elektronik, nga operatori ekonomik ankimues, konstatohet se ky i fundit ka paraqitur dokumentin kontratë furnizimi të datës 08.05.2023 midis shoqërisë “Tolimo” SHPK furnizuesi dhe shoqërisë “Alko Impex General Construction” SHPK porositi, autorizim prodhuesi nga Colorificio Sammarinese s.p.a i cili autorizon shoqërinë “Tolimo” SHPK, certifikatë dhe skedë teknike. Prodhuesi Colorificio Sammarinese s.p.a për materialin bojra, nga verifikimi i dokumentacionit të sipërcituar konstatohet, se autorizimi prodhuesit, skeda teknike dhe certifikata janë në gjuhën italiane të papërkthyer dhe noterizuar, në kundërshtim me përcaktimet e autoritetit kontraktor në dokumentet e tenderit. Në pikën 4.7 të seksionit IV të dokumenteve të tenderit, “Gjuha”, si dhe në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, është përcaktuar qartë që gjuha e përdorur është gjuha shqipe dhe rrjedhimisht çdo dokument i paraqitur në gjuhë të huaj duhet të jetë i përkthyer dhe noterizuar në gjuhën shqipe, për sa kohë që procedura e prokurimit është nën kufirin e lartë monetar. Sqarojmë, se përkufizimi ligjor i mësipërm është gjithpërfshirës, pra për të gjithë dokumentacionin përkatës, që paraqitet në këtë procedurë prokurimi. Në kushtet kur, në dokumentet e tenderit të hartuara e të miratuara nga Agjencia e Prokurimit Publik, e konkretisht në kriteret e përgjithshme të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë, si dhe nuk duhet të ndryshohen për asnjë arsye nga autoriteti kontraktor gjatë hartimit të dokumenteve të tenderit, është përcaktuar qartësisht se *“Nëse gjuha e përdorur në procedurë është gjuha shqipe, atëherë dokumentet në gjuhë të huaj duhet të shoqërohen me një përkthim të noterizuar në gjuhën shqipe”*, në këtë kuadër i gjithë dokumentacioni i paraqitur në procedurën e prokurimit në sistem elektronik duhet të jetë në gjuhën shqipe ose i shoqëruar me përkthim të noterizuar në gjuhën shqipe. Gjithashtu, duke u referuar në DST e procedurës objekt-ankimi, konkretisht në kreun *“Udhëzime për operatorët ekonomikë”* Seksioni 1, *“B Përgatitja e ofertave”* pika 2 *‘Gjuha e ofertës’* ku përcaktohet se: *Oferta, si dhe të gjitha*

korrespondencat dhe dokumentet në lidhje me procedurën e prokurimit do të paraqiten në gjuhën/gjuhët e specifikuar në njoftimin e kontratës. Dokumentet mbështetëse dhe literatura e printuar që janë pjesë e Ofertës mund të jenë në një gjuhë tjetër me kusht që ato të shoqërohen nga një përkthim zyrtar i fragmenteve përkatëse në gjuhën e specifikuar në njoftim”, duhet që të gjitha dokumentet e paraqitura në rrugë elektronike të jenë në gjuhën shqipe siç autoriteti kontraktor ka përcaktuar në njoftimin e kontratës ose nëse janë në gjuhë të huaj duhet të shoqërohen me një përkthim të noterizuar në gjuhën shqipe. Në rastin konkret, në sistemin e prokurimit elektronik, operatori ekonomik ankimues ka paraqitur në gjuhë të huaj, katalogon e sipërcituar dhe të pashoqëruar me përkthim të noterizuar në gjuhën shqipe, në kundërshtim me atë që autoriteti kontraktor ka përcaktuar në përmbajtjen e dokumenteve të tenderit. Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin oferta, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit, pasi ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente do të refuzohen si të papranueshme. Akoma më tej, Komisioni gjykon, se nuk jemi përballë devijimeve të vogla në ofertë, sepse modifikime të tilla do të ndryshonin përmbajtjen e ofertës, duke synuar të kthejnë një ofertë nga e pavlefshme në të vlefshme, në kundërshtim kjo me nenin 92 pika 1 të *lex specialis*. Në këtë kuadër, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se nga ana e ankimuesit nuk janë përmbushur të gjitha kërkesat që autoriteti kontraktor ka përcaktuar në dokumentet e tenderit, duke dorëzuar dokumente në gjuhë të huaj të pashoqëruara me përkthim të noterizuar, një kusht ky i detyrueshëm për ankimuesin, pasi ai duhet të plotësojë çdo kërkesë dhe kriter të vendosur nga autoriteti kontraktor, si dhe të paraqesë çdo dokumentacion, që përmban të dhëna dhe elemente që janë gjykuar të nevojshme dhe të domosdoshme nga ana e këtij të fundit.

III.1.15. Lidhur me arsyen e skualifikimit të operatorit ekonomik ankimues se “për paisjet e sistemit HVAC, ka paraqitur Kaldajë nga prodhuesi Centrometac d.o.o në gjuhën angleze, katalog /Sked teknike në gjuhën angleze (të papërkthyer dhe noterizuara).”, nga shqyrtimi i dokumenteve të tenderit, vërejmë se autoriteti kontraktor në kriteret e veçanta të kualifikimit pika 2.4.2 ka kërkuar shprehimisht që “*Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë autorizim prodhuesi ose distributori. Në rast paraqitje autorizim distributori duhet të paraqitet kontrata ose dokumenti i angazhimit midis prodhuesit dhe distributorit, për materialet (pajisjet mjekesore, hidroizolues, pajisjet mekanike, pajisjet hidrosanitare, shtrese pvc antibakteriale, dyer/dritare, gipse, bojrat, pajisjet e zjarrit, pajisjet e sistemit HVAC, ashensori) për objektet shendetesore. Për materialet e kerkuara OE duhet te paraqese katalogun/et ose skedat teknike të prodhuesit/ve, ku të specifikohen materialet që do të ofrohen, si dhe te paraqiten certifikatë/deklaratë konfirmimiti CE ose ekuivalente*”. Nga verifikimi i dokumentacionit të dorëzuar në sistemin e prokurimit elektronik, nga operatori ekonomik ankimues, konstatohet se ky i fundit ka paraqitur dokumentin katalog të shoqërisë Centrometal d.o.o për pajisjen kaldajë. Nga verifikimi i dokumentacionit të sipërcituar konstatohet, se katalogu i paraqitur për pajisjen kaldajë nga shoqëria Centrometal d.o.o, është në gjuhën angleze, i papërkthyer dhe noterizuar, në kundërshtim me përcaktimet e autoritetit kontraktor në dokumentet e tenderit. Në pikën 4.7 të seksionit IV të dokumenteve të tenderit, “Gjuha”, si dhe në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, është përcaktuar qartë që gjuha e përdorur është gjuha shqipe dhe rrjedhimisht çdo dokument i paraqitur në gjuhë të huaj duhet të jetë i përkthyer dhe noterizuar

në gjuhën shqipe, për sa kohë që procedura e prokurimit është nën kufirin e lartë monetar. Sqarojmë, se përkufizimi ligjor i mësipërm është gjithpërfshirës, pra për të gjithë dokumentacionin përkatës, që paraqitet në këtë procedurë prokurimi. Në kushtet kur, në dokumentet e tenderit të hartuara e të miratuara nga Agjencia e Prokurimit Publik, e konkretisht në kriteret e përgjithshme të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë, si dhe nuk duhet të ndryshohen për asnjë arsye nga autoriteti kontraktor gjatë hartimit të dokumenteve të tenderit, është përcaktuar qartësisht se *“Nëse gjuha e përdorur në procedurë është gjuha shqipe, atëherë dokumentet në gjuhë të huaj duhet të shoqërohen me një përkthim të noterizuar në gjuhën shqipe”*, në këtë kuadër i gjithë dokumentacioni i paraqitur në procedurën e prokurimit në sistem elektronik duhet të jetë në gjuhën shqipe ose i shoqëruar me përkthim të noterizuar në gjuhën shqipe. Gjithashtu, duke u referuar në DST e procedurës objekt-ankimi, konkretisht në kreun *“Udhëzime për operatorët ekonomikë”* Seksioni 1, *“B Përgatitja e ofertave”* pika 2 *‘Gjuha e ofertës’* ku përcaktohet se: *Oferta, si dhe të gjitha korrespondencat dhe dokumentet në lidhje me procedurën e prokurimit do të paraqiten në gjuhën/gjuhët e specifikuar në njoftimin e kontratës. Dokumentet mbështetëse dhe literatura e printuar që janë pjesë e Ofertës mund të jenë në një gjuhë tjetër me kusht që ato të shoqërohen nga një përkthim zyrtar i fragmenteve përkatëse në gjuhën e specifikuar në njoftim*”, duhet që të gjithë dokumentet e paraqitura në rrugë elektronike të jenë në gjuhën shqipe siç autoriteti kontraktor ka përcaktuar në njoftimin e kontratës ose nëse janë në gjuhë të huaj duhet të shoqërohen me një përkthim të noterizuar në gjuhën shqipe. Në rastin konkret në sistemin e prokurimit elektronik, operatori ekonomik ankimues ka paraqitur në gjuhë të huaj, katalogon e sipërcituar dhe të pashoqëruar me përkthim të noterizuar në gjuhën shqipe, në kundërshtim me atë që autoriteti kontraktor ka përcaktuar në përmbajtjen e dokumenteve të tenderit. Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin oferta, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit, pasi ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente do të refuzohen si të papranueshme. Akoma më tej, Komisioni gjykon, se nuk jemi përballë devijimeve të vogla në ofertë, sepse modifikime të tilla do të ndryshonin përmbajtjen e ofertës, duke synuar të kthejnë një ofertë nga e pavlefshme në të vlefshme, në kundërshtim kjo me nenin 92 pika 1 *të lex specialis*. Në këtë kuadër, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se nga ana e ankimuesit nuk janë përmbushur të gjitha kërkesat që autoriteti kontraktor ka përcaktuar në dokumentet e tenderit, duke dorëzuar dokumente në gjuhë të huaj të pashoqëruara me përkthim të noterizuar, një kusht ky i detyrueshëm për ankimuesin, pasi ai duhet të plotësojë çdo kërkesë dhe kriter të vendosur nga autoriteti kontraktor, si dhe të paraqesë çdo dokumentacion, që përmban të dhëna dhe elemente që janë gjykuar të nevojshme dhe të domosdoshme nga ana e këtij të fundit.

III.1.16. Lidhur me arsyen e skualifikimit të operatorit ekonomik ankimues se *“për materialin gips ka paraqitur autorizim prodhuesi nga Dekoll Sh.a shoqëruar me katalog të weber saint gobain, Dekoll Sh.a, nuk verteton se prodhon materiale gipsi, mungon katalogu ose skedat teknike si dhe certifikata/deklarata konformitetit CE”*., nga shqyrtimi i kriterit kualifikues ë përcaktuar në pikën 2.4.2 të Shtojcës 7/2 të dokumenteve të tenderit, Komisioni i Prokurimit Publik konstaton, se autoriteti kontraktor ka përcaktuar se *“Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë autorizim prodhuesi ose distributori. Në rast paraqitje autorizim distributori duhet të paraqitet kontrata ose dokumenti i angazhimit midis prodhuesit dhe distributorit, për*

materialet (pajisjet mjekesore, hidroizolues, pajisjet mekanike, pajisjet hidrosanitare, shtrese pvc antibakteriale, dyer/dritare, gipse, bojrat, pajisjet e zjarrit, pajisjet e sistemit HVAC, ashensori) per objektet shendetesore. Per materialet e kerkuara OE duhet te paraqese katalogun/et ose skedat teknike te prodhuesit/ve, ku te specifikohen materialet qe do te ofrohen si dhe te paraqiten certifikatë/deklaratë konfirmimiti CE ose ekuivalente”. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të ofertës të dorëzuar nga ana e shoqërisë “Alko Impex General Construction” SHPK, Komisioni i Prokurimit Publik konstaton, se kjo shoqëri ka paraqitur ofertë në këtë procedurë prokurimi në cilësinë e operatorit ekonomik dhe ka dorëzuar në dokumentacionin e ofertës, dokumentet si në vijim, Kontratë Furnizimi midis shoqërisë Dekoll SHPK si furnizues dhe shoqërisë “Alko Impex General Construction” SHPK si porositës për materiale suvatimi, veshje, gipsi, termoizoluese, hidroizoluese, bojra dhe rifinitura, Aautorizim prodhuesi lëshuar nga Dekoll SHPK për shoqërinë “Alko Impex General Construction” SHPK, katalog dhe dokumentacion të Dekoll SHPK, katalog dhe dokumentacion të Saint-Gobain SHPK. Nga shqyrtimi i kriterit kualifikues të sipërpërmendur, dokumentacionit të ofertës së dorëzuar nga operatori ekonomik ankimues, si dhe nga përcaktimet e nenit 82 pika 2 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon se operatori ekonomik ankimues, për përmbushjen e kriterit kualifikues të sipërpërmendur të përcaktuar në pikën 2.4.2 të Shtojcës 7/2 të dokumenteve të tenderit duhej që të paraqiste autorizim nga prodhuesit e materialeve të gipsit si dhe katalog apo skedë teknike për materialet e gipsit, ose autorizim nga distributorë të autorizuar nga kompanitë prodhuese të matërialeve të gipsit, si dhe të vërtetojë dhe lidhjen midis distributorit të autorizuar dhe kompanisë prodhuese. Referuar autorizimit të lëshuar nga Dekoll SHA, në asnjë moment nuk vërtetohet se ky subjekt është prodhues i gipsit, gjithashtu edhe në katalogët e dorëzuar nga ky subjekt nuk evidentohet në asnjë moment materiali i gipsit në katalog. Komisioni i Prokurimit Publik, referuar dokumentacionit të sipërcituar të paraqitur nga ankimuesi në përmbushje të kriterit kualifikues, lidhur me autorizimin e prodhuesit për gips dhe katalogët për këtë material, konstaton se operatori ekonomik ankimues nuk arrin të dëshmojë me anë të dokumentacionit, se disponon autorizim nga prodhuesi për materialin gips dhe as të ketë dorëzuar katalog për këtë material. Në këto kushte, KPP gjykon, se operatori ekonomik ankimues është në kushtet e mospërmbushjes së kriterëve të veçanta të kualifikimit pasi ky i fundit nuk arrin të vërtetojë së është i autorizuar nga prodhuesi për materialet gips dhe nuk ka paraqitur katalog për këtë material ashtu sikurse është kërkuar në dokumentet standarde të tenderit, duke dështuar që të dorëzojë autorizim prodhuesi nga kompania prodhuese e materialit gips, si dhe ka dështuar që të dorëzojë një dokument që të vërtetojë lidhjen midis kompanisë Dekoll SHPK dhe “Saint Gobain” SHPK. Gjithashtu ka dështuar të vërtetojë edhe paraqitjen e katalogut dhe certifikata/deklarata konformitetit CE për materialin e gipsit sikurse është kërkuar në DST. Sqarojmë se, referuar rregullave të prokurimit publik, kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të vërtetojnë se zotërojnë reputacionin, besueshmërinë dhe përvojën e duhur, për të zbatuar kontratën objekt - prokurimi, si edhe janë të detyruar të përgatisin oferta, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit, në mënyrë që edhe vlerësimi të bëhet në përputhje me këtë dokumentacion, pasi ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumenta duhet të refuzohen si të papranueshme. Mosplotësimi qoftë

edhe i një kriteri të vendosur nga ana e autoritetit kontraktor e bën ofertën e operatorit ekonomik të pavlefshme, si edhe përbën kusht për skualifikimin e tij nga procedura e prokurimit. Dokumentacioni i paraqitur nga operatori ekonomik ankimues në procedurën e prokurimit, nuk plotëson kërkesat e autoritetit kontraktor dhe nuk mund të konsiderohet i vlefshëm. Operatori ekonomik ankimues, duhet të dorëzonte të gjithë dokumentacionin e ofertës në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit nga autoriteti kontraktor, në sistemin elektronik të prokurimeve.

III.1.17. Lidhur me arsyen e skualifikimit të operatorit ekonomik ankimues se “nuk ka paraqitur autorizim prodhuesi ose distributori, katalog ose skedë teknike për dyer të brendshme laminat me kase alumini, e pajisur me aksesore “heavy duty”, me nje ose dy kanata sipas vizatimeve”., nga shqyrtimi i kriterit kualifikues të përcaktuar në pikën 2.4.2 të Shtojcës 7/2 të dokumenteve të tenderit, Komisioni i Prokurimit Publik konstaton, se autoriteti kontraktor ka përcaktuar se *“Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë autorizim prodhuesi ose distributori. Në rast paraqitje autorizim distributori duhet të paraqitet kontrata ose dokumenti i angazhimit midis prodhuesit dhe distributorit, për materialet (pajisjet mjekesore, hidroizolues, pajisjet mekanike, pajisjet hidrosanitare, shtrese pvc antibakteriale, dyer/dritare, gipse, bojrat, pajisjet e zjarrit, pajisjet e sistemit HVAC, ashensori) per objektet shendetesore. Per materialet e kerkuara OE duhet te paraqese katalogun/et ose skedat teknike të prodhuesit/ve, ku të specifikohen materialet që do të ofrohen, si dhe te paraqiten çertifikatë/deklaratë konfirmimiti CE ose ekuivalente”*. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të ofertës të dorëzuar nga ana e shoqërisë “Alko Impex General Construction” SHPK, Komisioni i Prokurimit Publik konstaton se kjo shoqëri ka paraqitur ofertë në këtë procedurë prokurimi në cilësinë e operatorit ekonomik dhe ka dorëzuar në dokumentacionin e ofertës, dokumentet si në vijim, kontratë furnizimi midis shoqërisë Everest SHPK si furnizues dhe shoqërisë “Alko Impex General Construction” SHPK si porosites për produktet Dyer/Dritare, katalog dhe dokumentacion për profile. Nga shqyrtimi i kriterit kualifikues të sipërpërmendur, dokumentacionit të ofertës së dorëzuar nga operatori ekonomik ankimues, si dhe nga përcaktimet e nenit 82 pika 2 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 *“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”*, i ndryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon, se operatori ekonomik ankimues për përmbushjen e kriterit kualifikues të sipërpërmendur të përcaktuar në pikën 2.4.2 të Shtojcës 7/2 të dokumenteve të tenderit duhej që të paraqiste autorizim nga prodhuesi dhe distributori për dyer, si dhe katalog os eskedë teknike për dyer. KPP gjykon, se mungesa fizike e dokumentacionit të kërkuar shprehimisht në kriterin e kualifikimit, përbën shkak për skualifikim në kuptim të nenit 82 të Vendimit Nr. 285 datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave *“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”* i ndryshuar, në të cilin përcaktohet se Komisioni i Vlerësimit të Ofertave verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta, që përmbushin kërkesat për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe janë të përgjegjshme/vlefshme. Është detyrim ligjor i subjektit ofertues të provojë me dokumentacion të plotë dhe në përputhje me kërkesat e autoritetit kontraktor plotësimin e kriterëve të kërkuara në dokumentet e tenderit, pasi ofertat që nuk përkatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Akoma më tej KPP sqaron, se në një procedurë prokurimi, subjekti i parë i interesuar është operatori ekonomik, i cili e përgatit ofertën e tij në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi dhe nga

ana tjetër, është autoriteti kontraktor, i cili përzgjedh operatorin ekonomik që plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit.

III.1.18. Lidhur me arsyen e skualifikimit të operatorit ekonomik ankimues se “për paisjet e sistemit HVAC, ka paraqitur kontratë furnizimi nga Haki Sianani, mungon autorizimi i prodhuesit, mungojnë katalogët për (Pompë Nxehtësie, Njësi Trajtimi Ajri Dërgim, Njësi Trajtimi Ajri Rikthim, Njësi Trajtimi Ajri Rikuperator Nxetësie, Fan Coil DysHEMEJE, Mono Split Mural, Radiator çeliku) si dhe certifikata/deklarata konformitetit CE.”, gga shqyrtimi i kriterit kualifikues të përcaktuar në pikën 2.4.2 të Shtojcës 7/2 të dokumenteve të tenderit, Komisioni i Prokurimit Publik konstaton, se autoriteti kontraktor ka përcaktuar se “*Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë autorizim prodhuesi ose distributori. Në rast paraqitje autorizim distributori duhet të paraqitet kontrata ose dokumenti i angazhimit midis prodhuesit dhe distributorit, për materialet (pajisjet mjekesore, hidroizolues, pajisjet mekanike, pajisjet hidrosanitare, shtrese pvc antibakteriale, dyer/dritare, gipse, bojrat, pajisjet e zjarri, pajisjet e sistemit HVAC, ashensori) për objektet shendetesore. Per materialet e kerkuara OE duhet te paraqese katalogun/et ose skedat teknike të prodhuesit/ve, ku të specifikohen materialet që do të ofrohen si dhe te paraqiten certifikatë/deklaratë konfirmiteti CE ose ekuivalente*”. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të ofertës të dorëzuar nga ana e shoqërisë “*Alko Impex General Construction*” SHPK, Komisioni i Prokurimit Publik konstaton, se kjo shoqëri ka paraqitur ofertë në këtë procedurë prokurimi në cilësinë e operatorit ekonomik dhe ka dorëzuar në dokumentacionin e ofertës, dokumentet si në vijim, kontratë furnizimi midis shoqërisë Haki Sinani SHPK si furnizues dhe shoqërisë “*Alko Impex General Construction*” SHPK si porosites për materiale kaldaja, sisteme kondicionimi, tubacionet e ujit të pijshëm, pajisje hidrosanitare dhe hidraulike, pompat, Autorizim Prodhuiesi lëshuar nga Haki Sinani SHPK për shoqërinë “*Alko Impex General Construction*” SHPK, katalog të Comisa, katalog të Bocciolone Antincendio, Centrometal d.o.o. Nga shqyrtimi i kriterit kualifikues të sipërpërmendur, dokumentacionit të ofertës së dorëzuar nga operatori ekonomik ankimues, si dhe nga përcaktimet e nenit 82 pika 2 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, i ndryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon, se operatori ekonomik ankimues, për përmbushjen e kriterit kualifikues të sipërpërmendur të përcaktuar në pikën 2.4.2 të Shtojcës 7/2 të dokumenteve të tenderit, duhej që të paraqiste autorizim nga prodhuesit e Pompë Nxehtësie, Njësi Trajtimi Ajri Dërgim, Njësi Trajtimi Ajri Rikthim, Njësi Trajtimi Ajri Rikuperator Nxetësie, Fan Coil DysHEMEJE, Mono Split Mural, Radiator çeliku si dhe katalog apo skedë teknike për këto materiale ose autorizim nga distributorë të autorizuar nga kompanitë prodhuese të tyre, duke vërtetuar lidhjen midis distributorit të autorizuar dhe kompanisë prodhuese. Referuar autorizimit të lëshuar nga Haki Sinani SHPK, në asnjë moment nuk vërtetohet se ky subjekt është prodhuies i materialeleve të sipërcituara, gjithashtu edhe në katalogët e dorëzuar nga ky subjekt nuk evidentohen në asnjë moment materialet e sipërcituara në katalog. Komisioni i Prokurimit Publik, referuar dokumentacionit të sipërcituar të paraqitur nga ankimuesi në përmbushje të kriterit kualifikues, lidhur me autorizimin e prodhuesit si dhe katalogët për materialet e sipërcituara, konstaton, se operatori ekonomik ankimues nuk arrin të dëshmojë me anë të dokumentacionit, se disponon autorizim nga prodhuies apo distributori i autorizuar nga prodhuies për këto materiale, si dhe të ketë dorëzuar katalog për këto materiale. KPP gjykon, se operatori ekonomik ankimues është në kushtet e mospërmbushjes së kriterëve

të veçanta të kualifikimit, pasi ky i fundit nuk arrin të vërtetojë së është i autorizuar nga prodhuesi apo distributori i prodhuesit, si dhe nuk ka paraqitur katalog për këto materiale ashtu sikurse është kërkuar në dokumentet standarde të tenderit, duke dështuar që të dorëzojë autorizim prodhuesi nga kompania prodhuese apo një dokument që të vërtetojë lidhjen midis prodhuese dhe distributorit. Gjithashtu ka dështuar të vërtetojë edhe paraqitjen e katalogut dhe certifikatë/deklaratë konformiteti CE për këto materiale sikurse është kërkuar në DST. Sqarojmë, se referuar rregullave të prokurimit publik, kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të vërtetojnë se zotërojnë reputacionin, besueshmërinë dhe përvojën e duhur, për të zbatuar kontratën objekt prokurimi, si edhe janë të detyruar të përgatisin oferta, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit, në mënyrë që edhe vlerësimi të bëhet në përputhje me këtë dokumentacion, pasi ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumenta duhet të refuzohen si të papranueshme. Mosplotësimi qoftë edhe i një kriteri të vendosur nga ana e autoritetit kontraktor e bën ofertën e operatorit ekonomik të pavlefshme, si edhe përbën kusht për skualifikimin e tij nga procedura e prokurimit. Dokumentacioni i paraqitur nga operatori ekonomik ankimues në procedurën e prokurimit, nuk plotëson kërkesat e autoritetit kontraktor dhe nuk mund të konsiderohet i vlefshëm. Operatori ekonomik ankimues, duhet të dorëzonte të gjithë dokumentacionin e ofertës në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit nga autoriteti kontraktor, në sistemin elektronik të prokurimeve.

III.1.19. Lidhur me arsyen e skualifikimit të operatorit ekonomik ankimues se “nuk ka paraqitur autorizim prodhuesi ose distributori për Pompë karburanti dhe për Rezervuar të lëndës djegëse”, nga shqyrtimi i kriterit kualifikues të përcaktuar në pikën 2.4.2 të Shtojcës 7/2 të dokumenteve të tenderit, Komisioni i Prokurimit Publik konstaton, se autoriteti kontraktor ka përcaktuar se “*Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë autorizim prodhuesi ose distributori. Në rast paraqitje autorizim distributori duhet të paraqitet kontrata ose dokumenti i angazhimit midis prodhuesit dhe distributorit, për materialet (pajisjet mjekesore, hidroizolues, pajisjet mekanike, pajisjet hidrosanitare, shtrese pvc antibakteriale, dyer/dritare, gipse, bojrat, pajisjet e zjarrit, pajisjet e sistemit HVAC, ashensori) per objektet shendetesore. Per materialet e kerkuara OE duhet te paraqese katalogun/et ose skodat teknike te prodhuesit/ve, ku te specifikohen materialet qe do te ofrohen si dhe te paraqiten certifikate/deklarate konfirmite CE ose ekuivalente*”. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të ofertës të dorëzuar nga ana e shoqërisë “Alko Impex General Construction” SHPK, kriterit kualifikues të sipërpërmendur, si dhe nga përcaktimet e nenit 82 pika 2 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon, se operatori ekonomik ankimues, për përmbushjen e kriterit kualifikues të sipërpërmendur të përcaktuar në pikën 2.4.2 të Shtojcës 7/2 të dokumenteve të tenderit, duhej që të paraqiste autorizim nga prodhuesi ose distributori i prodhuesit për pajisjet mekanike. KPP gjykon, se mungesa fizike e dokumentacionit të kërkuar shprehimisht në kriterin e kualifikimit, përbën shkak për skualifikim në kuptim të nenit 82 të Vendimit Nr. 285 datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, në të cilën përcaktohet, se Komisioni i Vlerësimit të Ofertave verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta, që përmbushin kërkesat për kualifikim,

të përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe janë të përgjegjshme/vlefshme. Është detyrim ligjor i subjektit ofertues, të provojë me dokumentacion të plotë dhe në përputhje me kërkesat e autoritetit kontraktor, plotësimin e kriterëve të kërkuara në dokumentet e tenderit, pasi ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Akoma më tej KPP sqaron, se në një procedurë prokurimi, subjekti i parë i interesuar është operatori ekonomik, i cili e përgatit ofertën e tij në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi dhe nga ana tjetër, është autoriteti kontraktor, i cili përzgjedh operatorin ekonomik që plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit.

Në mënyrë eksplicite ligji për prokurimin publik parashikon, se vlerësimi i ofertave duhet bërë vetëm në përputhje me kriteret e kualifikimit të parashikuara në dokumentet e procedurës përkatëse. Gjykoj, se është detyrim ligjor i subjektit ofertues të provojë me dokumentacion të plotë dhe në përputhje me kërkesat e autoritetit kontraktor, plotësimin e kriterëve të kërkuara në dokumentet e tenderit, pasi ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Akoma më tej, në një procedurë prokurimi, subjekti i parë i interesuar është operatori ekonomik, i cili e përgatit ofertën e tij në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi dhe nga ana tjetër, është autoriteti kontraktor, i cili përzgjedh operatorin ekonomik që plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit. Gjithashtu kërkoj të sqaroj se, bazuar edhe në nenin 82 pika 1 të ligjit 44/2015 “*Kodi i Procedurave Administrative i RSH*”, i ndryshuar, barra e provës për të vërtetuar plotësimin e kriterit të përcaktuar nga autoriteti kontraktor, bie mbi operatorin ekonomik, i cili në rastin konkret ka dështuar ta vërtetojë atë, ndaj dhe është në kushtet e mospërbushjes së kriterëve të përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit objekt - ankimi.

III.1.20. Në rast se operatori ekonomik “*Alko Impex General Construction*” SHPK do të kishte paqartësi në lidhje mbi plotësimin e kërkesës/ave së mësipërme, ka pasur në dispozicion momentin procedural të paraqitjes së kërkesës për sqarime pranë autoritetit kontraktor, deri në pesë ditë para dorëzimit të ofertave parashikuar nga neni 75 i LPP-së. Në nenin 75, pika 1 të ligjit Nr. 162/2020 “*Për Prokurimin Publik*”, parashikohet se “[...] *Ofertuesi i mundshëm mund të kërkojë sqarime për dokumentet e tenderit nga autoriteti ose enti kontraktor, i cili duhet t’i përgjigjet çdo kërkesë për sqarim të dokumenteve të tenderit, të bërë nga çdo operator ekonomik, me kusht që kërkesa të jetë marrë jo më vonë se 6 ditë para afatit përfundimtar të dorëzimit të ofertave. Autoriteti kontraktor ose enti duhet të përgjigjet brenda 3 ditëve nga depozitimi i kërkesës, në mënyrë që të bëjë të mundur dorëzimin e ofertës në kohë nga operatori ekonomik dhe, pa identifikuar burimin e kërkesës, duhet t’ua komunikojë sqarimin përkatës të gjithë operatorëve ekonomikë, që kanë tërhequr dokumentet e tenderit. Në çdo rast, sqarimi i dokumenteve të tenderit nuk do të konsiderohet shtim, pakësim ose ndryshim i kërkesave të përcaktuara nga autoriteti ose enti kontraktor në dokumentet e tenderit [...]*”, apo dhe paraqitjen e ankesës parashikuar nga neni 110/1 të LPP-së në të cilin përcaktohet se “*Në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar, në rastin e ankesave për dokumentet e tenderit, operatorët ekonomikë kanë të drejtë të ankohen brenda 10 ditëve nga publikimi i njoftimit të kontratës ose publikimi i ndryshimit të kërkesave në dokumentet e tenderit. Në procedurat e prokurimit nën kufirin e lartë monetar ky afat është 7 ditë*”. Atëherë përsa kohë që ky operatori ekonomik nuk ka shfrytëzuar asnjë nga këto dy momente proceduriale ligjore,

atëherë gjykoj, se është detyrë e tij që të përgatis ofertën në përputhje me kriteret dhe kushtet e vendosura nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit, për sa kohë që i ka pranuar ato dhe nuk i ka bërë në asnjë rast objekt-ankimimi.

Për sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik ankimues “*Alko Impex General Construction*” SHPK nuk qëndron.

III.2. Lidhur me pretendimet mbi arsyet e tjera të skualifikimit të operatorit ekonomik ankimues “*Alko Impex General Construction*” SHPK, referuar gjykimit më sipërm në pikën III.1., gjykoj, se nuk do të merren në shqyrtim për ekonomi të procedurës administrative, pasi gjendja faktike dhe juridike e këtij operatori ekonomik do të vijojë të ngelet e skualifikuar edhe pas ankimit në KPP, duke mos pasur më interes të ligjshëm në lidhje me këtë procedurë prokurimi.

Si rrjedhojë e arsyetimit të bërë më sipër, në lidhje me dispozitivin e vendimit, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “*Për Prokurimin Publik*”, nenit 34 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “*Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik*”, gjykoj:

1. Të mos pranojë ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “*Alko Impex General Construction*” SHPK për procedurën e prokurimit “*Procedurë e Hapur*”, me Nr. REF-78915-09-04-2023, me objekt: “*Rikonstruksion i Spitalit Rajonal Diber "Rrahim Xhika"*”, me fond limit 325,049,984 (*treqind e njëzet e pesë milionë e dyzetë e nëntë mijë e nëntëqind e tetëdhjetë e katër*) lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 25.10.2023, nga autoriteti kontraktor, Drejtoria e Spitalit Rajonal Diber.
2. Autoriteti kontraktor lejohet të vijojë me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
4. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Anëtar
Kreshnik Ternova